

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-32

L14

teodor
laço

ARI

TOUR

I

MESNATES

tregime

814-32

S

224

TEODOR LAÇO

AJRI I FTOHTË I MESNATËS

BIBLIOTËKA E SHITËTIT
GJIRKASTER

~~67222~~

1780

Tregime

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TREGIM LIRIK NË DIMËR

A të kujtohet ajo natë janari dhe hija e palëvizshme në dritare?

Unë u nisa herët nga qyteti. Nuk shpresoja ta gjeja udhën të çarë, sepse kishte dy net që qielli shkarkonte më nge e me një qetësi tinzare retë e mbarsura me dëborë të trashë. Por dikush kishte shkuar para meje dhe kishte lënë në bardhësi gjurmë të lodhura. Unë mendova vetëm një çast për fatin e udhëtarit të çuditshëm që kishte lënë pas gjurmët e veta si kujtime që treten e mbulohen nga koha. Pastaj s'mendova më për të. Udha për te ti po shkurohej por lodhja më pëshpëriste se sonte ti nuk më prisje, sonte ti do të flije herët dhe më kot do të të trokisja në dritare. Ti kishe të drejtë të mos më prisje, sepse në një dimër të tillë udhët e zëna mund të ndillnin pas vetëm të krisurit. Kur arritëm në fshat, ishte ende ditë dhe mua më pushtoi një dëshirë e ethshme që ti ta merrje vesh se unë kisha ardhur. U ndërrova me nxitim dhe mora skitë e vëllait. Ai i kishte lyer me dhjamë dhe ato shkisinin për drej. Ngutesha. Dola në Rrahun, nën korije. I thirra dikujt me zë të lartë dhe zëri u drodh si kabanë nëpër ajrin e ngrirë. Më dukej se mbrëmja e gjatë po nxitohet të zbriste nga pylli dhe atëhere ti s'do të më shquaje dot në mes të djemve të tjerë që rrëshqisnin me ski. Po prapë kisha një shpresë. Ti e dije se unë rrëshqisja mos më keq, s'merrja mirë asnjë kthesë dhe te kokojka që ishte si tram-

plin i vogël rrëzohesha përherë. Kështu ndofta ti do ta kuptoje se kisha ardhur dhe do të më prisje.

Pastaj erdhi errësira e bardhë. Tisi i hirtë i pyllit u zhvendos dhe u shtri qetësisht mbi rrëpirat e zhveshura nga drurët. Mua më ishte dukur se vetëm në dimër rrëpirat ishin të lumtura sepse dëbora i bënte të bukura njësoj si pyllin, kurse në pranverë shuriga e tyre avullonte me përtesë dhe dukej si e mbuluar me lesh të hirtë dhije, nderur në diell.

Pastaj erdhi nata.

Nëpër ajrin e trashur nga mjegulla binin duke dremitur flokë të rrallë dëbore. Ata ishin pothuaj të padukshme, si flutura të bardha të natës, që dridheshin nga të ftohtët aty lart, në pafundësinë e murrme të qiellit dhe prandaj merrnin udhën tatëpjetë e binin të flinin në shtratin e vjetër e të bardhë. Ishte ora kur fshati dhe macet dremisnin. Gërhisnin anës zjarreve. Dikur zgjoheshin dhe pyesnin: «Mos ka mbetur ora?»

Unë erdha te ti. E dija se gjyshja jote kishte fjetur në dhomën e saj të vogël, mbledhur kutullaç nën levenxat. Ajo nuk e duronte dot ajrin e rëndë të sobës dhe flinte në ashef, pranë vatrës.

Hapa lesën e kopshtit. Këmbët më fundosën në dëborë. Dëbora kërciste krap.. krap... sikur përtypnin krënd dhitë. Degët e kumbullave të egra ishin varur përdhe. Në dritare digjej llamba. Ajo hidhte jashtë një katror drite. Unë trokita. Ditën, ashtu të trokisnin harabelat. Ti u hidhje thërrime buke në dritare, zogjtë e shkretë e dinin këtë dhe vinin të trokisnin.

Në dhomë u ndie fëshfëritja jote e shpejtë. Flaka e fitilit u ngrit dhe dora jote lëvizi kortinat e bardha të dritares. Për një çast vezulluan sytë e tu të hirtë, të trembur s'di se pse. Dhe diçka u drodh e rrezëlliu brenda tyre. Ishte një dritë e ethshme, ku ishin trazuar si në një vorbull lumi ujërat e shqetësimeve, pritjeve, anktheve, dashurisë e frikës. Brenda në dhomë ishte era jote. Ajo e kishte mbushur dhomën plot. Era e veçantë dhe e mirë e asaj që duam, era që e ndjejmë në shtrat kur ngrihemi

në mëngjez, era që i mbyt gjithë erërat e tjera. Erë ftoi dhe mollësh.

Unë isha i ftohtë nga nata. Dëborë e flokëve të mi ra dhe u shkri në gjoksin tënd të valë. Ti mbështete faqen në gjoksin tim, aty ku ishin harruar flokëzat e dëborës. Flokët e tu të dredhur e të butë u ngatërruan me to. Unë të putha. Ty t'u muar fryma dhe sytë të rrëshqitën tek unë me një vështrim që pyeste. Dorë jote më shtroi flokët e lagur. Diçka e ftohtë më rrodhi nëpër shpinë. Unë qesha.

— Nuk më prisje?

— Të prisja.

— E dije që do të vija?

— Jo.

— Po pse më prisje?

— Sepse unë të pres gjithmonë. Çdo të shtunë të pres.

Ti fillove të më fshije flokët e lagur.

— Pse je lagur kështu?

— Rrëshqisja me ski. Nuk më pe?

— Të pashë. A s'ishe ti që rrëzoheshe?

— Unë isha!

Pastaj, për një kohë të gjatë ne heshtëm. Dhoma u mbush edhe më me aromën tënde prej ftoi. Ora e vjetër ndiqte me mërzitjen e vet monotone përshpëritjet tona të çuditshme e pa kuptim. Mbi sobë këndonte avulli nëpër grykën e gjymit prej alumini. sikur piqej ndonjë kërmill.

— Mos! Më lërë të heq gjymin, se po avullon gjithë uji dhe do të thahet — the ti.

— Jo! Le të thahet!..

— Pse?

— Sepse... më kishte marrë malli!

Pastaj ne përsëri heshtëm. Ti hape një fletorc. Ishte hartimi i një nxënësi. Mua më kishte mposhtur një kapitje e ëmbël dhe dehëse. Ti ule ngadalë fitilin e llambës dhe muret u murmën.

— Si i shkruajnë hartimet ata nxënësit e tu?

— Mirë i shkruajnë. Vetëm se kudo fusin pyllin, zogj-të dhe dëborën!

Mua m'u kujtua se edhe në hartimet tona hynte përherë pylli dhe dimri...

— E di? Është një nxënës në klasën e shtatë. Kishte një gazetë ku ishte botuar ai tregimi yt. «Ky që ka shkruar këtu, ka mbaruar shtatëvjeçaren tonë. Me të parët fare, që më 1950. A e dije, mësuese?» — më tha. Jo, nuk e dija, i thashë. «E pra, është nga tanët ky!» — tha ai. Unë e ndjeja se isha skuqur flakë. Ti e di. Unë skuqem dendur.

— Kur dëgjon emrin tim?

— Ndofta.

— E dinë ata që ne dashurohemi?

— Jo, jo! Ç'thua ashtu?

— Ndofta pëshpërisin?

— S'e di S'besoj. Jo. Pusho më mirë! Sepse pastaj do të ishte keq!

— Pse?

— Sepse... ky është fshat pra!..

Fitili i llambës ulej vetëvetiu. Në dhomë hynte gjysm-errësira e dëborës.

— Do të të sjell mollë dhe arra. Mirë?

— Mirë!

Unë e shova llambën. Në dhomë u derdh një dritë tjetër, fantastike. Ajo dilte nëpër kuadratin e vogël të derëzës së sobës. Refleksat e prushit i ngjyen muret me të kuq. Flakët fërfëllonin dhe më dukej sikur ato murmuronin mijëra fjalë misterioze të kuqe, të ngjajshme me njëra-tjetrën dhe të nxituara. Ato hynin e përkuleshin diku brenda qenjes sonë. Pastaj nëpër dritare hyri një gjë-mim i mbytur, i thellë si zë shpelle. Gjëmimi lëvizi sikur zhvendosej diku masa e paformë e natës. Kjo ishte frymëmarrja e rëndë e mushkërive të dheut dhe ky zë ishte edhe më i fshehtë e i pakuptueshëm se murmuritja e flakëve.

— Ç'gjëmon ashtu? — të pyeta unë.

— Gjëmon korija.

— Pse?

— Kështu gjëmon saherë zë e fryn juga. Pastaj bëhet butësi dhe nisin e shkrijnë qerpikët e akullit.

— Kur?

— Ndofta, nesër. Netët do të bëhen të buta e të kthjellëta. Do të dalin yje të dendura, si në gusht.

— Digjen yjet tani?

— Jo.

— Pse?

— Kushedi? Ndofta sepse është ftohtë dhe mërthihin...

Papritur jashtë rrëshqiti një dritë e verdhë dhe reflekset e flakëve u zbenë. Ishte hëna që kishte hapur shtigje midis mugëtirës së reve.

Dhe prapë papritur unë ndjeva shtrëngimin e fortë të dorës sate mbi buzët e mia. Ndjeva dridhjet e trupit tënd që më mbuluan sikur donin të më fshihnin nga ajo dritë. Ti tregove diçka në dritaren e vogël të jugut.

Në dritare ishte shfaqur një hije e palëvizshme.

Dritarja ishte e ngushtë. Ajo shihte në kopësht, aty ku kishin mbetur gjurmët e mia. Dridhjet e tua m'u ngjitën edhe mua dhe ne mbetëm si të ngrirë. Hija ishte një kokë. Një kokë me një formë pak të çrregullt, e stërgjatur si pjepër, po sigurisht ishte hija e një koke. E ç'rëndësi ka nëse ishte e rrumbullakët apo e stërgjatur? Hijet bëjnë shumë lojra të tilla. Mjaftonte që ajo njollë ishte një kokë.

Unë e hoqa me zor dorën tënde të butë nga buzët. Ora nxitonte. Ç'nxitonin ashtu ato trokitje? Trokitjet e mbushën gjithë dhomën e vogël. Hynë në shtrat. Gjëmonin. Gjëmimi i korijes pushoi. Hijet e kuqe të flakëve ngrinë në mur. Gjymimi nisi të ziente dhe avulli lëshoi një fërshëllimë si fishë alarmi.

Hija e kokës s'lëvizte fare. Tre qerpikë akulli varreshin mbi të. Dy qerpikë i binin mbi supet e padukshme. Qerpiku i mesit përgjysmohej nga hija. Më dukej sikur qerpiku ishte ngulur brenda në kokë. Po s'mund të ishte ashtu. Unë isha i sigurtë se hija e panjohur e kishte thyer qerpikun në mes, sepse ai e pengonte. Ai ka ndjerë atë çast ujin e ftohtë në duar. Pastaj duart i ka fshirë pas pantallonave. Deri nesër, qerpiku do të rrjedhë e do të formojë një majë tjetër.

Unë përfytyrova se si kishte ardhur ai, i huaji, pas gjurmëve të mia. Vjedhurazi. Kishte shkëlur mbi gjurmët

e mia. Kishte fundosur në dëborën e trashë. Pastaj ishte vendosur anës murit, nën strehët dhe përgjonte. Kur kishte ardhur ai, hëna ende s'kishte dalë, prandaj të gjitha hijet kishin qenë të padukshme. Kurse tani jashtë ngatërroheshin me njëra-tjetrën shumë hije. Hija e tij. E qerpikëve të akullit. E degëve të thata të kumbullave të egra.

Ai kishte zgjatur qafën drejt nesh. Kishte thyer qerpikun dhe kishte vënë veshin e vet të ftohtë mbi xhamin e dritares. Kishte përgjuar fjalët dhe puthjet tona. Unë isha i sigurtë se ai i kishte shqyer sytë duke kërkuar një hapësirë të vogël xhami të pazënë nga kortinat dhe ishte nxehur shumë kur s'kishte gjetur asnjë.

Drita e zbetë e hënës mori më të shuar dhe hija u mjegullua. Tashmë ajo dukej edhe më pa formë dhe e shkrrirë me hijet e tjera.

Ngadalë ne e gjetëm përsëri zotësinë e pëshpëritjeve që e kishim humbur më parë në zgavrën e dridhjeve e të hamendjeve.

— Kush mund të jetë? — pëshpërita unë.

— S'e di!

— Ç'kërkon ai?

— Përgjon! — the ti. Zëri të kishte humbur. Gjithshka të dridhej. — Përgjon — the ti — dhe nesër të gjithë do ta marrin vesh se mësueja Ev...

— Pusho! Ti ke frikë prej kësaj?

— Kam.

— Pse?

— Sepse... ky është fshat! Po ndofta jo vetëm nga kjo! Edhe sikur të ishte qytet, njëlloj do të ishte!

Tani hija u zmadhua çuditërisht, po prapë vazhdoi të mbetej e palëvizshme. Duhej të mërdhihte shumë i pajohuri aty në dritare.

— E sheh? Ai s'ka lëvizur fare!

— Kushedi sa mërdhah!

— Ai nuk mërdhah. Atë e kanë zënë ethet e vala të kureshtjes.

— Po kush do të jetë vallë? Mos është ai kushëriri im Xo..?

— Pse të jetë ai?

— Ai më ka thënë njëherë: «Pse skuqesh ti saherë takon atë?»

Unë vendosa se sigurisht ishte kushëriri Xo... «Paske genë qen, bir qeni, o kushëriri Xo... I poshtër sa më s'bëhet! Dhe je i ri, pa le! Paske ardhur pas gjurmëve të mia! Mirë! Tani do të kemi punë bashkë! Ta tregoj unë se si përgjohet!»

Shtrati krisi. Ti nxore një thirrje alarmi.

— Mos!.. — the ti. — Më mirë të rrimë kështu! Ai do të thahet së ftohti dhe do të shkojë!

— Ai nuk mërdhah pra!

— Po atëhere?

— Unë do të dal! — pëshpërita.

Në faqet e tua të nxehta s'di sepse rrodhi një lëng i ftohtë. Pastaj më puthe gjatë, gjatë. Unë mezi merrja frymë.

— Do të dalim bashkë! — the ti.

Unë u mundova ta çilja derën ngadalë, por ajo krisi shumë. «Ai ka dëgjuar», mendova. «Tani do të vrapojë nëpër dëborë. Por, nuk do të ikë dot larg, sepse në vrap e sipër s'do t'i gjejë dot gjurmët. Do të zhytet thellë në dëborë dhe unë do ta arrij!»

Unë vrapova nëpër oborr. Asgjë s'pipëtinte. Heshtja ishte pus. Hëna ishte kredhur. Gjurmët e mia të vjetra në kopësht ishin mbuluar. S'kishte asnjë gjurmë tjetër. Degët e kumbullës ishin rënduar dhe ishin varur deri në dritaren e vogël të jugut. Dëborë e lagët ishte ngjeshur nëpër majat e degëve, i kishte trashur dhe ato ngjanin si helmëta. Unë i rashë me një stap degës që varej në dritare. Ajo u shkund, kërciti, u ngrit lart dhe shkundi tjetër dëborë nga degët. Ti u mbështete në krahun tim dhe zure të qeshje.

— Ç'ndodhi ashtu me ne? — the ti.

— Nuk e di... — thashë unë. — Ndofta ishin varur frika e drojtja jonë në dritare!..

— Dëgjon? — the ti. — Po gjëmon prapë korija. Gjëmon për jugë. Nesër do të shkrijnë qerpikët e akullit!..

Të kujtohet ajo natë janari dhe hija e palëvizshme në dritare?

KATËR TË PANJOHUR

U shuan edhe dy lëmshet e zbëta të dritës që binin mbi truall nëpër mazgallat. Jashtë, në atë botën tjetër, diku po fundosej, brenda mugut të horizonteve dielli i vakët i mbrëmjes.

Trualli ishte i njomë. Trarët kishin zënë kërpudha dhe mbante erë noti. Asafit ja shponte hundën athtësia e kalbëzimit. Kjo erë ishte kudo dhe ajri i paktë ishte ngopur me të. Secili kishte zënë një qoshe, ishte strukur dhe priste të ndodhte diçka e papërcaktuar që po vonohej të ndodhte. Kjo ishte një pritje tërë ankth që të bënte ta humbisje ndjenjën e kohës dhe, sikur të mos ishin ato dy njolla të zbëta drite që u murrmen dhe u zhdukën ngadalë në dheun e lagët, ata nuk do ta kuptonin kurrë kohën kur ndërrohej kufiri i ditës me natën. Qilari ishte një zgavër e zezë. Ata nuk flisnin. Asafi e dinte tashmë se secili përgjonte frymëmarrjen e shokut dhe me sytë të kërcyer jashtë zgavrave mendohej të dallonte diçka. Ai njohu vetëm njërin. Ai i kishte thënë se quhej Lame dhe se e kishin marrë kot së koti. Në hatullat e shtëpisë së tij kishin gjetur bomba të mbetura që nga Lufta italo-greke. Lamja i ishte dukur njeri i ngrysur. Fytyra i kishin marrë bojën e dheut, sikur e parandjente vdekjen, por Asafi vuri re se ai fliste me përbuzje. «Lames mund t'i besohet», kishte thënë me vete ai.

Dy të tjerët s'i kishte parë në fytyrë. Ata i zbritën

kur ishte errur dhe ai nga zërat e mori me mend se njëri ishte djalë i ri, kurse tjetri i moshuar.

Nëpër dyshemenë e dhomës mbi qilar vente e vinte dikush dhe hapat e tij kërcisnin e kumbonin sikur dërmonisej misër. Asafit i bëhej sikur i bariste njeri me këpucë me gozhdë përmbi shpinë dhe nga ky fikësim ju duk se i dhembnin brinjët.

Kishte gjysmë ore që ata s'kishin shkëmbyer asnjë fjalë me njëri-tjetrin. Errësira rëndonte dhe qetësia e thellë, e panjohura, me të cilën ishte mbushur çdo zgavër e vendit dhe çdo çast i kohës, u kishte hyrë në shpirt si një kob që rritej e shtrihej sa më shumë depërtonte nata nga mazgallat.

Jashtë, përmbi heshtjen e trembur të territ dhe mbi cfilmat e gjatë të bulkthve lundronte një hënë e ngrënë që grisej nëpër fletë dhe që lyente me dritë të gjelbër plloçat e oborrit. Plloçat dukeshin nga dritarja. Kjo s'ishte as dritare, po një vrimë sa për një mace dhe atë e kishin zënë hithra të njomë. Nëpër gjethet e tyre me dhëmbëza përthyhej po ajo dritë e gjelbër dhe Asafi kishte zgjatur fytyrën drejt saj. Njëri, ai që rrinte në qoshen afër shkallëve, zuri të bridhte nëpër qilar. Lamja shkoi e ul në shkallaren e fundit. Ua kishte ngulur sytë të çarave të qepenit, nëpër të cilat rrëshqiste një dritë e venitur, si pluhur i verdhë. Në dhomën mbi krye, dikush kishte ndezur një fener dhe ecja monotone mbi dhogat s'dëgjohej më. Ai që zbriti i fundit murmuriste nëpër hundë dhe bridhte poshtë e lart. I katërti s'bëhej fare i gjallë. Ishte ulur shesh nën shkallët. Dikur atë e zuri një kollë e gjatë dhe e lodhur, sikur i shkulte gurmazin. «Kollë plakul!» — mendoi Asafi.

Kush do ta thyente i pari këtë heshtje që vërtitej si një vajtim midis katër njerëzve të panjohur? Asafi për vete e dinte se s'duhej të fliste asgjë. Ç'mund të ishin ata? Çdo gjë mund të ishin! Ai kishte heshtur gjatë po tani nuk duronte më. Ai kishte katër ditë që mbyllej vetëm me natën, kurse sonte e kishin mbyllur me këta të tre. Duhej të bënte diçka. Të thoshte diçka. Po të ishte me Lamen, do të ishte ndryshe puna. Po ja, kishin sjellë edhe

dy të tjerët. I kishin sjellë në errësirë. Ndryshe mund të ishte sikur mos t'i kishin sjellë në errësirë. «Makar të kishte një fije dritë. Të shihja se ç'fytyra kanë. Ja, aq gjë!» — mendoj Asafi.

Ai duhej të thoshte diçka. Aq sa të grisej heshtja. Pastaj do të thoshin diçka edhe ata dhe ai do të mundohej ta merrte vesh se cilët ishin. Përse i kishin sjellë dhe i kishin mbyllur këtu. Ndofta njëri ishte vënë prej tyre për të përgjuar! Spiun i ndyrë! Mund të ishte! Ndofta jo! Cilin do të përgjonte? Atë e kishin kapur fare rastësisht dhe asnjeri nuk e dinte që ishte korrier. E kishin marrë për fshatar që u ndodh rastësisht në zonën e luftës.

Shkallët kërcitën mbytur. Ishte Lamja që ngjitej. Koka i arriti te qepeni i qilarit dhe e çara e dyshemesë u zu prej flokëve të tij. Qepeni krisi ngadalë. Ishte një krismë e lehtë si brejtje miu. Pastaj brejtja pushoi dhe u dëgjua gulçimi i lodhur i Lames, si prej druvari.

— Është i hapur! — tha ai.

Ai që ecte, i pushoi varavingat. Plaku nën shkallë u ngrit.

— Kush? — tha plaku.

— Qepeni i qilarit!

— Hesht! Mbylle! — tha Asafi.

— S'dua!

— Mbylle, se mbi kokë janë ata!.. Nuk janë pa veshë!

— Asgjë s'dëgjohe!

— Le të mos dëgjohe! Ata janë në dhomë dhe na ruajnë!

Plaku u kollit dhe pështyu gëlbazë. Asafi e kuptoi që kjo ishte një kollë e shtirur, që mos të dëgjohehin fjalët.

— S'plaska! Unë do të shoh njëherë se ç'bëhet në atë dhomë! — ta Lamja.

— Jo — tha Asafi.

— Vdekur se vdekur! — tha Lamja dhe mbështeti pëllëmbën në qepen. Drita i përshkonte nëpër mollëzat e gishtave dhe i dukeshin koskat si të kufomave.

— Porsa të nxjerrësh kryet, ai do të të grijë me automatik. Do të të grijë ty dhe ne bashkë! — tha Asafi.

Lamja mbeti në mëdyshje, por dorën e hoqi.

— Ty t'u dhimska shpirti shumë! — tha plaku me inat dhe u ul në shkallare.

— Edhe ty të dhimset! — tha Asafi.

— Unë e kullota livadhin tim...

— E kullote, po prapë të dhimset! — tha Asafi.

Plaku s'foli. Lamja zbriti shkallëve dhe u ul një shkallare më lart se plaku. I katërti, ai që s'dihej se ç'ishte, s'bëhej i gjallë. Ai ishte fshehur brenda hararit pa formë të errësirës së qoshes dhe qenjen e tij diku e dëshmonte vetëm turfullimi i nxituar i ajrit nëpër hundët e zëna nga ftoma e qilarit.

— Më dhimset, ta marrë djalli — tha papritur plaku. — S'ka filluar akoma vapa dhe ditët janë shumë të bukura! Të vjen keq të shkosh begarja në ditë të tilla!

— Ku e di ti që do të shkojmë ashtu? — tha Lamja.

— Ç'të mirë pret, kur bie në kthetrat e egërsirës, ë?

— Mua më kanë marrë kot! Për ca bomba të mbetura nga Lufta italo-greke!

— Mundet! — tha plaku. — Edhe mua nga pylli më morën! S'di se pse! S'thonë më kot që shkon i njomi me të thatin!

— Ç'do të na bëjnë? — tha zëri i të panjohurit. Zëri i tij i ngjiste një klithme të trembur.

«Ky ka frikë», mendoj Asafi.

Ai e ndjeu frymën e nxehtë, të të katërtit mu në qafë, si një afsh i ngrohtë e i dridhshëm. U kthye nga i panjohuri dhe ndjeu qenjen e tij fare afër, si një gjë pa formë që mezi ngopej me frymë.

— Ku je ti? Pse nuk afrohesh këtu? — tha plaku.

Ai nuk u përgjegj.

— Të pihet duhan? — tha plaku.

— Unë s'pi! — tha ai. Zëri tani ishte si një fëmijë.

— Pse të kanë marrë ty? — tha plaku.

— Nuk e di. Unë kullojsja viçat. Ata dolën nga pylli dhe më morën me vete.

— Ku ishe bari? — tha plaku.

— Në Shkumbas!

— I kujt je ti?

— I Dano Shukos! Tanush më thonë!

— E njoh babanë tënd — tha plaku. — Eja këtu, djalë! Unë jam Kalo Malushi nga Arrësi. Mbase e ke dëgjuar...

Asafi psherëtiu.

Ata u mblodhën të katër kokë më kokë nën shkallën e drunjtë. U dëgjua prapë ecejaka e gjermanit mbi krye. Hapat gjëmonin dhe ishin të ngadalshëm.

— Sa vjeç je ti? — pyeti Asafi.

— Gjastëmbëdhjetë — tha djali.

— Tamam për pushkë qenke. Di të shtiesh?

— Di!

— Po ty, plak, përse të morën që nga pylli? — tha Lamja.

— Për sytë e bukur! — tha Kalua. — Ja, ashtu! Më përmbloodhi vala edhe mua!

— Të gjithë kot më kot na kanë marrë! — tha Lamja.

— Kur nuk gjejnë dot ata që duan, shfryjnë mbi popullin — tha Kalua. — Të gjithë kështu kanë bërë!

— Ata po bëjnë një operacion tjetër — tha Asafi. — Si ai i dimrit dhe më i egër!

— Kafsha bëhet më e egër ku e ndjen ngordhjen — tha Kalua. — Bëhet e verbër dhe ç'gjen përpara e përmbledh, si stuhia.

— Ndofta na pandehin partizanë? — tha djaloshi.

— Mbase! — tha plaku.

— Mbase pandehin se jemi partizanë të shpartalluar e të mbetur pyjeve pa lidhje — tha djaloshi.

— Nuk shpartalohen ashtu partizanët, djalo! — tha Kalua.

— Ata nuk ua gjejnë dot gjurmët partizanëve, prandaj ua kanë edhe më frikën! — tha Asafi!

— Mos je partizan ti? — pyeti djaloshi.

— Jo, s'jam. Edhe unë jam ashtu si ju. Më gjetën rrugës dhe më morën.

— Po ku veje?

— Në qytet!

Ra qetësia. Fjalët s'kishin më asnjë kuptim. Hapat mbi krye reshtën dhe qetësia i ngjante një përgjimi të

gjatë që ishte ndehur në të gjitha skutat. Fijet e dritës, si cerga të grisura të verdha, që hynin nëpër të çarat, u zbehën dhe menjëherë pastaj u zunë nga hijet.

— Tani, ai po na përgjon! — tha Lamja.

Asafi u mbështet pas gurëve të murit. Në shpinë ndjente lagështinë e lëmashkut dhe kjo i pëlqeu sepse ai kishte një zjarmi të pakuptueshme. «Dikush nga ne duhet të shpëtojë — mendoi ai. — Dikush duhet ta shpjerë këtë lajm... Unë, jo, sigurisht. Mua më mbajnë të lidhur. Mbase ky djaloshi bari ose Lamja. Ku dihet? Sidoqoftë... vetëm më në fund, vetëm atëhere... unë kam të drejtë t'ua them këtë lajm...»

— Aty në qoshe është një kurorë me qepë! — tha Lamja.

— Janë të kalbura. Janë kalbur që në pranverë — tha plaku Kalo.

— Po mbase ka mbetur ndonjë e pakalbur, ë? — tha djaloshi.

— Ke uri?

— Kam!

— Mirë, mirë! Edhe ne kemi!

— Sa ditë ke ti? — pyeti plaku Kalo.

— Pesë ditë — tha Asafi. — Më bredhin fshat më fshat duarlidhur!

— Mua nuk m'i kanë lidhur! Pse vallë? — tha Lamja.

— Nuk e di! Mbase mua më padehin korrier a partizan të veshur teptil si fshatar!

— Pse na bredhin kështu? — tha Lamja.

— Trembin popullin me ne! — tha Asafi.

— Po të kishin për të na vrrarë, do të na vrisnin që në vend! — tha Lamja.

— S'dihet! — tha plaku Kalo.

— Çfarë s'dihet?

— Dimë vetëm atë që shkon! Dimë edhe që egërsira e ha gjahun e saj larg strofkës! — tha plaku Kalo, në mënyrë të pakuptueshme.

— Po shpresat nuk i humbim, apo jo? — bëri të qeshte Asafi. — Ku mund ta dish ç'sjell e nesërmja?

Tani ata ishin aq pranë njëri-tjetrit, sa ndjenin se si

u përziheshin frymët dhe erërat e veçanta e të panjohura të secilit. Ato ishin si erërat e ngrohta të fillimit të pranverës, si fryma që lëshon dhe dhe kur avullon lagështinë, si erërat e luleve të brishta e të posaçelura të kumbullës.

Asafi mbështeti dorën mbi supin e Tanushit dhe ndjeu në pëllëmbë koskën e mprehtë të shpatullës. Dridhërima e tij e lehtë, pothuaj e pandjeshme, e përshtoi edhe atë si mornicë. Ai e dinte se ajo që dridhej në supet e djaloshit ishte frika. Frika për të nesërmen, që po afrohej tani prej së largu nëpër gulshet e dendura të errësirës. E nesërmja do të hynte me një rreze drite të përthyer nëpër hithrat para mazgallave dhe kjo do të ishte e para rreze e pangarkuar me gëzimin dhe ngazëllimin e dritës për atë djalosh. Ai do të mendojë kullotat e blerta të maleve ku drita zbret e rrokulliset nga majat si tufa delesh me lesh të zverdhur nga dimri dhe ky zbardhëllim i grisur e lypsar do t'i duket atij si fundi i botës. — Mos ki frikë, se s'dihet! — pëshpëriti Asafi.

— S'dihet, jo! — tha Kalua.

— Sikur të kishim makar një bukë misri! — pshe-rëtiu Lamja.

— Më ju dhj... profetin e tyre — shau plaku Kalo. — Ç'patën që m'i morën eshkën e masatin dhe më lanë vetëm duhanin, o qenat?!

— Ta kanë frikën se mos u vesh zjarrin! — tha Lamja i ngrysur.

— Po ty çfarë të morën? — pyeti Asafi.

— Asgjë! — tha Lamja — Morrat më morën! Po ti ç'ke që pyet përherë dhe për vete s'e hap gojën, ë? Apo do të blesh mendje?

— Mirë mirë! Mos u mërzit! —tha Asafi. — Të gjithëve na ka ardhur majë hunde! Puna është që njeri nga ne duhet të shpëtojë!

— Pse të mos shpëtojmë të gjithë? — pyeti Lamja.

— Ashtu është më mirë. Po të paktën njëri duhet të shpëtojë!

— E pse?

— Nuk është tani koha për të ta thënë këtë! — tha

Asafi. — Po ja, fundja edhe vetëm për t'u treguar partizanëve gjithë sa kemi parë me sy këto ditë!

— Zor! — tha plaku Kalo. — Puna jonë u pa!

— Nuk është parë jo — nguli këmbë Asafi. — Mos e ndill ashtu të keqen, or Kalo!

— Po ç'ke ndër mend xhanëm?

— Tani për tani asgjë. Po ku i dihet? Udhët janë të gjata! Mund të na dalë një rast dhe arratisemi!

— Kujt, këtyre?

— Udhët janë të gjata! — tha përsëri Asafi. — S'u dihet fundi!

— Udhët tuaja, vërtet! Ajo imja është në fund! Ti mundohu të arratisesh! E dimë, e dimë! Mos thuaj asgjë! E dimë që ti je ca si ndryshe nga ne, po edhe ne të kësaj lufte jemi, biro! Hape zembrën, biro!

— Unë s'kam se si! — tha Asafi. — Mua më bredhin lidhur!..

—
—

Djaloshi që quhej Tanush flinte. Ai ishte i vetmi që e zuri gjumi. Plaku Kalo ja kishte marrë kokën në duar dhe e kishte mbështetur mbi këllqet e veta. Këmbët i ishin mpirë dhe i lëshonin miza por nuk lëvizte që të mos e zgjonte.

Dikur, u gdhi! Një tufë drite hyri si e trembur nëpër mazgallë dhe brodhi nëpër truallin e ngjeshur. Asafi e tundi lehtë Tanushin dhe ai murmuriti nëpër gjumë. U zgjua dhe nuk pyeti asgjë.

Një dorë që s'dukej e ngriti me rrëmbim qepenin dhe nëpër shkallë vërshoi drita e mëngjezit. Lames ju vranë sytë. Një gjerman i gjatë, me helmetë, rrinte stapitur. Lameja i shihte vetëm majat e ngrëna të çizmeve. Gjermani bërtiti diçka që u dëgjua si krismë çifteje.

— Ngjitu! — tha Asafi që nga fundi i shkallëve. Gjermani

mani bërtiti prapë dhe plakut Kalo ju dëgjua si maliherr me veshë.

Në oborr kishte shumë gjermanë. Një fshatar me shallvare të kojtura në gjunjë, me vështrim të përvuajtur, që ishte udhërrëfyes, u mundua t'i fshihte sytë e vet prej tyre dhe ktheu shpinën. Ata u ulën mbi ploçat, nën strehët e një plevice. Po ai gjermani që i kishte nxjerrë nga qilari, rrinte përkarshi, me bërryle mbështetur në armën e vogël automatike që e kishte varur në gjoks. Ai ishte i ri dhe i shihte me bishtin e syrit, sikur shihte ca kafshë të rralla. Mbllaçiste galetë dhe dukej i shkujdesur.

— Sikur s'po na e varin shumë torbën! — tha Lamja.

— Mbase na lirojnë, ë? — tha Tanushi.

Plaku Kalo u ngrit, ktheu fytyrën nga muri dhe bëri shurrën. Gjermani ja dha të qeshurit dhe u bëri shenjë edhe të tjerëve. Plaku Kalo shtrëngoi brezin që e kishte lëshuar dhe tha:

— Ç'më çani kokën, bufër! Sikur s'keni parë kurrë hallate burri!

Ai u bëri gjermanëve edhe një shenjë tjetër kuptim-plote dhe u çapit nëpër ploçat e oborrit e doli në kopësht. U kthye me brezin zvarrë. U ul.

— Shkojnë drejt Kutajt! — tha nëpër dhëmbë. Asafi hetoi rreth e rrotull. Sot, kush e di se ku kishin humbur edhe ata ballistët e derri! Gjermanit i shndrisnin nën helmëtë sytë e kaltër.

— Kupton gjë ai se ç'themi ne? — tha Tanushi.

— Na plasi bytha! — tha Lamja. — Folë, se kemi mbetur si të shurdhër!

— Pashë një karvan me mushka. Kanë ngarkuar mortajat dhe municion. Kapërcyen lumin dhe morën të për-pjetën e Kutajt. Edhe ne nëpër atë udhë do të na zvarrisin ndofta. Deri në Qarri është bokërrimë dhe të ha plumbi anëmbanë, po më tej është një pyll lirishtë. Aty...

Gjermani bëri një shenjë padurimi dhe bërtiti.

— Pusho! — tha Asafi nëpër dhëmbë.

U afruan edhe dy gjermanë të tjerë. Njëri i bëri një nojmë Asafit dhe ai u ngrit me përtesë. Gjermani u zgërdhi dhe nxori një palë hekura. Lames i kërcyen sytë si

poška. Tanushi u drodh. Asafi zgjati duart. Gjermanët bënë shenjë që të niseshin.

Ishte një karvan i gjatë që përdridhej e lakohej si një bisht i stërmadh nëpër pluhurin e udhës. Dielli shtrembërohej e shëmtohej nëpër përroin e helmetave. Vetëm qeleshja e plakut Kalo zbardhte si një copë dëborë mbetur nën hijet brinjëve të malit.

Një tufë kurila fluturonte si e mpirë në thellësinë e qiellit. Tanushi vuri dorën si strehë mbi vetulla. «Sa kurila janë vallë?» — mendoi dhe u mundua t'i numronte. Një herë i dilnin gjashtëmbëdhjetë, një herë shtatëmbëdhjetë. «Po të jenë shtatëmbëdhjetë, gjermanët nuk do të na vrasin. Ose do të ndodhë diçka. Ç'mund të ndodhë? Mund të sulmojnë partizanët nga pyjet. Oho!.. Si do të kërcasë! Dhe atëhere, ne do të zhdukemi nëpër përrunj e nëpër gremina. Tatëpjetë nuk të ha plumbi aq shumë. Po ku të futesh? Bre... ç'vend i zhveshur qenka ky! Sa kurila janë vallë?»

Ecnin njëri pas tjetrit. I fundit ishte Asafi. Pas shpinës së tij ecte një gjerman i gjatë që këndonte. Tanushi nuk ishte i sigurtë nëse kjo ishte këngë apo gjermani bisedonte me dikë. Duhej të ishte këngë sepse atij nuk i përgjigjej askush, por ajo këngë nuk ngjasonte me asnjë prej atyre që dinte ai. Ajo ishte një lloj kënge e zvarrë dhe atij i dëgjohej si një tra... ra... ra... pambarim, ashtu si trokashka e mullirit. Ju duk çudi që edhe gjermani mund të këndonte. «Këndo, o derr, se këtu është vend i zhveshur dhe s'ke frikë, po më tej të të shohim!» — mendoi ai.

— Xha Kalo! Sa kurila janë në atë varg? — tha ai.

— Nuk i shquajnë sytë e mi, biro — tha Kalua.

Ai deshi ta pyeste Asafin se sa kurila ishin në atë varg, por gjermani që ecte në krah të tij i dha një të shtyrë në zverk dhe ai s'e pyeti dot.

Kapërcyen lumin. Ura e vjetër prej guri bubullonte sikur po thërrmoheshin me radhë të gjithë gurët e lashtë, që kishin aty qindra vjet. Lumi gjëmonte shurdhër. Ujërat ishin si të ndryshkura. Lëpinin zallin dhe linin mbi të jargët e kuqe të llumit që kishin gërryer nëpër brinjët e zhveshura të maleve. Kalua e kishte quajtur përherë

të prapë këtë lumë. Poterja e ujërave të tij dëgjohej deri thellë, si një shungullimë ortiqesh që s'e di nga vjen dhe ku shkon. Por sot poterja e tij ishte shurdhuar, shungullima vinte e mbytur dhe ai dëgjonte vetëm krakitjen e gozhdëve të gjermanëve nëpër gurë. I dukej sikur një kafshë e panjohur me një nofull të madhe e me dhëmbë prej metali të ndryshkur kafshonte e thyente papushim gurë. Gjithë mali ishte mbushur me këtë zhurmë që sa vinte e rritej dhe bëhej si krismë rrufesh. Po kjo ishte një rrufe pambarim që e çante qetësinë e vjetër të shtigjeve dhe të honeve të malit si me thikë.

Kolona mori një të përpjetë të ngushtë nëpër shpatin e malit. Shpati ishte gjithë shkurre dëllinje dhe trungete drurësh.

Tanushi kundroi edhe një herë qiellin e thellë. Tufa e kurilave kishte humbur si një pikë e vogël andej thellë. Andej duhej të binte fshati i tij. «Tani kurilat po fluturojnë mbi të dhe shokët e mi po i numrojnë!» — mendoi.

Kalos i rridhte një çurkë djersë nëpër qafë. Shpina e Lames i lëkundej përpara syve. Gjermanët kishin përveshur mëngët dhe shfrynin. Zhegu lëkundej. Duhej të ishte vapë e tmerrshme po Tanushi s'ndjente asgjë. Edhe Asafi, që vinte pas tij, siç dukej nuk e ndjente këtë vapë, sepse ai nuk e kishte hequr kasketën dhe nuk kishte zbërthyer asnjë kopsë. Po atij i ra ndër mend që Asafi s'mund të mbrohej fare nga vapa sepse i kishte duart të lidhura mbrapa. Ai ktheu kryet dhe i buzëqeshi. Asafi i shkeli syrin. Ai kishte sy të mëdhenj bojë ullirri dhe mjekra i nxinte korb. Ai diçka pëshpëriti po Tanushi s'mori vesh gjë dhe mbajti këmbët.

— Mos folë, vetëm dëgjo... — pëshpëriti Asafi. — Pas një ore do të hyjmë në një pyll. Udhë më tej të shpie në fshatrat e Dukësit. Përroi të nxjerr në fshatin Murrash. Kur të shohësh në krah të majtë një rrëpirë veshur me drurë lisi, vërvitu poshtë dhe rrokullisu! Nuk do të vri-tesh jo, sepse ka fletë të vjetra dhe vendi është i butë si kadife. Drurët janë të dendur dhe, po të rrokullisesh, plumbi nuk do të të zërë. Dëgjoje? Tani thuaj edhe xha Kalos! Kalua le t'i thotë Lames! Të rrokulliseni të tre!

Kush të arrijë gjallë, le të shkojë aty ku ju kam thënë! Dëgjovë? Dhe do të hidheni kur të kollitem unë!

Tanushi dëgjoi trokitjet e zemrës së tij që mbushën gjithë ajrin. Mezi e mblodhi veten dhe pastaj tundi kokën disa herë e ju afrua shpinës së plakut. Ja tha të gjitha. Kalua ktheu kokën. Një oficer që posa kishte ardhur nga kreu i kolonës bërtiti dhe plaku nxitoi hapat. Posa u largua oficeri, xha Kalua nisi t'ja thoshte një këngë. Ishte një nga ato këngët e vjetra me iso, po fjalët ishin të çuditshme dhe ai i përsëriste shpesh. «Ashtu, more, ashtu... ashtu do të na grijnë... do të na grijnë... Do të na ndjekin more... do të na... Unë t'ja marr... more, në një anë... tjetër, more, tjetër... pyllit!» — thuhej në atë këngë. Gjermanit ju mërzi kjo brerimë monotone e plakut, e mbërtheu për jake dhe e shkundi.

— Mirë, de, mirë! — tha plaku. — Budalla! Po zotrote, a s'na çave veshët që parë me atë këngë si klithmë?

Lamja vështroi Asafin. Kishte një buzëqeshje të hidhur.

— Të hidhet Tanushi! — tha ai.

— Edhe ti! — tha Asafi.

— Unë, pas tij!

Gjermani bërtiti prapë dhe i dha një të shtyrë me tytë. Lamja u pengua dhe u qorrollis nëpër gurë, po u ngrit menjëherë dhe nxitoi.

Posa hynë në pyll, pushoi si me magji dhe ajo krismë e vrazhdë gozhdësh që mbushte malin. Tani shumë fëshfërinin vetëm fletët e kalbura. Kolona u ngushtua. Dy ushtarë të tjerë u vendosën pas shpinës së Lames dhe e ndanë atë prej plakut. Lirishta ishte ende e re dhe kurorat e drurëve të rralla. Pylli ishte mbytur i tëri në një dritë të verdhë. Cijasnin zogjtë. Kalua murmuriste diçka me vete. Asafi gulçonte. Duart e lidhura e pengonin të nxitonte si të tjerët dhe disa herë u pengua nëpër kërcëpë e mëndra në hundë. Dhe, saherë pengohej, ndjente në shpinë tytën e rrumbullakët të automatikut që e shponte me ngulm. Gjermanët i pushuan të gjitha zhurmat. Pylli kishite hijen e tij të rëndë dhe ajo u hynte në grykë si një komb që mezi gëlltitet. Më të majtë të shtegut, drurët

nisën të shkurtoheshin të shkurtoheshin... të shkurtoheshin... Ishte rrëzima ajo që shkurtonte kurorat e tyre. Tanushi vuri re se pjerrësia vinte gjithnjë duke u thelluar drejt një përroi të padukshëm. Ai kërkoi vështrimin e Asafit. Asafi e qetësoi me një shenjë dhe kafshoi buzët. Gjermanët u ngjeshën edhe më. Një pëshpërimë kaloi nëpër helmë. Një oficer vraponte sipër shtegut duke shkarë nëpër fletë. Asafi qëndroi. Shtrëngoi bulçitë dhe ja dha një kolle të fortë që gjëmoi nëpër qetësinë e pyllit si një krismë. Tanushi u kthye drejt tij dhe ai i bëri një shenjë padurimi me kokë. Po atë çast ai vuri re se si ja mbathi vrapit përpjetë pyllit xha Kalua. «Eh... or xha Kalo!» —...psherëtiu ai.

Gjermanët bërtitën diçka dhe dikush ja dha një breshëri të gjatë. Po atë çast Tanushi u vërvit si gur tatëpjetë shtegut, nëpër shtronjën e fletëve dhe mori rrokullimën. Xha Kalua s'bëri as njëzet hapa. Pushtoi me duart një lis të hollë që u hepua nga pesha e tij. U lëkund, duart i shkanë nëpër lëkurën e drurit dhe mbeti ashtu i varur si një zog i zi. Vetëm qeleshja ju rrokullis ngadalë tatëpjetë derisa u zu pas një ferre. Asafi ndjeu tytën e rrumbullakët që i bënte një vrimë në shpinë. Befas edhe Lamja u vërvit tatëpjetë dhe pa rënë ende në tokë, hapi krahët në mënyrë të çuditshme, sikur do të fluturonte e u rrokullye si gur. Plumbat korrnin me rrëmbim gjethe e degëza.

Tanushi s'dukej. Dëgjohej vetëm rrokullisja e tij thellë e më thellë. Oficeri që vraponte sipër shtegut kishte nxjerrë revolverin. Asafi pa se si po zmadhohej duke ju afëruar atij tyta e zezë e revolverit. Pastaj s'pa më asgjë.

H E S H T J A

Njeriu me çantë të zezë (ajo mund të ishte çantë, po mund të ishte edhe dosje) kishte udhëtuar i qetë deri në stacionin e fermës. Atij i pëlqente të udhëtonte i vetëm. Të mbështeste kokën në sediljen e butë, të shtriquej dhe të dremiste. Në stacionet e vogla nuk e ktheu kokën asnjëherë nga korridori i vagonit dhe bënte sikur nuk i vinte re udhëtarët. Dhe, ngaqë udhëtarët ishin të paktë ose ndofta sepse fytyra e tij pak e ashpër e përqëndruar dhe e ngrirë në vijat e rrepta metalike të syzeve u dukej njerëzve të mirë si ajo e një intelektualit që ka mendime të mëdha, kjo s'dihet sepse, njerëzit i çmuan vetminë, syzet dhe çantën e tij të zezë (që mund të ishte edhe dosje) dhe nuk e shqetësuan. Tërë kohën ai bëri sikur lexonte gazetën, mirëpo tani po ngrysej, dritat e vagonit ishin të zbeta dhe ishte fare e kotë ta mbante edhe më atë gazetë para syve sepse çdo artikull e kishte lexuar nga dy herë. Gazeta ishte i vetmi send me gërma në bagazhin e tij. Pastaj ai hëngri bukë. Bukën ja kishte vënë e shoqja në valixhe, nën bizhamatë, dhe ai u gëzua që asaj i kishte vajtur ndër mend t'i vinte bukë me sallam turistik dhe djathë kasher. Natyrisht, bukën e hëngri gjatë udhëtimit midis dy stacionesh, kur kishin reshtur gjithë ecejaket në korridor dhe duke ngrënë ai kundroi se si trashej shkumbi i muzgut gushpëllumbi, se si pastaj u hirosën dhe u tretën në një terr të lehtë kodrat dhe shkurret në të dyja

anët e hekurudhës. Kur fishkëlleu lokomotiva ai kishte mbaruar. Ndezi një cigare me filtër. Këto ishin cigare mjaft të rralla në treg, por atij ja ruante banakierja e turizmit.

Mbrëmja ishte e butë dhe gjithshka përkundej e dridhej lehtësisht. Fushat u nxinë nga nata, ajri u dendësua dhe brenda në kabinë ishte ngrohtë, si jo më mirë. Ishte siç duhet të jetë. Përkundja e vagonit, e kolltukëve, e dritave dhe hijeve, ishin aq marramendëse e të këndshme, sa atij ju duk se ky pikërisht ishte një nga ato çastet e rralla të jetës kur qetësia na derdhet në gjithë qenjen tonë si ujë i ngrohtë dhe na sjell një gjumë të lumtur. Ai ishte i qetë dhe i kënaqur. Dhe kishte dëshirë të flinte, të mbështeste pak thembrat e këmbëve mbi meshinën e gjelbër të sediljes karshi, po me kujdes që të mos bënte njolla. Mund të kishte fjetur, por lokomotiva fishkëlleu prapë dhe atij ju kujtua se aty ishte stacioni i fermës. Kur i erdhi gjumë, atij i pëlqeu të mendonte se fishkëllima e lokomotivës ishte sinjal për një tunel dhe përfytyroi: «sa mirë është të flesh kur treni gjëmon brenda errësirës së tunelit». Por, meqë ky s'ishte tunel po stacion, ai s'mund të flinte. Vuri gazetën përpara syve. Kështu kishte bërë gjithë rrugës, në çdo stacion dhe njerëzit e kishin lënë rehat.

Por, që prej këtij çasti, njeriu me çantë të zezë s'pati më qetësi. Në kabinë hynë me rrëmbim dy njerëz. Ata vazhduan bisedën e tyre që e kishin lënë copa-copa nëpër udhët dhe nëpër errësirën e fushës.

— Domethënë ai ju ndau! — tha njeri — i imtë, i ri, që atij ju duk si traktorist.

— Po! Ajo kishte shumë frikë prej tij. Si të ta shpjegoj? Kjo ndofta s'ishte tamam frikë, po një ndjenjë tjetër e ngatërruar, ku përziejehet edhe frika, edhe respekti, edhe ndjenja e pavarësisë. Kupton?

— Po!.. Po..

«Ti s'kuptove asgjë! — mendoi njeriu me çantë. — Më thertë mua në kuptove gjë! Edhe ai tjetri, më thertë mua, në e di se ç'do të thotë, sepse ai nuk e ka zotësinë e sintezës së mendimit!»

— Ai i bëri presion, kupton? «Të ndahesh prej tij —

i tha. — Kush është ai, a s'ma thua? — Ndofta nuk i ka thënë tamam kështu, po diçka të ngjajshme duhet t'i ketë thënë.

— Ky duhet të jetë mësues fshati ose veteriner i mesmë — gjykoi njeriu me çantë. — Po, ç'zekth i ka kafshuar që duan medoemos ta mbarojnë bisedën e tyre në sytë e mi dhe me zë të lartë?»

Natyrisht, ai s'i honepste dot këta njerëz që sjellin në tren bashkë me valixhet edhe bisedat e tyre të mbetura përgjysmë nëpër udhët e vetmuara.

— Domethënë, kush është ai, ë? — tha tjetri, që mund të ishte traktorist.

— Po! Një student e aq është!

— Student e aq! — përsëriti tjetri.

Befas, tani gjithë kjo bisedë i zgjoi një kureshtje të tërbuar. Ajo ju duk mjaft e habitshme, interesante dhe pak zbavitëse. E habitshme sepse ajo përngjiste me një histori tjetër. Interesante sepse... Ndofta për hir të po atij përngjasimi. Zbavitëse mund të mos ishte, dakord. Megjithëse i dha karar që ajo histori s'kishte asgjë zbavitëse. kureshtja e përfshiu për dreq dhe ai bëri një gabim të vogël. E hoqi gazetën që ja fshihte sytë, ngriti kokën, u kapardis. Gazeta kërciti sikur po grisej dhe befas... kabina u trishtua nga qetësia. Fërkimi djallëzor i rrotave me shinat hyri brenda dhe zuri vend midis heshtjes. Fërkimi u zgjat, u rrit, u bë një gërvitje e fortë sikur kushedi sa gryka i bënin jehonë. Ky duhet të ishte një gënjim akustik, natyrisht, sepse këtu s'kishte kurriz malesh, as pyje dhe gryka, as horizont, kishte vetëm një kabinë të mbyllur që s'mund të bënte asnjë jehonë. Pra ky ishte një gënjim akustik. Megjithëse ai u bind se ky ishte një gënjim, gërvitja e fërkimeve vazhdoi t'i zhuzhurinte në kokë me përtesë për një kohë të gjatë. Ai mendoi se tani, në bisedën e dy djemve kishte zënë vend heshtja, si ujë i ftohtë. Dhe heshtjen e derdhi ai. Atij s'i pëlqente më heshtja. Jo vetëm sepse ishte ai që e sollti heshtjen. Jo për këtë. Po sepse ajo histori që dëgjoi i hodhi farën e një shqetësimi. Dhe tani që ai kishte një shqetësim, ata heshtnin si guakë. Ai i kundroi me ngulmim. Ju duk se njëri mund të ishte diçka

më shumë se traktorist. Ta zëmë, mekanik. Sidoqoftë ishte shumë i shkujdesur për veshjen e tij. Tjetri mësues, ose veteriner në fermë. Epo mirë. U mundua të bënte një përfundim nga historia që dëgjoji. Ai mund ta bënte këtë, sepse tërë jetën ishte shquar për zotësinë e bërjes së përmbylljeve logjike. Dhe e bëri. Historia duhej të ishte këshutu: djaloshi me triko të gjelbër, kur ishte student, do të kishte pasur një të dashur dhe pastaj i ati i vajzës ose familja e saj e kishin ndarë prej tij. Doemos. Mirë ja kishin bërë. «Sepse kush je ti? Kush je ti? Në thelb, ti je askushi! Të kuptohemi: unë e kam fjalën për thelbin, e jo për lëvozhgën. Në thelb ti je një askushi student dhe nuk më thua, të lutem shumë, cilin baba e ka marrë malli ta martojë vajzën me Student Askushin?»

Kështu polemizoi në heshtje ai me djaloshin dhe mendimi i vet ju duk mjaft i saktë, por edhe i shqetësuar e pak i zyrtë. Ky mendim i erdhi papritur, ashtu si një shi në mes të verës, që vjen me vrundull, derdhet, zhduket dhe le pas një atmosferë të mbushur me hidhësinë e pluhurit.

Pastaj, përngjasimi që e shqetësoi ju duk i rëndomtë, bajat. Megjithatë, ai ishte kureshtar të dinte fundin. Por, në kabinë bridhte vetëm heshtja. Sepse ata të dy u shqetësuan prej tij kur lëvizi gazetën dhe tani i binte atij të zhdukte këtë shqetësim. Dhe buzëqeshi. Ishte një buzëqeshje e gjerë, me gjithë fytyrën, pak e zorshme vërtet, por ai e dinte se pavarësisht nga nuancat, çdo buzëqeshje është buzëqeshje. Është si pije freskuese në mes të zhegut. Në mes të zhegut që sjell era e valë e botëve të ndryshme të njerëzve të panjohur që i takojmë në udhë rastësisht. Por kabina ishte kredhur në një dritë të dobët e të verdhë prandaj edhe buzëqeshja e atij ju duk atyre të dyve e verdhë dhe pa shije. Ata vazhduan të heshtnin. Në korridor, në dritaren karshi kabinës, u mbështet një çift. Ai s'dëgjonte asnjë fjalë të vetme nga biseda e tyre, po diçka merrte me mend. Për shembull, në qoftë se djaloshi porsa e kishte njohur atë vajzë, tani ai mendohej t'ja mbushte mendjen që ajo ishte shumë e bukur, kurse në qoftë se e kishte njohur prej kohësh, i përsëriste me

përbetime dashurinë që i digjte gjoksin. Kaq gjë merret me mend lehtë. Buzëqeshi prapë. U kujtua për cigaret e rralla «DS», nxori paqetën nga xhepi dhe ua zgjati djemve. Ata i morën cigaret dhe pëshpëritën «falemi nderit». Ai shkrepri çakmakun në formë revolveri.

— Cigare të mira! — tha njeriu me çantë.

— Të buta! — tha ai që mund të ishte mekanik.

— Përqindja e nikotinës duhet të jetë më e ulët, natyrisht! — tha ai.

— Ndofta!

— Kjo ka rëndësi, sepse ka disa kërkime shkencore tani që...

— Çfarë? — pyeti djaloshi me triko të gjelbër.

— Në lidhje me nikotinën... me lëndët e dëmshme të tymit — u ngatërrua pak njeriu me çantë (që mund të ishte edhe dosje). — Kur ke njohuri nga mjekësia, të bëhet të mos pish kurrë duhan, po kur mëson pastaj se në një ambient ku pinë të gjithë, edhe ai që s'pi merr një dozë mjaft të madhe nikotine..., të duket e kotë që ta lësh. Apo jo?

— Po... po... — u nxitua të pohonte mekaniku.

Njeriu me çantë mendoi se kaq ishte mjaft nga pala e tij për të nisur bisedë, dhe priti. Pritja ishte si ajo e gjahtarit, që i ve veshin lehjes së qenit të tij pas ndonjë gjurme, në një pyll ku drurët të pengojnë të shohësh. Ishte një pritje e tillë, ku çdo zë i huaj të mërzit pa masë. Por, megjithëse kabina ishte fare e mbyllur, brenda saj hynin shumë zhurma, sidomos ai fërkimi i tmerrshëm i rrotave me shinat. U mërzit, u mbështet mirë e mirë në sediljen e vet dhe tha me vete: «Në djall të venë! Gjersa s'duan ta hapin gojën, në djall të venë! Unë po fle. Apo të bëj sikur fle? Shiko, shiko! Kjo është mjaft interesante, e zgjuar dhe pak zbavitëse! Të hiqesh sikur fle dhe në të vërtetë të përgjosh! Gjumi im do t'i ndjellë prapë fjalët e tyre!»

Ai lëvizti, e lëshoi trupin, u mbështet më mirë, mbylli sytë. Padashur lëshoi një gërhitje. Ju duk foshnjarake ajo gërhitje e pakohë dhe i erdhi pak turp, andaj nuk i lëvizti më buzët. Dhe ashtu e mbuluan kujtime. Ai mund

të mos kujtonte asgjë, sikur ata të flisnin, sepse njeriu s'mund të bëjë në një kohë dy veprime. Mirëpo heshtja po lëshonte rrënjë në atë kabinë.

«Siç duket, fizionomia ime, që më parë ishte fshehur prapa gazetës, posa u doli karshi, ju imponua, i mposhti dhe ata do t'i kenë dhënë karar që s'ka hije të bisedojnë në sy të një njeriu të tillë ca dokrra dashurie!» — tha me vete. Ky përfundim ju duk mjaft i mençëm dhe ai u kënaq. Fundja, edhe kjo kishte të mirën e saj.

Pastaj, njeriu me çantë të zezë solli ndër mend me gjithë hollësitë atë ndodhinë tjetër që kishte përngjasim të habitshëm me atë që dëgjoi. Ai mund t'i kujtonte të gjitha hollësitë sepse... ajo i kishte ndodhur atij vetë. Disa muaj më parë. Po, në maj. Miku i tij Ll. i tha në telefon që të nisej. «Jo!.. Jo!.. — i tha ai — asgjë e madhe s'ka ndodhur». Doemos, sepse si mund ta lejonte ai, miku i tij, që të ndodhte diçka e madhe? Të lutem! Ja vetëm kaq kishte ndodhur: vajza e tij po shoqërohej pak si shumë me një farë Aleko. Ç'ishte Aleko? Një student në inxhinieri. Nga ishte Aleko? Besa, ai s'e dinte mirë, po diku nga jugu, nga fshatrat e bregdetit. Po, një farë Aleko, student. Asgjë s'kishte ndodhur, jo, e qetësoi miku i tij Ll. Të lutem! Ja, ndonjë shetitje bulevardit! Po edhe me kaq ai e kishte për detyrë ta sinjalizonte, apo jo? Ai e falënderoi. U nis. Dhe rrugës pati aq kohë sa ta mendonte gjithë bisedën e ardhme me vajzën e tij. E mendoi deri në hollësiat e vogla. Ishte një bisedë e vështirë kjo! O, sa e vështirë ishte për një baba që e ka ditur por s'e ka qasur kurrë në përfytyrimin e tij çastin kur e bija dhe një farë Aleko, të dash... Kjo bisedë mund t'i shkonte më për shtat gruas së tij, po ajo zor se ja dilte mbanë, sepse ishte grua e ndjeshme e pak e trishtuar gjithë jetën. Në këtë bisedë më e rëndësishmja ishte të gjente pikën e dobët të vajzës. Pak a shumë si në taktikën ushtarake, kur kërkohet pika më e dobët e kundërshtarit dhe aty jepet goditja. Dhe ai u mundua të gjente pikën e dobët të vajzës së tij. Dhe më në fund e gjeti. Sepse ai kish menduar gjithmonë që një prind i mirë duhet ta njohë botën e brendshme të fëmijëve të vet. Ta dijë ç'i gëzon, ç'i mërzit, ç'i kënaq, ç'i

trishton më shumë. Dhe ai i dha karar që pika më e dobët e vajzës së tij ishte... dhimshuria. Kishte një dhimshuri të pushuar për nënën e saj ajo, sepse nëna vuante nga një aritmi e zemrës. Bisedën duhet ta fillonte me qetësi, me butësi, me një farë dredhie, si në taktikën ushtarake kur i merren krahët kundërshtarit. Për çudi, asnjëherë nuk i vajti mendja ato ditë se mund të ishte interesante të njihet me atë studentin. Kjo s'kishte se si, s'kishte sepse se, sido që të bëhej, ai s'ishte asgjë më shumë se sa një student dhe një farë Aleko. I njihete ai këta lloj studentësh!

Por biseda me vajzën nuk shkoi aspak ashtu siç e kishte menduar; sepse, sa më shumë i afrohej Tiranës, aq më i përbindshëm i dukej fakti që e bija dhe një farë Aleko dash... Kështu që, posa e takoi, ju shkreh mirë e mirë, me të gjitha bateritë, nxituar, vrazhdë. «...Na thanë se e paske ujdísur me një farë Aleko! Student! Jo, unë s'jam kundra dash... po ku të shpie mushka moj? Për këtë të dërguam në universitet? Dhe, ç'është ky njeri? Hiç, mos thuaj gjë, e marr me mend se ç'është! Një horr horrit! Sot të do ty, nesër një tjetër! I njoh këta tipa dhe këtë moshë unë! Jo, unë s'jam kundra dash... por edhe në mos qoftë një horr, prapë ç'është fundja? Askushi! Hushkukur! Pa stabilitet! Pa personalitet! Pa dinjitet! Njeri pa biografi! A e di se si u bë mamaja kur dëgjoi këtë? A e di se ç'aritmi i erdhi në zemër? Thashë se kapërceu!...»

Pra, bisedën përgatitore ai e harroi me përjashtim të zemrës së mamasë. Këtë s'kishte se si ta harronte, sepse zemra e mamasë ishte arma e tij sekrete. Pastaj ajo kishte qarë, e kishte mohuar disi dhe ai ishte ngazëllyer nga lotët e saj që s'mund të ishin gjë tjetër veçse lot pendimi. Dhe kishte ikur. Dhe s'kishte gabuar, sepse edhe miku i tij Ll. e njoftoi më vonë se një farë Aleko ishte zhdukur pa lënë gjurmë. Sigurisht kishte mbetur në klasë dhe e kishin përjashtuar nga fakulteti! Kështu sot ai mund t'i kujtonte të gjitha këto mjaft i qetë dhe i lumtur, sikur ajo dreg historie të mos ngjasonte pak me të tijën.

— Po ti, s'bëre asgjë? — pyeti befas ai që duhej të ishte mckanik.

— Unë s'e dija që kishte ndodhur kështu. Ajo filloi të më rrinte ftohtë. Ndofta jo tamam ftohtë, po si e trembur. Kupton?

Njeriu me çantë mbajti frymën pezull, sikur druhej se mos frymëmarrja e tij binte përsëri si ujë i ftohtë mbi bisedën e tyre dhe e bënte të mërdhihte. Ai u tremb më kot, se fishi i trenit lajmëroi një stacion tjetër, mekaniku u ngrit dhe zbriti. Ata mbetën dy në kabinë. Çifti në dritare tani i guisnin njëri-tjetrit si pëllumbat dhe s'çanin kryet aspak për ta. Moskokëçarja e tyre ishte mjaft e habitshme, interesante dhe pak zbavitëse. Se, edhe pëllumbat shqetësohen kur i shohin njerëzit gjatë dhe me ngulm. Në kabinë heshtja u dendësua. Ai u bë nervoz. E ndjeu nervozitetin t'i shtrihej nëpër gjymtyrët e t'i lëvrinte si një qenje e gjallë, shumë e nxehtë, që le pas një gjurmë të përdredhur. I zgjati paqetën djaloshit dhe e pyeti rrëmbyer:

— Ç'punë bëni ju?

— Inxhinier në oficinën e fermës — tha ai. — Po ju?

— Nëpunës — ja preu shkurt ai. Pastaj ju duk sikur djaloshi do ta pyeste edhe më. Këtë s'e duronte dot as në rrethana të tjera, të qeta. E quante «mbushja e fletë-anketës në udhëtim», e jo më ta duronte tani, prandaj u ngut të buzëqeshte gjerësisht dhe tha:

— Ajo ndodhia juaj ë?.. — Zërin e vet e ndjeu të veshur me një tantellë të tejdukshme e të butë dhe kjo ju duk aq dashamirëse, sa e lëvdoi veten me mend. — Natyrisht, unë e dëgjova rastësisht, po sa interesante që ishte! Si në romanet!

— Ç'romane? — tha djali. — Këto ndodhin rëndom.

— Mundet! Dhe si? Ju ndau babai i saj, ë?

— Në fillim po!

— Çudi! Në thelb duhet të ketë qenë fanatik. Mos ishte fshatar?

— Jo, seç bënte një punë diku! Po unë s'e kam parë kurrë. As ai s'më ka parë.

— S'dihet. Ai mund t'ju ketë parë dhe ju s'e dini!

— Jo, jam i sigurt. Më ka thënë vajza!

— Vajza? Po pse, a nuk u ndatë?

— Në fillim, po! Jua thashë! Ai na ndau! Po unë s'mund të ndahesha, kupton? Se e dashuroja! Edhe ajo më dashuronte, e dija, por ajo u tremb nga dashuria e saj, sepse dashurinë ja bënë gogol. Atëhere, ç'të bëja unë sipas jush?

— Ç'të bënit ju? Besa... s'di se ç'duhet të bënit ju!..
— u ngatërrua ai.

— Unë duhet t'ja provoja asaj se sa e madhe ishte dashuria ime. Prandaj nuk ju ndava, ju bëra ferrë. Se në thelb, siç thoni edhe ju, dashuria jonë rronte. Unë s'mund ta braktisja!

— Edhe?

— Dashurohemi përsëri. Sonte ajo më pret te stationi...

— Ku punon ajo?

— Asgjëkundi. Është studente!

— Kurse ju... inxhinier! — belbëzoi ai. — Po?

— Po!

— Çudi!

— Pse?

— Pse?

Ai heshti.

«Tani unë duhet ta pyes në ç'fakultet është vajza!»
— mendoi ai i mjeruar. Por, ngaqë ishte bërë nervoz, bëri edhe një gabim tjetër të vogël, si aty pari kur kishte hequr gazetën që i mbulonte fytyrën. Tha me zë të ulët dhe si me vete:

— Çudi!

— Pse u bëtë kaq kureshtar? — pyeti djaloshi. — Mos jeni shkrimtar?

— Jo... kot! — tha ai dhe heshti. Dhe në heshtje e qortoi veten rëndë: «Më kot e the për së dyti fjalën çudi! Mjaftonte vetëm një herë. Ai s'do të flasë më dhe ti s'do ta pyesësh më për asgjë. Por... fundja ajo e pret në station dhe, nëse është ajo, atëhere? Atëhere?» O! Sa të errëta e të vrara ishin hamendjet që ju shpëstollën njëra pas tjetrës si fill i leshtë i një lëmshi të ngatërruar! Dhe sigurisht, asgjë në natyrë, as kodrat, as kërcurët e butë të vreshtave rrëzë të cilave ngiste si i harbuar treni i

mbrëmjes nuk ishin kredhur e shtrënguar aq thellë në pelenat e natës, sa mendimet e tija brenda pelenave të brengës së papritur. Dhe bëhej aq i thellë e pa shpresë nganjëherë ky shqetësim, sa i bëhej të besonte se shqetësimi rronte perjetësisht brenda qenjes së tij, ose ishte ngulur që nga çasti kur mësoi se e bija dhe një farë Aleko dash... Dhe kishte mbetur kjo brengë diku brenda, në errësitrat e qenjes, e shtyrë nga gëzimet e shqetësimet e vogla të përditshme dhe kishte pritur këtë natë, këtë tren që të shfaqej si fantazmë dhe ta pushtonte të tërin.

Njeriu me çantë e shpërpiu me një vështrim të rreptë djalosin inxhnier. Brenda atij vështrimi tiparet e djaloshit ju dukën armiqësore, të pagdhendura dhe tallëse. Dhe ai, që ishte shquar për aftësinë e përmbylljeve logjike. tani s'ishte i zoti t'i përgjigjej pyetjes që i bërtiste nga çdo qelizë: «Ç'do të bësh, po të jetë ajo?»

Fishkëllimën e zgjatur të sirenës e dëgjoi si nëpër ëndërr. Djaloshi doli me ngutësi nga dera. Ai kujtoi se do ta zgjidhte shqetësimin vetëm po ta ndiqte atë pas, vetëm po të ndodhej afër vendtakimit të tyre dhe prandaj u ngut të dilte edhe ai. Por në korridor të gjithë nguteshin. Një plakë e trashë me një bohçe ja zinte udhën kurse plakës ja pengonin udhën ata dy të dritares. Zbriti i mërzhitur e pa shpresë, sepse e kishte humbur djalosin nga sytë. Megjithatë vazhdoi të nxitonte, t'i shtynte njerëzit me bërryle, t'i shkelte. Vështrimet e tyre të habitura e të zemëruara i shpërfillte. Ç'ishin ankesat e tyre të vogla përpara shqetësimit të tij? Kurrë në jetë s'ishte ngutur njeriu me çantë të zezë, vetëm sonte duhej ta bënte këtë. Dritat ja bënin me sy, sikur e përqeshnin. Befas, në fund të platformës i pa ata të dy. Ishin larg dhe ai u shihte vetëm shpinat. Njëherë ju bë se ajo ishte tamam vajza e tij. Po ata flokë të gjatë.. Pastaj ju duk sikur s'ishte ajo. S'mund ta besonte se ishte ajo vetëm nga flokët e gjatë, sepse flokët e gjatë i mbanin të gjitha. Ata u kthyen në një rrugicë mjaft të dyshimtë. U kthye edhe ai. Rrugica ishte e errët, po ca reflekse të largëta i jepnin një lloj drite të mekur. Tani s'ishin as dhjetë hapa larg. Edhe shtatë! Errësi e mallëkuar! Ajo kishte diçka

të ngjajshme me vajzën e tij, po edhe diçka të ndryshme. Sa lehtë mund të gabojë një tru i nxehtë!

Djaloshi e tërhoqi vajzën afër vetes, nën strehën e një porte dhe e puthi. Ai s'mund të qëndronte. Do të ishte çmenduri të mbetej në vend dhe të shihte se si pu... ata të dy! Megjithatë, brenda një çasti shumë të shkurtër ai i shpërpiu me një vështrim të gjitha tiparet e dukshme të vajzës dhe psherëtiu. Ajo s'ngjiste me vajzën e tij!

Posa doli në bulevard, dyshimi ju tret fare dhe ai humbi brenda turmës. Ai i dha karar që historira të ngjajshme mund të ketë shumë në këtë qytet të madh ku ka kaq shumë të rinj, i dha karar që ajo vajzë s'ishte vajza e tij, sepse vinte më e shkurtër, sepse vajza e tij ishte më e turpshme dhe më e sjellshme dhe s'mund të pu... në errësirën e rrugicave, sepse disa fjalë që tha djaloshi ai nuk ja kishte thënë së bijës, sepse në fund të fundit ai s'deshi që të ishte vajza e tij! Tani ora ishte tetë e gjysmë e natës dhe vajza e tij, natyrisht ishte në konvikt. Ai do të shkonte që tani në konvikt dhe do ta takonte. Dhe shqetësimi do të tretej brenda atij gëzimi të ëmbël që e ndjeu edhe dikur, tamam atë ditë që mësoi se një farë Aleko ishte zhdukur pa lënë gjurmë.

Njeriu me çantë të zezë (që mund të ishte edhe dosje) shkeli me hap të rëndë në rrugicën e kopshtit të konviktit të vajzave. Dikush i tregoi dritaren e një pallati. Dritarja ishte e errët, ashtu si shqetësimi i tij në këtë mbrëmje të gjatë!

DANKA E ROJTARËVE

Në mbremjen e ditës së tretë, në autobusin e vogël të linjes hipi edhe një djalë i ri me bluzë të verdhë golf. Bluza e tij e verdhë kishte rënë në sy, si një vjeshtë e parakoshme midis gjelbërimit të dendur të pyllit ku ishte ngatitur kampi malor i pushimit dhe ndofta për shkak të saj a të moshës së tij më të njomë se e të tjerëve, ai ende kishte zënë ndonjë shok. Ai nuk i tha askujt se në mbremjen e ditës së tretë do të shkonte. Hipi qetësisht në urbanin e linjës dhe u mbështet në dritaren e hapur.

Kryetari i këshillit të kampit doli me vrap nga mensa.
— Ku vete more? — tha ai, duke gulçuar.

— Po shkoj — tha djaloshi që mundohej të mbahej i qetë e indiferent. Por duhet të ishe shumë i pavëmendshëm që të mos e kuptoje se një shqetësim i brendshëm, që mundohej ta përmbante me zor, e bënte që të mos shihte asnjëri drejt në sy dhe prandaj vështrimi i tij bridhte lëndinave me fier të gjatë, buzë xhadesë.

— Po si kështu? — tha kryetari dhe hapi krahët si një zog i stërmadh që përgatitet të fluturojë. — Mos të ka ndodhur gjë në familje? Tregona, djalosh, se fatkeqësite vetëm me shoqëri kalohen!

— Asgjë s'më ka ndodhur. U mërzita. Vend i shkretë. Ftohtë. Të kishte të paktën një bilardo!

— Ti je i ri! — tha kryetari i nervozuar tashmë. — Gabimet e rinisë kushtojnë shtrenjtë! Veri gishtin kokës,

se ky është një lloj dezertimi! Kamp pushimi vërtet, po e ka një disiplinë në rend të ditës! Ne do të bëjmë ekskurSIONE të organizuara! Do të sjellim edhe orkestër për vallëzim!

— Nuk dua! — tha ai. — Unë do të shkoj në plazh, në Durrës. Këtu është vetmi e madhe!

— A! Këtu qenka vetmi e madhe! Domethënë ne s'jemi njerëz që të ta mbushim syrin! Kurse ata që hargalisen plazheve ta ngopin hë?

— Unë s'thashë ashtu. Ju po i thoni këto gjëra. Po ç'm'u qepët me bukë në torbë xhanëm? Pse më mërzisni? Dua të shkoj dhe pikë!

Shoferi i ra bories dhe ai ktheu kokën. Kryetari pësh-tyu pluhurin e hidhur që la pas maqina dhe u kthye në mensë. Ishte i zymtë dhe si i vrarë shpirtërisht.

Ky njeri kishte bërë çmos që të binte në sy qysh gjatë udhëtimit. S'di sepse na u imponua ashtu, po të gjithë e shihnim me kuriozitet, si njeri që e nxjerr qimen nga qulli kudo qoftë. Kur u mblodhëm për të zgjedhur këshillin e kampit, ai diskutoi i pari. Tha se kishte qenë në shumë kampe pushimi dhe se nga përvoja e dinte se, për të kaluar pushime të këndshme në këtë kamp malor pak të vetmuar, ishte e domosdoshme të zgjidhnim në këshill disa shokë aktivistë të mirë shoqërorë, që u vinte ndoresh për aktivitete kulturore masive. Tha se këtë çështje duhet ta merrnim seriozisht.

Unë propozova shokun tim të dhomës, një marangoz me fytyrë vrarëlije. Që natën e parë ne kishim lojtur tavëll me të dhe ai ma kishte marrë tri herë rresht qyrtin; marrsh. Një vajzë propozoi diskutantin e parë. Anëtari i fundit i këshillit u zgjedha unë. Diskutanti i parë që quhej Duro Malltezi dukej shumë i kënaqur. Ai tha: «Tani ne duhet të zgjedhim kryetarin. Zgjedhëm atë. As unë s'e kuptoj përse preferuam atë! Ndofta sepse asnjëri nga ne të tjerët nuk e merrte me aq seriozitet sa ai detyrën e anëtarit të këshillit të kampit! Serioziteti i tij na u duk garancia më e mirë për postin e kryetarit! Mua më mbiu një antipati e hidhur për këtë njeri. Më dukej se ishte përfaqësuesi më i denjë i asaj kategorie që hiqen për ak-

tivistë të mirë shoqërorë, po që në të vërtetë s'bëjnë asgjë dhe s'kanë asnjë talent. Zotësia e tyre kryesore është që ta fillojnë të parët ndonjë këngë revolucionare ose të hedhin parulla nëpër mbledhje. Ata marrin pjesë në çdo provë të grupeve artistike të ndërmarrjeve, megjithëse s'janë as aktorë, as solistë. Ndonjëherë vetë zgjidhen asistentë regjizorë, u kërkojnë llogari shokëve që mungojnë dhe bëjnë thirrje për disiplinë proletare. Kur dalin trupat turne, ata rrinë në kabinë me shoferin, kurse të tjerët në karroceri. S'ka njerëz që të dinë të shtiren si aktivistë më mirë se këta.

Por unë, shpesh e kam qortuar veten për antipati të tilla, të lindura vetëm në mënyrë vizuale, prandaj nuk thashë asgjë.»

Menjëherë pas largimit të atij djaloshit me golf, kryetari Duro Malltezi na thirri me ngutësi në një mbledhje. Zdrukhtari Soto Vilza u mërzi. Ai posa kishte filluar të lexonte «Karrierën e Zotit Maksut» dhe seç murmuriti kur e ndanë nga libri.

U mblodhëm në zyrën e drejtorit. Drejtori ishte njeri pa rëndësi. S'di se ku e kishin gjetur, po edhe kampi ishte i vogël, me 80 vetë. Në sytë e vegjël me qepalla të shkurtër të drejtorit lëvizte një shprehje e hapur admirimi për mendjemprehtësinë e Duro Malltezit. Ai kishte thënë që kryetar të tillë s'kishte për të pasur kurrë më në atë kamp dhe ju lut Duros të vinte edhe vitin tjetër. Po Durua i tha që Bashkimet Profesionale nuk të dërgojnë dy vjet rresht në kamp.

— Incidenti i sotëm — filloi Duro Malltezi — duhet të na bëjë të reflektojmë të gjithë. Në një kohë kur partia e dërgon atë punëtor të ri të çlodhet në një kamp të mrekullueshëm midis natyrës madhështore, si ky yni, në një kohë kur e dërgon që të kthehet me forca të shumëfishuara për realizimin e tejkalimin e detyrave të planit, ai djalosh, pa pikën e përgjegjësisë dhe ndërgjegjes socialiste ngrihet e ikën!..

Ai foli pastaj për nevojën e edukimit të brezit të ri dhe për disiplinën proletare dhe, pasi përmendi favoritët pak të gjata dhe pulovrin e verdhë golf që tregonin ndiki-

me të dukshme nga shije të huaja, Duro Malltezi tha edhe këto:

— Propozoj që të dërgojmë në ndërmarrjen ku punon ai një karakteristikë të qëndrimit të tij arrogant, mospërfillës dhe të papajtueshëm me normat e moralit tonë të shëndoshë. Propozoj të dërgojmë një motivacion!.. — tha ai.

Ne ramë në një heshtje nervoze. Soto Vilza lëvizi qafën me vrull dhe u dëgjua se si i krisën damarët. Drejtori i kampit mori frymë thellë dhe tha:

— Ne, si drejtori, jemi plotësisht dakord!

— Jo, more! — gjëmoi zëri i thellë i mikut tim të dhomës, Sotos. — Domethënë ja vutë vulën edhe ju, ë? S'mbetet gjë tjetër veçse fjala e zezë shkruar në të bardhë të marrë udhët e të vejë të llangosë me baltë fytyrën e atij djalit! Tamam si në pyll! Shkon rojtari dhe ja vë damkën një druri! Pastaj venë druvarët dhe i venë sharrën!

— Më falni! S'kuptoj se ç'doni të thoni me këto fjalë të ngatërruara ju, shoku Soto! — tha Duro Malltezi.

— Dua të them se deri më tani ju dija vetëm një llafazan të mërzitshëm, po ju qenkeni edhe i rrezikshëm! Dale, dale, mos u tharto që tani, se më të thartat vijnë pas! Po a dini ju, mor lumëzinj, si e kishte hallin ai djalë?

— Ah! — psherëtiu Durua! — Për këtë u shqetësuar ju, shoku Soto? Nejse, njeriu mund të marrë zjarr si... po për ju, si punëtor i vjetër që jeni ne kemi shumë respekt dhe nuk jua vemë re. Po si, more shokë, mund të dilja unë me këtë propozim pa qenë i sigurtë se ai djalosh s'kishte asnjë arësye serioze, përveç kokëshkrepjes së tij? Po kokëshkrepja s'është arësye! Unë i shkreti ja qava hallin si njeri, po a e dini ç'më tha? «U mërzita — tha. — Është vend i tmerrshëm ky! Vetmi e madhe! Kurse unë kam qejf të bredh plazhit! Aty ka femra, ka turistë!»... — Ç't'ju them, more shokë? Me një fjalë: aventurier! A i ka hije një të riu të dalë nga klasa punëtore të thotë: «do shkoj plazhit të bredh me femra?»

Soto Vilza uli kokën e madhe mbi gjoks dhe po men-

dohej. Ballit të rjepur nga dielli ju thelluan brazdat. Fytyra e hijshme e Duros shkëlqeu nga gëzimi.

— Në qoftë se ju do të merrni vendim të dërgoni atë karakteristikë, unë do t'i bëj një letër personale sekretarit të partisë në ndërmarrje — tha ai.

— Pse? — pyeti drejtori me drojtje.

— Sepse jam krejtësisht kundra. Sepse njeriu nuk gjykohet nga një xhest. Sepse karakteristikat e njeriut nuk bëhen duke mbledhur poshtë e lart opinione njerëzish të përciptë e ndonjëherë keqdashës që duan të duken duke bërë biografitë e të tjerëve. Ne nuk e dimë aspak se si e kishte punën. Mund të kishte një të dashur ta zëmë dhe e mori malli e iku. Ose thjesht, u mërziu këtu, sepse s'kishte asnjë shok moshatar ose s'kishte argëtim për të. E di, or drejtor, e di që do të thuash se kampi posa u hap dhe se do të plotësohet me mjete kulturale avash-avash. Mund të kesh të drejtë. Po edhe ai mund të ketë të drejtë të mërziut e të ikë, apo jo?

— Po ç'do të bëhej sikur të gjithë të mërziut e të ikim? — tha Duro Malltezi me dinakëri. — Do të ishte njësoj si braktisja e frontit!

— Ti, or djalë, e paske mbushur kokën me fjalë që pëlcastin si flluska dhe bëjnë zhurmë! Po ato s'të lënë she një gjëkundi, ta dish! E di si i themi ne andej kësaj? Të shesësh pordhë, ja kështu i themi!

Fytyra e Duro Malltezit u bë flakë e kuqe dhe ai u mundua të mbante dinjitetin e kryetarit duke u ngritur me rrëmbim më këmbë. Diçka belbëzoi nëpër dhëmbë, po edhe ato s'u dëgjuan sepse nga nxitimi ai rrëzoi karrigen. Shpinorja e karriges, që ishte ngjitur keq, u shkëput. Drejtorit ju duk sikur u thye dhe u pikëllua. Soto Vilza i hodhi një sy karriges që ishte thërrmuar ashtu dhe tha:

— Punë kërpaçi!

Ne heshtim. Një vajzë e re, punëtore në Kombinatin e Tekstilit fshihte fytyrën midis pëllëmbëve dhe supet e rrrumbullakëta i dridheshin nga të qeshurit.

— Unë!.. unë... nuk toleroj! — ja priti Duro Malltezi.

— Posi! S'na toleroke ti! — tha Soto Vilza. — Bëke biografitë e njerëzve ti! Pse, kështu more djema? Ç'bëhet kështu? Disa prej jush mund të thonë tani: ç'pati ky Soto Vilza që mori flakë kështu? Mora flakë se kam një plagë të vjetër edhe vetë dhe, saherë dëgjoj kështu, nis e më rrjedh. Daleni, do t'jua tregoj se si ndodhi...



Ka shumë vjet kjo, që atëhere kur u hapën kampet malore për herë të parë. Sa dolëm nga lufta, unë hyra zdrukthtar në ndërmarrjen e ndërtimeve. Punë kishim shumë. Shkatërrime kudo që të hidhje sytë. Punonim orë e pa kohë dhe s'para ngopeshim me bukë. Ama partia e bënte të vetën. Na dërgonte për muaj mjekun për vizitë. Kur, më dikton ky mjeku edhe mua një hije më të djath-të Shokët e mi u trembën, se ishte gogol tuberkulozi atë- here. Varfëri, ç'pyet! Unë e mora me të qeshur, dhe bëra mirë, se shpesh njeriun e sëmur meraku për veten. Më dhanë një fletë kampi gratis për në Voskopoje. Unë e kisha ndarë mendjen ta shkoja ndryshe lejen, po ata ngulën këmbë. «Të çlodhet një muaj në kamp shoku Soto». — E po në kamp që në kamp. Voskopoja, vend i mirë, pishë e gjallë. Ajër që të ngop me erë rrëshire e stikash. Ush- qimi si jo më mirë. Mirëpo mua më brente përnatë një hall. Sa bija të flija, më binte në mend xha Golja. «Bre! — thosha — që i dola fjalës xha Goles». — Golja ishte nga një fshat i fushës. Shtëpinë ja kishte djegur gjermani dhe mezi e kishte ngritur karabina. E kishte edhe lëndën e drurit po s'kishte kush t'ja shtronte dyshemetë e t'i vinte dyert e dritaret. Unë ja kisha dhënë fjalën që do t'ja bëja kur të merrja lejen. Golen e kisha mik dhe ai më kishte premtuar një mëshqerrë. Unë kisha një vëlla në fshat. Lufta e la krunde fare edhe atë dhe kishte dy vjet që mundohej të blinte një lopë, po s'i mblidhte dot paratë. E kisha ndarë me kohë që t'i mbaroja dyshemetë

xha Goles e t'i çoja mëshqerrën vëllait. Doemos, mëshqerra bënte më shtrenjtë se puna, po me Golen ishim miq dhe ai do të më priste ca kohë për paratë e tjera. «Eh, që e gënjeva xha Golen e shkretë» — mendoja. Edhe vëllanë e lashë lugëthatë! Apo s'kishte ai një rreth fëmijë që mbanin gojën hapur si zogjtë! Edhe xha Golja zor se gjente usta tjetër. Edhe mund të gjente xhanëm, po privatët të kërkonin qimen e kokës atëhere!

I bëra pesëmbëdhjetë ditë në kamp. «Kaq mjaft është — thashë — sa për t'ua bërë qejfin shokëve dhe doktorit. Ditët e mia do t'i shkoj si të dua». — Valixhen në sup, tatëpjetë xhadesë dhe e mbajta frymën në Orman, te Golja. Punova si kalë, ditë e natë. Pas dy javësh mora mëshqerrën për kapistre dhe u nisa. Isha i dërmuar nga lodhja, po i kënaqur. Nuk e di në e keni ndjerë se sa i lumtur është njeriu kur mbaron një punë të mirë dhe e ndjen veten prej saj të lodhur, po e di ama që ka punuar mirë! Është një lloj lodhjeje e ëmbël! S'di se kush nga të njohurit më pa rrugës me mëshqerrën pas, po duhet të më kenë parë shumë se unë i rashë xhadesë mes për mes, ashtu siç i ka hije një njeriu të kënaqur. Pas një jave më thotë drejtori ynë:

— Po ç'na ke turpëruar ashtu, o derëzi? Drejtori ishte burrë i mirë, kishim qenë bashkë në luftë dhe bile ishte zanatçi si ne. Unë u vreja, kurse ai qeshte e këpuste ijet. Unë s'merrja vesh asgjë.

— Ti paske ikur nga kampi more! — më tha.
— Po! — thashë. — Kisha një punë në Orman, te Golja.

— A e di ç'tha për ty sekretari i bashkimeve profesionale të rrethit, shoku Uan Nasho?

— E nga ta di? — thashë.

— Ishte një mbledhje me gjithë drejtorat dhe erdhi fjala për atë... si i thonë dreqit... ndërgjegjë në punë. «Shokë — tha! — Kemi raste dhe punëtorë të pandërgjegjshëm akoma — tha — si për shembull Soto Vilza në ndërtim që la kampin e pushimit ku e dërguam të shërohej dhe vajti e punoi privat në fshat. Gënjeu fshatarësinë punonjëse si matrapaz dhe me ato para bleu një lopë.»

Nuk e di se si u bëra në fytyrë. Drejtori më tha që u gjelbërova si fletë. M'u duk e gjitha një padrejtësi shumë e madhe. Po ta shihje punën kallëp, si ne sot, tamam ashtu ishte. Se unë kisha shtruar dyshemetë për një mëshqerrë. Po e lëmë mënjanë që ato vite të gjithë punonin nga pak privatë dhe se kishte shumë zanatçinj privatë. Unë e dija gjithashtu që Taso Dinja, një shoku im mobilier i kishte bërë jashtë orarit një palë kolltukë tamam atij Uanit. Po fundja këto s'kishin rëndësi shumë dhe unë s'kisha ndër mend t'i thosha gjekundi. Thelbi i punës ishte që mua s'më mbushej mendja që kisha bërë një gjynah të atillë, sa të më vihej nofka punëtor i pandërgjegjshëm! Bile mua më dukej se kisha bërë dy të mira përnjëherë: edhe Golja kishte futur kokën brenda shtëpisë, edhe vëllai ishte bërë me mëshqerrë. Mirë thonë — mendoja. — Bëj mirë e gjej keq. — More po si s'më pyeti një herë ky Uani, thosha me vete, si e pate hallin, o Soto Vilza, të më thoshte, që na bëre këtë proçkë e ua mbathe këmbëve nga kampi?

Po unë heshta, ula kokën dhe e gëlltita. Ndofta çogndjeja edhe unë disa fije të vogla faji, s'di si të them! E gëlltita, po doli pas që paskesha bërë gabim dhe më pat mbetur në grykë. Njeriut që e ul kokën ashtu, i hipin në shpinë dhe i thonë «ush!, derr!» S'mbeti mbledhje ku të mos ngrihej si Uani ose të tjerë nga ata që mbajnë konferenca dhe të mos thuhej: «Ja, shokë, kemi raste si punëtori i pandërgjegjshëm Soto Vilza që la kampin e pushimit, punoi privat dhe pastaj bleu lopë!» Tërë qyteti e dinte këtë histori dhe nisën t'i venin këmbë e duar. Thoshin se gjoja unë e kisha akoma lopën në qytet, se isha bërë ortak me një bostanxhi, ai barin unë lopën dhe qumshtin e shisnim me të shtrenjtë, se gjoja xha Golja na paske qenë një fshatar i këputur më dysh nga varfëria i ziu, bile baba dëshmori dhe, meqë s'kishte para të më paguante, unë me egërsinë e kapitalistit i rrëmbeva lopën nga stalla. Aq e trashën e aq bozë u bë kjo gjë, sa edhe drejtori im vajti e takoi atë Uanin. Dhe a e dini ç'i tha ky birçja? «Keni të drejtë, shoku Llambi — i tha. — Po neve na duhen raste që të mos grijmë fjalë në erë, apo jo? Dhe rast si

ky s'ke ku e gjen. Dakord, ka dhe punëtorë të tjerë që bëjnë punë private, po si ky rast s'ka! Të lësh kampin e pushimit gratis, të vesh në fshat, të blesh lopë e më the të thashë! Sa të na dalë ndonjë rast tjetër i fortë si ky, ne do meremi me të! S'kemi ç'bëjmë! Fundja, për hatrin tënd, tani mund ta përmendim vetëm si rast, dhe emrin e atij punëtorit që ti po thua se është aq i mirë nuk do ta zëmë dendur në gojë!»

Dhe sa vazhdoi kjo, mendoni ju? Plot një vit e gjysmë! S'mbeti fjalim që kishte të bënte me punën pa e thënë me gojë plot e me zë të lartë rastin e ati; që la kampin, punoi privat dhe bleu lopë!

Ama, më erdhi në majë të hundës! M'u bë shpirti derr dhe m'u mërzit vetja, prandaj një ditë i çatisa atij Uanit drejt e në zyrë. S'ja kisha parë kurrë më parë fytyrën! Hyra pa trokitur. Ishte zhytur në një kolltuk meshini nga ata të vjetrit, që kishte pasur bashkia dhe çoç shkruante. M'u duk pesë para njeri. Një i verdhë e i squllët, si zhol. Zaten zhol duhej ta kishte pasur edhe zemrën, qyqari, gjersa i zuri goja lesh me këtë qimer time dhe nuk shihte trarët e të tjerëve apo të vetët.

— Ulu, shok! — më tha.

U ula kundrejt tij. Ai nuk e ngriti kryet dhe po shkruante akoma. Ama shpejt i shkiste ajo pena e shkretë mbi letër!

— Si e keni punën, shok? — më tha.

— Nuk e kemi mirë — thashë.

Atij i ra kalemi përdhe dhe ngriti sytë. I kishte të turbull dhe nuk të shihte drejt. Unë i kam pasur zët njerëzit që shohin shtrembër. Ma thoshte mendja që vetëm çakërrëve u lejohej të shihnin ashtu se ua ka dhënë natyra, po të tjerët përse?

— Po ç'ju ka ndodhur? — tha.

— Unë jam ai i pandërgjegjshmi Soto Vilza i kampit dhe i lopës! — i thashë.

Një nënqeshje tallëse i mbiu në tërë fytyrën. Dhe kishte një fytyrë të lëmuar, aq të lëmuar, sa më vinte t'ja ngjeshja një pëllëmbë të mirë që t'i mbeteshin pesë vijat e gishtërinjve në faqe. Se si m'u kujtua atëhere një

nga ata pseudokomunistët e grupit të «Zjarrit» që na kishte ardhur njëherë për agjitacion. «A e dini sa e pasur është Shqipëria? — na thoshte. — Është aq e pasur, sa vetëm me naftën që kemi ne do të rrojmë pa punuar dhe do të hamë me lugë floriri!» «Tëmën, budalla që paske qenë — i tha një shoku ynë. — E po si, do rrimë këmbë mbi këmbë dhe do t'i vemë syrin diellit kur të çlirohemi, ë?»

— Ti qenke Soto Vilza? — tha ai. — Të merrja me mend ndryshe!

— Si? — i thashë.

— Me një fytyrë pak të gjatë, dhelparake dhe të veshur për të qenë. Kurse ti më qenke kripë... Apo mos ke ardhur kështu që të më hedhësh hi syve?

— Pikës i re! — i thashë.

— Po pse erdhe tek unë?

— Dua të të pyes, në mos e paça më triskën e bashkimeve profesionale, a do të ma zini më në gojë atë çështjen e lopës?

— Si? — u tmerrua ai. — Ti do të dorëzosh triskën? Po a e di, more shoku Soto, që kështu hidhesh vetëvetiu në kampin e armikut?

— Aty nuk hidhem, or jo — i thashë. — Se kanë shumë borxhe për të marrë tek unë ata!

— Po pse? — tha ai.

— Se të të pëlcastin! — i thashë. — Se kam qenë malit që më 42 dhe se kam shpënë në atë botën tjetër shumë syfete nga soji i tyre! A e more vesh tani?

Ai bëri të ngrihej shpejt nga kolltuku, po kjo s'ishte e lehtë se ata kolltukët ishin të thellë dhe kishte fundosur shumë.

— Pse s'na e ke thënë më parë, more shoku Soto? Pse s'na ke thënë që je partizan i vjetër?

— Se ata të vjetrit s'para e thonë këtë gjë — i thashë.

— Po ta dinim, do ta trajtonim rastin ndryshe. Sepse, shoku Soto, fakti është fakt. Ti e le kampin dhe bleve lopë. Po faktit mund t'i jepen disa shpjegime. Unë jam i sigurtë tani se shpirti i vogël mikroborgjez i fshatarit e mposhti përkohësisht shpirtin revolucionar të punëtorit

te ti. Sepse ty të duhej një lopë. Sepse!.. po, po. E kuptoj!.. Kjo ndodhi vetëm përkohësisht!

— S'kupton gjë ti, jo! — i thashë. — Sepse po të kuptoje, para se t'ja nisje asaj llototitjeje pa fund, do të kishe pyetur dhe do të kishe mësuar se xha Golja e kishte shtëpinë gollash e do ta zinte dimri në kasolle, se vëllai që mori mëshqerrën është i varfër e me një rreth fëmijë. Mbase do të dukeshin gabim të gjitha ato që bëra unë, po mbase dhe nuk e bëje kaq tërkuzë. Po ti s'bëre asgjë dhe ma vure damkën. Pse? Sepse doje shembullin ti! Më merr vesh? Jo, s'besoj se më merr vesh! Bile ti nuk e merr vesh edhe pse je aty ku je!.. Po unë erdha të të them ta mbyllësh sqepin, se më ka ardhur në majë të hundës dhe s'më bëhet të punoj kur dëgjoj këtë histori të ndyrë! Dhe aq më bën në s'gjen dot ti rast tjetër që ta kesh si shembull!

Ishte mbledhur i ziu njeri grusht, sikur po e përpinte dheu. — Ja kështu më ndodhi, more djema! Kështu, more ti Uan Malltezi, si të thonë — tha ai.

Ne heshtnim. Në sytë e vajzës nga kombinati ishte habia.

Duro Malltezi u gëlltit me mundim dhe u ngrit më këmbë.

— Kur ka ndodhur kjo, shoku Soto? — pyeti.

— Andej nga vitet pesëdhjetë — u përgjegj Sotua.

— Historira të vjetra — tha ai. — Tani, shokë, kemi dy propozime: Ai imi, dhe ai i Soto Vilzës. Le t'i hedhim në votë...

Mirëpo ajo flokëverdha e kombinatit ja dha befasi një të qeshure sikur rrokulliseshin kanaçe dhe e qeshura e saj na u ngjit të gjithëve. Dolëm jashtë. Dikush i binte çangës për darkë. Shushurinim nga era gjethet e plepave në mes të të cilave ishin montuar llamba elektrike.

NË TREN

Mbi platformën e stacionit rëndon zhegu. Vagonat e vjetër mbi linjat e vërbëra, hekurishtet, pllakat e çimentos shfryjnë dumanë me afshe të vala si gojë furrash dhe çdo gjë është e mbuluar me një pluhur bojë ndryshku.

Një grua e merr të bijën për dore dhe të dyja tërhiqen në një skaj të platformës ku është një çesmë pa ujë. Dy djem, të mbështetur në telat rrethues me kurrizët lakuriq, hanë shalqin dhe pështynë me përtesë fara të kuqe mbi asfalt. Lëngu i shalqinit u varet nëpër buzë si jargë dhe gruaja pështyn me neveri. Gruaja e brendh vështrimin e saj si prej zogu të trembur në të gjitha anët e platformës dhe ndjenja e një frike të panjohur i fërgëllon në shpirt dhe i trazohet me ndjenjen e mërisë dhe të përbuzjes për gjithë ata trupa njerëzish të zhveshur ose gjysmë të zhveshur që kullojnë djersë. Vajza lëviz si e mpirë, me gjymtyrë të drunjta. Por gruas i duket sikur vështrimi i së bijës është i dyshimtë dhe i lëvizshëm si zhivë. Vajza shvesh me ngathësi xhaketën prej akriliku dhe llërret e bardha e të plota i fërgëllojnë nga një dridhje e nga një morrnice e lehtë. Gruaja e lëshon shaminë e bardhë si strehë mbi sy. Fytyrën ja mbulon hija e shamisë por megjithatë i zhehit kryet sikur ka brenda një tufë zhuzhakë. Ndofta prandaj edhe mendimet i ka shumë të vala dhe i dridhen ashtu siç dridhet edhe zhegu mbi zhukat e mbira në rërë. Vajza vështron detin që dergjet e dremit

nën dritën e madhe të diellit. Platforma e stacionit është afër detit. Ajo sheh se si hipin njerëzit në një vapor të vogël turistik. Ajo s'kishte hipur kurrë në një vapor turistik. Bile, ajo s'kishte hipur as në varkë. Varkat e plazhit duhet të jenë më të mëdha se ato të liqenit artificial që i kishte parë një të diel kur kishte dalë shetitje me shoqet. Ajo vëren edhe katër vajza që lëpijnë akulllore. Njëra e ka gjoksin shumë të hapur dhe që të katra kanë funde të shkurtëra. Ajo s'ka mbajtur kurrë fund të tillë. Njërës i duken format e rrobeve të banjës që nuk i janë tharë ende.

Gruaja kthen fytyrën nga qyteti dhe mundohet të shohë afrimin e trenit nëpër shina.

Ato kishin ardhur vizitë te vëllai i saj që banonte në Shkozet. Vajza nuk e dinte se përse kishin ardhur ashtu papritur për vizitë dhe as që i shkoi ndër mend se kjo gjë u bë që atë ta shihte një njeri. Atë mbrëmje, si rastësisht, te xhaxhai kishte ardhur edhe një njeri tjetër. Shumicën e kohës ata të dy kishin luajtur tavëll dhe ajo nuk e kishte vënë re mirë sepse e kishte mendjen te qëndizmat e shumta që kishte përgatitur për pajë Luljeta, kushërira e saj që ishte fejuar në Elbasan. Nënës, nga ana e saj, ky burrë nuk i kishte pëlqyer. Vështrimi i tij ngulmonjës e i pacipë ju duk sikur e shvishte vajzën e saj. Ky duhej të ishte zagar burrë. Pa le që ishte edhe i madh nga moshë. Pse, ç'e kujtonte vajzën e saj ky i vëllai? Të mbetur e dinte? Punë e madhe se ai burri na paska një pozitë të mirë! Vajza e saj është si dritë dhe nuk i ka dalë as gjysmë fjale, larg qoftë! Ajo ju merit të vëllait për këtë zgjedhje dhe kjo fejesë nuk do të bëhej. Po i vëllai ishte finok i madh. Bënte sikur në këtë mes i fyeri ishte ai dhe mezi i tha udhën e mbarë.

Sheshi i stacionit tani është mbushur deng me njerëz dhe lëvizja e tyre të merr sytë. Koka. Krahë të nxirë dhe të rjepur. Lëkurë e rjepur. Vajza pa cipë.

Gruaja dhe vajza ishin nga i njëjti qytet i madh me udhëtarët e tjerë. Ky qytet ishte rritur si një përbindsh me njerëz të ardhur nga krahina të tjera, që flisnin secili sipas të folmeve të tyre dhe gruaja mendonte se të gjitha

zakonet e mira dhe namuzin e qytetit i kishte marrë lumi tani. Dhe shkak u ishin ata të ardhurit e pacipë. Ajo vetë ishte nga ato familje të vjetra të qytetit që i kishin pasur rrënjët po këtu dhe që bënë një jetë të veçantë e të këndshme nëpër shtëpitë e vogla përdhese. Kjo ishte një jetë më vete, që asaj i kishte pëlqyer shumë, po të ardhurit, që e shtonin qytetin, thoshin se ajo nuk u pëlqente. Lagjja e tyre tani s'njihej më. Ishte bërë mëmëligë. Zakonet ishin marrë nëpër këmbë. Thoshin se çupat e Stërmasëve, që ishte derë nga të vjetrat, tani vinin çdo të diel në plazh dhe i ati, rryp kaishi, s'bëhej merak. Vajza e saj, shyqyr s'kishte ardhur kurrë këtu. Kishte vëllezërit ajo, shyqyr, dhe ata s'e linin të bënte çap!

Gruaja dëgjon fërshëllimën e lokomotivës dhe turma lëviz drejt trenit si e shtyrë nga era. Ato mbeten të fundit dhe hyjnë në korridorin e vagonit atëhere kur ai është mbushur plot me njerëz. Gruaja e tërheq të bijën për dore, del përpara dhe mundohet të çajë nëpër turmë. Që tani asaj filloi t'i mbahet fryma dhe e ndjen se si i mbijnë e i lëvrijnë në gjithë trupin djersë të vala. Fustani i ri, prej një stofi të mirë të errët, i është ngjitur pas trupit. Ajo kthen kokën dhe heton sytë e vajzës. Sytë e saj i duken të lodhur e si të përgjumur. Në shpinë të saj është ngjeshur një grua e veshur si vajzë me një fustan të bardhë e të tejdukshëm. Vajza-grua, mban me kujdes ngritur mbi krye një kasetë të vogël druri. Ajo thotë një herë me vete: «Ç'mund të ketë ajo grua-vajzë në atë kasetë që e ruan sikur e ka prej kristali?» Por pastaj qetësohet dhe bën përpara. Pas pak, nga fundi i korridorit, vjen një valë tjetër, njerëzit dynden e ngjeshen njëri me tjetrin dhe ato vetëvetiu shtyhen më tej. Gruaja është tani nën ventilatorin dhe herë pas here ndjen ajrin e ftohtë që i than djersët e fytyrës. Kjo freski i pëlqen dhe ajo vendos të mos bëjë këmbë më tej. Ajo s'ka udhëtuar kurrë në mes të një turme të tillë. Sytë e saj kërkojnë ata të vajzës dhe e pyesin: «Ç'bëhet kështu?»

Vajza buzëqesh me drojtje. «S'kuptoj asgjë!» — thonë sytë e saj.

Një djalosh korrozi ja lëshon vendin e vet me mirë-

sjellje dhe bën të zërë vendin e saj në shpinë të vajzës, po ajo i rëndon mbi supet dhe e ul në vendin e tij. Pastaj vagoni lëkundet dhe treni nisët. Të panjohurit rreth saj gumëzhijnë dhe ajo kap me vesh ca fjalë pa kuptim që e mërztin.

— Budallallëku më i madh është kur lahesh afër bregut. Uji është i pastër vetëm në thellësi, te tramplini...

— Njëzet herë i rashë bregut nga «Iliria» te «Teuta» po nuk e pashë më...

— Ama ç'mburravec!

— Po ta dija me siguri se ishte në rërë, edhe njëzet herë të tjera t'i bija, nuk më vinte keq!

— Ti nuk noton dot deri te tramplini. E di unë...

— E ruajnë shumë të vëllezërit...

— Mos e bëj atë provë, se do të vesh në alarm varkat e shpëtimit...

— Kur e kujtoj të dielën e shkuar që...

Ato të dyja ngjasin shumë me njëra-tjetrën. Po ai ballë i ngushtë nën një kurorë të zezë flokësh, hunda pak me samar, goja e madhe, sensuale. Vajza është një kokë më e gjatë. Nën fustanin prej basme i dridhen gjinjët dhe ajri i ftohtë i ventilatorit e gudulis e i hyn midis tyre. Befas, gruaja vë re se tani ndodhen në mes të meshkuve. Para vajzës është shpina e një djali të gjatë flokëverdhë. Në krah të saj një burrë me flokë pak të thinjur në tëmtha dhe me syze. Në anën tjetër është një djalë i imtë që mbështetet në krahun e ndenjësës. Ky është llafazan i prapë. Sytë e gruas mbushen me dyshime të egra dhe me urrejtje. Ata shkundin kudo mijëra dyshime, si fletë të zverdhura. Treni lëkundet si një i dehur dhe zhurmat e tij varen kërcënuese në ajër. Sytë e gruas mjerohen. I duket vetja fare pa fuqi, trembet. Vë re se gjinjët e vajzës janë mbështetur pakëz në shpinën e flokëverdhit. I bëhet se ai, i panjohuri flokëverdhë, e ndjen atë prekje të lehtë, dridhërohet për atë prekje dhe prandaj e kërkon duke e hepuar edhe më shpinën prapa. Vajza vështron tani përpara dhe ajo nuk ja sheh më sytë. Por ajo vëren se si ngjitet e shtohet në qafën e në llërët e saj të bardha një ngjyrë e kuqërremtë. Kjo është ngjyra e diellit të gushtit

që ra për herë të parë në një lëkurë kaq të bardhë, po gruaja nuk e di dhe as që do ta dijë këtë gjë. Ajo është e sigurtë se kjo është kuqërremja e turpit. Pastaj i bëhet se edhe vajzës ja ka ënda atë prekje të lehtë. Ajo bën një lëvizje të shpejtë e të vendosur. I shtyn me bërryl burrin me syze dhe vajzën e saj dhe del vetë prapa shpinës së flokëverdhit. Vajza tani është vendosur në vend të sigurtë, midis saj dhe burrit me tëmtha të thinjur. Ai i duket njeri serioz. «Ai duhet të jetë i martuar. Kurse ai flokëverdhi,... atë do ai... Kurse ky tjetri është burrë i mirë dhe serioz. Jo si disa... Megjithëse ai është ende i ri. Po të mos kishte disa thinja, do të dukej fare i ri. Ai duhet ta ketë rrethin e unazës në gisht. Paçka se nuk i duket, sepse i ka duart të varura poshtë, po ai duhet ta ketë me siguri rrethin e unazës».

Ajo qetësohet një copë herë dhe vetëvetiu i vjen të mbyllë sytë. Djersa i ngjitet në fytyrë. Tani ajo e ndjen edhe më shumë djersën sepse është qetësuar dhe s'mendon më asgjë të trishtuar, nuk ruan më asgjë. Pastaj e ndjen erën e ftohtë të ventilatorit dhe kot më kot mundohet të shohë diçka prapa xhameve të syzeve të burrit. Po xhamet e syzeve të tij janë shumë të errëta. Përse i mban këto syze kaq të zeza? Mos është qorr? Po kush e mban për dore? Jo, jo... s'është qorr po këta mbajnë të gjithë syze tani. Ajo nuk sheh asgjë përveç fytyrës së saj të shtrembëruar që pasqyrohet në xhame si në një pasqyrë me avull. Gruaja vëren se është afruar këtu edhe ajo gruaja — vajzë me kasetë, që i ka të gjitha të tejdukshme. Burri me syze ja ka nisur një bisede shumë të përzemërt me vajzën. Ajo, e pacipa, vajza-grua, nxjerr nga kaseta disa fletë letre vizatimi dhe ja tregon atij. Gruaja vë re se në to janë vizatuar trupa njerëzish lakuriq... «O, ç'turp, e pacipa! Kjo qenka e përdalë! Kurse edhe ai... që duket aq serioz, qenka një... Qenka një zagat nga ata që... Këta janë më të rrezikshmit! Këta, tridhjetë e pesë, dyzetvjeçarët... Punë e madhe se janë të martuar!»

— Oi!, ç'fatkeqësi! Kemi shumë pak njerëz që e kuptojnë pikturën e vërtetë! Kurse ju... Unë e vura re menjëherë këtë gjë! Ky është një akuarel! Po, po!

— Portreti i këtij... natyrisht,... do t'ju shërbejë për ndonjë kompozim...

— Po, po... Për një kompozim...

— Po ky pejsazh...

— Hë?.. A nuk të kujton pak atë të Saliut që bëri bujë në ekspozitën e fundit?..

— Në kompozimin tuaj... ishte i spikatur portreti i atij inxhinierit...

— Më ka pozuar një alamet djali... Oi! Ç'alamet ishte! Është portreti i tij!

— Kishte shumë ngrohtësi...

Fytyra e vajzës me fustan të bardhë ka disa rrudha të lehta rreth syve. Ajo është e shqetësuar shumë për to, dhe ja tregon burrit me syze. Ai ja prek ato me dorë, si mjek. «Nga dielli... nga dielli...» — dëgjon ajo nëpërmjet kaosit të zhurmave zërin e trashë të burrit. Pastaj ai e heq këmishën dhe mbetet vetëm në kanatjerë. Trupin e ka të nxirë. Llëra e tij prek rastësisht llërën e vajzës së saj. Asaj i duket sikur ngjyra e kuqërremtë është shtuar edhe më në fytyrën e vajzës. Tani ajo e ka fytyrën e vajzës karshi dhe vëren se sytë e saj janë pulitur e shohin larg. nëpër gjelbërimin e fushave, me ëndërrim. I bëhet se vajzës i vjen mirë nga prekja e burrit në llërë. Ajo e shtyn në mënyrë energjike burrin me syze, që habitet fare nga kjo gjë. Tani e ka vendosur vajzën midis vetes dhe djalit të imtë llafazan. Ky i duket i vogël. Është edhe llafazan, pra e ka mendjen te fjalët. Treni nxiton. Lëkundjet shtohen edhe më. Ajo mundohet të dëgjojë me saktësi se ç'llomotit ai thatuqi. Duhet ta dëgjojë mirë se ç'thotë ai. Mos thotë edhe ai maskarrallëqe si këta të dy të pacipët? Ai flet shumë shpejt dhe ajo dëgjon vetëm ca fjalë: «ishte një copë që...»

Dhe ai me të tjerët, pasi flasin disa herë për një «copë», ja marrin një kënge.

Treni nxiton si i harbuar tani. Të gjithë i ndjejnë lëkundjet e tij dhe lëkunden me përtesë. Asaj i duket sikur gjatë këtyre lëkundjeve këmba e djalit thatuk afrohet dhe e prek pulpën e vajzës së saj. I vogël, i vogël por...

Lëvrin tërë nerva. Nuk zë vend gjëkund. Shtyn për-

sëri me bërryle, çan përpara dhe e tërheq vajzën për dorë. Vajza e ndjek pas me trishtim, si manare.

Më në fund, ajo është larguar nga ai rreth njerëzish të pacipë dhe tani ato janë midis një grupi vajzash. Këtu ka edhe disa djem me kanatjere, por shumica janë vajza. Në shpinë, përpara krahëve, ato kanë tani vetëm femra.

— Unë bëja sikur nuk e vija re, po ai vinte pas meje. Ti e di, ishte ai që të kam prezantuar...

— Pastaj?

— Unë e shihja me bishtin e syrit dhe mundohesha t'i bëja një shenjë që ta kuptonte...

— Pse?

— Se isha me atë kushëririn pra...

— Edhe?

— Ai u bë xheloz, se nuk e njihte kushëririn dhe më shihte me një inat që... thashë se më përpiu!

— Të dashka shumë!

— Vdes!

Shqetësimi i gruas rritet dhe e mbërthen si një makth. I bëhet se është në një ëndërr dhe e ka pllakosur hija. Po s'është ëndërr. Ja, vajza e saj po shikon mbrapa, po shikon grumbullin e njerëzve ku kishin qenë më parë. Ajo ndofta kërkon sytë e flokëverdhit!

Fytyra e flokëverdhit i ngatërrohet me atë të burrit me syze, pastaj me atë të asaj së pacipës që kishte vizatuar njerëz lakuriq, që i kishte futur vizatimet në një kasetë dhe që e ruante kasetën sikur e kishte prej kristali...

Treni uturon dhe vështrimi i saj mjegullohet. S'di nga ta ruajë vajzën më parë. Të gjithë ja kanë qepur sytë asaj, fytyrës së saj, llërëve, gjinjëve... Dhe të gjithë zagaret i shkelin syrin. Dhe vuajtja e syve të saj rritet e rritet. Ku ta fshehë vajzën nga ato vështrime lakuriq, nga ata krahë lakuriq, nga ata trupa la...

Dhe, sa më shpejt trokon e ecën treni, aq më shumë vuajnë e ngrijnë sytë e gruas që kishte ardhur në Shkozet me vajzën për dorë!

ÇESHTJA E PULAVE E TË TJERA

(Ndaj të gdhirë, Fuzuliu pa një ëndërr të llahtaritur. Sikur kishte dalë një lumë i turbull dhe kishte bërë shtrat udhën që nga shtëpia e tij deri në kryesi. Ai hapi derën si çdo ditë, por valë ujërash të ndyra e të verdha ju llokoçitën mu në prak, sikur zjenin dhe pastaj u bënë si ca gjuhë me qelb që i lëpinin gishtërinjtë e këmbëve. Sikur një zë vëngonte nga nën uji dhe e përqeshte «Fu... fu... li Fu... fu...li!» Kurse biçikleta i kishte fundosur dhe sikur ai tha me zë të lartë; «Bobo! ç'do vonohem në zyrë!» Pastaj mori govatën ku u shtinin gëzhuta pulave dhe e bëri si varkë Po më s'mbante mend, ju mbyt edhe govata apo doli në breg...)

Ëndrrën ja rrëfeu kryetarit Mystehak Mullamake.

— Ujin e turbull dhe këmbët e z bathura i kam ters! — tha Fuzuliu. — Edhe atëhere kur na polli belaja me ata revizorët, e pashë veten këmbëzbathur dhe sikur haja jeshil. E mban mend?

— Kur shikon ujë, është mirë — kundërshtoi korrieri Hyskë — se uji të shpëlan të ligat!

— Mos bëni petulla me ujë tanithi! — tha Mystehaku. — Ëndrrat janë dobiçë të fesë dhe prandaj duhen hedhur përrenjve si këlyshët e tepërt të bushtrës!

Në drekë herë, shtrëngoi vapa. Fuzuliuut s'i bëhej për punë. Zhubroste nëpër duar një fletëdalje me firmën e

përgjegjësit të blegtorisë, nga pularia. ku shkruhej se ishin therur gjashtë pula për nevoja të kryesisë. Në ç'zë të shpenzimeve duhej t'i hidhte këto të shuara pula? Kish dhe atë parandjenjën e ligë që nga mëngjezi dhe sido që ajo çështja që ëndrrat janë dobiçë të fesë ju duk shumë e mençur, përsëriste me mend: «për të mirë më daltë!»

Meqë nuk i dha dot përfundim se në ç'zë duhej t'i pasqyronte pulat, vendosi të pyeste kryetarin Mysto. Mystua u nxeh.

— Mor! More! — tha. — Kush e mëson atë Shuqon të na sjellë karturina të tilla xhanëm?

— E hedh barrën nga kurrizi i tij, mbi tonin — tha Fuzuliu.

— Herë tjetër. mos na ha kohën me çështje pulash! Kryesia ka pasur dhe do të ketë shpenzime, se shqiptari, s'ka virtut më të madh se sa trimërinë dhe mikpritjen? E thotë edhe historia!..

— Po pse nuk hap aty një qitap «shpenzimet e mikpritjes!» — tha Hyska me naivitet.

— Mos na fut hundët edhe ti tani! — tha Fuzuliu.

— Llogaria s'ka qitape, se është shkencë ajo!

— S'e dija! — tha Hyska.

— Bëni një procesverbal. Ngordhje. Ose të ngrëna nga gjeraqi. Dhe Shuqua ta firmojë — tha Mystehaku.

— Ka një kokë ai Shuqua që... — tha Fuzuliu dhe pëshpëriti me vete: «Rrëmbyer e ka marrë shoku Mystehak! Rrëmbyer! Mos më rrokullisë pas vetes edhe mua pa?! Mos është ky lumi i turbull? Për të mirë më daltë!»

— Shuqua ka një javë që ruan gjeraqin me çifte — tha Hyska.

— Krisma në mes të fshatit s'dua unë! — tha Mystehaku. — I thoni të zërë pusi andej thellë, përrenjve!

— Përrenjve ka breshka! — tha Hyska në mënyrë të pakuptueshme.

— E ç'do të thuash? — tha Fuzuliu gojëhapur.

— Po mbase vjen vërdallë edhe ndonjë gjeraq! — tha Hyska.

— Po shpenzimet ku, pa? — tha Fuzuliu sikur ishte kujtuar papritur që u harrua më kryesorja.

— Do të të udhëzoj nesër — tha Mystehaku. — Na-
ta është për mendime, dita është për punë!



Asnjë fshat nuk vuan për korrierë këmbëshpejtë, po askush nuk e meritonte më shumë se xha Hyska vendin e korrierit. Sepse, në janë dendur, si këpurdhat këmbëshpejtët, hokatarët si ai janë të rrallë si xhirokulli¹⁾. Në atë kohë për të cilën bëjmë fjalë, Hyska kishte lëmin e shakasë në formë fjalimi. Dëgjo e bot, ditë e natë fjalime nëpër mbledhje, ju mbush mendja se edhe ai mund të fliste dhe bëri gati nja shtatë referate me fjalë të mëdha e të huaja, doemos, rroma për toma. Më i godituri i referateve ishte ai i «raportit vjetor për bujqësinë» ku imitonte zërin e fjalët e Mystos, po kryetari nuk zemërohej sepse mendonte që bota imiton vetëm njerëzit e mëdhenj, përderisa edhe majmunët, që janë kafshë budallaqe, imitojnë njeriun që është aq i zgjuar. Po më vonë një i deleguar i tha se me atë referat prekej disi prestigji i kryesisë sepse Hyska thoshte shumë budallallëqe, kështu që ai e urdhëroi Hyskën ta avullonte nga hamamet e kujtesës atë referat.

Në zyrën e Mystehakut kishte ardhur shefi i bujqësisë së rrethit. Hyska nuk ja dinte emrin po ai ishte i mendimit se është më mirë mos t'ua dish emrat shefave sepse ndodh që ngatërrohesh dhe, në vend që t'i thuash shef, i thua Sadik për shembull, mirëpo shefave u pëlqen më shumë emri shef se sa emri i kumbarës. Hyska rrinte në korridor, në një bankë të shtrembër e pa një këmbë dhe i mbante veshët bigë, se mos e thërrisnin nga zyra për punë. Po kur njeriu i mban veshët bigë, sado të qëruar ta ketë zemrën, vetëvetiu përgjon diçka, prandaj

1) Xhirokull — bimë medicinale, me vlerë të madhe.

edhe ai dëgjonte copat e fjalëve që dilnin nga zyra.

— Nuk është në binarë SMT-ja, jooo! — ankohej Mystehaku. — Riparimet i kanë bërë shkel e shko dhe autokombajna që na kanë sjellë është si ai kau plak që mezi vihet në brazdë. Po shyqyr krahët dhe lejlekët, se do na thërrmohej gruri!

— I kam shifrat operative, i kam në evidencë! — thoshte shefi. — S'është nevoja të më raportosh. Ja... më rezulton që vetëm me shpendët s'po bëni mbarë!

— E pa! A bëhet stan me lepuj e me pula, more shoku shef? Ty të rreh mendja ditë e natë te zogjtë e inkubatorit dhe i sheh si dritën e syrit, kur fup... të pëlçet pseudopestis¹⁾ në të rriturat! Pa le që ana jonë mban edhe shumë gjeraqë dhe nga dy pula në ditë sikur i kanë bërë tain!

— Ja... ja... ja! Kaq shumë?

— Për ideal! U kam thënë edhe grave që të thërresin «Uj... uj... uj...» se tremben ashtu të përshkretët, po do ti që e mësuan edhe këtë avaz e s'duan t'ja dinë më!..

Më tej Hyska u mërzi se ata të dy zunë një muhabet për flamurët e garave, jo po kush mund ta marrë e më the të thashë dhe u ngrit. Nga vapa zukasnin tufa të tëra me miza, sepse oborri kishte pleh. Ai zuri t'i qëllonte me vrasësen prej meshini dhe kjo gjueti e thithi si kënetat gjuetarin e rosave, dhe nuk e vuri re se në kryesi hyri edhe një njeri tjetër. Ky ishte inspektori i sigurimeve shoqërore që merrej me dëmtimet në bujqësi, shoku Nesti. Kryetar Mystehaku doli në korridor dhe u vrëjt kur pa muret me njolla mizash të vrara.

— Po ç'bën, or t'u shoftë fara! — tha! — Leri mizat në punë të tyre, se na turpërove!

— Po na pinë, o të shkretën, e më s'gjejmë rehat! — tha Hyska.

— Nesër merr kapëse në dyqan! Tani thuaj Zenepes të gatujë dy pula se kemi shokët për drekë! Po shpejt, ë!
Hyska vrapoi në pulari, mori pulat, u kthye në mensë

1) Pseudopesti — mortaja e pulave.

dhe ja filloi përsëri me mizat. Por... paskej qenë ters ajo ditë dhe s'kishte për të pasur qetësi, i gjori Hyskë! Dhe kurrë? Në këtë zheg furre! Erdhën kular dy njerëz me uniformat e blerta të pyjeve. Gjithë ata me uniforma Hyska i merrte për rojtarë po doemos që gabohej, sepse uniformë kishte edhe drejtori, kishte edhe tekniku i zonës që hynë brenda atë çast.

Brenda u ndez biseda dhe më s'po merrej vesh sepse të gjithë nxitonin të zbraznin thesin e diturisë së tyre. Pastaj Hyska zuri t'i shkoqiste zërat (sepse koha ç'nuk të mëson!). Nesti i sigurimeve kishte një zë të hollë e të lartë që i solli në hatër këngën e atij gjelit zijosh e të çakërdisur në orar, që ja thoshte atëhere, kur të tjerët tulateshin nga vapa.

— Ama vapë! — ankohej vazhdimisht shoku Nesti.

— Piqet kulaçi në diell — thoshte në mënyrë pro-verbiale drejtori i pyjeve.

— Vetëm birra e ftohtë e shuan këtë! Po ku ta gjesh?

— Për miqtë, edhe qumësht dallëndyshe gjendet në kooperativën time!

Ky ishte Mystehaku, doemos.

— Shoku Mysto! Ne erdhëm për ata milorët që kemi folur — tha drejtori.

— Thikën presin! — tha Mystehaku. — Po pse nxitoni kështu? Prisni sa të thyejë vapa!

— Do presim doemos!

— E po atëhere, mirë se na urdhëruat për drekë! Hyskë! — thirri Mystehaku.

Hyska hodhi vrasësen e ndyrë të mizave dhe hyri brenda. Mystua ngriti lart si furkaçe tre gishta të zinj nga qimet. Dhe, meqë çdo korrier i mirë e di që, kur të flet përgjegjësi me nojma, po të mos jesh kokëtrashë, edhe ti duhet t'i përgjigjesh me nojma, nxori dorën e djathtë përpara, që të thoshte «i kuptova të gjitha» pastaj i ra gjoksit me grusht dhe kjo lëvizje tha: «çdo gjë do bëhet si jo më mirë!» Ja mori vrapit prapë deri në pulari. Zhegu ishte trashur dhe sytë i zhezhisnin nga lodhja, prandaj nuk vuri re se ç'pula ishin ato që mbante për këmbë. Por

udhës i pa njëherë me bishtin e syrit dhe u trondit. «O dreq! hajvane fare ajo rritësja e pulave! E qysh guxoi të jepte për të therur gjelin zijos, çamarrokun e orëve? O, i ziu gjel! Ku do vesh?» — I erdhi keq dhe ju zbruzemra. Mori një vendim. U kthye dhe e lëshoi gjelin në oborr të polarisë. «Le të hanë nga një kopan më pak!» — mendoi. Gjeli shpupurisi krahët dhe u ngjiti rëndë-rëndë mbi pullaz. Në mensë nuk qëndroi se kishte zemër të dhimshme dhe nuk shihte dot gjak me sy, pa le të ishte edhe gjak pule. Më vonë bëri edhe një udhë tjetër deri në klub, për birra. Posa i çoi birrat në mensë, ku ishte shtruar dreka, të gjashtë burrat lëshuan një «oh!» habie. Mystehakut i ndritën faqet nga kënaqësia e surprizës.

— Ilaç është, e shkreta birrë! — tha shefi.

— Qëkur erdhi birra në fshat, nuk e ve njeri në gojë rakinë — foli për herë të parë Fuzuliu, që kishte heshtur tërë kohën si vuv.

— Bëjnë mirë! — tha Nesti. — Në Çeki, ku kam studjuar unë, birrën e pinin në vend të ujit, se birra s'është pije alkoolike!

«Ama ç'na çuditi edhe ky!» — mendoi Hyska, që rrinte si murgaç i zbythur në një qoshe të mensës dhe gati për urdhëratë.

— Me meze të tillë, sikur tërë ditën të pish, nuk ke të nginjur — tha drejtori i pyjeve.

Pastaj bisedën e rrëmbeu dhe e bëri fir oreksi, dhe dëgjohej se si dikush përplaste buzët me zhurmë.

«S'e preu dot këtë të shkretë huq ky kryetari ynë» — mendoi Hyska dhe me bishtin e syrit pa se si nguteshin të gjithë të mbaronin një orë e më parë, sikur e kishin lënë ujin në brazdë! Por po atë çast Mystehakut i ra në sy se edhe një njeri tjetër rrinte i mjeruar në një qoshe dhe, meqë ai njeri mund t'i hidhte tani zjarr bisedës së platitur, e thirri. Hyska u afrua me përtesë në tryezën që tani ishte bërë sikur kishte rënë karkaleci.

— Ngrije! — i tha kryetari dhe i zgjati një shishe birrë. — Ngrije dhe thuana atë referatin për vallen bark më bark! Po ta qash fare, ama!

Në trurin e Hyskës të zjerë nga vapa shkrepri një mendim që e bëri të vinte buzën në gaz.

— Do them një referat të ri — tha. — Sot e bëra. — Dhe mori pozën e oratorit. — Të dashur shokë! — tha — Tërë bota është në një mendje për shijen e mishit të pulës dhe këtu s'ka kontradhikta fare. Pula ka rëndësi të rëndësishme se ajo është për ditë të bardhë e të zezë dhe të nxjerr faqebardhë përpara mikut.

Mirëpo pula ka një kontradhiktë me gjeraqin. Gjeraqi është qerrata i madh ai, si Izraeli! Vërtitet e vërtitet, si i pafaj, kur fup!.. vërsulet si i babëzitur. Unë kam bërë një shpikje se si mund të zgjidhet çështja e kontradhiktës së pulave me gjeraqin. Them që gjeraqët duhet të tremben e të bargarisen përrrenjve, për breshka. Jo të mos jenë, se ashtu s'ka lezet bota, po të dalin edhe ata njëherë për breshka! Pra, të dalë tri ditë me radhë fshati, kokë më kokë e jo një këtu e një përtej dhe me goditje të përqëndruar të thërrasë «uj... uj... uj... kokën në pelgut!» Ashtu do tremben e do mos vërtiten më këtu!

Fuzuliu, që s'kishte folur veçse një herë, i shkau përdhe furkulica. Kryetar Mystehaku uli vetullat dhe një pikë yndyre i pikoi nëpër mjekër.

— E ç'ishte kjo, more!? As mish as peshk! Asgjë për të qeshur s'kishte! Ke nisur të rrëgjohesh dhe s'bën dot më referate të reja, po thuaj më mirë atë mbi dëmin që i bën pleqërisë vallja bark më bark! — tha Mystehaku.

Xhamet e dritareve të mensës u drodhën nga një e qeshur e zorshme, po e zhurmshme, si çdo gjë e zorshme.

(Po atë mbrëma Fuzuliu pa një ëndërr tjetër të cilën e harroi në moment. I mbeti vetëm ajo ndjenja e rëndësirës dhe e pikëllimit, si një hidhësi në gojë. Ja tha këtë Mystehakut.

— Budalla! — e shau Mystehaku. — Ti e vret mendjen shumë, dhe ajo nuk gjen dot çlodhje! Hiq dorë! Ja, unë e kam gjetur tani se ku duhet t'i pasqyrojmë shpenzimet e mikpritjes. A nuk e kemi ndarë në planin financiar një fond për mbajtjen e qenve? Ka një zë të tillë aty, ka! Fondi i qenve — quhet. Për qentë e stanit, të kopesë, për konet e zagarët. Mirëpo ne shyqyr atë fond nuk e shpenzojmë dot se vetëm dy qen stani kemi, sepse të tjerët u spastruan kur ra tërbimi. Shënoi pra aty! Dhe vitin tjetër më kujto që ta rrisim ca atë fondin e qenve!

FORTESA

U ul mbi një kërcu shelgu, anës lumit. Ujërat kishin shterur sepse shirat e vjeshtës nuk kishin zënë ende dhe lumi rridhte si i përgjumur.

Ky ishte lumi i tij. Ai mund të përfytyronte kur të desh gjithë bryllakët, gropat, vanat dhe shtjelljet e ujërave. Gjithë femënia e tij ishte këtu: larë nëpër pellgje, fshehur nën hijen e rakitave, shtrirë në barin e livadheve. Ujërat po merrnin ngjyrën dhe ftohtësinë e mugut. Pas kodrës, që nxinte nga dëllinjat, ishte fshati. Ai duhej ta kishte pritur errësirën në dushkerë, po lumi e kishte tërhequr me rrjedhën e tij që i vinte në vesh si një gurgullimë e femënisë. Ai donte të besonte se e kishte mashtruar mugëtira e zakonshme e pyjeve të dendura dhe nuk e kishte kuptuar që ende s'ishte ngrysur. Megjithatë ai ishte i qetë sepse asgjë s'pipëtinte. S'kishte asnjë lëvizje dhe qetësia ngjyrë kafe e pyllit ishte shtrirë si për gjumë në tërë hapësirën që i hante syri. Ishte hapësirë e gjerë, rrethuar me kodra të rrumbullakta, çkërfitur nga ara të pjerrëta dhe ngastra koriqesh të vogla.

Babai rrëfente se dikur të gjitha kodrat ishin të veshura me koriqe dushku e lisi dhe se nëpër rrahet e tyre mërzenin derra të egër. Baldosat vinin natën nëpër misra dhe ata i ruanin misrat prej tyre duke fjetur arave nëpër kasolle kashte. Pastaj baldosat u zhdukën, sepse pyjet u prenë. I prenë ushtri të huaja, që luftonin këtu. Nga gjithë

rrëfimet e fëminisë, ai mbante mend ato të babait për ushtritë e huaja që prenë pyjet dhe ende më lashtë, për kohën kur u vra gjyshi Dine. Historia e gjyshit Dine atij i ishte dukur përherë si një përrallë dhe fantazia e tij e vishte atë gjithnjë me ndodhi të reja e të çuditshme.

Sa vjet shkuan qëkur u tret nën një dorë dhë pylli gjyshi Dine? Gjyshi Dine bridhte me martinë krahut. Babai me maliherr. Ai kishte një patickë. Ai bridhte malit tani bashkë me shokët e batalionit, kurse gjyshi Dine kishte bredhur i vetëm. Nëpër trojet dhe sinorët, si i çartur. Kur e kur, martina e tij qëllonte derra me dy dhe me katër këmbë. Me historinë e gjyshit, ai ishte përkundur që fëmijë, që atëhere kur fërkonte pas gurëve të mbrehjes një jatagan të ndryshkur që e kishte gjetur në tavan. Ajo ishte si një përrallë e zymtë, ku lëviznin nëpër terr njerëz tinzarë, hajdutë e pritarë që mbajnë erë këllirë e thartirë, si qentë e staneve...

... Ishin pesë hajdutë dhe kapedan Shashua gjashtë. Jo komitë të mirë, po hajdutë të gjësë e të njerëzve. Kapedan Shashua e hiqte këmbën osh, si kërcu. Heshtje. Pastaj, zëra të çuditshëm të pyjeve. Pastaj fëshfëritje fle-tësh nëpër opinga. Heshtje. Qukitje të thata qukapikësh. Klithjet e kalit të qyqes. Kërcitje degësh. Fëshfëritje tinzare. Pesë hajdutë. Dhe çalamani Shasho, gjashtë. Mjekërshpupuritur nga era, si prift. Doemos me mjekër si të papa Ndonit, se Shashua ishte njeri i pyjeve. Çalamani përgjon diçka me veshët bigë. Përgjon zërat e pyllit dhe të mbrëmjes. Qan një ulluvegë. Ullu-ullu! Si përherë. Dhe Shashua ka frikë nga diçka. Trembet, sepse e ka mbushur kupën e zullumeve. «Punë e madhe se e kam mbushur», mendon ai. Ja kanë bërë benë të gjitha fshatrat. «Punë e madhe se ma kanë bërë benë», mendon ai. Sonte ai ka zënë një gjah të majmë. Një treskali¹⁾ që kthehet nga Mali i Shenjtë. Treskaliu ka dy mushka të zeza, po paratë nuk ja gjen dot. Ai thotë se s'ka para. «Jo, ke! — thotë Shashua. — Diku i ke fshehur! Ku i ke

1) Treskali — nga katundi Treskë.

fshehur, derr treskali!? Ku? S'të dhimset shpirti? Lerë paratë te Shasho Gjergjova dhe shpëto shpirtin! Nxirri! Ti ke paratë e tua dhe të kurbetlinjve të tjerë! Duarbosh s'kthehen kurrë nga kurbeti! Ku i ke paratë, derr treskali?!»

Qan ulluvega. Pylli ka shumë shtigje... Shtigje të verbëra, traga me bar të kalbur, udhishta kuajsh. Njëpër cilën prej tyre zbriste gjyshi Dine? Ai i dinte të gjitha shtigjet. Ato që kishin krye dhe dilnin diku, dhe ato që ishin të verbëra dhe mbaronin në një burim. Ai zbriste nga një shteg i verbër. Ai mbajti vesh. Era solli fjalë. Fjalët i rënduan si gurë varur në qafë. «Ku i ke paratë?» — thoshte era. Gjyshi Dine fshihej prapa një tringu ahu. Hajdutët ishin më këmbë. Mushkat kullosnin bar në rrahun e pyllit. Samarët i kishin bërë copë-copë. Hejbet i kishin grirë. S'kishin gjetur asgjë. Mjekrat ua merrte era. Fjalët ua merrte era. Treskaliu dergjej më krahëzaj, syzgurdulluar. Shashua i vinte vërdallë. Si ujku deles. Kur do t'i hidhet? Po ai nuk i hidhet. Ai bërtet dhe tund jaganin. Të tjerët bëjnë sehir. Gjyshi ve martinën në sy. Një krismë dhe Shashua këputet në arrëzë të qafës. Po të tjerët janë pesë dhe s'bien lehtë në dorë. Përfytyrimi i tij s'i thotë më asgjë. Diçka ndodh me gjyshin Dine. Asnjëri nuk di se ç'ndodh. Shumë vjet më vonë, vijnë zëra nga larg, nga hajdutët që kanë shpëtuar, që pëshpërisin: gjyshin Dine, treskaliun dhe Shashon i kanë mbuluar bashkë, në një përrua. Njëri bri tjetrit. Nën një dorë dhe, nën një grumbull fletë të kalbura. Dhe tumbat e tyre i ka sheshuar dimri dhe ujërat e pranverës...

... Ai u përmend nga kujtimet e fëminisë. Këmbët i ndjente të nxehta valë nga të ecurit. Zbathi opingat dhe futi këmbët në ujë. Uji ju duk i vakët. Njëpër të vozisnin fletë të verdha kumbullash. Mbi mish ju ngjiti një fletë. Ai e hoqi. Mendoi se kishte bërë mirë që kishte qëndruar te lumi. Lumi ishte gjithë fëminia e tij...

Kurse tani ai ishte në batalion. Dhe pardje ja kishin ndezur me Ballin në Radom. «Balli e ka lëshuar brezin për sherr — kishte thënë komisar Josi. — E ka lëshuar

për sherr dhe po na e bën borxh! Po ti duhet të mos biesh në sy! Të shpiesh këtë letër dhe të marrësh me vete dyllë blete për spangon e opingave! Pa dyllë, s'qepen opingat që na janë bërë copë!»

Mori përpjetë një udhë të ngushtë. Hyri në shtëpitë e para. Ishte qetësi. I ra udhës tërthor nëpër kopshte, shtyu një lesë dhe u gjend në një lëndinë ku xha Janua mbante bletët. Në prak të shtëpisë u duk figura e zezë e hallë Marës që kyçiti duart përmbi bark. Plaka vrapoi drejt tij dhe e mbështolli me krahë, si për ta fshehur. Ai ndjeu erën e finjës dhe instinktivisht vrojtoi vendin.

— Si hyre deri këtu, ditëzi — tha ajo. — Në fshat janë ballistët!

— Ku janë?

— Janë mbledhur në shtëpi të Semajve. Kanë nxjerrë edhe roje nëpër udhët dhe venë e vijnë si kaposhë.

— Kush ua ka shtruar te Semajt?

— S'ua ka shtruar njeri, jo. U shtruan vetë dhe dërguan fjalë në fshat për pula dhe për bakllava, që hëngërshin këmbët e tyre — mallëkoi plaka.

— Do të më japësh ca pite dylli, se na duhen për spangon e opingave. Unë do të hidhem deri në shtëpi, të shoh njëherë, se kam edhe një porosi për babanë. Do të vij t'i marr afër mesnatës.

Plaka bëri kryqin. Ai u fut nën drurët e kopshteve, ku ishte që tani errësisë. Kapërceu gardh më gardh dhe u gjend në lëmë. Kishte për të kapërcyer edhe një mur. .



«Ky Çalamani më vret sytë! Për atë allah, pikë e kam në zemër që e mbajnë të gjithë për të parë! Kush e vuri komandant atë shtrembo? I parë jam unë! Ndonjë natë do t'ja dërgoj një plumb pas shpine dhe do t'ja thërrojmë kafkën! Të vejë me të shumtët! Fisi ynë, i Daduçëve,

është me nam! Jemi të parë në shtatë fshatra. Kurse ai është kërcu! E mbajnë të parë, sepse ai e mblodhi çetën! Punë e madhe! Edhe unë mund ta mblidhja çetën, po ata derrat tanë kanë shkuar me partizanët, se janë thellësira, vende për komitë ato anët tona.»

Koka po i turbullohej dhe i vinte t'u këpuste një shqelm të mirë të gjitha shisheve që ishin mbledhur mbi sini.

Çalamani pinte ngadalë. Më shumë hante se sa pinte. Ishte njeri i heshtur dhe mërзитеj nëpër ahengje. Po gjithë krerët e tjerë ishin të djegur për aheng dhe ai s'ua prishte dot, se ata ishin shokët e tij të luftës. Një javë të shkuar, në përpjekjen mbi Radom, ua kishin mbathur këmbëve qenat. Vetëm Bezat Bregasi kishte luftuar si trim, me shpirt në dhëmbë dhe ishte vrrarë. Mortja do trima. Mos do hajë mut, si ky Orhan Daduçi? Ky Orhani ja vriste synë. Vishej e kapardisej si bej, me rrobe angleze prerë te terziu dhe kali i tij pullali kishte takëmin më të mirë në çetë. I kishin thënë që Orhani mburrej e thoshte se gjoja kali i tij e linte një të shtënë larg Gjokun e komandantit. Kjo s'dihej. Edhe Gjoku ishte i mirë. Kurse ky nipi i Orhanit, Lulo Daduçi, është një qull ky që i trembet edhe hijes së tij. Vetëm Bezati ishte trim. Po edhe ai u vra.

I zotj i shtëpisë rrinte mbështetur pas murit këmbë-prerë, si i varur. Çalamani bëri shenjë që të hiqnin rakinë e të sillnin bakllavatë.

— Për flamur, po të mos qëndrojë malihërri më këmbë në mes të thelave, do t'ua hedh maceve bakllavanë! Dëgjove, or ti? — tha Orhani.

— Dëgjova, dëgjova. Do të qëndrojë — tha fshatari.

— Jo, nuk do t'ua hedh maceve. Do ta dend ty në gojë, sa të të pëlçasin bulçitë! Ashtu do të ngjallesh! Ç'je ashtu i thatë, si i tharë në tym, o i zi?!

— Nga hallet — tha fshatari.

— Mjaft, se na mërзите — tha Çalamani. — Me të gjete të mbrihesh për shërr? Ke ku ta rrëfesh trimërinë!

— Dhe e kam rrëfyer!

— E dimë! — tha Çalamani.

«Do të ta gjej natën, mos ki dert! Shtrembo! Dhe do të ta hap kafkën me një dum-dum, që të të derdhen trutë! Do të ta gjej natën!» — mendoi Orhani.

Një ballist i moshuar, thyer më dysh nga pesha, solli një tepsi të madhe dhe e vuri në sini. Lulua zhvari maliherrin nga gozhdra dhe hoqi një thelë nga mesi.

— Mos na ndy bakllavanë! — i tha çalamani.

Lulua s'bëri zë. Ballisti i vjetër u përkul në vesh të Orhanit dhe i pëshpëriti diçka. Ky ishte një nga njerëzit që kishte sjellë me vete ai. Çalamani e pa vëngër. Orhanit i lëvizën gjithë muskujt. Ballisti u zbyth drejt derës.

— Ç'thotë? — tha Çalamani.

— Thotë se kanë diktuar një njeri të dyshimtë, të armatosur, që fshihej kopshteve.

— E zunë?

— Jo. Thotë se ka hyrë në një shtëpi.

— Të rrethohet shtëpia! — tha Çalamani.

— Lerma mua! Lerma! — tha Orhan Daduçi. Në sytë e tij të kërcyer, Çalamani pa se si lëvrihej me vërtik sherri. U tërhoq. «Kokën hëngërt!» — mallëkoi.

— Mirë! Shko! — tha ai. — Po e dua të gjallë!

— Gjallë do të ta sjell — tha Orhani dhe doli.

Lulua e ndoqi pas, si kone. Çalamani u mbështet në jastëkët e fortë mbushur me kashtë dhe ju hap goja.

— Një njeri i armatosur! — tha me qesëndi. — Vetëm një! Trimëri e madhe të kapësh vetëm një njeri. apo jo?!

Xhemil Vishti ja dha gazet.

— Le të vejë, që të ketë edhe ai me se ta rrahë gjoksin nesër! — tha Çalamani.

O

Çako Dinua, i ati i partizanit Jake, kishte që në mëngjez në mulli. Mullisi ishte plak dhe ai e ndihmonte.

Nuk deshi të rrinte në fshatin që ishte dinga me ballistë dhe vendosi ta kalonte edhe natën këtu.

Krismat e para nuk i dëgjoi. Gurët e mullirit vërtiteshin qetësisht me atë gurgurimën e tyre të njëjtë që i ngjiste si një këngë e vjetër, ardhur nga vitet e largëta kur punonte nëpër sharrat e manastireve të malit Athos. Ujërat bënë punë nëpër kadet dhe rrihnin e shkumbëzoheshin pas fletëve të pendës. Mullisi plak hyri brenda duke hequr pranë një barrë shkarpa të thata për zjarrin e natës.

— A i dëgjove pushkët, o Çako? — tha mullisi.

— Jo! Ku ranë?

— M'u bë se ranë në mëhallën tuaj.

Çakua mori malisherin që e kishte lënë mbi dhogat e shtratit të mullisit dhe doli jashtë. Mbahti vesh. Fshati, lart në kodër, nuk lëvizte, sikur ishte i tëri prej guri. «Do t'i kenë bërë veshët plakut», mendoi. Por një krismë e vetme, që shqeu qetësinë si një klithmë, e bëri të luante vendit e të përgjonte. Vetëtimthi syri i zuri figurën e një fëmije që vraponte nëpër tragën e jazit. Fëmija dukej e zhdukej nëpër degët e holla e të zhveshura të rakitave. Ishte një djalë. Ai shtyu lesën e shtegut të mullirit dhe mezi mundi të thoshte dy fjalë, duke gulçuar:

— Rrethuan Jaken!

Atij i flakërinë në tru si xixa prushi dhjetëra pyetje. hamendje, dyshime e shqetësime, njëherit. «Jaken? Pse? Ku? si? Ç'kërkon Jakja në fshat? Si do të dalë nga rrethimi Jakja?»

Nuk mundi dhe nuk deshi të pyeste më asgjësend dhe ja mori një vrap të shpejtë përpjetë kalldrëmit. Mullisi plak u drodh. Vuri duart si hinkë në gojë dhe thirri sa i hante në kokë:

— O Çaaako!! Jo andej, more. se udhët janë plot ballistë! Merr udhë nëpër mezhdat e arave!

Çakua u ndal si i prerë, pastaj u përkul sikur po e përgjonin shumë sy dhe u vodh nëpër hijet e manaferrave të mezhdave.

«E, or Jake! Në paç zënë pritë aty ku të kam thënë.

do ta mbajmë ndezur gjatë. sa të gjëmojnë malet! Të kujtohet? Ta kam thënë që ky vend i ngushtë në mes tri plevicave është tamam për luftë. Tri anë janë me mure të trasha dhe përpara shteg i ngushtë e i zhveshur, që mund ta korrësh me plumba. Njëpër mure kam fshehur fishekë malihëri dhe bomba. Fishekët për vete, bombat për ty! Ta kam thënë! E, or Jake. në paç zënë aty pusi!

Atij ju bë se e kishte të birin aty përpara, ashtu të parritur ende, siç e kishte përcjellë dikur.

Silueta e gjatë e Çakos lëvizte tinëz, si hije, në sfondin e mugët. Hëpërhë askush s'e kishte mendjen tek ai, sepse të gjithë zhezhisnin rreth shtëpisë. Krisma të rralla dhe britma pa kuptim i vinin në veshë. Në të hyrë të fshatit, ai u fsheh prapa tringut të një arre dhe përgjoi rrugicën. Nuk lëvizte njeri. Shtëpitë ishin si të shurdhëra. Ai duhej të kalonte tri rrugica të tilla, pastaj lëmin, pastaj një avlli dhe më në fund do të gjendej në fortesën e tij. Por prapa çdo kthese mund të ndeshte ballistë. Atij ju duk se po vonohej shumë duke menduar. Mori pushkën në dorë, i ngriti sigurecën dhe vrapoi. Pastaj u fsheh prapa një avllie dhe priti. Thirrje të pakuptueshme zbrisnin e thërmoheshin njëpër gurët e kalldrëmit. U tërhoq në një qoshe të murit dhe përgjoi rrugicën me një sy. Zbritën duke rendur katër ballistë, kurse nga poshtë vinte Xhemil Vishti. Xhemili i ndalo!

— Ku veni, or u shofshi! — thirri ai.

— Na dërgoi Lulua — tha njëri. — Orhani mbeti brenda shtëpisë, se i vlarë, se i plagosur. Merrni benzinë, na tha, t'i vemë zjarr shtëpisë që të digjet brenda si miu, ai komunisti!

— Kthehuni, hajvanë! Na urdhëroka edhe Lulo buzëqumështi tani! Po xhaxhanë, edhe atë do ta djegë brenda? Kthehuni, se do ta zëmë gjallë!

Çakua priti sa u zhdukën matanë kthesës dhe u nis. Në një qoshe i zuri syri prapë dy ballistë. Qëlloi në vrap e sipër. E dinte që asnjë prej plumbave s'do të zinte në mish, po të paktën ai e spastroi rrugën e tij për disa çaste të shkurtëra. Qëlloi edhe një herë. Plumbi ciflosi një gur në murin e një shtëpie.

Kjo pushkë, që mbillte krisma nëpër udhën e ngushtë, u pa nga shumë pak vetë. Edhe ata që e panë, s'arritën ta qëllonin sepse figura e tij e gjatë dredhonte shpejt dhe u humbiste nga sytë. Kur kaloi nëpër lëmë, i fërshëllyen dy-tre plumba përreth. Mbështeti shpinën në mur dhe përfshiu një hapësirë, sa mund të dukej me sy që aty. Kjo hapësirë ishte e ngushtë dhe nëpër të s'guxonte të lëvizte njeri sepse e hanin krismat që vinin nga shtëpia. U shtri barkas dhe futi një ballë fishekë në folenë e pushkës. Dy plumba njëri pas tjetrit i vezëllinë mbi kokë. Vrojtoi. Prapa trungut të një kumbulle nxinin këmbët e shtrira anësh të një njeriu. Mori shenjë dhe shtrëngoi dhëmbët. Njeriu lëshoi një ulërimë dhe u tërhoq praptazi, deri në shkarrëzimë. Ai u kacavjerr në mur dhe u gjend në hapësirën e ngushtë midis tri plevicave.

Aty s'kishte asnjëri. Jakja ishte brenda.

«Eh!.. or Jake, kur s'të kam këtu», mendoi ai. U shtri dhe zuri pritë prapa murit me gurë të mëdhenj, të zinj, që kufizonte vendin e hapur nga ana e shtegut. Kishte goxha që s'dëgjohej më asnjë krismë. Nxinin dritaret e vogla të shtëpisë. Dëgjohej zëri i Lulo Daduçit:

— Shtyhuni në sulm, or qena, se ma latë xhaxhanë shtrirë në këmbët e atij komunistit!

— Hidhu vetë i pari — bërtiti Xhemil Vishti.

Nja tre ballistë dolën me kujdes në krye të udhës, bënë dy tre hapa dhe u shtrinë. Dy krisma, njëra nga shtëpia dhe tjetra nga plevicat, përshkënditën gurët rreth tyre. Ballistët u zbythën dhe u fshehën pas qoshes.

O

Jakja e kuptoi menjëherë që e patën diktuar, kur vuri re se si vidheshin kopshteve nëpër hijet e drurëve ca hije të errëta njerëzish që mundoheshin të afroheshin në heshtje. Hapi derën dhe shtyu jashtë pothuajse me zor nënën dhe dy motrat e vogla.

— Dilni shpejt! — tha ai. — Merrni nëpër kopshte

dhe futuni në ndonjë shtëpi! Dhe dërgoni fjalë babait në mulli: Jakja është rrethuar, i thoni.

Ato dolën, me fytyra të trembura kthyer drejt tij. Dera mbeti gjysmë e hapur dhe ai i ndoqi me sy, gjersa u bind se nuk i trazoi askush. Vrojtoi përsëri hijet që lëviznin kopshteve e gradinave. Po e rrethonin larg e larg, pa u ngutur, derisa ta ngushtonin darën. «Do të zë pozicion në dritaret e katit të dytë dhe do të mbrohem. Derisa të kem edhe një fishek, do të mbrohem! S'kam ç'bëj më! — mendoj. — Dhe do ta mbaj flakën e pushkës derisa të bjerë natë e thellë! Pastaj ndofta tërhiqem! Ose ndofta dëgjohen krismat dhe ja ndez andej majave batalioni!»

Ky mendimi i fundit ju duk fare fëminor dhe ai qeshi me vete me shpresa të tilla. Batalioni ishte larg, shumë larg. Të gjitha këto i shkuan nëpër mend në një çast aq të shkurtër, sa edhe krisma e një pushke, dhe ai u çudit se si njeriu mund të mendonte përnjëherësh aq shumë gjëra. Shtyu derën e madhe prej dhogash të trasha dhe mori llozin që ta mbështeste.

Një batare troshiti derën, lart, te kllapa. Plumbat u ngulën në tavan. Ranë copa suvaje dhe një sifër druri prej kllapës. Ai u mbështet pas murit.

Ishte gabuar. Nuk ja kishte marrë mendja se ata mund të ishin afruar deri në murin rrethues të oborrit pa vënë re. Një batare tjetër automatiku rrahu prapë lart, te kllapa. Ai s'kuptoi përse qëllonin aty.

— Mos u afro te dera, se të grimë me plumba — thirri një zë. Ishte e kotë të shtinte më tym nëpër dhogat e derës, kur s'dihej se ku mund të ishin ata dhe prandaj ai mori shkallën përpjetë. S'kishte ngjitur as tri shkallë, kur kllapa e derës u hap dhe pesë vetë hynë në korridorin e ngushtë. Bëri të ngjitte edhe një shkallë tjetër.

— Mos lëviz, qenush! — tha ballisti që ishte në krye duke u zgërdhirë. — Mos lëviz, në të dhimset lëkura, se të bëmë shoshë! Unë jam Orhan Daduçi, në do ta dish, dhe ti tani do ma dorëzosh mua pushkën!

Njeriu që zgërdhihej ishte i pashëm, i veshur me rrobe kaki të prera bukur dhe në vend të qylafit mbante

një kapelë lëkure me strehë të fortë. Jakja vuri re se në sytë e tij shkëlqente një ngazëllim i madh. «Kështu duhet të gëzohen gjithë fitimtarët», mendoi.

— Hidhe pushkën tani, hë këlysh i vogël! Hidhe, se meqë je mustaqe pa dirsur, mund të të kursejmë!

Katër tyta të zeza pushkësh dhe një grykë automati-ku e shihnin në një pikë të vetme të gjoksit ku diçka i përvëlonte. Po edhe tyta e pushkës së tij shihte diku. shihte gojëhapur nën kopsat e verdha të ndritshme të xhaketës së Orhan Daduçit.

— Nuk jepet pushka — tha ai. — Po ta mbajti, eja merre!

— Do të vij, se ty nuk ta mban ta shkrehësh — tha Orhani. — Nuk ta mban se, posa ta afrosh gishtin te këmbëza, ata trima që janë pas meje do të të dërgojnë katër plumba mu në kokë!

Orhani bëri dy hapa përpara. Ju duk se pushka e atij çunakut dridhej. Ai duhej ta çarmatoste vetë. Gjithë krahina do ta merrte vesh që Orhan Daduçi çarmatosi një partizan. E çarmatosi duke ja hequr vetë pushkën nga dora. Me rrezik të jetës. Ja hoqi nga dora. Po, nga dora. Kush e ka bërë këtë? Mos vallë Çalamani?

Bëri edhe një hap. Jakja nuk u zbraps më. Orhani mbështeti pllazin e këmbës në shkallë, zgjati duart dhe e zuri pushkën nga tyta. Një gëzim i egër i shpërtheu në fytyrë, një gëzim që nuk e kishte provuar kurrë.

— Lëshoje tani, qenush! — tha Orhani.

— Merre! — bërtiti Jakja dhe rrëmbimthi u ul më gjunjë, tërhoqi pushkën drejt vetes dhe e shkrepiti. Orhan Daduçi u përgjunj. Vuri të dyja duart në bark, sikur deshi të mbante zorrët dhe u hoq praptazi deri te muri. Sytë ju zbardhën dhe ju bënë të ujshëm, si xham. Një tym i bardhë vërtitej nën tavan.

— Po më vrave, o qen! — tha me një fije zëri Orhan Daduçi.

Jakja e shkrepiti prapë dhe plumbi ju ngul në pulpë. Dikush nga ballistët arriti të qëllonte dhe atij i ranë copa gëlqereje mbi krye. U zbraps dhe vërtiti një bombë

mu në derë. Krisma shurdhuese zhvendosi ajrin jashtë sikur e thithi një pompë dhe ajri u trazua me ulërime. Korridorin u boshatis. Kapërceu me një të hedhur trupin e ballistit që kishte mbetur më krahëzaj te praku dhe shkoi llozin e rëndë në derë. Krisma të çrregullta qëllonin dhogat dhe muret. Jashtë klithi Lulo Daduçi:

— Ku vini more! Booo! Ma latë xhaxhanë shtrirë në këmbët e atij komunistit!

Orhan Daduçi në regëtimat e fundit të jetës, që po i derdhej bashkë me gjakun, mendohej të shtrëngonte plagën e tmerrshme në bark, po duart nuk i bindeshin më. Jakja nuk i vështroi fare të dyja kufomat që ishin në korridor. Rrëmbeu automatikun e Orhanit që ishte nën shkallë, u ngjiti në katin e dytë dhe zuri dritaren që shihte oborrin. Qëlloi një herë në fereckat e hithrave që ishin xhumbë anës murit. Dy vetë kaptuan murin. Pastaj nata ra në qetësinë e saj të zakonshme. Të bëhej se s'po ndodhte asgjë, se asgjë nuk lëvizte dhe flinte si përherë, me shkujdesjen që sjell pas qetësisë e natës. Askush nuk guxonte të dilte në orbitën e qitjeve të pushkës që përgjonte në dritaren e ngushtë. Pastaj u dëgjuan të shara. Ishte Xhemil Vishti që tallej me Lulon i cili rrinte strukur pas murit. Zhurmat u shumuan dhe ai dëgjoi një zë tjetër të trashë e të vrazhdë, që s'e kishte dëgjuar më parë.

— O burra, Lulo Daduçi! Hidhu që ta zësh të gjallë!

Po asnjëri nuk lëvizti.

Po atë çast u dëgjua një krismë e vetme. E njohu menjëherë. Ishte një krismë e thatë. — Shgër-dau!.. sikur shkyheshin drurë nga bora. Ky ishte malihërri i vjetër i babait. Ai hyri në dhomën tjetër, dritarja e së cilës shihte mbi çatitë e plevicave. Dukej vetëm një lëndinë e vogël me bar, po figura e babait nuk ishte aty. Siç dukej, ai kishte bërë pritë qoshen tjetër, ku ishte vendi më i mbuluar.

Nuk po lëvizte njeri dhe kjo e nervozoi. «Ata presin të dendësohet errësira dhe ta ngushtojnë rrethimin derisa të vijnë te dera. Pastaj mund t'i venë zjarrin katit poshtë.

Jo, nuk do t'ja venë zjarrin, sepse brenda është trupi i Orhanit. Po pse s'lëvizin? Pse s'lëviz askush?»

Ai ndjeu t'i mbinin qindra dyshime dhe prandaj u mbërthye edhe më pas murit, nën dritare.

O

Nata shtriu krahët e vet të errët dhe heshtja u bë më e kobshme. Dikush lëvizi nëpër dheun e shkrifët të kopshteve, ku posa ishin nxjerrë patatet. Kur e kur, nga shtëpia dhe nga lëndina midis tri plevicave shkrepnin dy pushkë dhe pastaj flakës së tyre i qepej një breshër i nxituar plumbash. Pastaj rivendosej pritja dhe qetësia. Jepeshin urdhëra me zë të ulët dhe në krye të rrugicës bënte të dilte ndonjë prej hijeve të rrethuesve, po dy krisma të menjëhershme ua prisnin rrugën. Atëhere rrethuesit e kuptonin që bataretë e tyre kishin shkuar kot dhe ja nisnin me zemërim një batareje tjetër.

Jakja vrojtoi edhe një herë në dritaren që shihte plevicat. S'dukej gjë.

«Unë tani duhet të dal nga shtëpia dhe të bashkohem me babanë — mendoj. — S'kam tjetër shpëtim. Pozicioni i babait është shumë i mirë dhe aty do t'ja mbajmë ndezur gjatë...»

Zbriti shkallët. Në korridor kufomat nxinin si kamina të shembura qymyri. Hoqi llozin dhe në heshtje të plotë doli jashtë e u zvarris anës murit. Kur po afrohej në qoshe, dëgjoi fëshfëritje fletësh dhe qëndroi. Dy hije u hodhën nga muri dhe mbështetën shpatullat te dera. Nëpër portën e rrugës vrapuan dy të tjera dhe zunë dritaren e vetme të katit të parë, që ishte zënë me hekura, po asnjëri nuk e zgjati kokën brenda hapësirës së dritares. Njëri nga ata që ishin te dera thirri:

— Dorëzohu, se të erdhëm në derë! Dorëzohu, se ta vumë pishën!

Ai u zvarris nëpër plloçat e ftohta të oborrit, hapi lëshën e kopshtit dhe u hodh në lëmë. Një plumb i fërshëlleu

pas veshit dhe ai e kuptoi që po e qëllonte i ati. U platit pas dheut dhe thirri: «Mos qëllo, se jam Jakja!»

Ngjiti ledhin, kapërceu murin e ulët, prapa të cilit ishte i ati. Hija e tij e errët ishte shtrirë anës murit dhe nuk lëvizti. Ndjeu një frikë të pakuptueshme dhe dridhërimë. Ju bë se babai ishte i vdekur.

— Eja, eja! — tha zëri i babait. — Zvarrisu, se dukesh!

Ai u afrua. Babai zgjati dorën e majtë dhe i shtrëngoi krahun fort... Yjet e rralla bënë një dritë të mekur aq sa dalloheshin format e shtëpive, të drurëve dhe hijet e njerëzve.

— Ata hynë në shtëpi! — tha ai.

— E di! — tha babai.

Pastaj mbetën të dy, afër njëri-tjetrit. Çakua ndjente frymëmarrjen e shpejtë të të birit. Duart i digjnin dhe ftoma e gurëve i hynte nëpër to, sikur prekte akull.

— Po tani? — tha Jakja.

— Zerë pozicion në mes të murit! Mos shko më tej, se aty të ha plumbi! Pastaj shtjerë dy herë dhe lëre pushkën në vend! I kujt është automatiku?

— I Orhan Daduçit — tha ai.

— Mirë. Qëllo dy herë, lëre pushkën dhe zvarrisu anës murit!

— Pse ashtu?

— Bëj si të them! — tha rreptë babai.

Shkrepën katër të shtëna që shpuan terrin dhe gëmushat e shtegut. Ata u zvarrisën drejt njëri-tjetrit. Në pozicionet e para vezëllinë plumba.

— Kështu kam shpëtuar — tha babai. — Qëlloj dhe zvarrisem. Ata shtien më flakët, po s'janë aq të shpejtë, se kanë frikë. E ke pushkën aty?

— E lashë!

— Mirë. Tani ata e dinë që ne jemi të dy. Ti merr me vete automatikun e Daduçit dhe hiq zvarrë, po mbaj anën e mezhdës, nën hithrat e tharë. Nuk do të të diktojnë dot, jo, se unë do të qëlloj nga të dyja pozicio-

net, një herë me njëren, një herë me pushkën tjetër. Ata do të pandehin se jemi përherë të dy. Hajde!

E afroji pranë vetes dhe mbështeti faqen e tij të paruar mbi faqen e nxehtë valë të të birit. Ishte një përqa-fim i ashpër. Jakja ndjeu t'i ngjitej një dridhje e ftohtë në gjithë gjymtyrët. Çakua i rëndoi në sup.

— Jo! — tha Jakja. — Nuk dua! Nuk dua të të lë vetëm!

— S'ka se si... — tha babai ngadalë. — Është e kotë. Tani ata do t'i venë flakën shtëpisë dhe vendi do të bëhet ditë. Nata s'na mbron dot më...

Çakua u zvarris drejt vendit ku kishte mbetur pushka e Jakes. Jakja kaptoi avllinë dhe rrëshqiti nëpër pluhurin e hidhur të rrugicës. Mbi kokë i fërshëllenin plumbat, po ata përplaseshin më lart, në gurët e avllisë. Në një ndërkohë të rregullt, vazhdonin të shkrepnin edhe të dy pushkët.

Kur hyri nën raketat anës jazit, pa flakët që shpërthyen në çati. Reflekse të kuqe dritash rrëshqisnin mbi barërat e kalbura nga vjeshta të livadheve. Të dyja pushkët ndiheshin ende.

Flakët përpinë trarët dhe shtëpia e vjetër u dogj si një pishë e stërmadhe.

Çakua s'lëvizte më. Kishte mbetur te pushka e Jakes, mbërthyer pas murit me një plumb që i erdhi pas shpine, nga pullazet.

Pastaj zjarri shpërtheu përsëri. Çalamani ju afrua njeriut të shtrirë anës murit. Gishti i kishte mbetur në këmbëzë të pushkës. Ishte burrë i thyer. Çalamani çakëriti sytë. Partizani ishte zhdukur. Ai zbrazti një karikator të tërë në kokën e njeriut të shtrirë dhe tha nëpër dhëmbë:

— Lulo, or qen! Ngarkoje xhaxhanë në mushkë dhe shpjere e varrose në fshatin e tij!

Po atë çast partizani Jake mori rrjedhën e lumit. Ky ishte lumi i tij dhe ai kishte lënë aty gjithë femininë...

RRUGICA, MJESHTRI I MANDOLINËS DHE XHAXHAI

Gjithë fëminia jonë kishte shkuar nëpër udhët e ngushta të fshatit që kishte shumë drurë dhe ujëra dhe ne rrallëherë kishim qenë në qytet. E përfytyronim qytetin si një vend ku gëzimet s'kanë kufi ose, edhe në kanë, ata janë të padukshëm e fantastikë si në përrallat, ku nata është tjetër natë dhe jeta tjetër jetë. plot fshehtësi e të papritura që ne do t'i zbulonim në pasditet e lira nga shkolla.

Por... shpresat tona u zhgënjyen. Ndofta kishim ëndërruar shumë. S'kishte asgjë të jashtëzakonshme dhe për më tepër askush nuk bëhej merak se na paskëshin ardhur nga fshati katër djem që vazhdonin gjimnazin, që banonin në ca dhoma të vogla me qira dhe që s'dinin si ta mbushnin zbrazësinë e asaj ndjenjës së paemër e lodhëse që ishte mërzi, trishtim, brengë dhe mall së bashku. Kjo ndjenjë ishte si një shi i gjatë vjeshte dhe e vetmja strehë ku fshiheshim prej tij ishte dhoma e xhaxhait të Gorit, Çome Zakos. Mua më dukej se njeriu më me fat nga ne të gjithë ishte Gori, sepse ai kishte xhaxhanë dhe sepse i pari nga ne e rregulloi me portierin Kiço të kinasë që të hynte në shfaqjet e mbrëmjes. Më i mjeri isha unë, sepse s'kisha asnjërin prej shokëve në të parën «B» dhe isha i detyruar të rrija në bankë me një farë Krisostom që më dukej medjemadh beteri. Më vonë doli që ishte djalë i mirë, po ditët e para, megjithëse e dinte

që unë s'kisha parë asnjë film, përveç «Lenini në Tetor», më mërziste me ato pyetjet e tij budallaqe «Ore!.. e ke parë ti filmin «Xhulbars?» «Jo!» — thosha unë. «As «Vasilika e bukur?» «Jo!» «As «Lulja magjike?»... Bre ti, qenke gdhë nga filmat!»

Porsa binte zilja e orës së fundit, prisnim të gjithë Gorin në oborr dhe i thoshim: «Kur?» «Më gjashtë — thoshte ai — se xhaxhai ka disa punë sot!»

Xhaxha Çomja ishte zdruckthtar dhe në orët e lira merrej me mandolina e kitara. Këto ishin instrumenta të vjetër të të njohurve të tij të shumtë dhe ai u ngjiste bishtat e thyer ose bënte çelësa druri.

Ne psherëtinim sepse ora gjashtë na dukej shumë larg dhe shpërndahehim.

Xhaxhai banonte në një dhomë të madhe në fund të disa shkallëve të ngushta e të errëta prej druri që ishte nën çatinë e pjerrët me tjegulla të thërrmuara nga vjetërsia e që pikonte dendur. Kjo dhomë ishte në një shtëpi të madhe, aty ku rrugica «Doktor Hahn» ndahej nga bulevardi. Ishte shtëpia më e shëmtuar që kam parë dhe i ngjiste një govate me vrima të mëdha minjsh. Bulevardit i kishte kthyer me përbuzje shpinën, që ishte e arnuar me copa të murrme suvaje dhe kishte hapur në shezitore vetëm një sy të gjatë. Syri ishte dritarja e dhomës së pronarit, një plaku shurdh, që kishte qenë hambarxhi. Shtëpia ishte ndërtuar që në atë kohë kur bulevardi ishte vetëm një rrugë me pluhur dhe si më e vjetër në moshë se ai, ajo as që denjonte ta shihte qartë se sa me një sy, që ishte edhe ai i errët e si i verbër prapa perdeve që s'hapeshin kurrë. Kurse dritaret e dhomës së xhaxhait shihnin në drejtim tjetër: përmbi çatitë e shtëpive të rrugicës. Xhaxhai i kishte thënë disa herë pronarit plak që t'i shkëmbenin dhomat, po plaku sepse dyshonte dhe nuk pranonte të shkonte nga dhoma e tij, ku nuk e linte të flinte rehat zhurma e bulevardit. Plaku ishte bërë gërnjar dhe, kur filluam të shkonim në atë shtëpi edhe ne, u ankua në këshillin e lagjes kundër xhaxhait i cili guxonte të fuste në shtëpinë e tij një tufë marrozësh që të çanin veshët me mandolinat e kitarat. Xhaxhai i merrte të

gjitha me shaka, nuk ja varte torbën dhe, saherë ngjitej plaku te ne për t'u grindur, i shkelte syrin dhe i thosh: «Eja, eja t'ja marrim asaj këngës «Kur vjen behari dhe qershitë, vajzat e bukura, faqe paputhura!» se, e di që të pëlqen!»

Në atë kohë ne nuk ja pohonim vetes se ç'na mblidhte në atë dhomë sepse, po ta thoshim. na dukej sikur do të fyenim xhaxhanë, po s'kishte dyshim që aty na mblidhnin kitarat e mandolinat. Nuk ishin kushedi se sa, ata që i sillnin për ngjitje i merrnin shpejt, po xhaxhai kishte një benxho të vjetër dhe kishte bërë vetë dy kitara. Njëra ishte hedhur mbi një dollap dhe xhaxhai e kishte dënuar duke e lënë pa tela. «Kjo gërdallë s'doli gjë! Nuk u godit! Mos i vini tela, se kjo ka zë fals dhe do t'ju prishë veshin. Kitara tjetër ishte goditur më mirë.»

Ne e kishim zbukuruar me gajtanë të kuq e të verdhë dhe i kishim ngjitur një fotografi reviste të Greta Garbos. «Kjo është kitarë spanjolle» — thoshte xhaxhai me naivitet dhe ne ishim të sigurtë se kjo ishte një e vërtetë që s'mund të mohohet kurrsesi.

Ne besonim se xhaxhai ishte një muzikant i shquar. Sidomos mandolinën ai e qante fare! I binte me një mall e me një trishtim të pakuptueshëm në fytyrë dhe ne vetëvetiu sepse pikëlloheshim bashkë me të. Atëhere nëpër tela vinin e dridheshin si flutura të heshtura nate trishtimet e dikujt dhe lëviznin perden e mugëtirës së dhomës. Këto ishin valse dhe mazhurka të vjetra dhe ne nuk e pyesnim kurrë se përse ja kishte ënda aq shumë ato melodi triste. Po kishte ditë që xhaxhanë e pushtonin ethe të një gëzimi pa fre dhe atëhere vinin valë erërash çapkëne, të shpejta e marroke, të fokstroteve e polkave dhe neve na ngjitej ngazëllimi i tij, fytyrat na shkëlqenin dhe, kur ai pushonte, na këputej përbrenda e na gurgullonte diçka e ngrohtë dhe këto çaste ishin aq të bukura e të papërsëritshme, sa na vinte keq që koha nxitonte përnatë njëlloj, me ftohtësi dhe na thoshte me këmbëngulje që të largoheshim... Xhaxhai ngrinte kokën e rëndë. të pluhurosur nga tallashi dhe e mbyllte mandolinën në këllëf.

Po... ne ishim të sigurtë se xhaxhai ishte një muzi-

kant i rrallë dhe s'kishim turp t'ja thoshim këtë çdo mbrëmje. Ai shihte me dyshim gishtërinjtë e vet. I kishte të trashë e tërë gunga të ashpra, si të gdhendur pa kujdes në dru pishë dhe thoshte: «Po t'i kisha gishtërinjtë më të hollë, do t'i bija më mirë. Po m'i ka trashur zdrukthi dhe prandaj e shkel nganjëherë la-në bashkë me mi-në! Po ju kot thoni që unë jam mjeshtër, more djema! Kot! Po të shihni Nuçi Shytin se si i bie, atëhere të shohim ç'do të thoni! Ai, po! . . . Po s'keni se ku ta shihni se ai është mandolinë e parë në mandolinatën e radios bashkë me atë profesorin tuaj me syze, Koçon!»

Neve na vinte inat. Shumë po na e mburrte Nuçin dhe atë gjyzlykon tonë të matematikës, që për të diel vinte në Mitropoli!

Ishte kjo rastësi e fillimit të jetës sonë në qytet që na futi tinëzisht në botën e tingujve dhe nga rastësitë shpesh lindin pasione të vërteta. Përnatë shtëpia gjë-monte nga akordet e kitarës. Ne merreshim më shumë me kitarat sepse na dukej që në mandolinë s'kishim për ta arritur kurrë xhaxhanë dhe sepse ai vetë na nxiste! «Më-soni kitarat, se s'ka kush të na akompanjarë» — thoshte. Më indiferenti ishte Stavri, po atë e kishim si kripën e gjellës sepse e qeshura e tij gurgulluese të ngjitej si së-mundje dhe kështu ai na bënte ta harronim dendur mallin për fshatin tonë.

Një mbrëmje (posa kishim mësuar akordin mi minor dhe na dukej sikur ky ishte kulmi i ëmbëlsisë e i mallit), në dhomë na erdhi tërë bujë e britma rrobaqepësi Krist Toronika që kishte rrobaqepësinë «Elegant», një portë më poshtë se ne. Ne ishim zënë me të sepse në ato ditët e para, kur shumë gjëra na mahnisnin, kishim qëndruar një orë të tërë përpara vitrinave të tij duke parë modelet e kostumeve të burrave nëpër fletë të zverdhura dhe sidomos manekinin veshur me kustum dopiopet, që na dukej si njeri i gjallë. Dritaret e Toronikës ishin karshi tonave, po më poshtë, sepse shtëpia e tij ishte dykatëshe. Atë mbrëmje posa kish trokitur dimri dhe ne kishim ndezur sobën. Xhaxhai fërshëllente Valsin e Qyqes, që ne nuk po e mësonim dot, kur na u shfaq mu në prak si hije

vozeje Toronika. me sytë tërë vrer, si maçok që gjuan!
— Ua... ua... ua! — shfryu Toronika. — Këtu pas-
kan dasmë jevgjit sonte!

Xhaxhai u mërziu dhe shfryu hundët.

— Po ty, si të erdhi sonte? — tha ai.

— Na shurdhuan nga veshët këta nipërit e tu! Xën-
gër mëngër!... Kanë tërë mbrëmjen! S'kemi veshë të
tepërt që!..

— Ata mësojnë instrumenta — tha xhaxhai. — Di
gjë ti se si mund të mësohen ata pa u rënë? Në e ditsh.
do të ta dimë për nder!

— E ç'u duhen? Le të hapin sytë në librat e shkollës!

— Edhe muzika t'i hap sytë, mor Krist! — tha xhaxhai.

— Ja edhe i mësuan! Pastaj? Fshatarë se fshatarë
do të mbeten! — tha ai nëpër dhëmbë e me një mllef
që s'e fshihte dot. S'priti më përgjigje dhe mori shkallët
tatëpjetë, sikur rrokullisej.

— Qafën thefsh! — mallëkoi Stavri.

Xhaxhai rrinte më këmbë në mes të dhomës dhe
shihte zbrazësinë që mbeti midis derës dhe korridorit të
errët. Ne me Peçin vendosëm kitarat mbi shtrat me kuj-
des. Na kishte hyrë në trup diçka e ftohtë dhe e rrësh-
qitshme si lëkurë gjarpëri. U ndjemë të ngathët e të pa-
fuqishëm. Xhaxhai doli e i ra një herë kryq e tërthor
korridorit, sikur përgjonte. Kur hyri brenda, shau dikë
që s'dihej se kush ishte. Pastaj sytë e tij të mëdhej bro-
dhën me vëmendje nëpër fytyrat tona ku kishte mbetur
nga një buzëgag i pafuqishëm, si i atyre që kanë vazhdi-
misht frikë se mos i fyejë dikush.

— U topitët fare, budallenj! — shau ai. — Pse i latë
instrumentat? Merrni Valsin e Qyqes! Mos ja varni tor-
bën atij! Do të rriteni dhe do t'i njihni më mirë banorët
e rrugicës! Janë ca qytetarë të mykur, denbabaden, dhe
fatmirësia më e madhe u duket që janë tamam qytetarë
dhe që njihen me njëri-tjetrin brez pas brezi! Pa le ç'inat
kanë marrë me plakun e shtëpisë sonë që është i pazoti
dhe e la shtëpinë t'i mbushej me të ardhur, si me çimka!
Mos çani kokë për ta, dëgjomëni mua!

Vërtet. rruga «Doktor Hahn» ishte pak e çuditshme.

Dikur në të kishte pasur shumë tabela të zanatçinje e të tregëtarëve të çikërrimave dhe në mëngjez qepenat të gërvishnin zorrët me kollën e tyre të ngjirur prej plaku. Edhe në mbrëmje, rrugica i thoshte botës «natën e mirë» me po këtë zë të ndryshkur. Tani disa tabela ishin hequr dhe ishin hapur dy dyqane të shtetit, po kishte mbetur ende rrobaqepësia «Elegant» Kr. Toronika dhe vëllai, furrë «Oreksi» e Odhise Cicos nga e cila vinte erë tavash dhe në fund të rrugicës «Gjela dhe Londo ushqimore e përzjerë». Ky dyqan kishte dalë jashtë vijës së drejtë të rrugicës si çiban gati për t'u shtrydhur. Shtëpitë ishin të qeta, të pastra dhe kangjellat ishin mbuluar me lule zvarranike e trëndafila. Ishte një rrugë aq e pastër, sa i ngjante për çudi manekinit të Toronikës. Megjithëse xhaxhai s'ua përtonte aq shumë fqinjëve, ai na urdhëroi ta zinim me batanije dritaren që shihte shtëpinë e Toronikës dhe pas kësaj ne sikur u ngrohëm dhe vazhduam me këmbëngulje t'i bienim Mi-minorit dhe Valsit Çelu-Çelu!

O

Një mbrëmje, xhaxhai erdhi bashkë me një burrë tullac me syze ku shkëlqenin rrathët e verdhë metalikë. Ky njeri shkeli mbi dyshemenë e dhomës me majat e këmbëve, sikur kushedi se sa rëndonte. Në fakt dyshe-meja ishte ca e lerosur nga koha. Peçi, që ishte duke mësuar atë fokstrotin e shpejtë titullin e të cilit e kishim masakruar dhe e kishim bërë «Allo-Pistushe!», e la mandolinën mënjanë dhe u skuq nga turpi. I huaji, veshur me kostum të zi dhe papion u hodhi një vështrim të shpejtë si prej ketri shtretërve ku uleshim ne dhe, meqë diçka nuk i pëlqeu, la në to vetëm këllëfin e zi të mandolinës që mbante në dorë, kurse vetë mbeti më këmbë.

— Pse nuk ulesh? — tha xhaxhai.

— S'kam nge! — tha ai dhe hapi këllëfin. Druri i zi i mandolinës lëshoi vezullime të buta dhe llamba elektrike u drodh nëpër lustër, sikur ra hëna mbi ujërat e pellgjeve të natës.

Na mbetën sytë!

— Këtu është gërvishur lustra! — tha i huaji! —
Është këputur edhe një çelës po kam një tjetër prej
qelibari. Ti vetëm sa ta vesh. Mirë?

— Do ta bëj! — tha xhaxhai.

— Vetëm se... kjo s'është mandolinë dosido!

— E di!

— Është «Xhibson». Firma «Xhibson» në mandolinë
është pothuaj si «Stradivarius» në violinë! Thesar i rrallë!

Ky ishte mjeshtri i mandolinës Nuçi Shyti, që luante
në mandolinatën e radios. Ai na mbiu në sy si një vizion
i shumëpritur, me rrathët e artë të syzeve, me papionin,
kostumin, me tërë figurën e tij të errët, si e ardhur nga
një botë tjetër e largët dhe e ëndërruar. Befas figura aq
e dashur e xhaxhait me gishtat e trashë që shkelnin pa-
dashur dy tela të ndryshëm u zvogëlua dhe mbeti e pa-
rëndësishme. Ishte, jo se s'ishte muzikant edhe xhaxhai,
po ai tjetri ishte muzikant nga thembra e deri te fijet e
pakta të flokëve. Ç'jetë dhe ç'mendime misterioze kishte
vallë ai njeriu me të zeza? Jeta e tij duhej të ishte e
kredhur e tëra nëpër tinguj fluturues që të jepnin prehje
e ëndrra! E ku xhaxhai! Le, po edhe nuk ja filloi me-
njëherë riparimin, po u muar me lahutën e Hajro saze-
xhiut! Do ta kishte pak zili edhe xhaxhai!

Xhaxhai e futi në këllëf dhe e vuri mbi dollap pranë
kitarës së pagoditur.

— Këtë mos e prekni! — tha. — U morëm vesh?

Por dihet, s'kishte porosi më të kotë se sa ajo. Posa
iku ai, tundimi për ta provuar na u ngjiti si rrodhe dhe
filluam t'i binim fshehurazi.

Por një mbrëmje na ndodhi ajo që s'na kishte shkuar
kurrë ndër mend. Ne ishim tre: Stavri, Gori dhe unë.
Rrinin në errësirë, «për çdo të papritur». Gori i binte man-
dolinës së mjeshtrit dhe pëshpëriste herë pas here «hajde,
mall, hajde!» Mua më dukej sikur nuk i kishim aq të
akorduara, po s'bëja zë.

Nëpër shkallë ja bënë si bubullimë hapa të shpejtë.

Po të mos ishte fshehtësia dhe ndjenja e fajit, ne
do ta kishim kuptuar që po vinte Peçi, sepse vetëm ai

pengohej në çdo shkallë dhe bubullinte ashtu, mirëpo zhurmat na befasuan keq dhe ne e fshehëm «Xhibsonin» nën jorgan. Peçi hapi derën, ndezi dritën dhe thirri: «E mora!» — njëlloj siç mund të thërriste «Eureka!» Nxori nga gjiri një send të vogël, të kuq, që ishte pashaporta. Letërnjoftimi e bënte të barabartë me ne që ishim një vit më të rëndhenj dhe ishte çelësi për të hyrë në kinema! Ai kishte vrapuar dhe shfrynte avull si kalë. Kështu u plas mbi shtrat. Gjithë fatkeqësia jonë bëri vetëm një «krak!». Kurrë s'mund të kishte fatkeqësia britmë më të dobët se sa ajo! Por ajo na ngriu kallkan!

— Bobo!.. xaxai! — ju muar goja Gorit.

Stavri, që rrinte si gjithnjë në qoshen e tij, u mundua të mbante të qeshurën. «Ama edhe ky! Tani e gjeti të qeshë, kur neve na vjen për të qarë?» — mendova.

Asnjëri s'guxonte ta ngrente jorganin e të shihte ç'kishte ngjarë. Peçi ishte zbythtur në një cep dhe rrinte si mi i përvëluar. Më në fund, u afrua Stavri dhe e zbuloi. Bishti i «Xhibsonit» u var si zorrë e kalbur. Telat ishin mpleksur.

— Bobo!.. xaxai!.. — belbëzoi përsëri Gori dhe zuri të vërtitej nëpër dhomë me duar kyçitur si për zi. Peçi psherëtiu.

— Mos qani, se do ta ngjitim me tutkall! — tha Stavri. — Pastaj e vemë në këllëf dhe s'ka për ta parë më njeri. Xhaxhai e ka mbaruar lustrën, kurse ai muzikanti juaj është qorr! Deri të hunda shikon!

Të gjitha këto ai i tha duke u zërdhirë.

— Mos qesh! — bërtiti Gori. — Për të qeshur është? Mos qesh, se mora thikën!

Ky ishte kërcënimi më qesharak që kishim dëgjuar, kështu që tani e qeshura m'u ngjit edhe mua. Por, meqë Gori ishte fare i zijosur, mua m'u pre gazi në buzë dhe puna m'u duk e pashpresë.

— Fundja... ja tregojmë atij muzikantit të shquar se si ndodhi, dhe ai do të na falë! — tha Peçi.

— Ajo është mandolinë «Xhibson»! — tha Gori kot më kot.

— E çë «Xhibson»? — tha Stavri. — S'është prej xhami që të mos ngjitet!

— Ai është muzikant i shquar, është artist! — tha Peçi. — Të gjithë artistët kanë zemër të madhe. Prandaj ai do të na falë.

— S'ma ha mendja të jetë aq zemërmadh ai tullaci! — tha Stavri.

— Unë e di! — nguli këmbë Peçi. — Artistët e kuptojnë njeriun. A ishte një gabim pa dashje? Ishte. A ishte gabim nga gëzimi? Ishte. Ai do të na falë!

— Ama llogje o! — tha Stavri! — Ç'na ke mbushur kokën me libra edhe ti! Ne do ta ngjitim, po fajin do ta marrësh përsipër ti! Se ti e bërë zararin!

— ... zararin... zararin! Bobo, xaxai! — tha Gori.

Ne e ngjitëm dhe e futëm në këllëf. Xhaxhai, që e kishte mbaruar më parë punën e vet, as që e pa. Të nesërmen në mbrëmje erdhi muzikanti. Ne të katër ishim struktur në një qoshe dhe bënim sikur mësonim, megjithëse e përgjonim me bishtin e syrit. Ai na vrojtoi me ata sy të vegjël që na u dukën si prej miu, po s'foli fare. E pa mandolinën dhe e futi në këllëf. Stavri u krekos. Doemos! Ngjitja ishte e duarve të tij! Të nesërmen, në mësim, ishim me zemër të ngrirë. Profesor Fundua më vuri një dysh në algjebër për mosvëmendje.

Me t'u ngrysur, shkallët bubulluan. Kjo ishte bubullimë ja, jo ajo e Peçit! Xhaxhai tërë qejf rruhej dhe fërshëllente. Pastaj ja merrte me zë të zgjatur: «Eja... eeejjaa në krahnor!»

Dera u përplas dhe në prak u dha mjeshtri i mandolinës. Balli dhe koka i ishin mbushur me damarë të kërcyer mavi, sikur do t'i plaste gjaku venoz.

— Barbarizëm! — thirri! — Fshatarë! Të pagdhen-dur! Ah, unë i mjeri! Ky s'ishte instrument, po thesar! Kopukë! «Xhibson» origjinal Bobobobo! «Xhibson!»... Bobobobo!»

Xhaxhai u pre me brisk dhe qetësisht zhdodhi një cigare dhe e pllakosi plagën me duhan.

— Të paska hyrë zegri kështu? — tha ai.

Muzikanti hunguroi dhe na hodhi një nga ato vësh-

trimet asgjësuese që të presin gjunjët. Hapi këllëfin. Bish-ti dhe telat e mandolinës u varën si të mjerë dhe neve na u duk se atë çast mjeshtri i mandolinës do të qante. Xhaxhai u zbeh!

— Eja të dalim në korridor! — tha ai. — Aty bise-dojmë! — Muzikanti i dha derës një shqelm dhe një copë suva u shkërmoq. Unë vura veshin te vrima e çelësit.

— Barbarizëm! — tha prapë mjeshtri.

— Mos bërtit ashtu, se unë do të ta rregulloj prapë!

— E ku ka të rregulluar kjo, more? — bërtiti ai.

— Po të më bërtasësh mua, do të mbetesh me gisht në gojë — u nxeh edhe xhaxhai. — Dëgjove? Dhe mos më inatos më, se këto shkallë janë si të minareve!

Tjetri murmuriti, pastaj u qetësua.

— S'paska qenë gjë edhe ky symiu! — tha Stavri. — Kurse ti, seç na përrallisje: jo po muzikant i madh, jo po zemër të madhe! Na! Ky ma paska sa të pulës!

— A nuk e kupton që djemve u kanë hyrë në shpirt instrumentat? — thoshte jashtë xhaxhai. — Ti vetë si ke filluar? Ata e morën në dorë nga kurioziteti, ngaqë i duan instrumentat, prandaj duhen falur!

— Të falen!? Po «Xhibsoni» im, ë? Jo, jo! Ky është vandalizëm! Ti s'kupton gjë nga vlerat e instrumentave, sepse edhe vetë je çapaçul! — tha mjeshtri i kreshpëruar kot më kot.

— Tani e teprove — tha xhaxhai. — Unë çoç të dija, muzikant të ndjeshëm gjoja! Po ti paske qenë! Ptu! Na, prit, prit! Unë do të ta paguaj sa të të hapet goja! Që ta marrësh vesh njëherë e mirë!

— E ku ka të paguar more, ku ka të paguar... — murmuriti nëpër dhëmbë mjeshtri. Po tani në zërin e tij ndjehej toni i pajtimit.

— O symiu me zemër të madhe! — u tall Stavri brenda. Ne s'folëm. Ishim të zhgënjyer përsëri nga gjithë ato që dëgjuam. Megjithatë, nuk ishim të zhgënjyer krejtësisht, sepse kishte edhe «zemra të mëdha e të ndjeshme prej artisti», siç thoshte Peçi, paçka se gishtat e trashë u zinin dy tela bashkë!

Të nesërmen xhaxhai e shiti kitarën «spanjolle».

DY, QË VALLËZONIN TË DIELAVE

Për fat të mirë, në ato vite, kur ne ishim në praktik të njëzet e pesave, në «Turizmi» e kishin hequr atë tabelën e frikshme «të shtunë-të diel, vetëm me dama!» (Ndodh që disa fjalë të shkruara në një xham të ftohtë të trishtojnë si një shi tërkuzë në pranverë).

Në këtë qytet, ku ne kishim bërë dikur shkollën e mesme, e ndjenim veten të huaj. Emërimi ynë në një shkollë të tij i habiti shumë banorët e rrugicës «Doktor Hahn» ku vazhdonte të jetonte xhaxhai i Gorit, ai ustai i mandolinave të vjetra. E shoqja e rrobaqepësit Krist Toronika tha: «Ua! Këtu i sollën nipërit e tu, Çome? Çudi e madhe! Djalin e Odhisesë, që është denbabaden qytetar, e hodhën në Kolonjë! Paskeni miq!» «Kemi moj, kemi, po jo këtu! Andej përpjetë» — i tha xhaxhai nga inati.

Në ato vite (po pse jo edhe tani?), ky qytet nuk e pranonte në normat e tij të moralit që të vije në një lokal serioz (aq më pak jo serioz), me të dashurën. Kjo do të ishte thagma më e madhe e stinës dhe do të mbahej nëpër gojë aq, sa të ndodhte një thagmë tjetër. Bile kjo mund të emërohej edhe skandal dhe pas tij dikush do të përcillte në seksion të arësimit një raport «mbi sjelljen e papëlqyer morale të dy mësuesve...»

Nuk ishte e lehtë të gjeje tryezë të dielave në «Turizmi». Qyteti jetonte vetëm për të dielën. Po ne përfitonim nga diçka. Tundimi i paradës së modës në bulevard,

i xhiros së shumëpritur, nuk na kishte pushtuar ende, meqë çdo të diel pasdite bënim nga tri orë udhë më këmbë, për t'u kthyer nga fshati ynë ku shkoni çdo të shtunë. Ne vinim herët dhe tryezën tonë nuk arrinte ta zinte asnjëri. Vetëkuptohet tryeza ishte në një pikë strategjike.

Mbrëmjet e së dielës ishin një nga ato kënaqësitë tona të vogla, kënaqësi me të cilat jeta e njeriut është mbushur plot. Dikujt mund t'i duket e vakët ose jo e kohës kjo, po ne s'para kemi çarë kryet se si u duken të tjerëve kënaqësitë tona. Gjithë mbrëmjen e shkoni vetëm të dy. Dy karriget e tjera prej thuprash rrinin bosh të ftohta, dhe dukej sikur pinin me ne, në heshtje, mërzinë e tyre. Ndonjëherë ua jepnim të tjerëve, po dendur i ruanim me kryeneçësi, gjoja se prisnim dikë. Aty kishte se kush të vinte (*se, nuk ishim aq të humbur de!*), po unë e thashë që kjo do të ishte një thagmë skandaloze.

Ata që vinin në «Turizmi» duhej të ishin njerëz shumë të sjellshëm ose të drojtur, ende s'e kam kuptuar se si; por ua kish ënda më mirë të prisnin një orë më këmbë derisa të lirohej ndonjë tryezë se sa të begenisin të ulerin në karriget tona bosh. Vetëm një herë u ul një djalë që posa e kishim njohur, i cili kishte lënë në holl të fejuarën dhe një kushërirën e saj.

(Shoqërimi i të fejuarve me kushërira ishte gjëja më e zakonshme. Ato që i shoqëronin kishin dy detyra: bënë një paradë për fejesë për vete dhe mundoheshin të bini në sy me fustanet, rruazat, karficat dhe njëherit ishin edhe roje e të fejuarve, se kushedi, mbase i kapte më shumë se ç'duhej malli i dashurisë dhe e tepronin duke i kaluar kufitë e caktuar të shikimeve e më the të thashë!). Kjo ishte një natë fatlume sepse kushërira qëlloi të ishte e bukur dhe vallëzonte si flutur. *(Të nesërmen xhaxhai e kishte marrë vesh që Gori do të fejohej me çupën e Tasi Kosaxhiut. Kurse ajo, nga ana e vet, pasi na përshëndeti ndonjë javë, u lodh nga pritja dhe bëri sikur s'na njihte më!)*

Çdo të diel në «Turizmi» shihnim po ato fytyra. Mund të shihje edhe fytyra të reja, po ato harroheshin menjë

herë. Bërthama ishte po ajo dhe kishte bërë një rregullore të pashkruar që e respektonin të gjithë. Dihej që vallëzimin do ta hapte inxhinier Gogua. Ne kishim një zili të fshehtë për inxhinierin, sepse ai kishte një të fejuar të bukur dhe vallëzonte mirë. Ne bile mund ta admironim atë, sikur të mos ishte pak snob. Kështu, megjithëse edhe një fëmijë e di që këpucët e rënda me gomë peshku të pengojnë shumë në rrotullimet e valsit, (*Valsi i gjorë! Atëhere ishte ende në modë, kurse tani është braktisur, si limua i shtrydhur!*) ai mbathte gjithmonë po ato këpucë me një gomë të verdhë, tre gisht të trashë. Dihej gjithashtu që dy herë në natë, në pistë do të vallëzonte vetëm një çift dhe të tjerët do të ishin spektatorë. Ky nder i bëhej Ngjeli Kajtazit, sepse ai kishte bërë shkollë danci dhe vallëzonte tango me figura. Neve s'na pëlqente tangoja me figura, sepse Ngjeli shtrembërohej më të dy krahët, si i thyer në mes. Edhe si çift ai me të shoqen ishin shëmti e gjallë sepse Ngjeli vinte i thatë e i imtë si pendë, kurse e shoqja ishte një patë dërdënge që mezi lëvizte. Po figurat i bënte Ngjeli, kurse ajo vetëm e pasonte, e ngrysur dhe me përtesë.

Kundrejt tryezës sonë pinin përherë dy njerëz. Ishin djem të rinj, me flokë të shtruar pas kafke e të ndritshëm si të lëpirë nga lopa. Merrnin pije të forta dhe s'i shihnin dot me sy birrën e mezetë. Në fillim pinin nga dy konjakë, pastaj kërkonin kokteje likernash dhe bënëin shamatë kur kamerieri ua sillte pa sheqer rreth buzëve të gotës. Kamerier Dinka u thoshte ftujakë dhe me siguri s'mund të gjendej nofkë më e mirë.

Një natë, në rrethin e ngushtë të vështimeve tona, hynë edhe dy njerëz të tjerë. Erdhën vonë, siç vinin zakonisht fillestarët. U hutuan nga zhurmat e muzika dhe mbetën më këmbë mu në hyrje, duke penguar kamerierët. Pastaj u zbythën anës murit e u mbështetën në tryezën e serviseve. Kjo gjë ra në sy menjëherë, ashtu siç bie në sy edhe një çiban në qafë. U duk sheshit se ishin njerëz tuafë që s'dinin asnjë gërmë nga rregullorja, sepse ata, që kishin durim e prisnin sa të lirohej një tryezë, duhej të rrinin në holl ose në shkallët prej mermeri dhe

burri duhej të hynte herë pas here në bar që të gjuante castin kur dikush paguante. Kurse ata mbetën te tryeza e serviseve, krah për krah, si për t'u ngrohur nga vështrimet e ftohta e të gjelbëra që u binin si brëshër nëpër xhamin e shisheve të zbrazura. Gruaja ishte shumë e hutuar. Burri e mblodhi veten më shpejt dhe e përfshiu tërë sallën me një vështrim të shkujdesur e provokues. Ishte i gjatë, me fytyrë bojëbakri të tharë nga erërat dhe sytë e vegjël vështronin me një farë mërie. Kurse sytë e butë e të thellë të gruas trembeshin e turpëroheshin me ngut, sikur prisnin të ndodhte diçka që po vonohej të ndodhte, po që sigurisht do të ndodhte. Ndofta kjo botë i dukej shumë e huaj dhe ajo kishte frikë të mbështetej pas saj se mos mbetej e ngjitur përgjithmonë si pas letrës kapëse të mizave. Pranë ashpërsisë së tij, butësia e saj dukej si prej fëmije, por i jepte dhe më tepër feminitet.

Atë natë ata ranë në sy, por do të ishin harruar si një anekdotë, sikur edhe në të dielat që pasuan të mos ngulnin këmbë që të hynin në bërthamën e të përhershmëve. Ishte edhe veshja e tyre që ra në sy. Jo se s'kishte edhe të tjerë njerëz demode. Ngjeli për shembull, me kostumin e zi me bel dhe pantallonat që fshinin parkestin, dukej si i dalë nga vitrinat e rrobaqepësive të viteve tridhjetë, po kjo gjë s'binte në sy dhe harmonizohej fare mirë me valset e tangot me figura.

Burri kishte një kostum blu, qepur si qëmoti, me supë të ngushta dhe me bel. Kokën e kravatës e kishte lidhur të madhe, aq të madhe, sa kokat e kravatave të dy ftujakëve para saj dukeshin si gjalma leshi varur në qafë të koteleve.

(Ç'është moda! Ajo lidhje demode atëhere, tani u bë prapë e modës!)

Gruaja kishte një fustan emprime, me një tutë frute të bardha e të ngrira si lule artificiale në gjoks.

Të dielën e dytë erdhën fill pas nesh dhe zunë tryezën e dy ftujakëve, e cila ishte edhe ajo mjaft strategjike. Ftujakët, posa panë tryezën zënë, u thartuan dhe bënë fjalë me kamerier Dinkën.

Ti nuk u the atyre tipave që kjo tryezë është e rezervuar? — tha i gjati, që ne ja kishim ngjitur Zeshkan.

Dinka s'bëri zë dhe shkau nëpër tryeza si ngjalë.

— Miserabël! — tha tjetri, që vinte i zbetë e i verdhë si i sëmurë. Ne i thoshim atij Verddhash.

— Haram bakshishi! — tha me zë të ulët Zeshkani. Dhe shkuan. Pas kësaj ndodhie, vunë mend dhe vinin më herët. Kurse çifti i panjohur e i demoduar u bë i përhershëm.

(Unë mendoja e shqetësohesha për ta. Sipas meje, e vetmja dëshirë që i shtynte të vinin këtu këta njerëz nga fshati, ishte dëshira për të vallëzuar. Ishin dy valltarë të lindur. S'bënin asnjë figurë të re, por muzikën e ndjenin me gjithë pejzat e trupit dhe nuk i pashë kurrë lëvizjet e tyre të shkëputura nga ritmi. Ndofta kjo nuk ishte thjesht një dëshirë. Ishte një ndjenjë që s'e emëroja dot, po megjithatë e dija që ishte një nga ato ndjenjat që për disa çaste i ve në gjumë të tjerat dhe të thotë të jetosh vetëm me të, për të. Njerëz të tillë, s'janë të rrallë, megjithëse dendur gjen edhe nga ata që vallëzojnë në pista sa për t'i bërë qejfin gruas ose për të shkëlqyer me kostumin e ri!)

O

Ne e quajtëm midis nesh «qejfliu i Boboshticës». Gruas nuk i ngjitëm asnjë nofkë. *(Mania jonë për të vënë nofka tregonte se edhe ne ishim mjaft të molepsur nga ca huqe të këtij qyteti)*. Në fillim ata u strehuan tinëzisht në mendimet e mia, pastaj si pa kuptuar zunë vend edhe në bisedat tona dhe u bënë diçka e zakonshme. *(Kjo nuk ishte thjesht një kureshtje që mund të ngopet me rrjedhjen e ditëve dhe netve, s'ishte as nga ato ndodhi anekdotike që të tërheqin për disa çaste e të thithin si tinë, po që më vonë ua sheh përsipër llumin e kotësisë)*.

Ditët e para e prisnim ardhjen e tyre me një buzëgaz ironik trazuar me një lloj mëshire, po koha provoi se kjo ndjenjë e zvergur ishte kalimtare dhe e rremë. Ne nuk i

pohuam ndonjëherë mendimet tona për ta dhe nuk do t'i kishim pohuar, sikur të mos ndodhte diçka. Po para se të tregoj këtë duhet të shtoj, se për çdo të diel ata bënin nga një ndryshim të vogël drejt së bukurës. Sidomos grua-ja. (*Gratë kanë një intuitë të çuditshme për të bukurën*). Ajo nisi të vishej më thjesht, jakat prej dantellash dhe lulet u zhdukën, flokët i mblodhi kurorë dhe kështu e la t'i dukej qafa e gjatë dhe e bardhë, si patë. Edhe ai bëri disa ndryshime, megjithëse kishte një lloj përbuzje për modën. Pantallonat i ngushtoi. Kravatën e lidhte në formë trekëndëshi, kurse xhaketën s'e preku, ndërsa fytyrës bo-jëbakri s'kishte ç't'i bënte.

Një të diel, në fund të verës, ata zunë prapë tryezën e ftujakëve. Ne e dinim që ata ishin njerëz shumë të sjellshëm dhe, sikur ta dinin që kështu dëshpëronin dy njerëz të tjerë, nuk do ta zinin atë tryezë. Po kjo s'domethënë që ata bënin pjesë në atë soj njerëzish të squllët që ua ha qeni shkopin. Kjo provohej nga qëndrimi i tyre fare i lirshëm tani si edhe ngaqë një herë ata thyen rregullat dhe e hapën stinën e natës së vallëzimit në vend të inxhinierit.

— Pa shiko! .. pa shiko! — tha Gori. — Qejfliu ua zuri tryezën ftujakëve! Ç'do të vejë, ç'do vejë! Dua të vë re se si do t'u thartohen turinjtë! Por, nuk i pamë dot, sepse na tërhoqi vëmendjen Ngjeli që po demonstronte një lloj vals me kalime anësh. Papritur, ftujakët u stapitën para nesh dhe kërkuan me mirësjellje të uleshin. Tashmë ishim fytyra tepër të njohura dhe mund të pinim në një tryezë.

— Mizerabël! — tha si me vete Verddhashi. Sytë nën qepallat e shkurtër i kishte të përskuqur si pas një nate pa gjumë.

— Se nga dalin ca njerëz të kotë dhe ta bëjnë qejfin haram! — tha Zeshkani.

— Secili bën qejf sipas mënyrës së tij. S'ka rregulla këtu! — tha Gori.

— Ekzakt! — pohoi Verddhashi kot së koti.

— Kush? — tha Gori.

— Ajo de! .. që s'ka rregulla!

Ne buzëqeshëm, edhe ata buzëqeshën sikur kishim bërë një marrëveshje të heshtur. Dinka na solli biftekët e skarës. Ne i përllamë shpejt e në heshtje dhe i bëmë pjatat si të lëpira me gjuhë.

— Ka një dallim esencial midis meraklive të rinj e të vjetër të pijes. E dini? Njihen nga mënyra se si e trajtojnë mezenë! — tha Zeshkani duke ju përgjigjur vetëvetes. — Të rinjtë e llufitin shpejt, të vjetrit e hanë me lezet e me qetësi!

Sipas nesh e ngrëna jonë ishte shenjë e oreksit të mirë, mirëpo Zeshkani deshi të na shiste të tjera mendje.

— Hajvanllëqe! — tha Gori. — E ngrëna varet vetëm nga oreksi.

— Nuredini është specialist për gjëra të tilla dhe për aforizma! — tha Verdhashi. Zeshkanit ju bë qejfi dhe e gjeti për të mençur që të shtonte edhe më:

— Kurse meraklitë e kategorisë më të lartë, të parët fare, nuk i duan pijet që serviren me meze. Si te Enriko Remarku!

Kamerier Dinka lëshoi me kujdes koktejet.

— Banakieri juaj është mizerabël — tha Verdhashi. — S'di asnjë formulë të vërtetë kokteji, kurse në fakt pregatitja e tyre është shkencë dhe art së bashku. E kupton?

— Në «Dajti» servirin kokteje ku çdo shtresë ruan ngjyrën e likerit dhe kokteji duket si ylber! — tha Zeshkani.

Dinka shtrembëroi buzët. Ky ishte një kamerier që s'para e mbante pluhurin mbi veshë.

— Po pse s'ja mbathni në Tiranë, mor ftujakë? — tha. — Mbushuni ore, mos më shisni mend mua, se ju njoh unë! Ju as që e keni parë me sy derën e «Dajtit»!

Ata s'kundërshtuan po, kur Dinka ishte larguar, Verdhashi tha:

— Mizerabël! E kam për princip mos bëj fjalë me kamerierët, se përndryshe!..

— Haram bakshishi! — tha Zeshkani.

— Arti i të shërbyerit ka rënë përtokë! Gjëja më

elementare është të dish të mbash klientët, kurse ky derri, as tryezën nuk di ta ruajë!

— E pse t'jua ruajë? Kush jeni ju, fundja? — tha Gori i hakërryer e i mbrehur për sherr.

— Dakord, dakord! — u paqësua Verdhashi. — Kur vijnë njerëz si ju e si ne, ai s'ka nga ja mban, po atij tipi demode mjaftonte t'i thosh dy fjalë dhe ai do të tëhiqej. . .

— Pse do të tërhiqej?

— Sepse ai këtu s'ka rrënjë, kupton? I duket vetja si dhisë në mes të dhenve dhe është gati të bëjë lëshime.

— Një natë, na e kishte zënë tryezën një çift nga ata që vijnë gabimisht në këto lokale. Ama unë e nuhata këtë gjë dhe u thashë: «Na falni, po ju keni zënë tryezën tonë». «Na falni, nuk e dinim» — tha burri, dhe u ngrit! Interesante ë?

— Gjithë gënjeshttrat janë interesante dhe komike në një farë mënyre — tha Gori.

— Si?

— Pse, nuk e dini që gënjeshttra vetëvetiu është interesante? Po a nuk merrni mundimin ta provoni edhe një herë me ta? Provojeni, po, në ngulshi këmbë shumë, mund të hani një nga ato grushtet që të lënë thes përdhet!

— Prej tij? — qeshi Zeshkani. — Vërtet duket i fortë, po unë jam marrë me boks ama!

— Punë e madhe! Grushtin megjithatë do ta hanit dhe do të puthnit parketin!

Biseda po bëhej me zë të lartë dhe ne po tërhiqnim vëmendjen e të tjerëve. Verdhashi u mundua sërish ta paqësonte bisedën e t'ja ndërronte fillin.

— Interessant! — tha ai. — Nga vijnë njerëz të tillë, demode dhe anakronikë?

— Nga fshati janë — thashë. — Po pse ju duken ashtu?

— Por. . . sepse ashtu janë! — pëshpëriti ai. — Edhe juve vetë ashtu ju duken.

— Dikur, ndofta, tani që jam menduar e interesuar për historinë e tyre më duken ndryshe.

— Ty të përkiste të interesoheshe! — tha ai. — Ti je shkrimtar dhe ata janë objekte të letërsisë.

Unë (atëhere isha një letrar i ri që kisha botuar *nja dy tregime*), u habita, po siç duket edhe u llastova dhe ndofta prandaj ja nisa të rrëfeja të gjitha mendimet e mia për ta. (Gjëja më e lehtë që mund të bëhet, është të zberthehet bota e brendshme e atij që shkruan). Ngjarja e tyre mua më shqetësonte, thashë. — A e dini që çdo të diel i bëjnë nja katërbëdhjetë kilometra rrugë që nga fshati? Fshati i tyre është i përparuar, po prapë fshat është. Kur vjen nata, njerëzit bien të flenë që me pulat. Kurse ata s'duan të flenë që me pulat dhe kanë një shtytje të brendshme drejt argëtimit. Kjo kërkesë shpirtërore ndofta i kapërcen ato të zakonshmet, po atë do ta kenë nesër edhe të rinj të tjerë. Dhe, kur njeriu kërkon, ai lëviz diçka nga vendi, prish diçka nga rregullsia e vjetër. Kështu, a nuk ju duken ata si njerëz të së nesërme? — Më duket se diçka të tillë, retorike, thashë atë natë.

— Ama fantazi, ë? — tha Zeshkani.

— Kurse juve ju mungon fantazia. Ju jeni mendjemëdhenj dhe i përbuzni! Nuk është kështu? — tha Gori.

— Nuk e mohoj! — tha Zeshkani. — Unë përbuz çdo gjë që është primitive dhe e shtirur. Sidomos primitive. Ata janë njerëz të një ambienti tjetër dhe argëtimi i tyre duhet të jetë diçka më ndryshe. Të bëjnë qejf, posi! Po pse jo në «1 Maji», ose në kinema? Qëkur, ata drejt e në «Turizmi?»

(*Mua m'u kujtua ai djali i imtë që kisha në bankë në klasën e parë gjimnaz e që më pyeste: «E ke parë filmin «Xhulbars?» Ou! I gjori ti, s'ke parë asgjë, sepse je fshatar!» — Më erdhi edhe mua pështirë e u hakërrova tani edhe unë për sherr.*)

— Kurse ju e mbani veten për modernë. Ju nuk shtireni ë?

— Ah!.. sa për këtë! Na dinë të gjithë! Po ç'doni të thoni me këto pyetje? — tha Zeshkani.

— Më mirë e lëmë këtë bisedë — tha Verdhashi. — Përse të grindemi kot së koti?

— Atë përbuzje, për të cilën folët. unë e ndjej për

ju, në doni ta uini — tha Gori tërë nerva. — Sepse ju vetë jeni primitivë, me gjithë rrobet e modës, kokat e kravatave e koktejet! Sepse jeni bosh! Flluska! Fuuuu! Ja ç'jeni!

— Ky është ofendim direkt! — kërcëu Zeshkani. — Jeni në një lokal serioz ku unë kam emër të mirë, se përndryshe do t'jua bëja turinjtë përshesh!

— O! Na u ofendoke zotrote, pale! Hajt, mbushuni nga tryeza! — tha Gori.

— Nuro! Më mirë të shkojmë! Ti e di që! — tha Verdhashi.

— Do shkojmë, po s'kemi për t'ju harruar, jo!

— As ne! — tha Gori.

Porsa shkuan, na hipi një gaz që s'mbahej dot.

— Ama ç'qullavecë, ë — tha Gori. — A e di se ç'm'u kujtua? «Xhibsoni» që theu Peçi dhe muzikanti i xhaxhait! Ata m'u kujtuan!

— Po ç'djall t'u kujtuan?

— Nuk e di. Kot së koti!

Dolëm jashtë. Ishte natë gushti dhe glediçiet e trotuarit furshullonin nga era. Nëpër një rrugicë zbrisnin me nxitim dy sy të kuq cigaresh dhe bënin ca shenja të turbulla drejt nesh.

— Aha!! Qenkan ftujakët aty! — tha Gori. — Do të kërcasë grushti sonte!

— Për qejfliun e Boboshticës?

— Për të! — tha ai.

Kapërcyem vijat e bardha të bulevardit. Bëmë njëzet hapa nëpër kalldrëm, aty ku prisnin dy sytë e kuq të cigareve.

— Eja, eja! — tha një zë — se do të t'i thërrmoj dhëmbët si rruaza!

— Dil ti, këtu në dritë, se kam qejf të të shoh si do të të vejë goja shtrembër — tha Gori.

Zeshkani u trimërua, e kapërcëu largësinë me tre hapa dhe menjëherë i vërviti me të djathtën një grusht nga poshtë lart, drejt nofullës. Ky ishte një aperkut sipas

rregullave, po Gori ju shmang dhe Zeshkanit i krisi shpatulla. Pas një çasti ai u gjend i mbërthyer për mesi dhe sytë i kërcyen si pofka.

— E, or plehër! Dhëmbët e mi shpëtuan, po të shohim koskat e tua tani! — tha Gori.

Sa për Verdhashin, u pa sheshit që s'ja kishte ngenë dhe takatin boksit sepse, posa u ndodhëm pranë, ai murmuriti:

— Po përse xhanëm, ë? Për hatër të një... Nejse! Fundja, përse?

Nga goja i vinte erë dhëmbi të prishur. Kështu, ne s'u goditëm fare. Po edhe mundja mbaroi shpejt sepse Zeshkani arriti të shkëputej nga krahët dhe, kur pa shokun e vet të squllur, ja dha vrapit përpjetë, nëpër errësirë.

— Ç'na shpëtuan! — tha Gori.

Dolëm në bulevard. Nga «Turizmi» po dilnin klientët e fundit. Qetësisht dolën edhe qejfliu me të shoqen. Ai provoi gomat e biçikletave në ishin të fryra, zilet, pastaj hipën dhe pedaluan me forcë. Projektorët bënë dy gjurmë të zbeta drite në asfalt, pastaj ata e shtuan shpejtësinë dhe dritat u bashkuan e bënë një gjurmë të vetme, si hinkë që çau më dysh errësirën e rrugicës, derisa u zhdukën pas kthesës.

S'mund ta merrnin kurrë me mend se atë natë katër njerëz të panjohur ishin zënë për ta.

Po vallë vetëm për ta?

KATËR AKTE TË PROVËS

1.

— Ka disa gjëra në jetë — ngulte këmbë babai — që njeriu s'mund t'i gjykojë vetëm me veten dhe vjen një ditë që këshilla e të mençurit bëhet e nevojshme si notia e pyllit për kërpudhën. Ky nuk është një hap i thjeshtë që mund ta hedhësh si të duash, majtas ose djathtas, duke fërshëllyer nëpër buzë një këngë. Ky është një hap që duhet bërë në atë rrugën e padukshme e të përdredhur, që quhet jetë!

Çdo të shtunë babai i përsëriste po këto, vetëm se i shkëmbente fjalët dhe ai kishte filluar të mërzitej. Nuk vendoste dot asgjë. Nganjëherë e gjitha kjo i dukej e thjeshtë deri në infinit, po shpesh mendonte se çdo e thjeshtë ka brenda doemos edhe farën e ndërlikimeve të papritura.

Sa e ndërlikuar!

I duhej një këshillë. Vetëm një. Ndofta çeshtja s'ishte kaq tragjike. Do të ishte më mirë të kishin lënë shef seksioni Duro Bezatit. Njëqind herë më mirë. Atë nuk e kishte njohur. Mund të thuash me plot gojën që atë askush nuk e njihnte. Ndofta jo askush. Disa e njihnin, po ata ishin pak. Po të ishte shef Durua, gjithshka do thjeshtohej si një thyesë algjebrike. Do të bënte një kërkesë siç bënin të tjerët për vit. Do të shkonte në pritje dhe do t'i num-

ronte disa arësye nga ato që kishte shënuar edhe në lutje. Do të dëgjonte të përsëriteshin po ata argumenta që i dëgjonin edhe të tjerët: «Kemi të tjerë në kushte më të vështira, kemi gra me fëmijë që i mbajmë mësuese në fshatrat përreth për mungesë vendesh në qytet. Tani jemi në një kohë kur vetë koncepti mbi punën e mësuesit është revolucionarizuar. Natyrisht ti e kupton që koncepti të transferohemi pranë familjeve është i shtrembër. Atdheu nuk është vetëm ky qytet, dhe vetë natyra e punës së mësuesit. . . jo, jo, s'dua të them se këto koncepte i ke ti, po ashtu në përgjithësi. . . Pastaj, Ismet Sali Bruçaj. . . Për ty kemi konsideratë tjetër. . . »

Korridorët e bardha të shkollës ju dukën sikur ishin zgjatur. Në katin e poshtëm bënë shkollë nate. Ishte qetësi e thellë e këndshme. Atij i pëlqente heshtja e korridoreve të shkollës pasdite. Llambat hidhnin një dritë të butë, pakëz të zbetë dhe ca reflekse të dobëta rrëshqisnin nëpër dyert e mbyllura të lyera me gri. Nëpër këtë heshtje, hapat e tij kumbuan fort dhe këpucët trokitën sikur ishin mbathur me patkonj. Atij i ra ndër mend se sot u kishte vënë këpucëve hekura. Atij nuk i pëlqenin paftat në këpucë. Ky fshat i madh, që kushedi sepse e kishin futur në listën e qyteteve të vogla dhe që e përmendin në gjeografi, i kishte të gjitha rrugët me kalldrëm. Gojët e gurëve i hanin shuajt si bukën e thekur. Babai e këshillonte t'u vente pafta, por ai harronte. Babai e dinte që ishte harraq dhe në mëngjezin e së hënës ai dëgjonte se si trokisnin paftat e reja të këpucëve në kalldrëm. Kjo ishte një zhurmë pak a shumë ushtarake, dhe ditën e parë e nervozonte. Pastaj mësohej. Pastaj gojët e gurëve i hanin paftat dhe në mëngjezin e së hënës ai i gjente me pafta të reja. Dhe kjo kishte katër vjet që përsëritej.

Vështroi oborrin e shkretë, nga dritarja. Koha dukej si për shi. Hyri në dhomën e mësuesve për galloshet. Galloshet i linte gjithnjë nën dollapin e hartave. Te harta e gjatë e dy Amerikave fshinte pluhurin e tyre. Aty fshihte ndonjëherë edhe byrekët që sillte të hënave nga shtëpia

sepse kishte gjetur belanë prej Zakës. Zaka, kur ja gjente, i kullufiste pa asnjë paralajmërim.

Në sallë ishte ngrohtë. Guxua, Dhorka dhe Bashkimi korrigjonin detyrat. Dhorka e vërejti me çudi atë dhe galloshet dhe fshehu një buzëqeshje nën flokë.

— Bie shi? — pyeti Bashkimi si guak.

— Nuk bie, po do të bjerë!

— Ashtu thotë ai barometri yt sonte? — u tall Dhorka.

— Ashtu — tha ai thatë dhe mbylli derën.

Galloshet e mbushën korridorin me një fëshfëritje të lehtë.

«Nga këta të tre, s'ke ç'këshillë të presësh. Bashkimi është i lënë. Dhorka, po Dhorkë! Guxua... s'është keq, po e ka talljen majë gjuhës, dreqi!»

Doli jashtë dhe mori udhën që të çonte në kafe «Labëria». Neonet e futura në govata të ngjyera me bojë të bardhë ndizeshin e shuheshin.

Ishte vrëjtur dhe lagështia rëndonte. Asfalti shkiste si i lyer me dhjamë. Mbi asfalt, herë binin pellgje drite, herë pellgje errësire.

«Do ta bisedoj me të parin mësues që do të takoj në rrugë ose në kafene. Dikë duhet të zgjedh. Kështu është më mirë se sa të rrish e të vrasësh mendjen pafund. A, sa u ndërlikua puna me Stefanin! Po ku gjetën dhe e bënë atë shef seksioni? Kurse babai na u gëzua!» «O... shoku i vjetër u bë shef! — thotë. — Ky është një grand shans për ty! Ku ta gjesh?! Çdo njeri që ngrihet në përgjegjësi mendon edhe për shokët e vet! Pse për kë do të mendojë, për Stamo Dumon? Jo, ore bir, se kjo është dialektike! Ti merre me veten tënde. Sikur të ishe ti shef dhe të kishe një vend vakant, ku do të të shkante mendja? Tek ai që e njuh dhe që i di dhëmbë e dhëmballë. Me atë je mësuar. Matematikë elementare kjo! Ose kur e sjell sëra që të ngrihet njëri në përgjegjësi. Kë do të rekomandoje në udhëheqje ti? Dihet, atë që e njuh, e ke mik e ke shok! Ai të bëhet edhe krah i djathtë. Kurse kali i ri mund të dalë me huqe!».

«A... ç'na çudite, o baba! Shok i vjetër dhe i ngushtë, thua ti! Po nuk e njuh Stefanin! S'di atij krahu ai,

jo! Le që edhe aq «të ngushtë» nuk kemi qenë! Jo dhe jo! E ku? Vërtet, një vit kemi fjetur në të njëjtën dhomë. Vitin e parë. Bile një natë para Vitit të ri kemi luajtur kumar. Tridhjetë e njësh. Unë fitova. Ehu... të shkuara të harruara! Pastaj Stefanin e bënë drejtor. Mori shtëpi, solli gruan dhe fëmijët. Njëherë na ftoi dhe ja shtruam me raki. E ka një të mirë Stefani! Megjithëse është nja dhjetë vjet më i madh se ne, bëhet një me mendjen tonë. Rrogoz fare! Atë natë unë u deha. Unë dhe Piri. Dhe këndonim të dy arien e Rigolettos... Kurse tani... Stefanin vajtën dhe e bënë shef!»

Në kafe «Labëria» kishte pak njerëz. Ai u ul i vetëm në një tryezë të qoshes. Aty ishte gjysmerrësirë. Mbi mbulesë kishin derdhur verë dhe ishte bërë një njollë e errët që i ngjiste hartës së Spanjës.

Në kafe hyri Gjelua, mësuesi i fiskulturës. Atij i shkrepri në mendje premtimi që i kishte bërë vetes rrugës. nën pellgjet e kryqëzuara të dritës dhe të hijeve mbi asfalt. Po ai premtim ju duk tani fare i përbuzshëm, si ato mendimet naive të fëmijëve. Kishte edhe ai diçka nga fëminia. Të gjithë e kanë dhe e ruajnë në pavetëdijë. Diçka të brishtë, të papërsëritshme që mund të shpërthejë ndonjëherë si fontanë uji. Do të ishte fantastike ta bisedoje këtë gjë me Gjelon, mësuesin e fiskulturës, që bënte përditë 27 kilometra udhë me biçikletë vajte-ardhje deri në fshatin e tij. Ç'mendim foshnjarak ishte që të këshilloheshe me të!

Megjithatë, ai ishte i bindur se i duhej një këshillë, sepse edhe babai ngulte këmbë për këtë. Piu një gotë çaj me konjak. Në kafe u shtuan njerëzit dhe u bë tym. Tymi i veshi me një cipë të murrme të gjitha vështrimet e njerëzve. Ai u kredh në karrige dhe ajo krisi. Askush nuk e kishte mendjen tek ai. Banakieri kishte ndezur qymyrin dhe salçicet lëshonin tym e digjeshin. Të gjithë bënëin zallahi duke kërkuar salçiçe dhe prej kësaj zhurme atij i dukej sikur s'mund të mendonte më asgjë në mënyrë të kthjellët. Ndezi një cigare. Atë e pinte kot së koti. Nuk thithe brenda asnjë fjollë tymi dhe, posa e nçillte, e shfrynte nga hunda.

Pra, ai do të këshillohej me një njeri. Ky njeri, sipas tij, duhej të kishte shpirt praktik dhe përvojë. Kjo s'ishte mjaft. Ai duhej ta kishte provuar në jetën e tij dobinë e këtij praktikiteti. Kjo ishte dëshmia e garancisë. Materializmi i teorisë në praktikë.

I tillë mund të ishte Musa Gjyshi, nëndrejtori i shkollës për filloren. E para: me të s'kishte asnjë lidhje direkte vartësie. E dyta: ai kishte mundur të qëndronte kurdoherë mbi ujë!..

2

Mbrëmjen e shkuar ai kishte qenë mjaft i turbull. Kjo ju duk normale. Se, a nuk ka njeriu çaste, orë dhe ditë të tëra kur e ndjen veten të burgosur brenda një avulli të lagësht të mendimeve të turbulla e shterpa dhe s'e gjen dot fillin e bardhë të qartësisë?

Dje i dukej e domosdoshme që, për të bërë këtë hap, i duhej të këshillohej me dikë. Sot nuk i dukej e domosdoshme. Ndofta kjo këshillë mund të ishte vetëm e dobishme. Por, midis së domosdoshmes e së dobishmes ka një dallim, apo jo?

Megjithatë, në këtë mes ishte edhe babai që ju bë ferrë. Vetë ai s'mund t'i këshillonte ndonjë gjë të saktë sepse fundja, në jetën e tij s'kishte pasur kurrë andralla të tilla. I kishte shkuar çdo gjë si mbi vaj. I kishte ngrysur vitet prapa xhameve të trasha të tryezës së punës, në bangë. Kishin shtëpinë e tyre të vogël, rrugicën e tyre të dashur, pakëz të errët në mbrëmje, po aq më mirë sepse gjithshka dukej misterioze. Kishin dy blirë në hyrje, që shushurin e mbanin erë të mirë kur hapnin lule. Shtëpia ishte e vjetër por e fortë. Karakteristike. Njëherë e kishte pikturuar vetë Vangjush Mio. Arkitekturë interesante tradicionale. Dritë-hije. Pusi i braktisur e i mbyllur, mbi të cilin vinin saksit. Babai thoshte se ai s'mund ta këshillonte asgjë dhe se nuk kishte më miq, aq më tepër sepse në poste drejtuese kishte shumë njerëz me origjinë nga fshati. Por ndjenja e tij prindërore i thoshte vetëm

kaq: do kishte një të mirë nga emërimi i Stefanit shef. Në komitet ata kishin edhe Harin, kushëririn, po ai nuk e nxirrte qimen nga qulli dhe më mirë të mos mësonte asgjë se përndryshe të prishte punë! S'ishte ai si Adem Shtufi që i rregulloi gjithë nipujt e mbesat mu në Tiranë. Babai bile mendonte se muslimanët janë më të lidhur me njëri-tjetrin se sa kaurrët. Aj. . aj. . aj. . paragjykime këto, asgjë më shumë!

Orën e mësimit ndenji si mbi gjemba. Nuk i bëhej të shpjegonte, sepse i dukej që diçka nga shqetësimet e veta do t'i futej edhe në mësim. U bëri detyrë me shkrim. Ai rrinte me duart kryqëzuar në dritare. Me bishtin e syrit vuri re se i biri i Rakipit, ai dregamani kishte vënë librin mbi gjunjë dhe po kopjonte. Nuk bënte vaki të pipërinte, pa le të kopjonte njeri në orët e tij! Ai bëri sikur nuk e pa sepse këto detyra s'kishte për t'i kontrolluar kurrë.

Njëherë ju duk se gjithë kjo që bluante në mendje prej ditësh, gjithë ky tension nervor, ishte një nga ato kotësitë e përhershme e pafрут që, kur i kujton më vonë të bëjnë të skuqesh. Stefani i vetëm s'mund të bënte dot asgjë. Do t'i duheshin shumë argumenta që ta mbronte propozimin për transferim. Dhe ai s'ja jepte dot argumenta. S'mund të merrte dot as raport mjeku si Luke Shani, s'mund të betohej as si Krisostom Falli që bënte be e rrufe se i kishte pleqtë me një këmbë në varr.

Por. . . ç'do të humbiste sikur të hidhte një gur në lumë? Në fakt ky s'ishte një gur që kridhet në lumë dhe humbet në tinë. Ishte një hap. «Një hap në atë rrugën e padukshme e të përdredhur që quhet jetë!» Dhe i duhej një këshillë. Më në fund ai kishte vendosur që të bisedonte me Musa Gjyshin. Musai e kishte vërtitur për merak gjithë jetën e vet. Vetëm tuafëve mund t'u dukej ndryshe. Po ai s'ishte tuaf! Musai ishte mësues në fillore. Nja dy herë i ishte vërtitur mbi krye shtërgata e pushimit se i mungonte arësimi përkatës, po ai e kishte hedhur lumin. I kishin dhënë pedagogjiken me atestim. Se, për kë, në mos për kuadrin e vjetër e me përvojë ishte atestimi? Kur e bënë nëndrejtor, i dhanë edhe dyvjeça-

rin me atestim. Disa thoshin se në shumë pika ishte tapë topi, po në jetë kishte qenë aq i lehtë, sa lundronte përherë mbi ujë. Historia më zbavitëse në jetën e Musait kishte ndodhur dhjetë vjet të shkuar, kur ishte shef seksioni Janaqi. Ai kishte vajtur për inspektim. Musai e kishte marrë për darkë dhe ai ishte kënaqur aq shumë nga biseda e mençur e tij, sa kishte thënë të nesërmen: «Pse ankoheni, more shokë, që s'keni kuadër të aftë ta ngrini nga fillorja në shtatëvjeçare? Propozoni shokun Musa! Shok i mirë!»

Mirëpo Musai ishte më finok se shefi dhe nuk e hëngri atë koqe ulliri.

Biseda e tij me Musanë u bë në kafe «Labëria». Thellë në vete, atë e gërryente një frikë e një dyshim që mundohesh ta mposhte. «Po sikur Musai ta priste rrëfimin e tij të singertë me një buzëqeshje tallëse?»

Nga kjo frikë, në krye ishte i drojtur dhe i merrej goja. Musai e dëgjonte ballërrudhur e gojëhapur. Vrëjtej e kthellesh si ditë prilli. Gishtërinjtë e duarve i kyçiste në mënyrë enigmatike dhe i kërciste. Ai i kërciste gishtat saherë i donte qejfi, sikur i kishte të bërë prej karthjesh që thyen pa forcë. Kërcitja e bëri pak nervoz dhe nuk ja tha hallin e vet ashtu si do të donte.

— Në thelb, e ka një koklavitje kjo çështje — tha Musai.

— E ka! — pranoi ai.

— Tjetrit, tungjatjeta, që me nder teje, nuk i ka rënë bytha në ujë, kjo gjë do t'i dukej pesë me hiç! «Ç'gjë të madhe e të zorshme, or lum miku, gjen këtu?» — do të thoshte. Sa e sa njerëz venë e qajnë hallet nëpër shefa e përpjetë dhe, para se të shkojnë, nuk këshillohen me njeri, ë?

— Po!.. edhe kështu mund të thoshin! — pohoi ai i hidhëruar sepse kjo gjë ju duk fare e zakonshme dhe fare e arësyeshme. Kishte nisur të ndjente një lloj pendimi qëkur kërcitja e gishtërinjve të Musait nisi t'i acaronte nervat.

— Do puna punë dhe çobani gunë! — tha Musai në mënyrë profetike. Atij i ishte bërë qejfi mal që një më-

sues kaq i zoti, si Nako Pali, e zgjodhi për plak. Ky Nakua do të shkonte lart. Po ja, i gjori njeri, ka edhe ai hallet e tij dhe askush nuk ja qan!

Nakua s'e kuptoi se ku dilte shtegu i asaj fjalës së gunës po nuk e bëri veten dhe heshtja ju duk më e mençur.

— A e di atë shprehjen klasike që thotë për përsëritjen? — pyeti Musai. Musai heshti përsëri. Në përgjithësi, saherë që i dukej se thoshte një gjë të mençur, ai heshtte një hop që t'i linte kohë tjetrit ta bluante mençurinë e fjalës së tij. Në kafe u përhap era e salçiçeve që piqeshin në skarë. Dëgjohej cërritja e dhjavit që kullonte mbi thëngjijtë. Në kafe kishte pak njerëz dhe atij ju kujtua se ishte data 15. Tymi u var dhe lëvizi mbi kokat si lëvere e nderur për t'u tharë. «Seç kishte një gjë prej atij tymi edhe në atë bisedë», mendoi ai. Ai u pendua. E shau veten. E quajti gomar. Bile gomar të madh! Vendosi të mos fliste. Pendimi i doli përpara si një kafshë e zezë e paformë. Çdo gjë që kishte bërë këto dy ditë, i dukej një budallallëk me brirë i disa çasteve kllapie. Dhe ç'është më kryesorja, ju duk se këto dy ditë kishte humbur befaz një pjesë të personalitetit të vet. E kishte humbur njëlloj sikur t'i kishin shqitur një copë nga organizmi dhe ta kishin nxjerrë në ankand për vështrim të turmës. Mallëkoi edhe babain. Ai e kishte fajin. A s'e shtyu ai ta bënte këtë hap? Ai mund ta bënte këtë hap, po pse doemos me kaq ndërlikime dhe djallëzi? Sikur të mos prisnin t'u sillte kamerieri salçiçe dhe birrë, ai do të ishte ngritur. Po. Mund ta vendoste një gjë dhe ta zbatonte. T'i thoshte vetes: «unë tani do të ngrihem, kurse këtij burrit me sy të vegjël e të lëvizshëm si të kunadhes do t'i them më fal, or mik, se unë ashtu kot së koti të kërkova një mendje, po s'kam për të bërë asnjë përçapje!»

— Përsëritja është mëma e dijes! — përsëriti Musai që e kishte vënë re hutimin e tij.

— E di, e di! Pastaj shtojnë se është edhe babai i mërzisë!

— Lere babanë! Babai s'ka rëndësi!

— Pse?

— Sepse unë e kam marrë nishanin gjetiu. Në thelb të gjërave, ashtu siç është përsëritja mëma e dijes, edhe prova është mëma e suksesit.

— Prova?

— Doemos! Prova është parashikimi. Të parashikosh bisedën. Çdo pyetje që bën ti, ka edhe një përgjigje. Por përgjigja ka disa traga dhe mund të hysh në udhë të verbër. Ndosht, deh, që nga se s'ke bërë asnjë parashikim, hyn në këtë udhë dhe pastaj udha e mbarë të qoftë!

— S'të kuptoj!

— Ç'ka të zorshme xhanëm? Prova nuk bëhet vetëm në teatër! Merr taktikën ushtarake të shteteve. Ç'janë ato manovra a loja demonstrative përveçse një provë përpara shfaqjes së vërtetë që është teatri i luftës? Ke dëgjuar kështu?

— Por... shef është Stefani! Ti e di që kemi qenë kolegë, kemi qenë shokë në një farë mënyre!..

— Prandaj ta thashë që në krye se e ka një koklavitje kjo punë. S'dihet se si merr biseda. Por, një gjë, që është në thelb të gjërave, di të ta them që tani!

— Çfarë?

— Frazja të jetë e shkurtër dhe e logjikshme!

— E kujt?

— E jotja deh! Frazë e shkurtër, pa përdredhje dhe lulka stili, siç bëjnë shkrimtarët. Kështu ka efekt. Doemos, kur është edhe e logjikshme!

— Por... si?

— Tani fusim në valle shkaqet. Radhitja e tyre. Në fillim një arësye e rëndësishme, që ngre peshë. Pastaj disa të dorës së dytë. Në fund më e rëndësishmja. Sepse e para dhe e fundit mbahen mend dhe bëjnë efekt. Si të thuash, një bombë, katër fishekë, një bombë!

— Një bombë, katër fishekë, një bombë!.. — përsëriti ai mekanikisht.

— Kjo është nga taktika ushtarake. Cilat janë arësytet?

— Arësytet? — u turbullua ai. — Po ja. . . u bënë katër vjet që jam këtu. Është edhe rasti që në shkollën e mesme «Asdreni» duhet një mësues fizike.

— Këto s'pinë ujë fare. S'janë as qorrfyshekë e jo më bomba!

— Po si i bëhet?

— Duhet menduar. Ta zëmë, arësye të forta shëndetësore. Ulçera.

— Me Stefanin kemi fjetur në një dhomë dhe ai e di që unë vuaj vetëm nga oreksi i tepërt!

— Familjaret!..

— S'të kuptoj!

— Vështirësitë ekonomike. Babai del në pension. Ke motrat për martesë. Edhe ty po të shkon mosha e martesës!

Trokitën gotat e birrës. Salçiqet ishin me specia djegës dhe ato digjinin për qamet.

3

Gjumi nuk e zinte. Thekët e levenxes së kuqe i vinin mu në hundë. Ai u binte me dorë që t'i largonte, po ato se si rrëshqisnin nëpër jorgan dhe ai i ndjente prapë në fytyrë.

«Ama ç'budallallëqe mund të bëjë njeriu ndonjëherë! — mendonte. — Ja, si ai i mbrëmshmi, me Musanë. Tërë biseda kishte qenë pa kripë. Komike. Estradë. Po ç'djall doemos, ë? Lere, lere! Megjithëse kishte edhe një të vërtetë të vogël. Duhet ta kishte menduar që më parë se ç'do t'i thoshte Stefanit. Puna ndërlikohej sepse ata njihe-shin mirë. Kishin ngrënë në një tryezë. Bile njëherë kishin lojtur edhe kumar. Tridhjetë e njësh. Kurse tani Stefanij ishte shef dhe me atë duhej ta bisedonte çeshtjen e transferimit të tij! Sepse kishte katër vjet në B. dhe sepse në shkollën «Asdreni» kishte një vend për mësues fizike. Jo, jo për këtë. Këto s'pinin ujë! Por sepse ishin ato vështirësitë ekonomike. Pensioni dhe babai. Martesa e tij e ardhme. O, kjo ishte qesharake! S'kishte menduar kurrë për të. Ajo e motrave, po. Frazë e shkurtër dhe e logjikshme. Bën efekt. Një bombë, katër fishekë, një bombë. E shkurtër dhe e logjikshme. Një fi... katër bom..

fishekë. Një. katër, një. Për efekt psikologjik. Komike. E logjikshme dhe e shkurtër. Një fi... bombë. Ishte e gjitha një lutje. Çdo lutje sikur e cënon tërësinë e personalitetit. Dhe del në ankand. E shkurtër...»

Fjeti.

Të nesërmen i dhimhte koka tmerrësisht. Piu dy aspirina. Në mësim shpjegoi përcuesat elektrikë. Nëndrejtor Sea i vajti kontroll. Mësimi nuk i doli mirë. Sea mbushi një fletore me shënime duke shtrembëruar buzët. Do të dilte keq në analizë. Sea do t'i thoshte «në përgjithësi... mësimi mbeti i papërtypur nga nxënësit». Sea thoshte shpesh «mësim i papërtypur».

Pasdite ra shi. Musai po e priste në dalje. Ju afrua dhe e mori mënjanë, si ndonjë komplotist. U futën të dy nën ombrellën e Musait.

— Eja të shkojmë në shtëpi! — tha Musai.

— Jo tani! Kam punë!

— Eja, eja, se do të të vlejë! Të rinjtë s'duhet të nguten. Ti je i ri dhe e ke të ardhmen përpara. Kam dëgjuar se edhe në organizatë flasin mirë për ty!

— Ku e di ti?

— Kaq gjë mos di unë? Jam njëzet vjet mësues.

— Ç'të bëj në shtëpi?

— Për atë provën!

— Mos e merr me kaq rëndësi, o derëbardhë! Unë desha vetëm një këshillë. Pastaj mbrëmë kisha pirë ca. Kushedi ç'gjepura të kam thënë!

— Ti ke folur birinxhi!

— Prova s'ka asnjë rëndësi!

— Ç'thua? — u alarmua Musai. — Derisa më përfrove për këshillë, dëgjomë deri në fund. Sot na filloi dita mbarë. Siç thotë edhe populli, dita e mirë duket që në mëngjez. Kam në shtëpi mysafir Tezik Sherollin. Do na vejë mbarë me Tezikun!

— Nuk e njoh. Po pse do të na vejë mbarë me të?

— Unë dhe Teziku jemi miq të vjetër. S'mbahet mend qëkur! Po si nuk të kujtohet Teziku ty? Ai ka fjetur një herë në dhomën tuaj!

— Inspektori i financës?

— Dora vetë!

— E njoh! Fjeti një natë në atë krevatin e shkatërruar të Zakës, në atë karakatinën që e ka sustën prej teli dhe fundos si govatë. Zaka e ka lënë atë, sepse aty as një mace nuk fle dot!

— S'do t'ja dijë nga vështirësitë ai. Është i kalitur. Një natë kalohet dosido!

— Më duket se ai njeri s'fle kurrë në hotel.

— Çeshtje financiare — tha Musai. — Kursen dietën. Po le që ju bë edhe si zakon të flerë nëpër baza!

Nakos ju duk se gjithshka mori tani një kthesë jo serioze.

— Mos je penduar? — tha Musai kur vuri re me sa përtesë i hidhte këmbët ai.

— Nuk e di!

— Dëgjomë mua! Shumë njerëz nuk i japin rëndësi përgatitjes shpirtërore para një bisede me rëndësi. Dhe venë si gomari në dasmë. Pa asnjë mendim të lidhur e të radhitur. Njësoj si të hysh në mësim pa planin ditor. Bëhet mësimi pa planin ditor? Thuaje edhe vetë! Se, edhe eprori që të dëgjon, s'e ka për zemër turbullirën. Atij i pëlqen kur ja shkoqit të gjitha mirë edhe shpejt, se për të koha është flori. S'thashë më kot unë: frazë e shkurter dhe e logjikshme!

— Mirë, ju flisni me mend! Po, a s'mund ta bënim këtë provë të dy?

— Jo! Në asnjë mënyrë! E para sepse ne të dy i kemi përgatitur gjithë argumentat. E dyta sepse njihemi aq shumë, sa biseda ka rrezik të degjenerojë në humor. Dhe a e di se ç'është më e dëmshmjja në një provë të tillë? Katandisja në shaka. Humbja e seriozitetit. Serioziteti në bisedë është gjithshka. Kishte edhe «Zëri...» një artikull për këtë problem. E lexove?

— Jo!

— Lexoje! Këtë dhe një tjetër që bëjnë fjalë për ndërhyrjet. Sepse në thelb të gjërave, ti do të kërkosh nga Stefani një ndërhyrje që është e drejtë.

— Ndërhyrje do të quhet thua?

— Pa dyshim. Prova me Tezikun t'i përmbledh mendimet dhe t'i radhit argumentat sipas rëndësisë së tyre.

«Një bombë, katër fishekë, një bombë!» — mendoi ai.

Teziku ishte njeri serioz. Më parë atij i ishte dukur i thatë, si trung i djegur që s'dihet se si lëshon ende filiza e degë të gjelbëra dhe lidh fruta. Balli i madh, i rritur nga rënja e flokëve, i ishte shkruar nga një sërë rru-dha e brazda të thella e si të nxira që, kur shtriheshin, bënin të dukej një lëkurë e bardhë midis vijave të errëta dhe atij kjo i ngjau me asfaltin e shetitores pardje, me asfaltin ku kryqëzoheshin pellgje drite dhe errësire. Edhe veten e ndjente në po atë turbullirë si atë natë kur neonet prisnin me shirita të dridhshëm drite errësirën.

Teziku e dëgjoi në heshtje dhe i përqëndruar. Buzët i kishte shtrënguar sa i ishin zbardhur. Suksesi ju duk i dyshimtë.

— S'është koha — tha ai. — Nuk janë pjekur rrethanat.

— Mirëpo është ajo rrethana e vogël që shef është Stefanit dhe ai ka pasur shoqëri me Nakon si edhe ajo tjetra që në shkollën «Asdreni» duhet një mësues fizike!

— Ajo e para, ka vlerë. Ç'kredi ke tek ai?

— S'ju kuptoj!

— Je debitor a kreditor ndaj Stefanit, dua të them?

— Asnjëra. Ne ishim shokë.

— Nakua ka kredi të hapur kudo. Është Xhevahir!
— tha Musai.

— Unë e di se si do të vejë kjo bisedë — tha Teziku.

— Gjithë shefat kanë huqe të njëjta. Do të të japë një cigare me filtër. Do të bëjë sikur mban shënime në një blok. Do të të thotë «mirë se erdhe!» Pastaj... do të bjerë zilja e telefonit dhe ai do të thotë: «ja, po vij menjëherë, shoku nënkryetar!»

— Po kjo?

— Kjo është e zakonshme, sepse shefat i kërkojnë vazhdimisht në telefon. Po mund të ndodhë edhe që në zyrë të jetë një inspektor dhe ai do t'i thotë: «prit nja dy minuta se kam punë me shokun Nako.» Dhe pastaj do të të pyesë ty: «a kishe gjë të ngutshme, shoku Nako?»

— Të kam thënë: frazë e shkurtër dhe e logjikshme!
— tha Musai.

— Ti ke dy minuta afat. Në qoftë se nuk e trondit që në fillim, ai do zërë të të pyesë: «si shkon procesi i revolucionarizimit të shkollës, si zbatohet trekëndëshi revolucionar. . .»

— Hë pra? — s'ju durua Musait. — Fillo!

— Po! . . po! — belbëzoi Nakua. — Po ja, kam menduar, shoku shef, meqë ndodhemi përballë disa vështirësive ekonomike familjare. . . Nga ana morale. . .

Ai e ndjente se duhej ta jepte medoemos tani këtë provë. Dhe e dha. I radhiti me kujdes gjithë argumentat e vegjël e të mëdhenj. Teziku seç tha nxitur për lidhjen e teorisë me praktikën në lëndën e fizikës, për hekurudhën dhe gatishmërinë e rinisë. Sipas tij, shefi do të merrej një copë herë me këta argumenta. Musai mbeti shumë i kënaqur nga prova. «Kjo ishte e domosdoshme, tha ai, dhe ti i radhite arësytet në më pak se dy minuta. Të lumtë!»

4

Të hënën mori lejë. Binte shi me shtëmba. Rrëketë derdheshin buzë trotuareve dhe rrugët e qytetit ishin shkretuar. Rrotat e makinave ngrinin stërkala uji dhe ai ecte anës vitrinave. «Tamam kohë për mbledhje! — mendoi i dëshpëruar. — Ve bast që shefi do të jetë në mbledhje. Më mirë t'i kisha bërë një letër. Po ndofta letra nuk i bie në dorë.» U kthye në mëngjezore të hante byrekë. Mbylli çadrën që kullonte ujë dhe menjëherë i vajtën sytë te Stefani që ishte në radhën e burrave. Takimi ishte aq i papritur, sa atij ju shkrep të kthehej, po tani ishte vonë sepse edhe Stefani e kishte parë dhe i shkeli syrin. Ju duk si më i rinuar Stefani! Doemos, mor vëlla! Në atë fshatin e madh, që i thoshin qyteti B., mbante veshur përherë bluza leshi me jakë golf kurse tani kishte kostum dhe kravatë. Të rinon edhe veshja!

— Për byrekë? — pyeti Stefani.

— Po!

— Sa?

— Dy! Po pres në radhë edhe unë!

— Jo, jo, po t'i marr unë, se ata me mish janë më të mbaruar.

Mbështetën bërrylet mbi fibrën e kuqe të tryezave të larta dhe nisën të hanin. Shefi hante me ngut dhe pa kujdes. Atij ju kujtua se gjithmonë ai kështu hante dhe bile i lëviznin veshët nga nxitimi. Ai e kapi byrekun me kujdes me letrën e bardhë. Një buzëqeshje e harruar seç dukej nganjëherë në fytyrën e shefit dhe ai i shkelte syrin me fshehtësi, të thuash se kishin midis tyre një të fshehtë komike që e dinin vetëm ata dhe që i bënte për të qeshur.

— Sa mirë që të takova! — tha Stefani.

Atij i fërgëlloi diçka në mendje dhe një, mendim ju lëkund si tel i tendosur. Shpresa të ishte kjo?

— Nuk e kam marrë çadrën me vete dhe ti mund të më përcjellësh deri në zyrë. Apo ke ndonjë punë?

— Jo, jo! Edhe unë desha t'ju takoja — tha ai.

Jashtë rridhte shiu. Stefani e zuri për krahu dhe u nisën, nën çadër. Ai vuri re se Stefanit i rridhte një spërkë uji mbi supin e majtë. Pastaj spërka e ujit nisi të rridhte mbi supin e tij të djathtë. Në heshtje, Stefani e shtyu bishtin e anuar të çadrës dhe e vuri drejt. Stefani fliste vazhdimisht dhe atij s'po i vinte radha të thoshte ndonjë gjë.

«Pse s'm'u përgjegj, kur unë i thashë se kisha dëshirë ta takoja? — mendoi ai. — Sigurisht, nuk i bëri asnjë përshtypje. Ehu, sa njerëz në ditë i thonë ashtu! Secili që e takon i thotë desha t'ju takoja për një çështje. Ku ndodhi që e takova te byrekët? Më mirë t'i kisha shkuar në zyrë se e gjithë puna do të merrte ashtu një ngjyrë më zyrtare. Kurse tani, porsa të hyjmë nën kubënë e hotelit të komitetit, ai do të më japë dorën dhe do të më thotë, lamtumirë. Po sikur të ngulja këmbë që të bisedoja? E përse? Ai mund të thoshte: kam një mbledhje të ngutshme, eja një ditë tjetër. Një ditë tjetër. Tjetër. Këmbëngulje e kotë. U pa dita që me rrebeshin e mëngjezit.

Më mirë s'po ja kujtoj fare dhe po ja jap vetë dorën i pari. Ashtu. Që të mos i shkojë mendja se po i lutem. Unë nuk lutem, po kërkoj. Kushdo që lutet humbet një copë nga personaliteti. . . »

Nuk e vuri re se përpara kishte një pellg me ujë, dhe shkeli si i verbër. Uji i spërkati të dy. Stefani qeshi. Ky njeri qeshte dendur dhe disave nuk u besoej se si mund të bëhej shef një njeri që qesh dendur!

— Ore, pse i mban sytë tek yjet? — tha Stefani.

— Më fal!

— A, djall i madh! Kushedi ç'ëndërron ti, pa je kë-shtu i hutuar! Në këtë moshë edhe unë isha hutaq i madh. Au, sa herë hyja pa ditar në klasë! Po, po një të martuar dhe na! . .

Hynë nën kubënë e hollit. Supi i majtë i shefit ishte lagur prapëseprapë. U kujtua për atë premtimin e hesh-tur që i kishte bërë vetes qëparë. Këto ditët e fundit i kishte bërë vetëvetes shumë premtime, por asnjë s'kishte mbajtur. Sikur e ndiqte një fatalitet dhe e bënte që mos t'i mbante. Po këtë do ta mbante. I zgjati dorën me shpejtësi.

— Ti sikur më the se do të bisedonim diçka? — tha Stefani i habitur.

— Thashë se mos ju pengoj! Një herë tjetër.

— Eja dhe mos më çaj kokën! — tha Stefani.

Shkallët i ngjiten krah për krah. Në zyrë ishte ftohtë se nuk kishin ndezur zjarr. Stefani u muar një copë herë me zjarrin.

— Nem një cigare se m'u ça hunda! — tha ai.

— I kam «Partizani!»

— Ato pi edhe unë!

Zjarri u ndez shpejt.

«Tani do të më pyesë: si vete revolucionarizimi në lëndën e fizikës!» — mendoi ai dhe buzëqeshi.

— Ku flini tani? E ndërruat dhomën?

— Po, po. Jemi afër shkollës.

— Aty është mirë. Mban mend kur mblidheshim dimrit në atë dhomën e Zakës?

— Mblidheshim. . .

— Nashua i binte kitarës kurse Piri na këndonte ca këngë melankolike dhe ca arie nga operat. Cila ishte ajo arie që e këndonit të dy?

— Nga «Rigoletto». Ishte ajo «Gruaja është e lëvizshme!»

— Tamam! Kur e kujtoj, shkrihem gazit! Njëherë se si m'u kujtua në një mbledhje dhe i kafshova buzët gjersa i përgjaka që të mbaja të qeshurën.

— Unë, shoku shef... — filloi ai.

Stefanit ju drodh një msukul në faqe dhe sytë ju pikëlluan, po bëri sikur s'dëgjoi asgjë.

— Po ajo historia e xhakaventos së Naskës që deshi ta ngjyrose Piri me bojë në fabrikën e lëkurëve, si vajti?

— O! Ajo është për të shkukur! Piri thoshe: «është gati! Ka marrë edhe një kolor... që t'i vret sytë. Po nuk i është tharë akoma boja». Kështu thoshte çdo javë derisa u ftoh koha. Pastaj doli që ai nuk e kishte shpënë fare në fabrikë dhe e kishte harruar në një musëndër me rrotat e vjetra të biçikletës!

Stefani qeshi. Pastaj u bë një pauzë, sikur s'kishin ç'të thoshin më.

— Shoku shef!... Desha t'ju thosha!... — tha ai.

— A, djall i madh! Lere atë shefillëkun mënjanë tani! Ç'ke kështu? Ne kemi fjetur në një dhomë! Apo harrove?

— Jo, por meqë jemi në një zyrë, vetëvetiu më vjen që t'ju drejtohem në mënyrë zyrtare!

— Ç'më ka marrë malli për ato qyfyret tona! Po kur s'na përfillte fare atëhere ai kamerier Qanua? Bre, ç'janë ca njerëz, o Nako! Dy javë të shkuara u ndala aty që të haja drekë: «urdhëro, shoku Stefan, hyrë në këtë dhomën këtu që e kemi rezervuar për shokë kryesorë» — më tha. Kur të të marrë drunë, o Qano! — thashë me vete. Ma prishi oreksin fare dhe nga inati vajta hëngra në pijetore!

— Do të desha t'ju thosha diçka, po kam frikë se mos ju vonoj!

— Nuk më vonon, jo! Ore, a s'më thua, luani ndo njëherë tridhjetë e njësh tani?

— Jo, ç'ne? — u alarmua Nakua. — Kumari është i ndaluar!

— Ama ç'na mbushe mendjen! E mban mend kur lojtëm një natë para Vitit të ri? Ti kishe shans. Na grive, na grive!

— Që atëhere, s'kemi lojtur më!

— Leri ato, se ju di unë! S'duroni ju, jeni si Caci, që do heqë dorë kur t'i venë plloçën!

Ai s'foli. Stefani mori një cigare tjetër. Ra telefoni. Stefani ktheu çelësin në zyrën e inspektorëve.

— Kisha një lutje — tha ai — po dyzova shumë derisa vendosa të vija. Sepse më duket që njeriu, saherë lutet për diçka, humbet një pjesë të personalitetit!.

«Po ç'm'u tipos tani ky mendim dhe e fillova kështu? — u alarmua ai. — Pse e fillova me personalitetin?»

— Kjo varet nga kërkesa — tha Stefani. — Kur kërkon me këmbëngulje një të drejtë që ta mohojnë më kot ose lutesh për diçka njerëzore dhe të arësyeshme, personaliteti rritet, apo jo?

— Ndofta! Si ju duken juve për shembull kërkesat që bëjnë arësimitarët e rinj për transferim?

— Të kërkoksh të jeshë afër familjes, është një kërkesë shumë njerëzore dhe e arësyeshme!

— Ashtu mendoja edhe unë! — psherëtiu ai. — Kam dëgjuar se në shkollën «Asdreni» duhet një mësues fizike. Ju e dini që unë kam katër vjet në B; kurse familjen e kam këtu. Thashë ta bisedoja këtë gjë njëherë me ju, sepse kam edhe arësye të tjera. . .

Atij ju kujtua se e kishte nisur bisedën si mos më keq, tamam me qorrfishekët, siç kishte thënë Musai. Po tashmë ishte vonë. Megjithëse ngatërruar njëra me tjetrën, ai prapë ja radhiti gjithë ato arësye që kishte menduar. Stefani u vrëjt pak, po e dëgjoji me vëmendje. Nuk shënoi asgjë. Mori edhe një cigare nga kutia e tij që kishte mbetur mbi tryezë.

— Më kanë thënë se ke bërë një kabinet të mirë fizike! — tha ai.

— Jo kushedi se çfarë! — tha Nakua dhe mendoi se shefi ju shmang si mos më keq përgjigjes.

— Qyteti B. është shumë i vogël dhe aty çdo gjë që bëhet merret vesh menjëherë! — tha Stefani.

Ai u topit dhe kërkoi të hetonte ndonjë shenjë dinakërie në fytyrën e Stefanit, po s'pa asgjë. «Pse vallë më tha se në qytetin e vogël B. merret vesh çdo gjë që ndodh? — mendoi ai. — Pse? Ndofta për kabinetin?»

Ai psherëtiu dhe bëri drejt derës.

— Ku vete? — tha Stefani. — Ne tani posa filluam të bisedojmë?

Zjarri kishte marrë mirë dhe kërciste. Një cergë merimange u këput nga nxehtësia dhe u var në qoshen e lartë të zyrës...

MAÇOKU

Ai besonte se shkaku i të gjitha shqetësimeve të tij ishte mosha.

«Në vitet e mia, mendonte, koha vrapon revan, si kalë arab kurse ti dëshiron që ajo të mos nxitohet e të mos rrokulliset ashtu, rrokopujë. Por njeriu është i pafuqishëm ndaj kohës, dhe ngutja e saj ja zbut dhe ja ligështon zemrën e ndjenjat; prandaj çdo fatkeqësi, të madhe a të vogël, të vetën ose të fisit, ai e përjeton më gjatë dhe vuan më shumë se në vitet e rinisë. Megjithatë, në jetë është edhe harrimi. Pa harrimin, fatkeqësitë do të ishin fatale, do t'ja gjymtonin njeriut ditët e tij dhe do t'ja shkurtonin gjumin e netve...»

Ai ishte mësues i vjetër dhe aksioma të tilla dinte më shumë se sa duhej. Por, edhe pse dinte shumë aksioma, prapë nuk e harronte rrëmbimin e Elsës dhe shqetësimet që solli pas ikja e saj. Ai e quante rrëmbim dhe jo ndryshe, megjithëse gjithë qyteti e dinte që Elsa kishte shkuar vetë nga shtëpia me një mësues letërsie që i kishte prindërit në fshat. Kishte braktisur shtëpinë e saj duke lënë në abazhurin e komosë vetëm një letër të shkurtër, përmbajtjen e së cilës nuk e mësoi dot asnjëri veç atij të Elsës dhe atij, mësuesit, që ishte vëllai më i madh, këshilltari më i rëndësishëm i gjithë fisit të tyre të vogël që përbëhej nga tri shtëpi njëra bri tjetrës në Rrugën e Bilbilave.

Ai mund të mos e përjetonte aq gjatë e aq fort rrëm-

bimin e Elsës, sepse fundja ajo nuk ishte vajza e tij, por mësuesi kishte arësye të trefishtë që ta vuante këtë fatkeqësi, sepse sipas tij gjithë njerëzit me kulturë janë të ndjeshëm si një tel i tendosur dhe vuajnë më shumë se sa njerëzit e thjeshtë praktikë.

Ai besonte se kjo ngjarje e mërzitshme i ishte ngulur kaq fort në mend sepse ishte e para herë në jetën e fisit të urtë e të nderuar të Zhutëve që njerëzit turrnin nëpër gojë një ndodhi të tillë absurde që kishte të bënte me ta dhe që sadopak ishte një njollëzë për të gjithë. Vuante edhe sepse, gjithë edukimin e saj e kishte drejtuar ai, meqë vetë u martua i madh në moshë dhe s'kishte shumë vjet që ishte ndarë nga i vëllai. Besonte se i kishte dhënë asaj një pjesë të vogël të vetëvetes, sepse çdo fëmijë është produkt i edukatorëve të vet.

Shkakun e tretë nguronte t'ja pohonte vetes me gojë plot, por si njeri largpamës e i zgjuar, ai s'mund të mos e hetonte atë lidhje logjike që ekzistonte midis tri ngjarjeve aq të rrëmbyeshme në tre muajt e fundit të jetës së Elsës: propozimit që ju bë për t'u fejuar me piktorin Harilla, kundërshtimin e saj (të drojtur, vërtet, si pasojë e edukatës së mirë) dhe rrëmbimit apo ikjes së saj, quaje si të duash (që s'dihej pasojë e kujt ishte. Sipas tij në këtë mes ishte donzhuanizmi i mësuesit të letërsisë, sipas të tjerëve ishte një dashuri e fortë, që kishte qenë e fshehtë por e valë, si prushi nën hi dhe, posa ishte shpupuritur hiri nga era e fejesës së padëshiruar, prushi ishte ndezur. Natyrisht, ata që thoshin këto, duhej të ishin sipas mësuesit ca letrarë pa talent, që shpreheshin në mënyrë letrareske).

E keqja ishte se propozimin e fejesës ja kishin bërë ai dhe e shoqja, Nasta. (Ai nuk desh ta quante në asnjë mënyrë këtë propozim me emrin tjetër-mblesëri, si e shoqja. Ai e kritikonte të shoqen kur thoshte se Elsës s'kishin për t'i bërë kurrë një mblesëri kaq të mirë dhe se ajo s'kishte kokë për të!)

Kështu kishte ndodhur.

Kështu kishte zbritur mbi trazimet e tjera të shpirtit të tij edhe kjo vuajtje e re, kjo brengë e pakuptueshme që duhej të kishte sosur, po që s'po mbaronte dot. Shumë de-

ndur i premtonte vetes ta harronte dhe ende më dendur i buiste dhe e mbërthente si makth e njejtë pyetje: Ç'ligje të pashkruara po vinin e po hynin pa trokitur në shtëpitë e tyre të qeta, me ngulmimin kryeneç të erës, të vetmit fenomen natyror që s'mund t'i vesh fre?

Vera ishte shumë e nxehtë, po mësuesi Anton Zhuti besonte se zemrat e gjithë fisit ishin akull, ngaqë mbi to rëndonte hija e përhershme e braktisjes dhe e brengës që la pas ajo.

Shtëpitë e tyre i dukeshin më të zymta.

Ai vendosi ta mposhte dëshpërimin dhe sillej sikur s'kishte ndodhur asgjë, sikur gjithëshka u harrua dhe sikur s'kishte jetuar përbri tij ajo vajza e drojtur që quhej Elsa, e përkëdhelura e gjithë fisit që s'kishte dashur të fejohej me piktorin Harilla dhe që kishte rënë kokë e këmbë brenda grackës së mësuesit vagabond. Edhe e shoqja, Nasta, dukej e dëshpëruar. Dëshpërimi i saj i ngjante më shumë fyerjes. Sepse ishte ajo, dhe jo Antoni, pikërisht ajo që gjeti dhëndrrin Harilla. Kurse ajo budallaqja El-së, s'përfilli as emrin e njohur të piktorit, as jetën e shkujdesur në shtëpinë e tij (Ç'shtëpi? Vilë thuaj më mirë!). Dëshpërimi i saj ishte si vreri i papritur, mbledhur në një plagë po, meqë ajo ishte grua krenare, mendonte se nuk duhej ta humbiste torruan si i shóqi i cili, sipas saj, më kot mudohej të shtihej i ftohtë, sepse dukej sheshit që ishte i prekshëm si fëmijë. I bëhej bile se më shumë shqetësohej për Elsen Antoni i saj, se sa ati i Elsës, por për këtë nuk e vinte dot dorën në zjarr, sepse ndjenjat e njerëzve janë punë e ngatërruar.



Një ditë vere, ajo vuri re se Antoni i kishte ndryshuar disa nga zakonet e tija të mira. Nuk ishte më ai njeriu i përkorë që lahej e vishej me sqimë. Binte më herët në shtrat dhe nuk i mbathte më papuçet që ja kishte qëndisur Elsa dhuratë për Vitin e ri. Më e çuditshmja ju duk

argëtimi i tij me maçokun e shtëpisë për të cilin dikur as që kishte çarë kokën fare. Këtë gjë e pikasi një mbrëmje, nja dy muaj pas rrëmbimit të Elsës. Deri atë natë ajo nervozohej shumë nga jeta e rrugicës së tyre. Ajo ishte tërë zhurmë, siç kishte qenë përherë. Në mbrëmje, sofateve mblidheshin po ato gra që mblidheshin edhe dikur. Vetëm sofatet para portës së tyre kishin mbetur shkretë, si të molepsura nga sëmundje ngjitesë. Deri pardje rrinte në to gjyshi, i cili, si matuf që ishte, zinte e ua qante hallin e Elsës të gjithëve, po për fat të mirë gjyshin e mbërtheu një grip dhe s'lvizte më nga shtrati. Jo shumë kohë më parë, këto net vere, edhe ajo mezi i priste. Ja kishte ënda të rrinte e të kuvendonte sepse në bisedat e tyre ishte gjithë jeta e qytetit. Në ato biseda kishte shumë hamendje dhe prej sëcilës thurreshin ndodhira që «për atë Shën Gjergj!» ose «për atë kozmizëm, që më thertë!» kishin ndodhur tamam ashtu siç thoshte ajo që e kishte fjalën. Ajo vetë nuk dërdëlliste shumë, si Stefania për shembull, po në fund të çdo hamendjeje, si më e ngritur që ishte, vinte kapakun dhe s'mbetej më dyshim se, po të thoshte Nasta që kishte ndodhur «pikërisht kështu!», s'kishte më vend për kundërshtime.

Por tani netët s'ishin më të sajat, sepse në rrugicë pëshpëritej vetëm emri i tyre i papërlyer kurrë. Elsa, mble-sëria e saj dështake, piktori Harilla, që pagëzohej si fyell pa vrimë, mësuesi, Elsa, ajo... Ç'të të them më parë?

Zjente nga inati, mallëkonte dhe përnatë i ankohej Antonit:

— Gojëfëllegat! — thoshte. — Posa hyra në qoshe të rrugicës, e prenë fjalën dhe ajo bizbiqja Stefani deshi ta mbulonte kopilin dhe tha: «kështu, moj motra, mua më erdhën shumë të lagura drutë e dimrit. Ku i ka sytë komunalja?» — Uh! u drunjossh dhe u komunalofsh moj!

— Do ta harrojnë — thoshte Antoni. — Do të ndodhë diçka tjetër dhe do të merren me të.

— Edhe ty të mbiu në gojë kjo fjalë: do ta harrojnë, do të dalë diçka tjetër! Unë s'dua të ulem deri në nivelin e tyre, se ndryshe do t'ja kisha paguar mirë asaj Stefanisë. Sikur s'e di bota që e ka lojtur bishtin sa ka thënë «mjaft!» kur ishte vajzë!

Antoni mërzitej pa masë prej saj, po s'kishte forcë të zihej. Bile kishte një frikë të pashpjegueshme, frikë që i rritej sepse tani ishte e qartë që ai po plakej shpejt, kurse ajo s'luante fare!

(Pse e harronte vallë që ishte tetëmbëdhjetë vjet më i madh se ajo?)

Kur mërzitej, bënte sikur zhytej në leximin e gazetës ose dilte jashtë, për ajër. Posa dilte, gratë reshtnin e nemiteshin. Vetëm çesma e rrugës vazhdonte gurgullimën, meqë s'mbyllej se i kishin vjedhur rubinetin. Edhe llamba e qoshes kishte mbetur thyer, dhe atij i kujtohej që ajo ishte thyer po atë natë që ishte rrëmbyer Elsa.

I dukej se nuk do të kishte qetësi të plotë derisa të gjente qoftë edhe disa fije prej atyre mendimeve të çuditshme që e patën shtyrë Elsën drejt pasigurisë. Nën peshën e kësaj brengje që e shtypte me të panjohurën e me të papriturën e vet, ai u lodh dhe nuk po merrej më si zakonisht me edukimin e fëmijëve të vet ose të vëllezërve. Për fat të mirë, me sa dukej, fëmijët e tjerë ishin të urtë dhe s'kishin asnjë mendim heretik, bile e respektonin e ja dëgjonin gojëhapur çdo këshillë. Dhe këshilla për jetën, ai kishte vjet që jepte shumë dhe falas. Apo ndoshta gabohetj përsëri? Se, a s'kishte menduar dikur që edhe Elsa s'kishte të tjera mendime, veç të tijave?

Thellë në shpirt, ai ruante edhe një farë inati kundër së shoqes, sepse ajo e gjeti atë guakun Harilla, për hatër të të cilit u shpejtua «rrëmbimi», po ky inat strukej diku dhe ishte tepër thellë që të mund të ngrinte krye.



Pra, një natë, siç thamë, atij i ra në sy maçoku. Maçoku ishte në lulen e moshës, i zi, i madh, me sy të përshkënditur dhe nevrík. Kishte zët veç të tjerëve, djalin e tij dhjetëvjeçar, Mondin, sepse ai tallej me dinjitetin mashkullor të maçokut duke i varur në qafë zilka dhe kordonë shumëngjyrësh.

Në mbrëmje dremiste pas sobës dhe, kur e merrte uria, brofte si shigjetë e zezë dhe fuste hundën në poçen ku i shtinin për të ngrënë mbeturinat e darkës. Ditën gjuante minj nëpër hatullat e shtëpive të vjetra të rrugicës.

— Sa i bukur qenka ky maçok — tha Antoni, duke kundruar me kënaqësi se si ngrihej e ulej nga frymëmarrja barku i kafshës si i lyer me vaj.

— Maçok si gjithë të tjerët — tha e shoqja. Pse çuditesh sikur s'ke parë kurrë?

— Nuk është si gjithë të tjerët, jo — kundërshtoi ai.

— Vërtet — tha e shoqja — se kobash si ky rrallë gjen. — Po do t'i thyejnë peshkun e kurrizit me dru, mos ki keq! Gjithë ditën nëpër shtëpitë e botës bredh!

— Oj!.. oj!.. si duket! Si ndonjë gjeneral! — tha ai dhe e përkëdheli lehtësisht, pothuaj pa ja prekur qimet fare.

— Si nuk të vjen ndot! — tha me neveri gruaja. — Kafshë është!

— Kafshë, po kafshë e rrallë!

— Ç'të bëj se gjuan mirë, pa do e kisha shkëmbyer qekuri me një pulë!

Antoni, si padashur e përkëdheli prapë maçokun që dremiste, po këtë herë kafsha e ndjeu se dikush po ja trazonte qetësinë e tij apostolike dhe po i sillte dridhërimë nëpër shtatin e bëshëm, prandaj u përshkund nga dremitja duke turfulluar dhe brodhi me përtesë nëpër qilimin e butë, duke tundur bishtin. Pastaj doli jashtë derës. U dëgjua hapi i tij i rëndë nëpër shkallë, si hapa njeriu.

— Qenka i egër! — tha ai.

— Ç'të zuri kështu me maçokun? — ju shkreh gruaja.

— Pse, si thua ti, të mos flasim fare tani? — tha ai me inat. Gruaja u habit. Ishte e para herë që e dëgjonte të shoqin të përdorte një ton të tillë. Ajo nuk foli sepse nga e shkuara e dinte që ishte mjaft vetëm vështrimi i mprehtë i syve të saj të ftohtë bojëhiri, mirëpo Andrea i kishte nervat të cingrisura mos më keq dhe jo vetëm që nuk uli kryet nën peshën e atij vështrimi kryeneç, po tha tërë mllef:

— Ç'më shkrehesh kështu sikur ke përpara Edmondin?

— Sonte ti nuk je mirë — tha ajo. — Ç'është kjo tekë

të merresh me një maçok të qelbur? Mos do ta zbutësh e ta bësh manare?

— Edhe mund ta bëj, ke për të parë! — tha ai.

— Po bëhesh gazi i botës — tha ajo dhe kushedi sepse kërcënoi dikë me gishtin tregues të ngritur lart.

Antoni s'foli më. E dinte se gjithshka i erdhi nga nervat, ngaqë ju kujtua përsëri se ishte kjo grua, që e gjeti atë dudukun Harilla i cili kishte të vetmen të mirë që kish fatin e atij këndezi të përrallës, që e futën në thesaret e mbretit. Ju kujtua se ishte kjo grua, që ja mbushi mendjen edhe atij ta mblesëronin Elsën për burrë. Ama ç'dhëndërr! Mirë thonë: bëmë me fat dhe hidhmë në pleh! Ashtu edhe ai derdimeni!

Ai e dinte se nuk ishte i zoti të mbrehej pendë me fjalë me të shoqen dhe dikur do të mundej nga arësyetimet e saj, por sonte se si i erdhi mirë kur kundërshtoi me këmbëngulje.

Të nesërmen mbrëma, si për inat dhe për të provuar durimin e së shoqes, ai nisi ta përkëdhelte prapë maçokun derisa ai u mërzit dhe ja mbathi jashtë nëpër dritaren e hapur. Duke dalë rrëzoi saksinë me begonie dhe e theu. Nasta ja vuri ulërimës, Antoni s'foli. Kishte filluar të habitej edhe vetë me këtë tekë të papritur. «Kjo më vjen nga mërzia — mendonte. — Ose ngaqë dua të inatos gruan. Ose, ngaqë është interesante të mësos me sjellje të pëlqyeshme e të edukuara një maçok, ta mësos me një jetë tjetër, ta zëmë ta mësos me konfortin tënd». Pas një jave maçoku ishte mësuar me dorën e tij ledhatare, që s'kërkonte asgjë më shumë hëpërhë veç të përkëdhelte qimet e buta, bile ky ledhatim nisi ta nanuriste e ta vente në gjumë. Maçoku gërhiste me dëshirë.

Nasta, që bërtiti shumë ditët e para, ja hoqi fillin kur pa këmbënguljen e të shoqit po, kur uleshin në tryezë, nuk harronte t'i hidhte një vështrim të thiktë dhe t'i thosh: «Ngrehu e laj duart, se ke trazuar maçokun me to!»

Më vonë, siç ndodh shpeshherë, kjo tekë ju duk edhe asaj e arësyeshme, sepse ç'të keqe ka të kesh dashuri për kafshët e shtëpisë? Përkundrazi, është një gjë e mirë t'i bësh ato të bindura duke u dhënë një pjesë të edukatës

sate. Pastaj, dikur zonjat e fisme a nuk mbanin pas kone të bukura e leshtore, i ushqenin në tryezë dhe bile... flinin me to? Megjithëse maçokët nga fisnikëria nuk afrohen asgjekundi me qentë, prapëseprapë maçoku i tyre dukej që ishte sojlli. Pra, ca nga halli, ca nga dëshira e përhershme që të bënte diçka veç të tjerëve, ajo e përligji dashurinë e të shoqit për maçokun. Madje, meqenëse Antoni, si njeri pa fantazi nuk gjeti dot një emër më të mirë për ta pagëzuar dhe e thërriste shkurtimisht vetëm «Çok!», asaj i vajti mendja t'i vente emrin «Zhorzh», po fatkeqësisht u kujtua pak si vonë se ndërkohë maçoku ishte mësuar të përgjigjej vetëm kur i thërrisnin «Çok!», kështu që nuk e pranoi emrin e ri dhe ai u harrua.

Ishin të habitshme përparimet e Çokut! Pasi u mësua me përkëdheljet, ai pati aq mend, sa të mësonte dhe të jepte «dorën» dhe të vinte në prehër kur e thërrisnin me emër. Sa madhështor u bë maçoku i zi, që dikur ishte i egër dhe krenar, kur hoqi dorë nga bredhjet nëpër hattullat e shtëpive të hallakatura dhe kur i këmbëu minjtë me «dietën» që i vihej në një pjatë, në cep të kuzhinës! Atëhere Antonit ju duk se kishte ardhur koha që Çoku të mos lahej më duke u lëpirë dhe prandaj një herë në javë ai duhej të ndjente kënaqësinë ledhatare të banjës me ujë të ngrohtë dhe sapun «Diana». Ishte e vërtetë që pas banjës ai humbiste diçka nga madhështia e tij, po kjo ishte e përkohshme sepse, posa thahej, pamja e tij bëhej edhe më hijerëndë dhe më e ndritshme.

Kafsha e gjorë erdhi e u ngjall, u plogështua, nuk kërcente më. Mirëpo, kështu i rëndë dhe i avashëm dukej më ceremonial, si pjesëtar i denjë i familjes. Zbukurimet e zilkat e shumta i duronte me një qetësi stoike dhe i mbante tani me salltanet, si një princ zezak i tribuve në shekullin e shkuar.

Maçoku e vinte në disa mendime interesante Antonin. Ai arrinte me anë të tij në përfundime logjike që e bënin edhe më të pakuptueshme ikjen e Elsës. «Edhe Çoku, që është një kafshë, megjithëse instiktet e urdhërojnë të kthehet në format primitive të jetës, preferon të bëjë një

jetë komode e të qetë. Përse e shkëmbeu ajo këtë jetë? Kur njeriu ka mundësinë e zgjedhjes, ai zgjedh më të mirën. Këtë e thotë edhe biologjia. Kurse ajo zgjodhi më të keqen. Zgjodhi pasigurinë, privacionet!..»

Në të hyrë të dimrit, Çoku i habiti të gjithë, sepse mësoi brenda një dite të kërcente e të luante me topthat. Tопthat ishin bërë prej penjësh mëndafshi të mbështjellë lëmsh dhe ishin varur në mur me ca lidhëza prej fiongoje të gjelbër. Bashkë me ta kishin varur edhe rrotëza penjësh që tringëllinin. Gjithë këto ishin shpikje të Edmondit. Çoku u mësua të kërcente drejt tyre posa dëgjonte urdhërin e prerë «hidhu!». Kërshëria e shtynte vetëvetiu drejt atyre sendeve që i lëkundeshin mbi hundë. Mirëpo meqë kishte vënë dhjamë, kërcimet i bënte të ngathëta dhe të ulëta. Më vonë kjo stërvitje i bëri mirë dhe u bë muskuloz si më parë.



Dhe po mbaronte dimri i gjatë e i ftohtë e po ndjehej sërisht frymëmarrja e pranverës.

Erërat e ngricat i kishin tharë kërcëjtë e hollë të lule Shëmitreve që dilnin mbi dëborë dhe i kishin vënë një kore trishtimit të shtëpisë në rrugicë. Dhe, kur ka kore, plaga nuk lëndohet lehtë, kështu që Elsa e ikur, në vend që të falej, po harrohej sikur s'kishte qenë kurrë. Dikush kishte ndërhyrë për pajtim dhe të tre vëllezërit, bashkë me gratë, e biseduan një mbrëmje këtë gjë, por Antoni tha se ishte më e mirë harresa se sa pajtimi përulës që do t'i vinte prapë në mes të vëmendjes së jetës së qytetit.

Një ditë, me Çokun, fëmijën e përkëdhelur të familjes, ndodhi diçka.

Ishin ditët e fundit të shkurtit. Çoku erdhi e u ligështua, teshtinte papushim dhe Antoni u frikësua nga ndonjë pneumoni që mund ta kishte marrë në banjë e sipër. Por pas një jave ai u shërua. Pas shërimit nisi të rrëfente ca shenja kokëfortësie, si atëhere kur e zotëronin

instiktet e vjetra të egërsisë, kërcente si i harbuar dhe u desh që tophat e lojës të vareshin dy pëllëmbë më lart. Antoni mendonte se ky ishte një ligështim i arësyeshem nervor, pas sëmundjes. Por befas, Çoku u zhduk, sikur e përpiu dheu. S'dukej më as në shtëpitë e vjetra, as në rrugicë, askund. Asnjë gjurmë. Antoni i dha karar me pikëllim që Çoku aq e pati: ose ja vodhën ata që u ishin bërë merak forcës dhe qimes së tij të ndritur, ose e vranë rrugaçët, por që të dyja ishin njësoj përderisa Çoku nuk do të kthehej më.

Kaluan dymbëdhjetë ditë. Filloi një acar. Një natë, nëpër gjumë, atij ju bë sikur dikush e shtyri heshtazi derën e dhomës së gjumit. Dera po hapej me një zhurmë të lehtë. Si në kllapi, ai kërcëu nga dysheku. Zemra i rrihte si çekan. Mezi e gjeti çelësin e dritës. Po ajo ishte një dritë e mekur nën një abazhur të gjelbër dhe bënte vetëm një njollë në lustrën e komodinës. Drita nuk e përzinte dot gjysmerrësirën e turbull të dhomës, kurse praku ishte në errësi të plotë. Dera po shtyhej ende nga dora e padukshme dhe ai deshi të thërriste: «Kush është aty?» — mirëpo zëri i doli i hollë si një piskamë fëmije dhe s'u muar vesh se ç'tha. U zgjua edhe e shoqja, pushtoi gju-njët me duar dhe fshehu kokën prapa shpinës së tij. Nasta lëshoi një lloj thirrje të mprehtë dhe ai u habit se ku e gjeti zërin ajo. «Tani dera do të mbyllet dhe hajduti do të ikë» — mendoi ai. Por dera hapej edhe më, ngadalë dhe pa fuqi. Ai u mundua të shquante shkëlqimin e dorezës së derës dhe lëvizjen e saj, po s'pa asgjë. Kështu, ata nuk e vunë re se si shkau nëpër hapësirën e saj një maçok i zi, i ligur, koskë e lëkurë. Pastaj dera u mbyll me vrull, nga susta. Kjo ndodhi brenda një çasti të shkurtër që atyre ju duk pafundësisht i gjatë e i tmerrshëm. Gruaja pësh-përiti:

- Qenka një mace e zezë!
- Ç'është kjo mace e zezë?
- Mace e huaj do të jetë! Kobashit!
- Nem një dru nga të sobës t'i bie e t'i thyej kokën, se na e thau gjakun!

Maçoku u afrua te zjarri pa e trazuar qetësinë e tij të zakonshme dhe atëhere Antoni e njohu dhe tha i mallëngjyer:

— Po qenka Çoku!

— Çoku?

— Çok, bre bir! — tha Antoni. — Ku na humbe kështu? — U ngrit nga shtrati, e mori në duar dhe i erdhi për të qarë sepse ai s'rëndonte më as sa një mace ngordhalaqe dhe i numroheshin rebrat si të një kufome që po kalbej.

— Ç'je ligur kështu, bre Çok? — e pyeti. — Ke mbetur pa ngrënë, o i gjorë? Po mos ki dert tani, se do të të dëndim sa të lëpish thonjtë!

Dhe u ngrit t'i hidhte në pjatën e zakonshme mbeturi-nat e darkës. Ndërkohë, maçoku fjeti anës zjarrit. Antoni e la të flinte, sepse ai e dinte që gjumi disa herë është më i nevojshëm se sa ushqimi dhe u shtri në shtrat, mjaft i ngazëllyer. Të nesërmen në mëngjez ai nuk ja besoi askujt ushqimin e Çokut, i bëri disa lloje lllapash dhe e urdhëroi me kënaqësi:

— Çok, bre bir! Hidhu një herë!

Çoku i shkretë u mundua të bindej, por ishte i zgajdur dhe nuk kërceu më lart se hunda e tij.

— S'ka gjë, s'ka gjë! — e qetësoi Antoni. — Do të hidhesh nesër.

Atë mbrëmje, pas një mungese të gjatë, ai u kthye në klub për të pirë kafe. Aty takoi mikun e tij, veterinerin Sabaudin. Duke rufitur kafën ai i tregoi Sabaudinit rastin e çuditshëm të arratisjes dhe të kthimit të Çokut. Por Sabaudini i shpjegoi se për fat të keq, ato ditë të arratisë. Çoku i kishte kaluar me siguri pas maceve dhe se, po të kishte qejf që ta kishte maçokun përherë të bindur e të qetë, duhej ta tridhte. Vendosën që Çokun ta tridhte doktor veterineri Sabaudin, pasi të ushqej mirë ndonjë javë që ta merrte veten.

Si u dend mirë e mirë me ushqime të zgjedhura, Çoku nisi të shfaqte prapë disa shenja moshindjeje, si atëhere kur ishte arratisur. Siç duket e tundonte fort kujtimi i jetës së lirë të netve të shkuara dhe Antoni u ngut të lajmë-

ronte veterinerin Sabaudin. Por, një ditë para se të vinte ai, Çoku u zhduk.

Siç duket ishte velur edhe ai nga dieta dhe topthat, nga përkëdheljet, nga banjat e ngrohta dhe nga sapuni «Diana»; u vel nga kotjet e pafund anës zjarrit dhe nga ajo amulli e ëmbël, prandaj s'u kthye kurrë më. Thoshin se tani bridhte prapë nëpër hatullat e shtëpive të tjera.

KAPËRCIMI I HALLKAVE

Do të vinte një ditë dhe të gjitha ato ndodhi e biseda do t'i dukeshin për të qeshur. Por këto ditë ajo ishte e mër-zitur dhe nervoze. Hyri në dhomën ku kishte qenë kopshti. Karriget e vogla të fëmijëve rëndonin mbi njëra-tjetrën të mbledhura grumbull në qoshe. Mbështeti bërrylet në par-vazin e dritares. Avuj të njomë vareshin jashtë nëpër de-gët e murrizave. Natën kishte rënë shi. Porsa kishin shkuar dhentë dhe shtegu ishte shkruar me gjurmët e tyre si shkro-nja të pakuptueshme të një gjuhe të huaj. Shtegu ishte i ha-rruar, si një brazdë midis gardhit të manaferrave që plek-seshin me gjembat e njëra-tjetrës rrënjë e kërcell bashkë. Si pleksen edhe disa gjëra në jetë! Ja, ashtu si manaferrat! Dhe, eja e shpleksi po të duash! Ja, ishte përgjegjësi i sektorit, Mystehaku, Mystehak Mullamake. Ai i kishte thë-në rëndë-rëndë, para ca ditësh: «Që ta dish ti, këto janë koncepte! Oj! Eja në radhë! Eja, se po i kapërcen hallkat!» Ajo s'kishte kuptuar asgjë, megjithatë, ishte dëshpëruar. Sepse Mystehaku s'ishte çdokushi, po përgjegjësi i sek-torit. Dhe dëshpërimi i ra si brymë e ju bë se prej saj mërdhihte. Ku ta dinte? Ato fjalë për hallkat, Mystehaku ja kishte thënë edhe në vjeshtë. Njëherë ju duk se çof duhet të kishin një kuptim të thellë ato fjalë, paçka se asaj i dukeshin pa kuptim dhe të errëta si një lëmsh. Dhe, eja e çitirre këtë lëmsh. Oj! Vjen tjetri dhe të thotë ca fjalë të ngatërruara dhe pastaj ato të mbeten në mendje

për një kohë të gjatë siç mbetet një batak midis blerimit të livadheve. Si një batak ku kuakit një bretkocë e vetme: kuak!..

Atëhere, në vjeshtë, dëshpërimi kishte qenë më i gjatë dhe zëri i Mystehakut ishte i rëndë si plumb. Kurse pardje ai e kishte pasur zërin të ngjirur sepse kishte kënduar dhe kishte pirë tërë natën në dasmën e Shefkiut...

Ajo mbylli derën e kopshtit dhe trokiti me forcë në derën e kryesisë që ishte karshi. Megjithëse pas bashkimit. Mystehaku kishte mbetur vetëm përgjegjës i sektorit, tabela e vjetër nuk kishte lëvizur nga vendi dhe ajo thoshte: «Kryetari. Pritja e popullit çdo ditë, 6 deri 8. ndaina-tëherë.»

Derën e hapi korrieri, Hyska.

— Moj! Mos roite ti, që troket kaq fort?! — tha ai.

— A erdhi shoku Mystehak? — pyeti ajo.

— Jo, moj shoqja Dritëzë, jo! — tha Hyska. — E ç'do të kërkojë në zyrë kaq herët shoku Mystehak? Shokët drejtues vijnë vetëm në mbrëmje!

— Po unë si të bëj?

— Ku ta di unë i gjori? Megjithëse shoku Mystehak më thotë gjithnjë «ti je i brendshëm dhe mund t'i japësh xhevap popullit», a e ha unë atë kokërr ulliri dhe të jap urdhëra? Nuk e ha! — qeshi plaku me gojën pa dhëmbë.

— Unë nuk e mbyll kopshtin, more vesh? — ju shkreh ajo.

— Po ç'më shkarkon hajvanët mua ti, ë? — tha ai.

— Pastaj në daç mbaje edhe të hapur, po s'ka për të sjellë njeri fëmijë se unë lajmërova derë më derë që kopshti do të mbyllet.

Vajza mbeti në mes të hapësirës së derës. Plaku vuri re se si ju dëshpëruan sytë e mëdhenj bojë kafe dhe i erdhi keq.

— Po të duash, eja e më ndihmo mua që të arnojmë dokun e derës — tha ai. — Se, ke parë ti që nuk e fus dot më perin në gjilpërë? Pse, thua ti? Ja, ndofta sepse jam pak zaif që pardje, nga dasma, apo jo?

— Po, po! S'ka pse të jetë ndryshe! — tha ajo.

Vajza futi perin në veshin e madh të gjilpërës dhe ni-

si të qepte dokun e bërë vrimë. Plaku futi dru në zjarr dhe u çakarit pas tij.

— Eh! Kishim zyrë më të mirë atëhere, para bashkimit! Ku je ti? Pa na e veshi derën me pallto të madhe prej pambuku shoku Mystehak, dhe na e bëri si të zyrave të rënda. Mund të grindeshe tërë ditën dhe jashtë s'dëgjohej asgjë! Kurse tani u ngushtuam se na futën këtu edhe Fuzuliun. Po gjene dera s'duhet lënë pasdore, apo jo? Se, na janë vardisur ca qerrata minj xanxarë dhe na e bënë pallton shoshë më dhëmbë. E shpuan në katër vende. Rëndin pas farave të pambukut, firaunët! Lëre më, ç'u piperos shoku Mystehak! Ma hidhte fajin mua, sikur unë i paskështa urdhëruar ata firaunë! Inati inat, po minjtë duhen ksebërë ama! Vura grackë dhe zura tre miushë të vegjël... pastaj ehë... s'afrohej më asnjë! Edhe mua s'ma donte mendja që ta kishin ngrënë vetëm ata firaunë, po, ngaqë nuk zija dot të tjerë, i dhashë karar që ata e kishin ngrënë. Po kryetari s'më besoi. Mor po betohu e stërbetohu unë që tamam ata na e kishin ngrënë derën, pse e hante ai a? Pa, ja prishte mendjen edhe Fuzuliu, se i thosh që pallton e derës na e hëngrën prindërit e miushëve. Tollovi e madhe, ç'të të them! Pastaj ata hapën edhe një vrimë tjetër dhe Mystehaku më urdhëroi prerë: «Të arnohet dera!» më tha.

— A nuk e le ta hanë të gjithë? — tha ajo.

— Pse?

— Ç'i duhet Mystehakut kjo derë me pallto, ë?

— Pa të të them! — dyshoi Hyska. — Ajo ka për të ngjarë, se ka akoma fara pambuku!

Ajo doli nga zyra dhe hyri përsëri në dhomën ku kishte qenë kopshti i fëmijëve. Dhoma ju duk e shkretë dhe e vjetëruar menjëherë. Jashtë, dielli ishte i butë. Dhen-të shullësheshin në shurigë. Ugaret e vjeshtës shfrynin avuj të kaltër. Tre harabelë çukisnin elb nën strehët e depos së drithit. Ishte janar, po moti mbante ngrohtë. «Këtu te ne nuk vjen dimri fare!» — mendoi ajo kot së koti. Dhe mëngjezi ju duk i tejdukshëm. Dhe pse ishte ky mëngjez kaq i kthjellët dhe drurët kaq të heshtur, asaj i vegoi diçka e trishtuar. Diçka që kishte dashur ta harronte. Por

s'kishte mundur. Ky trishtim i vinte atëhere kur asgjë-kundi s'kishte zhurma dhe zëra. Vegimi i atyre ditëve të shkuara bridhte atëhere drejt saj. Pse kishte ndodhur gjithshka ashtu vallë? A s'mund të ndodhte ndryshe? Dhe të mos kishte kurrë një trishtim të tillë, të mos kishte asnjë kujtim të tillë të dhimbshëm? Apo ndofta, kur të piqeshin gruroret përsëri, dhe të vinin që larg nga fushat e Devollit autokombajnat, atëhere... Jo, ai s'kishte për të ardhur më! Sa larg mbetën ato ditë! Sa larg! Dhe, s'kishte shkuar as një vit që kishte qenë ai këtu! Vitin e shkuar, në verë. Kopshti i fëmijëve gumëzhinte. Kopshti ishte i vogël për atë tufë fëmijësh, po ajo i shetiste livadheve e jonxhave të posakorrura. Mëngjezeve rrinte mbështetur në dritare, ja kështu siç rrinte tani, dhe priste. Faqet i digjnin zjarr, aq shumë i digjnin, sa ajo i mbulonte me pëllëmbë dhe s'guxonte t'i hiqte ato sepse të gjithë do t'i thoshin «pse je skuqur kështu?»

Jashtë frynte furshullimë erë dhe në pemtoret karshi pikonin mollë. Sytë i bridhnin tinëz në gjelbërimin e dendur të manaferrave. Ato ishin të pleksura si flokë dhe shtegu ishte gjithnjë nën hije. Ky shteg ishte si një vend i fshehtë, i mbushur me një mister të pakuptueshëm, që ja jepnin hijet, manaferrat, heshtja. Nëpër shteg pëshpërisnin vetëm gjethet dhe ajo priste që pëshpëritja e tyre të trembej nga disa hapa. Sa mirë është kur pret! Dhe kur dëgjon se si një qyqe numron diku larg vitet! Vitet apo minutat numronte ajo qyqe ashtu? Ajo numronte minutat derisa të vinte një çast që heshtja e fletëve të dridhej nga tingujt e një zileje. Dhe dridheshin fletët apo dridhej diçka brenda saj? Ajo bënte sikur vërente drurët e kopshtit ku pikonin mollë. Kurse ai dukej si diçka e bardhë dhe e lëvizshme nëpër fletët e gjelbëra. Biçikletën e ngiste pa duar dhe bënte sikur kopsiste kopsat e këmishës. S'thoshte asgjë. Ngrinte dorën lart. Edhe ajo s'thoshte asgjë. Njëherë ai i tha: «A i mblodhe zogjtë?» — dhe kjo ju duk për të qeshur.

Por... pse mbaruan aq shpejt ato ditë vallë?

Një ditë tjetër, ajo kishte dalë e shetiste kot më kot nëpër atë shtegun e fshehtë. Ai erdhi pa zhurmë dhe befas

i tha: «Pse ke dalë sot këtu?» «Kot! — tha ajo — po ti, pse kalon këtu?» «Kot! — tha ai: — Më pëlqen bari i mezhdave!»... pastaj heshtën. Pastaj u dëgjua një zhurmë. Atyre ju bë se këto ishin zëra të mbytur. Ai u skuq dhe tha: «Shiko!.. unë doja të të thosha që... apo nuk e ke kuptuar?...» — Dhe mbështeti dorën që të qetësonte dridhjet e supeve të saj. Por zërat e mbytur të njerëzve befasisht u afruan dhe ai kishte ikur. Pastaj e kishte thirrur Mystehaku në zyrë dhe i kishte thënë ato fjalë lëmshe, pa kuptim. Kurse ai, kombajneri i ardhur nga fushat e Devollit, ishte zhdukur papritur. Thoshin që e transferuan në një kooperativë tjetër. Kishte shkuar, dhe ajo nuk i kishte thënë dot asgjë. Dhe i kishte mbetur tani pritja dhe trishtimi. Përse i kujtoheshin tani gjithë këto ndodhi të verës së shkuar? O! Fajin e kishte prapë ai Mystehaku dhe fjalët e tij çapraz për hallkat!

Por sot ajo ishte e vendosur që ta kundërshtonte. Kishte kundërshtuar edhe pardje, por sot i dukej se nuk i kishte thënë të gjitha ato që duhej të thoshte. Ishte më e tronditur pardje. Kur kishte hyrë në zyrë, s'kishte parë asgjë. Fytyrat e atyre që ishin brenda ju dukën të veshura me tymin bojëhiri të duhanit. Askush nuk ja vuri veshin. Mystehaku bisedonte me këmbë e me duar me Fuzuliuin. Xha Hyska i frynte zjarrit që nuk donte të ndizej. Të gjithëve u qanin sytë nga tymi.

— Për ideal! Ç'mendje pjellore kjo që më dhatë tani, shoku Mystehak — tha Fuzuliu. — Muzeum dëshironi? Muzeum ju bëjmë edhe ne! Dhomën e kemi. Muzeumi ka edhe një të mirë të madhe që s'të do as soba dhe as dru, si kopshti i fëmijëve. Sos do të ngrijnë fotografitë? I fusim derës edhe një çelës «Tutius» dhe pastaj... he... të na bëjnë veshët rehat njëherë e mirë, se na shurdhuan kalamajtë e Dritës!

Mystehaku buzëqeshi dhe dikujt i shkeli syrin.

— U vendos! — tha ai.

«Po këta si e kanë hallin? Mos do ta bëjnë muzeum kopshtin tim? — mendoi ajo. — Për këtë të më kenë thirrur?»

Ajo mbajti vesh bisedën e Fuzuliu me Mystehakun.

Por ata nuk e zunë më në gojë atë fjalë dhe filluan të bisedonin për agronomin e kooperativës i cili, sipas Fuzuliu, e përdorte motocikletën për qëllime personale.

— Po ky zjarr i mallëkuar, tërë dimrin këto avaze do të bëjë, or Hyskë? — u ankua Mystehaku dhe hapi dritaren. Ajri i ftohtë hyri me vrull dhe i fshikulloi ata që ishin brenda.

— I kemi drutë të lagura. Pa edhe oxhaku nuk heq më, se do fshirë bloza! — tha Hyska.

— Ç'blozë, more!? — tha Fuzuliu. — E kanë fajin qyngjet! Janë djegur fare, po ku të dëgjon shefi ynë në qendër për të blerë të tjera!

— Vjet i blemë! Kur u dogjën? — tha Hyska. — Për mua fajin e ka bloza dhe prandaj duhet t'ja vemë njëherë zjarrin oxhakut që të digjet!

— Oj, mendje! — tha Fuzuliu. — Ti dashke që të na marrin trarët dhe të digjemi megjithsej!

— Mystehaku e mbylli dritaren, sepse siç duket po mër-dhihte. Nxori nga xhepi një shami të madhe, të kuqe dhe fshiu lotët. Sytë i kishte kuq gjak, si prej qeni të tërbuar. «Edhe mbrëmë kështu i kishte sytë ky — ju kujtua asaj. — Ishte në krye të tavolinës së madhe, në dasmën e Shefkiut, dhe i shtinte raki në gurmaz Hyskës. Hyska ishte bërë çakërcejf dhe ngrinte dolli pas dollie: Për zyrën tonë, thoshte! Për kryetar Mystehakun një, për Fuzuliuin dy dhe për mua tre, që jemi trekendëshi revolucionar!»

Mystehaku mori receptorin e telefonit dhe nisi të vërtite me vrull dorezën.

— È!.. — ju drejtua papritur ai. — Sa fëmijë mblodhe sot në koshere?

— Tre! — tha ajo.

— Pak! — tha Fuzuliu. — Kopësht është ky?

— Epo ne, si kryesi, e kemi bërë punën tonë, që ta dish! — tha Mystehaku. — Porsa na vure në dijeni që njerëzia nuk po i sjellin kalamajtë në kopsht, e dërguam Hyskën derë më derë dhe u bëmë nga një paralajmërim. Apo jo, Hyskë?

— Posi, posi! — tha Hyska.

— Kanë të drejtë që nuk dërgojnë më fëmijë — tha

ajo. — Ç'na keni dhënë ju për kopshtin? Një sobë të grisur që bën tym, dru të lagura e të paprera, le më për lodra që s'i kemi parë me sy kurrë!

— Oj! Lodra thotë! — tha Fuzuliu. — Shiko, shiko! Pse, moj, në qytet jemi këtu? S'ka faj kjo, shoku Mystehak, kemi faj ne që e dërguam në qytet të hapte sytë nëpër kopshtet e qeverisë! Po a merr vesh ti nga ekonomia kooperativiste, moj? Leshtë, di! Edhe kështu, kopshti na kushton goxha!

— Ç'na qahesh për drutë edhe ti! — tha Mystehaku! — Ja ku e ke një sërë të panisur aty, merre sëpatën dhe preji! Le që këto bishtra ti i sajon vetë, se asnjëri nga fshati nuk është ankuar tek unë! Apo jo, mor Hyskë? Të kanë thënë gjë ty, kur bëre paralajmërimin?

— Xhanëm... njerëzia këtu e kanë gojën shumë të lagur dhe s'dinë gjë tjetër veçse të ankohen, shoku Mystehak! — tha Hyska.

— Ashtu ë? — tha Mystehaku. — A nuk i mëshon ca kësaj ziles së telefonit ti, shoku Hyskë! Dhe mos e ndërpre derisa të zgjohet nga gjumi ai kungulli i qendrës!

— Për ideal, ai çentralist do pushuar, shoku Mystehak. Ngrijeni në kryesi çështjen e tij! Oj! Ai sikur s'bën detyrën, po antidetyrën — tha Fuzuliu.

Hyska zuri ta vërtitë dorezën ngadalë, sikur e kishte dorën të tharë e të fishkur. Mystehaku, sikur posa i kishte dhënë dum një mendim të gjatë e të rëndësishëm, tha:

— Kështu, moj shoqja Drita. Kalamajtë s'vijjnë! Domethënë, s'vijjnë! Kur s'vijjnë, s'vijjnë, dihet ajo!

— Ne si kryesi detyrën tonë e bëmë deri më qimet. Apo jo, shoku Mystehak? — tha Fuzuliu.

— Dhe tani ti, çupë... — tha Mystehaku.

Por, po atë çast Hyska bëri një shenjë alarmi që thoshte se çentrali po përgjigjej dhe Mystehaku vuri gishtin e trashë mbi buzë e urdhëroi heshtjen të vinte. Dhe i bëri pastaj një shenjë me dorë Fuzuliu. Shenja thoshte: «Mer ru ti tani me çështjen e saj!». Fuzuliu u ngrit rëndë-rëndë, i afroi një karrige e i tha të ulej. Tani ajo i kishte kthyer shpinën zjarrit dhe tryezës së Mystehakut dhe kishte përpara fytyrën gjatuke, me një mjekër të vogël si të

shpifur dhe me dhëmbë kataroshë të Fuzuliut. Mystehaku po grindej me dikë në telefon dhe ajo s'dinte ç'të dëgjon-te më parë, Mystehakun apo fjalët e nxituara të Fuzuliut që derdheshin si një grusht me arra në dysheme. Në fillim ju turbullua mendja, po më pas ja doli t'i dëgjon-te të dyja bisedat, sepse Fuzuliut pothuajse nuk ja vinte më veshin. E kuptoi menjëherë ç'kërkonin prej saj.

(— Alo! Shoku Seit? Po unë, Mystehaku jam! Ç'kemi këtej nga ne? Këtej çdo gjë është në rregull. Të mora për një çështje tjetër, mjaft të rëndësishme. Po, po. Me rëndësi, pa dyshim. Alo!)

— A e more vesh tani? — i tha Fuzuliu asaj. — Jo se duam ne, po, hë! Nga halli! Meqë s'vjen asnjë fëmijë, ç'ta mbajmë hapur kopshtin kot më kot? Pastaj edhe ty nuk të leverdis fare, sepse është vendosur që ditët e punës të të jepen sipas numrit të fëmijëve që vijnë në kopësht!

— Unë nuk e kam hallin te ditët e punës, jo! Unë s'dua që ju ta mbyllni kopshtin, sepse fëmijët kanë dëshirë të vijnë në të. Ju duhet ta pajisni siç duhet, pastaj shohim në vijnë apo s'vijnë. Po ju e lini më ditë të hallit! Dhe unë do të ankohem për këtë!

— A? Po pse të ankoheni? Dhe ku? Gjene te ne do të ankoheni! Si nuk e kupton dot kaq gjë të thjeshtë? Janë hallka këto, siç thotë edhe shoku Mystehak! Ti ankohesh diku, lart, po ata s'dinë gjë se si qëndron puna poshtë dhe në ke të drejtë apo jo! Prandaj ata lart pyesin bazën. Si është puna e filanit? Po kush është baza? Gjene shoku Mystehak është! E shikon se si janë pleksur çështjet?

— Ja, ashtu si shtogu me kulprën, në oborrin tonë! — tha Hyska që kishte mbështetur mjekrën e parruar në grusht dhe dukej sikur dremiste. Kemi një shtog e një kulpër ne në oborrin e zyrave, po aq keq i ka hipur kulpra shtogut, sa s'duket më as kulpër, as shtog!

— Ore ti! — u ankua me zë të hollë Fuzuliu. — Ç'na mollois gjepura tanithi? Bre! Të kishe qenë ti në udhëheqje, belanë do gjenin njerëzia, se s'do të të merrnin vesh dot!

— Pse?

— Se e hedh llafin degë më degë!

(— Alo! Po! Është një Shezai Kodrasi në qytet. E di që nuk e njihni. Njeri pa rëndësi. Unë ta ngas fjalën, shoku Seit, që është e mira të merret edhe opinioni ynë, i fshatit. Përse jemi ne këtu, për të ruajtur dhitë? E dinë apo nuk e dinë ata shokë orixhinën e njeriut? Jo, jo, e ngas llafin tek orixhina unë! Alo?!)

— ...kurse po të vazhdosh ta mbash hapur kopshtin me kokën tënde, siç po më thua, ti do të bësh antidetyrën... Mos u çudit, se kjo është dialektike! Të duket sikur bën mirë, kur... hop, të del keq!

— Si puna e atij që vajti për lesh dhe u kthye i qethur — tha Hyska.

(— Alo! Transferohet i biri i botës në Tiranë, dhe ne si fshat s'dimë asgjë! Kush është ky? I nipi i Shezai Kodrasit. Po, ai inxhinieri. Ku e njoh unë inxhinierin? Nuk njoh atë, po njoh xhaxhanë e tij unë! Njoh Shezai-un! A e dinë ata që e transferojnë se xhaxhai i tij ka qenë me ballin? Po! ka qenë nja dy muaj! Alo!..)

— Ju e keni kot, se unë nuk e mbyll kopshtin dhe çdo ditë do të vij ta hap!

— Po ditët e punës kush do të t'i shënojë? Asnjeri nuk do të t'i shënoj, sepse me llogarinë merrem unë këtu!

— Le të mos i shënojnë!

— Po kjo është thyerje urdhëri! — tha me një habi të singhtë Fuzuliu. — Si u bëka kështu?

(— Alo!.. ju thoni që ata shokë po ju informojnë se Shezaiu ishte i gënjyer dhe pastaj kaloi me partizanët? E di, xhanëm, e di! Po fundja pse të gënjehej? Ne, pse s'u gënjem? Jo, unë e ngas fjalën që për këto gjëra duhet të pyetemi edhe ne! Alo!..)

— Oi!.. — psherëtiu Fuzuliu. — Si të bëjë njeriu me ty?

— Në rregull — tha Mystehaku! — dhe vuri receptorin në vend, me zhurmë. — Po ju?..

— Xhanëm... unë ja komunikova — tha Fuzuliu. — Por kjo... — dhe bëri një gjest mërzie.

— Kjo u vendos! — tha ai. — Hyskë! Dil edhe një herë nesër derë më derë! Për arësye madhore, thua, kop-shti i fëmijëve mbyllet. Fëmijë mos sjellë asnjeri!

— Si urdhëron! — tha Hyska. — A dëgjove ti, Fuzuli... Që mos rrëzoj këmbët deri te ti, ja ku po ta them që tani: «për arësye madhore, kopshti do të...»

— Ikë, djall me brirë — ja dha gazit Mystehaku. — Gremisu! Vdeksh duke qeshur, jalla!

Dolën jashtë. Mystehaku e përcolli. Mëma e Dritës e kishte Mystehakun fis të largët dhe tani, jashtë zyre ai e trajtonte sikur hanin në një çanak.

— Unë do të lajmëroj në qendër! — tha ajo.

— Rri edhe ti, ç'na hap avaze tani! — tha ai. — Hë... se në pranverë do ta hapim prapë dhe ty do të të vemë kujdestare. Ne jemi edhe tanët, të shkretën! Dëgjomë mua! Kur të kanë dalë për keq këshillat e mia? Mban mend ç'të thashë atëhere, verës së shkuar? Hë... qerratuçe! Ti nuk i di të gjitha, jo! Se, si shumë dendur voziste këtej nga kopshti ai kombajneri devolli, apo jo? Ç'ne të shkonte nëpër këtë tragë të harruar ai, kur kishte xhadenë? Vagabond i madh ishte, qeni! Unë të thashë: «A! Mos i kapërce hallkat e moralit të fshatit tonë!» — Dhe ti u skuqe! U skuqe si piperkë! Përderisa u skuqe, të dogji një gjë. Derisa të dogji, domëthënë kishte një zjarr! I rashë pikës! Po të mos isha unë, puna do të trashej. Pastaj, një t'i futur edhe atij një raport në brigadë: na e hiqni, thashë, se është vagabond i madh! Po i kapërcen hallkat e shëndosha! Dhe hë... ja ngritën rraquet! Oj, vjen tjetri nga anë e anës dhe fut hundët...

Ecnin në po atë shteg. Në po atë shteg ku një ditë ajo e kishte takuar rastësisht. Vetëm se atëhere porsa ishte gdhirë, kurse tani është mbrëmje. Atëhere pikonin mollët. Shushurinin manaferrat... Dhe ai i kishte vënë dorën në sup... Por sonte, është natë e errët. Manaferrat i kanë kalbur fletët dhe skeletet e kapërthyera të degëve të mollëve nxijnë. Ishte natë dhe Mystehaku mundohej më kot ta ndriste baltën e shtegut të shkruar nga këmbët e dhenve me një fener elektrik, sepse bateritë e tij pothuajse ishin mbaruar.

Dhe asaj i rrodhi trishtimi i kripur nëpër sytë, nëpër faqet... Mystehaku s'mund ta shihte këtë. Ai llomotiti papushim deri te porta. Ajo hyri brenda nxituar dhe i vuri

llozin portës. Pastaj, dy ditë rrjesht, e hapi kopshtin nga inati i tyre. S'erdhi asnjë fëmijë. Ditën tjetër, mblodhi vetë nja katër kalamaj. Kërkoi Mystehakun dhe Fuzuliun për të biseduar, po më kot, se ata se ku kishin shkuar në disa mbledhje të rëndësishme. Pas dy ditësh erdhi Fuzuliu. Ai mundohej të bërtiste e ta trembte, prandaj e vërviste qafën lart dhe e përdridhte si gjel. Po kjo gjë s'i kishte fare lezet. Megjithatë, të nesërmen ai i vuri kopshtit një çelës «Tutius».

Nga fundi i shkurtit atë e thirrën edhe një herë në zyrë. Ajo nuk e merrte dot me mend se përse mund ta kërkonin tani që kopshtin e kishin mbyllur. Aty kishin vënë dy stenda me fotografi të prera nga albumet dhe thoshin që do ta pasuronin avash-avash, derisa të bëhej muzeum.

Në zyrë kishte tym si përherë dhe përveç Mystehakut dhe Hyskës ishte edhe Zylfua i çative.

— Që të ta ngas fjalën më tej, or ti Zylfo, dua të më thuash a e di ti që kooperativa ka vendime apo s'e di?

— Ka, si urdhëron, shoku kryetar — tha Zylfua.

— Po statut dhe rregulla ka apo s'ka?

— Ka, si urdhëron, shoku kryetar!

— Po që ti je bërë tani si ai gomari që u mësua të hajë pollogjet e grurit e di apo s'e di? Po këtu i thonë kooperativë, domethënë qeveri dhe mua ç'ç' s'më duket vetja si pollog, po më thonë Mystehak!

— Ç'është ajo, shoku Mysto? — u tremb Zylfua.

— A e di ti, mor Zylfo, se ç'i bëjnë gomarit që mësohet të hajë pollogjet? E lidhin pas një huri në shurigë, ku s'ka ç'të lëpijë e jo më të hajë, përveç shurit, dhe e lënë aty që ta hanë mizat! Ja kështu!

— Ja kështu! — tha Zylfua.

— Larg qoftë! — tha Hyska.

— Po ti nuk e di, jo! Se, po ta dije, nuk do më livadhishje tërë janarin majë çative të fshatit duke zënë pikat, si privat!

— Ja kështu! Si të thoni ju, shoku kryetar! Bëj otokritikë! Në dorë tënde jam!

— Dhe të allahut! — ja ktheu Hyska.

— Lere atë allahun tani! — tha Mystehaku.

Ajo nuk e mbante dot të qeshurën. Por këtu ishte zyrë dhe e qeshura nuk lejohej. Mori një revistë nga tryeza e Fuzuliut dhe e fshehu fytyrën prapa saj. Hyska ja mori një kënge me hundë:

«O borzilok!.. o borzilok, ore të keqenë!..»

— Kryesia e madhe, andej nga qendra e kooperativës, kishte marrë një vendim të rëndë për ty. Do të të priste furnizimin me bukë nga furra. Ja kështu! Shko e kullot çative tani, po të duash! Privat ti! — tha Mystehaku.

— Bre!.. — u merakos Zylfua. — Ç'më thua? Bukën?

— Mirë që s'të prenë tjetër gjë! — tha Hyska.

— Ç'gjë?

— Lere, lere... — tha Hyska — se do më hipë zevzekllëku!

— Ty dhe ca të tjerëve, që s'bëjnë as minimumin e ditëve të punës, mirë t'jua bëjnë — tha Mystehaku dhe pa vëngër nga Drita. Po ajo shejtanja e kishte fshehur fytyrën prapa revistës dhe hiqej sikur s'dëgjonte gjë fare.

«Hë... e nuhati përse e kam thirrur, shejtanja, e nuhati — mendoi Mystua. — Mor po thuaj si të duash, dajakut i vjen era që larg! Vetëm mos ja shkrepë ndonjë të qari, se me këto femrat s'dihet dot se ç'ndodh. Ja, edhe ky hajvani, Zylfua, shiko si qenka vrerosur, i ziu!»

— Nejse, mos u vrëjt ashtu! — tha ai. — Ne kryesia e vogël këtu po ta falim edhe këtë herë. — Dhe goditi gjoksin e vet me grusht.

— Rrofshi, jalla!

— Dhe tani shtrohu në punë! Ashtu, me vrull dhe me forca të shumëfishuara! Dhe të mos dëgjoj më asgjë për ty! Pa shih ç'kohë e mirë po na mban! Kjo kohë të përtërin, more! Veri gjoksin kooperativës!

Zylfua rراسi në kokë një takije tërë blozë dhe doli jashtë. Hyska nxori orën e xhepit që e mbante varur me një gjalm të trashë prej gajtani.

— Vajti gjashtë? — pyeti Mystehaku.

— Do edhe dhjetë!

— S'paskemi nge! Më gjashtë bisedojmë me qendrën. Ti nis e bjeri ziles se, sa t'i vejë zëri atij, vete edhe ora.

Mystehaku u shtriq dhe krisi koskat. Dukej i lodhur.

— Tëmën! — tha. — Ja edhe Zylfon e vumë në udhë.

Puna me njeriun është gjë e rëndë! E kanë thënë klasikët. Është shkencë kanë thënë. Hajde de, kur ke të bësh me Zylfon që është dingë me mbeturina, po me ty që je rini, si të bësh?

— Po me mua ç'keni? — tha ajo.

— Shiko... shiko! Bën sikur s'dëgjon, bën sikur s'kupton! — tha ai me djallëzi. — Po ama edhe ti në një kallëp je, me Zylfon! Se, sa ditë ke futur në fund të janarit a s'më thua?

— E di! — tha ajo — e di; por...

— Hiç! Mos thuaj gjë, se do të ta marr për justifikim. Bëj autokritikë dhe mbathja këmbëve se u bë natë!

Hyska hyri me një krahë dru dhe i plasi në dysheme. Dyshemeja buçiti.

— Po s'ngule ditë — pune ti që je rini, kush do të ngulë, Hyska?

— Unë isha në kopësht në janar. Fuzuliu i llogariti ditët e punës sipas numrit të fëmijëve. Ç'faj kam unë? Bile pesë ditët e fundit që e mbajta kopshtin hapur ai nuk m'i llogariti fare!

— Leri ato tani dhe thuaje autokritikën, se s'kemi nge!

— Autokritikë të bësh vetë! — tha ajo me rrëmbim. I kishte hipur një inat e një mërzi e tillë që s'mund të mbahej. — Po, po! Mos ma prit fjalën! Ju e latë kopshtin në ditë të zezë! Pa zjarr, pa lodra! Pse të vinin fëmijët aty? I kam thënë Fuzuliu atë natë, i kam thënë që unë nuk e pranoj vendimin për mbylljen e kopshtit dhe që do ta mbaj kopshtin hapur! Dhe e mbajta! Dhe ju s'më dhate ditë-pune! Mirë, unë s'kërkova ditë-pune, po tani ç'më kërkon llogari për janarin?

— Oj! — ja bëri Mystehaku dhe u vrejti. «I kam thënë Fuzuliu?» më thotë! Ç'më fshihesh pas tij tani, apo do të përfitosh ngaqë Fuzuliuun s'e kemi këtu se e kemi dër-

guar në kurs? A, qerratuçe! Po kujt? Mystehakut ti? Ty s'të falet që ke ngulur vetëm shtatë ditë! Pikë! Po e bërë edhe një herë, unë të pres bukën! Dëgjovje? Dëgjova thuaj! Kam edhe Hyskën shahit që ta kam thënë këtë gjë, se ju ta bëni të bardhën të zezë nesër!

— Ju, shoku Mystehak, s'qenkeni në terezi sonte! — tha ajo. — Po a e dini ju se sa ditë kam bërë unë në qilizëm gjatë shkurtit?

— Lere shkurtin ti! Kryesia mori në shqyrtim ditë-punët e janarit. Kur të vijë puna për shkurtin, mund të të lavdërojmë! Kështu e kanë këto punë! Sot të bien më stap, nesër të bien me trëndafilë!

Ajo u kthye me rrëmbim dhe doli jashtë, duke përplasur derën.

— Le, po përplas derën! — tha ai. — Do më shohë!

Mystehaku u nxeh dhe bëri të brofte pas saj, po atë çast ra zilja e telefonit. Pastaj telefoni u ndërpre dhe, pasi u grind një copë herë me dikë që s'ishte askund, ai ju afrua zjarrit.

— Ore! Pa shiko aty në pasqyrat e Fuzuliut, sa ditë-pune ka bërë në shkurt ajo, që na mburrej ashtu? — tha ai.

— Tridhjetë e dy! — tha Hyska.

— Ja!.. — tha ai dhe heshti.

Ishte ngrohtë.

— The gjë ti? — pyeti Mystehaku.

— Hiç! — tha Hyska

— Po ti, pse më rri si hu? Pse s'flisje qëparë?

— Bah! — u habit Hyska. — Pa ç'nge kam unë që t'i kapërcej ato të shuara... si u thonë!

— Ç'llomotit ashtu, more?

— Ç'të këndojë pula e gjorë aty ku ja thotë gjeli, o shoku kryetar? Ashtu do t'i kapërcejja dhe ato të shuara hallka!

Mystehaku u mendua një copë herë.

— Po ti s'je hu gardhi këtu! — tha. — Ti je i brendshëm, kupton? Paçka se je korrier! Ti duhet t'i bëhesh furkë fjalës sime, se ashtu u mbushet mendja më shpejt njerëzve. Ti je zëri i masës këtu!..

«Hm... — dyshoi Hyska me vete. — E ç'i brendshëm jam unë, kur s'kam as tryezë në këtë zyrë?»

Një mbrëmje tjetër të po atij dimri, Mystehaku e thirri Dritën me ngutësi në zyrë. Ajo po vonohej të vinte. Mystehakut i dridhej mjekra sikur e kishin zënë tri palë ethe. Fytyra e verdhë e Fuzuliu ishte fshehur në errësirën e qoshes së dhomës dhe s'thoshte asgjë. Ishte ngrysur.

O! Këtë herë ishte mbushur kupa! Ishte mbushur dhe po derdhej! Jashtë frynte erë dhe pori kthente tym si gjithnjë.

— Prapë këto të mallëkuara qyngje? Prapë? — tha Mystehaku. — Nuk i fshive, që nuk i fshive!

— I fshiva, po nuk e kanë fajin ato! Duhet djegur bloza e oxhakut!

— Ç'blozë, more!? — tha Fuzuliu. — Po sikur, allasëndek, të marrë zjarr godina, kush përgjigjet? Ne me shokun Mystehak përgjigjemi! Kurse ti ve festen mënjanë! Duhet blërë qyngje të tjera, thuaj!

— Bloza... bloza!.. — nguli këmbë Hyska.

Qetësi. Fuzuliu zunë t'i qanin sytë, po nuk u ankua.

— Na mbyti! — u ankua Mystehaku. — Na mbyti dhe na qorroi dhe do bëhemi sakatë prej këtij tymi!

Qetësi. Një furrtare e zezë dukej si e ngordhur brenda një pezhishke.

— Po kjo firaune... po kjo! — bubulloi tani Mystehaku. — Pse s'po e sjell kokën?

— Unë e lajmërova! — tha Hyska. — Po s'dihet, edhe s'vjen tjetra!

— Si nuk ardhka, kur urdhëron përgjegjësi? — u çudit Fuzuliu.

— E po!.. Rinia e sotme s'ta ka për pesë! — tha Hyska.

— Firaune! Ç'na bëri! — tha Mystehaku.

— Hajde de, sikur të kishte ndopak të drejtë! Po nuk ka fare, për ideal! — tha Fuzuliu.

— Rri, more derr, se edhe ti ke faj! — tha Mystehaku.
— Pse nuk ja rregullove ato ditët e janarit? Na dërgove në qendër vetëm shtatë ditë. Dhe ata pastaj më urdhërojnë mua ta thërres e t'i kërkoj hesap! Hënde de!..

Në shpirtin e trazuar si vorbull të Fuzuliu, u ngrit një valë kundërshtimi po ai më në fund e qetësoi. Se, ç'fitim mund të ketë njeriu kur s'di të përmbahet? Andaj Fuzuliu vendosi ta përmbante kundërshtimin ndonëse i dukej se Mystehaku i shkeli keq kallon!

— A e dini se ç'ndodhi njëherë? — tha Hyska. — Një nga ata djemtë e «Zërit...» lexoi në një gazetë të vogël sipo kjo e jona, një letër me ankesa për kryesinë. Pa po kumbisi një javë në atë fshat dhe më t'u vërviti pastaj një artikull, goxha!

— Ku? — tha Fuzuliu.

— Në «Zëri...» doemos!

— Hë more, se s'merret «Zëri...» me letrat e një firauneje! Këta të gazetës lokale çoku botojnë, se u japin porosi që duhet kritikë nga poshtë, dhe ata e marrin kallëp!

— Po që këtë herë na e bëri borxh ajo Drita, na e bëri! — tha Fuzuliu. — Dhe pse pa? Kot së koti! Ç'i bëtë ju, shoku Mystehak? E kritikuat kaqëzë! Do t'ja dijë njeriu me kaqëzë kritikë nga përgjegjësat? Kurse ajo...

— Ajo... ajo... firaune!

«O, borzilok!.. O borzilok, ore, të keqenë!» — ja mori shtruar Hyska.

— Do propozoj që ta pushojmë! — vendosi Mystehaku. — Në kopsht do të vemë Lulushen e Sabriut.

— Po atë sikur e pushuam vjet nga furra!? — tha Fuzuliu.

— E pushuam vjet, po do ta vemë sivjet! Ti ç'thua?

— Unë? — u çudit Hyska. — Bah! Po pse t'i kapërcej ato të shuara hallka?

— Po ti je i brendshëm! Sa herë të kam thënë!

— Unë them të mos e presim më. Ta mbyllim zyrën, të vemë në shtëpi, të pjekim patate dhe të thekemi. Ashtu dhe mendohemi ca më mirë. Nesër i vemë zjarrin oxhakut që të digjet bloza!

— Hajde, pykë, hajde! — tha Fuzuliu me tallje. — A ta marr qendrën në telefon, shoku Mystehak?

— Merre!

— Të kërkojmë aprovimin e tyre për pushim! — tha rreptë Fuzuliu dhe i shkëlqyen sytë. — A e di sepse? Sepse ajo ka fyer edhe qendrën! I ka kapërcyer të gjitha hallkat. Ja, më fal tani për fjalën, po le ta zëmë se ajo kishte të drejtë dhe ne e kishim gabim...

— Si the?.. — bërtiti Mystehaku.

— Më fal! Le ta zemë se është ashtu — thashë! — Atëhere, ç'të drejtë kishte ajo të vente e të ankohej deri në komitetin e partisë së rrethit? Pse nuk i mori të gjitha hallkat me radhë? kemi këtu në sektor sekretarin e partisë, shokun Zylgani, i cili s'ka dijani fare për këtë çështje, kemi në qendër kryetarin e kooperativës, shokun Fuat, kemi pastaj instruktorin e zonës, shefin e bujqësisë... ehu! Ane e ti deri në komitetin e partisë! Ë?

— Të pjell mendja ty! Telefonin! — tha prerë Mystehaku.

Hyska vërviti me përtesë dorezën dhe për çudi, centrali u përgjegj menjëherë. Mystehaku u ngrit, vuri njërën dorë në brez si për t'u mbështetur diku.

— Shoku Seit? Alo? Po! Mirë mbrëma! E lexuam, doemos! E po ç't'i bësh? Rini janë dhe mund të nxit... Posi, posi! Po edhe ata shokët e gazetës le ta verifikonin njëherë, se aty ka të njoma dhe të thata! Që e ka të drejtën e kritikës? Po si nuk e ka? Kush ja hëngri? Po jo ama t'i kapërcejë të gjitha hallkat kështu! Kemi centralizim apo s'kemi? Le të ankohej te ju më parë, jo drejt e në gazetë! Kështu cënohet edhe autoriteti juaj! Organet e bazës duhen vlerësuar! Sikur t'ja nisin të gjithë ashtu, ç'bëhet? Ka të dr..? A, jo! S'jam dakord! Edhe për atë çështjen e Shezaiut s'kam qenë dakord! Do t'i dalë tymi ndonjë ditë! Ç'menduam të bëjmë? Ne mendojmë ta pushojmë! Motivacioni? Po ja!.. «Nuk vlerëson organet e bazës...» — Është indisciplinim apo s'është ky? Do vini ju vetë? Bukuri! Ejani! Thoni edhe shokëve opinionin tonë! Të kujt, tonin? Po ja timin, të Fuzuliu... Jo, jo... organizatën nuk e kemi pyetur akoma! Hë, hë!! Natën e mirë!

— Ç'tha? — pyeti Hyska. — Mos i kemi kapërcyer edhe ne ato të shuara hallka?

Mystehaku e pa vëngër.

— Do të vijë vetë! — tha me solemnitet, sikur këtë s'e dinte askush. Mystehaku deshi të shtonte edhe diçka. Deshi të prishte edhe pak së mos po vinte ajo firaune! Po ajo nuk po vinte. Era e përplasi derën me forcë. Jashtë kishte filluar të qëmtonte dëborë.

E FSHEHTA

Për të fundit herë fishkëlloi fisha e trenit të mbrëmjes dhe në kornizën e dritares mbeti fytyra e saj e palëvizshme, ku flisnin vetëm dy sy të zmadhuar nga kuresh-tja dhe nga habia. Atij ju dukën sytë e saj të përlotur e të ndritshëm, si të fshehur pas perdes së një lëngu të blertë. Lëngu i syve dridhej nga lumturia.

«Sa kënaqësi është ta bësh një njeri të lumtur! — mendio ai. — Sa kënaqësi është ta dish se je ti ai që ke mbuluar hutimin e pasigurinë e vjetër të syve me lëngun e dridhshëm të lumturisë!..»

Mbi platformën e stacionit era e vakët e natës që po-sa u shtrua përdhe mbi betonin dhe mbi kokat e lakrave të bostaneve, mblodhi nëpër shina letrat e ambalazhit të hedhura nga udhëtarët. Tensioni i rrjetit elektrik lëvizte dhe llambat me zhivë zbeheshin ose shkëlqenin. Një pas-truese doli që prapa kolonave dhe heshtja e platformës u çorr nga thuprat e gjata të fshesës. Ai vuri re se kishte mbetur i vetëm. Syri i kuq i fenerit që lajmëronte lëvizjen e trenave u mbyll dhe një njollë si bakër i ndryshkur mbeti varur në mugëtirë. Pastaj edhe njolla u tret dhe një fshesë tjetër nervoze nisi ta gërvishte betonin me këmbëngulje.

Mbrëmja dhe heshtja zbritën qetësisht, si një çift lej-lekësh dhe i sollën në shpirt një farë trishtimi të paprovuar kurrë më parë; një trishtim, në dallgët e të cilit trazohej e ngrihej shkumba e një ndjenje të re, të çuditshme, të

panjohur, ndjenjë pasigurie, ankthi, pritjeje, dyshimi...

Ai mendoi se ky ishte trishtimi i ndarjes.

I erdhën në mend disa vargje që i kishte lexuar dikur dhe që i ishin dukur të bukura. Ai i kishte të shkruar ato në blokun e shënimeve me kapak lëkure. Këtë blok e kishte pasur qëkur ishte student dhe në të shënonte vetëm adresat e miqve, numrat e telefonave dhe ndonjë citat të filozofëve të vjetër. Vargjet ishin: «Fllad, pranverë, shelgje, dritë hëne...» «Shpirti çel e ndjell vrulle çapkëne!» Emrin e poetit nuk e kishte shënuar. Ai duhej të kishte qenë poet i panjohur mirë. Vargjet ishin nën një citat të Ciceronit që thoshte: «Mosbesimi, është urtësia e budallait!»

Vargjet ju kujtuan sepse ai s'dinte si ta shpjegonte gjendjen e tij të re shpirtërore dhe ju duk se ato ishin tamam për ato ndjenja që provonte ai. Vetëm se dyshonte në mund të thuhej tani, pas së tretës dekadë të jetës së tij, që vrullet e shpirtit ishin «çapkëne!»

Shetitorja e gjerë «Marsel Kashen» kishte pak kalimtarë. Kundërmonin diku lulet e blirëve. Hijet e dendura të drurëve të trotuarit, nëpër të cilat shkisinin vija të verdha drite, shelgjet lotuese, freskia e zakonshme e mbrëmjeve të verës në Tiranë, heshtja, nata... të gjitha së bashku thurnin qerthullin e një pritjeje të fshehtë, ku ishte futur vetëvetiu edhe ai, që atë mbrëmje kur ishte fejuar. A mund të ishte e vërtetë vallë që fejesa e tij kishte më të bukur të papriturën dhe fshehtësinë e së panjohurës?..

«Në sytë e saj të mëdhenj, dridheshin lot lumturie» — mendoi ai përsëri dhe vetja ju duk pak a shumë poet. Shtrëngoi kombin e kravatës që ishte liruar. Pastaj ai tha me vete se ishte ende herët për të shkuar në shtëpi, veç asaj atë natë televizori s'kishte asnjë program interesant dhe u kthye. Nuk pa asnjë të njohur në kalimtarët e rrallë. Në parkun «Rinia» tryezat ishin të zëna. Ju duk ftohtë. Nga një tryezë afër orkestrinës dikush i bëri një shenjë me dorë. Sonte ai s'do të kishte pasur dëshirë të pinte pikërisht me Bekimin, po s'pat asnjë të njohur tjetër dhe duhej të ulej diku. Çdo i njohur, është më mirë se sa vetmia! Dhe vetmia më e madhe është kur ulesh në një tryezë dhe s'ke me kë ta trokasësh gotën. Ai u ul.

— Unë vij çdo mbrëmje në këtë bar! — tha Bekimi.
— Orkestrina e di gjithë repertorin e viteve 60.

— Vërtet? — pyeti ai kot së koti, sepse kjo gjë nuk i interesonte aspak.

— Po. Unë njoh kitaristin. Për hatrin tim, ata do të bëjnë gjithë repertorin e atyre viteve, kur ne ishim studentë.

— Nostalgji, asgjë tjetër! — tha ai.

— Ku ta dish? — tha Bekimi. — Ndjenjat nuk i emëron dot aq lehtë! Ndjenjat janë enigmat e njeriut! Ja, unë vij këtu qëkur fillon sezoni veror dhe nuk e di mirë përse vij! Po nganjëherë më duket se vij për të rijetuar kujtimet! Ty nuk të kujton asgjë ky lokal?

— Ç'të më kujtojë? — tha ai. — Ne kemi qenë në shumë lokale si ky.

— Për shembull... ajo natë!..

— Ehu!.. Sa net ka për të kujtuar njeriu!

— Por ajo natë!.. Ishte fantastike! Si është e mundur që nuk e kujton? Ne ishim të dy dhe bashkë me ne ishin edhe Dizi me Besën. Ishim shumë të shkujdesur, si gjithë të lumturit. Ti u pive dhe e puthe Dizin në sytë tanë!

— Bekim! — tha ai. — Unë u fejova. E dije?

— Jo! — tha ai dhe atij ju duk se kjo gjë nuk i bëri asnjë përshtypje atij tjetrit, me të cilin do të pinte në një tryezë.

«Ky vuan nga melankolia — mendoi. — Ose nga një kompleks i nostalgjisë për vitet e para të rinisë. Pse i tregova pikërisht këtij se pardje unë u fejova? Pse e solli rasti që nga gjithë shokët e mi, ky ta mësojë i pari këtë gjë?»

— Me Suzanën? — pyeti Bekimi, sikur posa ishte zgjuar nga një ëndërrim.

— Jo! Ç'Suzanë? — buzëqeshi ai. — Suzana është numër i djegur! Ajo është krejtësisht e panjohur për ju!

— Ah, djall i madh! — tha Bekimi. — E po?

— Çfarë?

— Trego!

— Më parë të pimë!

— Natyrisht. Ky është një rast që s'përsëritet dendur, apo jo?

— Që s'përsëritet më! — tha ai.

— Eh! U rralluan drurët në pyllin e beqarëve të moshës sonë dhe po mbetem qyqar! — tha Bekimi. — Gëzuar! Si thonë në këto raste? Një herë e me jetë! Kështu kam dëgjuar. Mirë. Hajde! Çoke këtu! Një herë e me jetë!

— Falem nderit! — belbëzoi ai.

Për herë të parë pas shumë vjetësh, ai vuri re se Bekimi i kishte sytë me dy ngjyra: njërin të blertë e tjetrin gri. Ky zbulim i bëri përshtypje. Përse e bëri pikërisht tani këtë zbulim?

Ishin sy të ftohtë, si një natë midis dimrit e pranverës, kur trazohen cikmat e papritura me ujërat e shkrirove!..

Bëri disa hamendje. Ose më parë nuk e kishte parë kurrë me vëmendje, ose e kishte harruar këtë hollësi, ose pikërisht tani që u fejua ju mprehën shqisat e vrojtimit dhe vëmendja! Një drej e di! Sidoqoftë, mbresa nuk ishte e këndshme. Dhe s'kishte më asnjë dëshirë që të fliste me këtë njeri me sy të ftohtë si netët, për të fejuarën e tij!

«Fundja, kjo është sjellje e pahijshme nga ai!.. — mendoj. — Ajo ai... ata të dy... dhe fejesa! Fejesa është diçka që më përket vetëm mua! Edhe ndjenjat e mia për të, më përkasin vetëm mua! Edhe vizioni i saj që është turbulluar paksa, diku në disa qoshe të miat, më përket vetëm mua! Pse s'mund ta përfytyroj krejtësisht fytyrën e saj, trupin, duart, lëvizjet? Pse kam një farë turbullire? Çudi! Sidoqoftë, sytë e saj... I kam këtu për-brenda! Sy të thellë, blu, nën kurorën e dendur e të zezë të flokëve. Gjë e rrallë! Sytë blu dhe kurora e zezë e flokëve... Në sa për qind të femrave mund të ndeshet kjo gjë? Hm!.. përqindje!.. Ç'fjalë prozaike për këtë rast! Po si ta thuash ndryshe? Nejse. Sytë dhe lëngu i blertë i lumturisë! Unë, ajo dhe fejesa jonë!.. Fejesa është një nocion abstrakt dhe ka shumë skuta të fshehta si çdo gjë abstrakte! Fshehtësia është një pus të cilit nuk ja gjen fundin kurrë. Fshehtësia! Kurse unë, gabova. U ula në tryezë me Bekimin! Ku e gjeta këtë maniak që vuan nga

kompleksi i nostalgjisë? Ai tani do të pyesë me ngulm. «Si është e fejuara?.. Prej nga është? Sa e bukur është? Sa?! — «Sa» është një pyetje që bëhet dendur në ekonomi. Sa për qind! Sa prozaik! Po ai mund të pyesë edhe kështu: Sa e bukur është? Se mos do rrijë t'i zgjedhë shprehjet si shkrimtarët? Do të më pyesë kështu dhe gjithshka e bukur e fejesës sime do marrë një kuptim prozaik, ekonomik, sikur bukuria të ketë një njësi matëse si pesha ose gjatësia! Hëm... Ky njeri do ta hedhë kovën e kureshtjes së tij në pusin e ndjenjave të mia më të fshehta dhe medoemos do të nxjerrë diçka. Do të nxjerrë ujën e sipërfaqes. Kështu do të bëjë disa herë. Pastaj do të vijë edhe të tjerët dhe do të bëjnë po këtë gjë. Kërkëllima e ngjitur e zinxhirit të kovës do të më gërryejë me mërzitje. Derisa të ngopen, ata do të vazhdojnë të nxjerrin ujë nga pusi i ndjenjave të mia!.. Kurse, po të isha fejuar me Suzin... hm... askush s'do të më pyeste! Suzin e njohin të gjithë shokët e mi. Fundja, Suzi... Po s'mund të ishte Suzi! Sepse, është tepër liberale Suzi! Ata nuk e dinë se si jam ndarë unë me të. Më mirë. Suzi është kokëfortë dhe krenare. Edhe gjuhën e ka të gjatë! Ajo më tha se e përbuzte pavendosmërinë dhe drojtjen time. Tha se kishte jetën e saj, që nuk donte t'ja varte në qafë askujt. Çudi e madhe! Ohu! Pseudoemancipim! Deri në shturje! Ajo mund të ma nxinte jetën me pavarësinë e saj kokëkrisur!»

Ata të dy kishin shumë kohë pa u takuar, prandaj heshtja, që është shenja e bisedës me vetëveten, s'mund të vazhdonte gjatë. Po përfytyrimet e secilit ishin shumë larg njëri-tjetrit.

— Bukur! — aprovoi dikë Bekimi.

Ai u përmend. S'kuptoi. Pastaj e mori me mend, se ai kishte thënë kështu për orkestrantët.

— Kjo ishte «Tango e trëndafilave». Argjentinase. Dikur argjentinasi quheshin mbretërit e tangos! — tha Bekimi.

«Ky vuan nga kompleksi i nostalgjisë...» — mendoi.

— Ç'është kjo heshtje? Unë po digjem nga kureshtja! — tha Bekimi.

— Ti më kot thua ashtu! — tha ai. — Ti s'je shquar

kurrë për kureshtjen tënde!

— Natyrisht! — pranoi ai... — Po këtë herë rasti është i veçantë! Ti më the vetë!..

— Ajo është nga një qytet tjetër. — tha ai me përtesë.

— Nga ç'qytet?

— Nga Fieri!

— Po si e psonise deri në Fier?

— Interessant me ty. — u inatos ai. — Po ç'hyn këtu fjala banalë «psonisje?»

— Mos u nxeh! Unë e thashë ashtu... për variacion. Desha të thosha «ku e njohe?»

— Nuk e njihja. Ndërhyri dikush, që njihte familjet tona.

— Një mblesëri?

— S'besoj! Një ndërhyrje e zakonshme dashamirëse. Daja i saj nuk është njeri sidokudo që të merret me mblesërirë!

— Ndodhin shpesh! — tha Bekimi.

«Ç'mërzi! — mendoi ai. — Ku e njohe? Ai është tuaf! Bën pyetje të marra! Ç'rëndësi ka tani fakti ku, kush, si u njohëm? Rëndësi ka fakti që ajo është... e jashtëzakonshme!»

— Është histori e gjatë! — shtoi ai thatë, si për ta mbyllur këtë bisedë, dhe trokëlliu gotën.

— Bëre mirë! — tha Bekimi. — Unë kam më shumë garanci për virgjërinë e vajzave të provincës. Këtu ka krisur dashuria, kurse aty... vetë klima e provincës sikur nuk e favorizon aq fort dashurinë, apo jo?

— Nuk e di! Ti po thua ca gjëra primitive. Ç'rëndësi ka tani në dashurojnë apo jo? Ky është primitivizëm!

— Ku ta dish? — tha Bekimi me djallëzi. — Ndjenjat janë enigma! E thashë edhe qëparë këtë më duket! Kështu si ti, thoshte dikur edhe Rezua. Të kujtohet Rezua? Edhe ai u fejua në Fier, me një gjimnaziste. Pastaj doli që ajo bënte dashuri me një tjetër, më duket se me një mësues fshati! Po kjo është vetëm një koincidencë!

— Jo, s'më kujtohet asgjë e tillë! — tha ai.

— S'është e mundur! Kjo bëri bujë! Dhe a e di se si e zbuloi? Nga një copë letër e parëndësishme!

— S'më kujtohet! Unë nuk e kam ditur kurrë këtë ndodhi të Rezos!

— Mundet! Kjo ka tre vjet që ka ndodhur dhe atëhere ti nuk ishte transferuar akoma këtu! E zbuloi nga një copë letër...

— Naivitete! — tha ai. — Asgjë tjetër!

— Ah, jo!.. Letra ishte me shifër!

— Si?

— Vetëm se shifra ishte vërtet naive? Pa fantazi! Një radhitje numrash. 7, 9, 14, 28. Numuri 1 ishte gërma e fundit e alfabetit, kurse A-ja ishte e 36-ta.

— Dhe si e gjeti shifrën ky Rezo-Pinkertoni?¹⁾

— Rastësisht! I gjeti së fejuarës një letër në çantë, mbushur me numra të tillë. Nuk i dha rëndësi, po megjithatë e mbajti në xhep. Mbase i lindi edhe ndonjë dyshim. Një ditë, shkoi me shërbim në Fier. Dikë njohu në tren. Më duket se një vajzë. Ajo dërdëlliste shumë dhe ndër të tjera i tha se, kur ishin në gjimnaz, kishin pasur një farë shifre për të shkëmbyer letra sekrete me njëri-tjetrin. Ajo ja kishte treguar edhe çelësin e shifrës! Kupton? Teka gjimnazistësh! Po kjo ishte bërë si traditë!

— Naive! — tha ai dhe e piu me fund gotën e birrës.

Orkestrantët bënëin pushim. Në një qoshe kamerieri bashkoi katër tryeza dhe në to u ul me zhurmë një grup njerëzish.

— Lojrat naive dhe barceletat përhapen si flakët e kashtës — tha Bekimi. — Bile ato trashëgohen nga brezi në brez!

Ai u ngrit, pagoi dhe kaloi nëpër rruginat shtruar me strall. S'frynte asnjë pikë erë. Tani po i dukej zagushi. Drurët e errët të lulishtes, si krijesa të lashta të fosilizuara nuk lëviznin fare. Nëpër stola s'kishte asnjë gift. «Preferojnë liqenin! — mendoi ai. — Të vete të shetis! Shetitja do ma largojë zymtësinë që më dha ai maniaku. Hm!.. Shifra! Posi! Teka gjimnazistësh!..»

1) Pinkertoni — dedektiv amerikan i viteve të luftës midis Veriut e Jugut.

Furshullonin gjethet e plepave të shetitores «Marsel Kashen». Shtetitorja ishte pa njerëz, furshullima ishte monotone. Ajo trazonte errësirën dhe bënte në të vorbuj ku shtilleshin ujërat e dritave dhe të mugëtirës. Furshullima i hyri në tërë qenjen, si një dihatje e një trupi të huaj.

«Unë do të shkoj tani në apartamentin tim! — tha më vete. — Netët e Tiranës janë më të ftohta se sa mendojmë! Kjo lëkundje temperaturash asgjë të mirë nuk i sjell njeriut. Do të shkoj dhe do të hap televizorin! Son-te s'ka asnjë program për të qenë! Edhe mbrëmë s'kishte asgjë të rëndësishme». Në shtëpi ishte edhe ajo me dajën. Ajo rrinte si mbi gjemba dhe mbante duart mbi gjunjët. Daja kryqëzonte vështrimin e tij të rreptë me vështrimin e saj të trembur. Ajo tërhoqte dhe ulte fustanin mbi gjunjë, sepse fustanin e kishte pak të shkurtër. Kështu, ajo i mbulonte vazhdimisht format e bukura të kofshëve ku shkisinin sytë e tij tinzarë. Ai përfytyroi se si pas disa muajsh, çdo lëvizje e saj do të pësonte një metamorfozë. Do të shkujdesej! Duart nuk do t'i shkisinin më mbi gjunjë, duke ndukur fustanin. Dhe shkujdesja do të shpaloste njëra pas tjetrës, shumë hire femërore. Ai ishte push-tuar tani nga diçka sensuale, tepër sensuale, që i sillte një dridhje e padurim nervoz. E dëshironte. Sepse asgjë, asgjë nuk i takonte deri tani atij. Asgjë nga gjithë ato që joshnin vështrimin, duart dhe vërshimin e lumit të rrëmbyer të ndjenjave. E dëshironte! Fejesa e tij ishte e çuditshme! Ajo kishte diçka të paprekshme e të mangët. Ajo kishte pasur mangët çastet e intimitetit, puthjet, ngrohtësinë femërore. Dhe prandaj vuante tani. Prandaj i furshullonin gjethet e natës. Jo gjethet e natës, jo. Gjethet e plepave të natës, që formonin kubënë e shetitores së qetë «Marsel Kashen»! Gjethet e dëshirave të tij!

Po përfytyrimi mund t'i çajë kubetë. Edhe kubënë e paprekshmërisë mund ta çajë ai. Deri tani kjo ishte një fejesë-dimër. E bukur, e bardhë, pakëz e ftohtë, si dë-bora që shkëlqen e të verbon. Po afër ishte pranvera. Erë-rat e ngrohta. Shkrirja. Vërshimi i nxituar i ujërave, që

do ta shuanin etjen për intimitet, për puthje, për... Dhe ai do të zbulonte vlerat ende të panjohura të saj! «Vlera? Ah, sa banale kjo fjalë e huajtur nga ekonomia! Po si të thuash ndryshe? Vlera të panjohura!»

Ai ishte tani në atë gjendje shpirtërore, kur mund t'i përsëriste sërish nëpër buzë vargjet romantike të atij poetit pa emër: «Fillad... shelgje... Shpirti çel e ndjell vru-llë çapkëne!» Vetmia nën kubënë e gjetheve po i dukej çlodhëse, paqësore, qetësuese. Ai u mundua edhe një herë të rikrijonte në mendje imazhin e saj. Po nuk ja arriti. I mungonte diçka aftësisë së tij përfytyruese. Këtë aftësi e kishin me siguri piktorët dhe artistët e tjerë. Kishte lexuar dikur që artistët i riprodhojnë më saktë imazhet që kanë parë në ëndërr, se sa njerëzit praktikë të shkencës, si ai. Imazhi që formonte ai kishte vetëm sytë. Po shprehjen e fytyrës nuk e formojnë vetëm sytë! Ai u mundua më kot. Nuk e përfytyroi dot. Ndjenjat sensuale ju shuan.

«Ku vanë e më shpunë këmbët në atë bar-veror? Po ai? Melankoliku! «Tango e trëndafilave!» Ptu! Tinzar i madh paska qenë! E dinim që e mbante veten për njeri që s'mund ta habitësh me kurrgjë! Siç thotë edhe Horaci «Nil admirari!» Po sa ja kishte ënda ta zbriste kovën e kureshtjes mu në thellësitë e mia! Dhe pastaj, trilloi atë ndodhinë naive të Rezos me numrat! Rezua e la të fejuarën, vërtet! Po ajo ndodhi s'mund të jetë e vërtetë. Mbase edhe mund të jetë. Brezat e të rinjve tani janë më të zgjuar se sa kujtojmë ne. Ne jemi naivë. Ohu-themi, kur kemi qenë ne maturantë ishim më të pjekur, më seriozë! Budallallëk! Largësia e viteve na ka ngritur mbi një pedestal të lartë. Po pedestal i është rërë. Ata janë më të zgjuar, dhe shkujesja e tyre fsheh në vetëvete zgjuarësinë. Edhe ajo është njësoj si ata. Ja... edhe ajo loja me shifra nuk është aq naive sa duket, jo. Se, dihet: letrat që u vijnë vajzave, i lexojnë shpesh edhe prindërit. Po prindërit s'janë aq finokë, sa të deshifrojnë disa numra të shkruar pa kujdes nëpër qoshet e letrave. Po ajo vallë, a e di këtë kod të fshehtë gjimnazistësh? Apo tani kanë tjetër kod?»

Pa u kuptuar këmbët e kishin shpënë në apartamentin

e vet. Shkallët ishin të errëta e të heshtura, si përherë. Nëna kishte fjetur. Darka e ftohur, mbuluar me një pecetë të bardhë, po e priste në tryezë. Nuk hëngri. Hapi televizorin. Kishte disa javë që jepej një program për gratë e famshme. Sonte vraponte Vilma Rudolphi, me atë hapin e gjatë mashkullor. Ai kishte një mërzi instinktive nga sporti. Çdo të hënë, një koleg e nervozonte qëllimisht duke bërë komentin e ndeshjeve të futbollit të javës. E dinte se ishte ende herët që të lëvizte drejt tij gjumi dhe prandaj nuk ra në shtrat.

Mendoj t'i shkruante një letër asaj. Ky nuk ishte një mendim i çastit. Ai ja kishte premtuar në platformën e stacionit këtë letër.

E dinte qëkur si duhej shkruar kjo letër që do të lexohej në gjirin e familjes. Pas mbiemrit «të dashur», do të renditeshin babai, nëna, ajo, vëllezërit e vegjël. Do të jepte disa të fala nga nëna e tij dhe nga daja i tyre. Disa pyetje për atë. Ç'thonë mësimet e maturës? Hë.. Ja përsëri një pyetje standart, jo e qëlluar! «Ç'thonë mësimet!» Sikur mësimet kanë gojë dhe thonë diçka. Po ndofta ky është një animizim që lejohet?

E shkroi.

Pastaj i shkrepri të radhiste disa numra. U mundua ca, se ju desh të radhiste në një letër të gjitha shkronjat e alfabetit. Njëherë i dolën tridhjetë e pesë. Mezi e gjeti se kishte harruar pa shkruar zanoren «Y». Pastaj i radhiti. Numrat thoshin: «Të dua shumë. Më shkruaj edhe ti me shifër!»

Në ekran vazhdonte të vraponte Vilma Rudolphi. Atë çast ai as që mendoi se ky ishte një naivitete femënor nga ana e tij. Fjeti një gjumë të trazuar.

Të nesërmen, para se ta hidhte në kutinë postare, i tha një zë i brendshëm që ai s'ishte gjimnazist dhe as mosha e as profesioni nuk ja lejonin lojra të tilla djallëzore. E grisi.

Natën, në vetmi, shkroi një letër tjetër. Letra ju duk më e thatë dhe më zyrtare se e para. Ju bë se nuk ishin fare pakuptim ato fshehtësitë e shifrës. Jo, nuk ishin të kota. Po të përgjigjej edhe ajo ashtu, ai do të zbulonte

një anë të re të karakterit të saj. Do të zbulonte që ajo nuk ishte aq e padjallëzuar dhe e brishtë, siç i ishte dukur kur u njohën. Pra, ajo dinte edhe të shtirej. Impresionet e para të gënjejnë. Koha dhe gjakftotësia janë çelësat e vetëm për të hetuar katërcipërisht çdo gjë. Për të hetuar për shembull virtutet, veset, tiparet e karakterit të njeriut.

Ai që kishte pasur disa vjet të një dashurie fluide e deri diku të pakuptueshme me Suzin, e dinte nga koha se Suzi ishte e prirur t'i bënte komike edhe gjërat serioze, e dinte që Suzi ishte aq zemërbardhë, sa s'ishte e zonja të kursente asgjë dhe se kjo bashkë me shpengimin e saj gazmor në çdo shoqëri që të ishte, e patën bërë që ta rishikonte çeshtjen e martesës së tij me Suzin dhe pat sjellë ndarjen e tyre.

Kurse ajo... ajo tjetra, e fejuara e tij shumë e bukur, si ishte? A ishte ndopak djallushe si shumica e gjimnazisteve?

Ai s'dinte asgjë.

Le t'u dukeshin të tjerëve naivë numrat e shifrës. Ai do t'i shkruante prapë. Se mos do t'i lexonte ndonjëherë ndonjë prej shokëve të tij? Jo!

Këtë herë ai i shkroi më lehtë, sepse si njeri i kujdesshëm, që nuk hedh kurrë gjë me vlerë përtokë, ai e kishte ruajtur radhitjen e shkronjave që pati bërë mbrëmë. Shkroi po ato fjalë. Dhe fjeti i qetë këtë natë, sepse i dukej sikur fshehtësia e fejesës dhe e asaj, po fashiteshin tani sikur rreth tyre ishin ndezur llamba me zhivë.

Por... nuk e dimë nëse të nesërmen e grisi përsëri apo e hodhi në kutinë postare atë letër që do të zbardhte mugetirën e shumë të fshehtave!..

EGERSIA

Pritej të hynin gjermanët.

Ata s'kishin depërtuar kurrë në vende kaq të thella e të humbura. Kjo pritje po zgjatej që nga ajo ditë kur u hap fjala se ata kishin filluar operacionin e dimrit. Ata e shkelnin vendin ngadalë, me drojën dhe kujdesin që u kishin mësuar ditët e para të operacionit, kur kishin besuar se lëvizja partizane që shuar dhe ishin habitur kur ajo kishte shpërthyer më me forcë.

Nëpër udhët e ngushta të fshatit, të ndyra nga bajgat e lopëve, bridhte tinëz si maçok i zi heshtja e ngrirë. Diçka e papërcaktuar, si një kërcënim i panjohur, vinte e vërtitej mbi pullazet bashkë me mjegullat e mbrëmjes. Netët rëndonin shpellë. Era fërshëllente në hatullat e zbrazura dhe vrimat e kanateve gëlltisnin dëborën që binte. Zhurma dhe jehona të çuditshme kumbonin netve. Ditët u bënë të murrme si guna të palara dhe heshtja e tyre ishte njësoj si heshtja e netve, sa të bëhej se kufiri i përjetshëm midis ditëve dhe netve kishte ngrirë e mbetur diku përrrenjve e s'dukej më.

Nuk ishte heshtja dhe zymtia e frikës. Ndjenjën e frikës ata e kishin mposhtur qëkur, me krismat e armëve. Ishte ankthi i së panjohurës së re që lëvizte drejt këtij fshati ku rrallë shkelnin të huaj e që përmbli dhej në fjalën e vetme: gjermanët!

Ç'do të bënin?

Fshati kishte shumë djem partizanë, por edhe në bata-kët e fushës ishin kredhur në bisht të të huajve ca të tjerë me shkabë në qylafet e bardha.

Një njeri, me një thes ngarkuar grarisht në shpinë, zbriste natën nëpër dëborën e ngrirë drejt mullirit. Njeriu nuk e kuptonte aq mirë se ç'ishte duke bërë dhe nganjëherë i bëhej se e gjitha kjo ishte një marrëzi. Mulliri s'punonte që prej vjetësh se jazi ishte vithisur. Ujërat kishin ngrirë dhe nën kadet e vjetra akulli i qerpikëve kishte bërë një mur. Ai mbështeti dorën pas murit prej akulli dhe eci për-bri tij si i verbër. Pastaj preku gurët e mureve dhe, kur gjeti derën e vjetër, e shtyu me sup. Dera kuisi më të qarë dhe ai u fut në qerthullin e dendur të errësirës. Mulliri ishte i braktisur, megjithatë ai ndjeu erën e za-konshme të pahasë së miellit, që kanë gjithë mullinjtë. —Kujt mund t'i shkojë mendja për mullirin — mendoj ai. — Askujt. Ky është një mulli i harruar dhe i ftohtë ku nuk shkel këmbë njeriu. Edhe jazi ka ngrirë. Mirë që ka akull! Do të mbathim kallçij dhe do të shkojmë nëpër akull. Akulli është i mirë, si shurdhët. As gjurmë të mban, as zhurmë s'të bën. E kush mund ta dijë më mirë se unë se si mund të vihet në mulli pa lënë gjurmë gjëkund? Dhe askujt prej tyre nuk do t'i shkojë ndër mend se ajo është këtu. Mbase ka fat dhe shpëton e gjora vajzë! Po doktori pse mblidhte supet ashtu? Pse? Mbase s'ka asnjë shpresë? Jo! Sakohë merr frymë, njeriu ka edhe shpresë! Netve do t'i bëj zjarr! Ditën do ta shuaj. Do ta mbuloj me le-venxa! Kokë e këmbë! Ç'mund të bëj tjetër? Asgjë s'mund të bëj! Asgjë!»

Ai shkarkoi barrën që kishte katër levenxa të kuqe me thekë dhe doli nëpër natë.

Ky ishte mullisi Kron Vani.

Në mëngjezin e po kësaj dite, kur çonte dhinë për ujë në krua, mullisi vuri re se prapa tij vinte duke nxituar nëpër shteg edhe Dule Dulja. Ai desh t'i bënte bisht dhe rrahu dhinë, që të nxitonin, po ato u shtynë e u ngjeshën të trembura nëpër dëborë dhe s'bënë këmbë përpara.

Dulja, mbathur me qiklla, ishte veshur e ngjeshur si për gjah. Një zagar pullali, si i këputur në vithe, tundte bishtin dhe nuhaste nëpër kakërdhi. Dulja e arriu duke u çapitur nëpër dëborën e pashkelur anës shtegut. Dhinë shfrynin avull.

— Dëgjova se nesër vjen Nazim Korua — tha Dulja.
— E dije ti?

— Ç'më duhet mua? — tha mullisi.

— Do të hyjnë këtu edhe gjermanët! — tha Dulja.

— E dimë, e dimë. Po ti, ku shkon kështu? T'i presësh?

— Kam vënë leq për lepuj. Do vete t'i shoh!

— Ngutu, ngutu, se lepujt janë të majmë sivjet edhe mund të t'i këpusin!

— Bëj leq të fortë unë! — kish qeshur nën mustaqe Dulja. Shapka, veshur me lëkurë dhelpre i kishte shkarë mbi sy dhe mullisi i shihte zverkun gollash, me shenja të vjetra çibanësh dhe leshrat e lagura ku kishin ngrirë fije të imta okite, si tela të bardhë e të përdredhur. I ishte mjegulluar vështrimi dhe një damar kishte filluar t'i rrihte me rrëmbim. Pastaj prapë vështrimi ju ngul në një pikë të zverkut ku ishte shenja e çibanit dhe ju duk sikur aty mund të zhbirohej një vrimë e prej saj mund të rridhte lëngu i squllët si zorrë i jetës së këtij njeriu, të cilin s'donte ta shihte me sy. «Kur s'ta shpuan partizanët me një plumb atë zverk, or qen, bir qeni! — Kur s'ta shpuan!» — kishte menduar ai.

— Or xha Kron! Në këtë luftë ti e ke më mirë se të gjithë, se as farë e fis më ke, as vetë nuk je përzier më ndonjë kra! Nuk të nget njeri ty, jo! Dhe në e mësofsh

dot ku e kanë fshehur atë dosën partizane që ishte e sëmurë, do t'i thuash tutje edhe fukarallëkut!

— Nuk di gjë unë, po hiq mënjanë e hapu udhë dhive — tha mullisi.

— A e di se pse të them? Në e shtifshim në dorë, me flori do na paguajë Nazim Korua. E patën pasur fjalën që atë do ta merrte nuse vëllai i Nazimit, Gurka. Po ua punoi vëllai i saj, Fehmiu.

— S'kanë për ta shtënë në dorë, or jo! Partizanët e morën me vete!

— Bah! E kush e ha këtë? Unë? Po ajo digjej furrë nga ethet e plevitit!

— Disa thonë se vdiq — tha Kroni dhe shtyu dhinë nëpër shteg. Një shytë ju fut nëpër shalët e gjata Dules dhe doli matanë, Dulja u vrëjt. Nxitoi edhe ai duke lënë pas gjurmët e qikllave si panxa ariu.

— Ku e varrosën? — thirri ai befas, duke u kthyer.

— Nuk e di!

— Ta dinim, t'ja digjnim varrin, se mos na ngjallet lugat dhe na tremb gratë tona!

Mullisit ju mjegullua vështrimi përsëri në atë blanë të zhubrosur në mes të zverkut të kuq, si të demit të therur.

Tërheqja kishte qenë shumë e shpejtë. Tri ditët e fundit batalioni kishte mbetur në rrethim dhe ishte përgjysmuar. Nëpër pyjet e dendura e nëpër guvat ishin fshehur ata që kishin humbur lidhjen. Pastaj batalioni e çau rrethimin, u grupua dhe qëndroi një natë në këtë fshat. Fshati ishte më i thelli në këtë krahinë. Natën tjetër partizanët e hodhën lumin në va. Vau kishte ngrirë. Mbi akull mbetën ngjitur copa bezesh, arna leshi dhe njolla të një lëngu të errët. Partizanen Lule s'mund ta merrnin. Ajo kishte një javë që dergjej midis jetës dhe vdekjes dhe tani, në qoftë se i kishte mbetur ndonjë farë nga jeta, ajo

mund të mbinte prapë vetëm duke ndenjtur në këtë fshat. Ndofta askush nuk besonte se ajo mund të mbetej gjallë, megjithatë askush nuk e pëshpëriti fjalën vdekje. Partizanen e lanë në fshat dhe ata besonin se këtë gjë e dinin vetëm fare pak njerëz të besuar. E lanë në shtëpinë e plakut Dolo Shirka.

Plaku po shkante llozin e rëndë në derë, kur ndjeu hapat e një njeriu që po afrohej. Hapat ishin të nxituar dhe dëbora ja bënte krap... krap!.. Ai vuri syrin në vrimën e një gdhëri të rënë dhe njohu mullisin Kron Vani. Mullisin e mbanin për njeri të urtë e pak të mefshtë, që s'dihej se ç'mendonte, sepse fliste rrallë e për mall. Plaku dyzoi një çast po pastaj e hapi derën. Mullisi hyri. Përgjoi nëpër derë udhën që kishte bërë dhe s'tha asgjë. Udhët ishin të shkreta. Pylli i aheve në rrëpirë, i rjepur nga dimri, dukej lakuriq, tejprëtej. Një zagar lehu diku dhe e lehura u përhap si zë alarmi. Plaku Dolo shkoi prapë llozin në portë.

— Kush leh ashtu? — pyeti plaku sa për të thënë diçka.

— Zagari i Dules!

— U shofsh, farë e ndyrë! — shau plaku dhe ndoti dëborën me një llokmë pështymë të gjelbër. Pastaj e shke-li gëlbazën e vet dhe ajo u fut thellë nën gjurmën me lerë bajgash.

— O Dolo! — thirri mullisi.

— Ë! — tha plaku.

— Unë jam fukara njeri! — u ngatërrua mullisi. — E me kë tjetër do jem unë veçse me luftën, more?

— E dimë, more Kron, e dimë! — tha plaku.

— Po ai qen pse më tha mua, «ti s'je përzjerë» ë?

— Ti ke mbajtur bazë aq partizanë! — tha plaku. — E dimë.

— Bazë mbajnë të gjithë — tha mullisi. — Unë dua të bëj një gjë më shumë se aq! Fëmijë s'kam që t'i dërgoj malit, dhe vetë jam plak tani! Unë dua që të shpëtoj atë partizanen!

Plaku Dolo u zbeh! Ishte edhe ai një nga ata që besonin se vetëm disa e dinin që në fshat kishte mbetur një

partizane! Mullisi Kron e dinte: sot duhej të fliste sa për tërë jetën! Sot, ose kurrë!

— Edhe Dulja dyshonte që ajo ka mbetur këtu! — tha ai. — Atë dosën partizane e do të gjallë Nazim Korua — më tha — dhe, në e gjetshim, do na i lajë me flori!

— Ti hajë m... — tha plaku.

— Unë i thashë: ka vdekur ajo, ka vdekur! Kështu i thashë!

— Po pse ja ndolle mortjen ashtu? — u trishtua plaku Dolo.

— Nuk e di! Mbase kështu nuk e kërkojnë më!

— E morën me vete, ti thoshe!

— I thashë edhe ashtu. Po nuk e besoi. Më pa vëngër e tha: e ku do vinte ajo me plevit e me një këmbë në varr?

— Po kush e di tjetër? — tha plaku.

— E dinë! I ka edhe fshati ynë disa halera dhe ata nuk i kanë sytë në bythë që!..

Plaku mbylli sytë, sikur ja vriste dielli.

— Thuaju shokëve! Kroni ka bërë një jatak në mullirin e vjetër, u thuaj. Aty nuk i shkon mendja njeriu. Dhe do të rri ta ruaj vetë, ditë e natë!

Plaku Dolo tundi kokën po prej asaj tundjeje s'kuptohej asgjë.

— Eja njëherë kur të ngryset — tha ai. — Mos i biesh në sy njeriu! Dhe po të duash, merr një kazmë e bëj nja dy tumba varri thellë, në përrua.

Mullisi u vodh si hajdut nëpër derë. Dolua hyri brenda. Në kënd, anës vatrës, zbardhte si kartë fytyra e imtë e vajzës. Flokët e gjatë ja zinin sytë. Në faqe i ishin bërë dy vula bojë all, si të thekura në afshin e prushit. Plaka i hodhi edhe një levenxë dhe vuri gishtin mbi buzë.

— Fërkoje që tani me shëllirë — tha plaku — se sonte do ta heqim.



Askush nuk e priste që ata të dilnin nga pylli. Kolona e tyre gri u duk në hapësirën e zbrazët midis drurëve

dhe nisi të varej tatëpjetë me ca lëvizje zigzage, të ngathëta e të çuditshme. Gjithë ai rrip që përdridhej me përtesë nëpër dëborën e pashkelur, ishte si një vijë me ujë të zi që del nga errësirat e guvave dhe ndyn me erën e tij të ndenjtur vendin. Nëpër bardhësi u hapën traga tërthore, sikur kishte shkuar parmenda e një bujku të çmendur.

Ata hynë pa zhurmë në fshatin e ngrirë. Të vetmet britma ishin kakarisjet e pulave. Nuk ndenjën. Bënë më tej, kapërcyen vaun dhe u hodhën në krahinën tjetër. Akulli i vaut u thërrmua copë-copë.

Fshati psherëtiu. Oxhakët tymuan më shumë.

Por më të errur, tërë bujë e potere, hynë ballistët e Nazim Koros.

Nuk ishte gdhirë ende, kur plaku Dolo dëgjoji dridhjet e portës. S'kishte fjetur gjithë natën. Thëngjijtë e vatrës ishin ndezur. Ai u çapit me benevrekë nëpër acarin e mugut dhe hoqi llozin nga dera.

Nazim Korua, i pakët e i thatë, me një uniformë kaki, shtyu dikë me bërryle dhe doli përpara. Dulja, me rroba gjahu, me një feste të madhe të bardhë, me shkabë, që e kishte vënë qysh mbrëmë, hyri në dhomën e zjarrit.

— Ti je Dolo Shirka? — tha Nazimi.

— Unë jam! — tha plaku.

— A nuk ka qenë bazë te ti një nga ato dosat e partizanëve, një Lule nga Rebasit?

— Në shtëpitë tona vijnë shumë njerëz. Lufta i hap dyert!

— Ajo ka fjetur këtu — tha Dulja që posa doli. — Edhe dhoma mban akoma erën e saj!

— Këtu ishte! — tha plaku Dolo.

— Po ti, pse i bëre jatak, o derr? — tha një ballist i gjatë, si vastarkë, prapa shpinës së Nazimit.

— Pusho, pusho! — tha Nazimi. — Ti, Asim, je hajvan! Lufta kështu e ka. Vijnë ata, populli u bën jatak, vijnë ne, prapë populli bën jatak! Populli i bindet armës. Kujt i kërkon hesap ti? Popullit? Ne për lirinë e tij robëtohemi ditë e natë!

Ballistët heshtën. Dy-tre prej tyre u zbythën fshehur dhe bënë përpjetë, nga kotecët.

— Atë e kemi pasur nuse për Gurkën — tha Nazimi.
E dije ti?

— Jo! Nuk e dija!

— Kishim lidhur fjalë që në djep. Po ata qena, u lidhën me komunistët! Unë u dërgova fjalë. U thashë: «do vijmë të marrim nusen e Gurkës. — S'kisha çetë ahëre, jo! Isha mënjanë! Po a e di ç'fjalë më dërguan? «S'është kohë për dasmë, thanë, se e kemi hasmin në vatër. Dhe ai Nazimi juaj, thanë, mos i dredhë vithet shumë duke ndenjgur asnjans, po të bashkohet me ne, me luftën!» — A kupton, or ti?

— Jo! — tha plaku.

— Bijtë e bushtrave! Do më jepnin mua mend! Kujt? Nazim Koros! Unë dola me çetën time, të Ballit. Atëhere i vëllai, Fehmiu, e mori edhe atë me vete në mal. E mori që të shkërdhehej me të gjithë, se vallë i sosnin ato të Gurkës! unë dua ta gjej! Dhe do ta gjej! Ti do të ma sjellësh!

— Është udhë e gjatë! Pa dëbora është trashur, dhe nuk e çajnë dot këmbët e mia! — tha plaku Dolo.

— Or gjidi e dërrit! — shau ballisti i gjatë — Asim!
A, më jep lejë, o kumandar, t'i heq një meremet?

Nazimi bëri një shenjë mërzie. Duart e vogla, si prej femre, trazonin një nga një kokat e fishekëve të gjerdanit, sikur përkëdhelnin një kotele. Një lëng i turbull, si i përbaltur, i shkëlqente në të bardhën e syve.

— Thonë se paska vdekur — tha. — Di gjë ti?

— Do të jetë çudi në pastë rrojtur! — tha Dolua.

— Po varrin ku e ka?

— Ku ta dish? Ata shkuan natën!

— Ti s'di asgjë! Askush s'di gjë! Po ne do ta gjejmë! Atë, ose varrin e saj! Dhe në pastë vdekur, dua ta shoh ç'nur i ka rënë. Asim! Merr pesë vetë! Bridhni arë më arë, përrua më përrua! Në gjetshi tumbë varri, hapeni!

— Kot po i mundon, o komandant — tha plaku. — Që pardje hodhi shumë dëborë Gorenit!

— Ti mbylle sqepin! Ramua dhe ju të tjerët përhapuni në fshat! Mos lini shtëpi, plevicë, shtrat, hale e vrimë pa kontrolluar! Mua më gjeni këtu. Do të ha në çanakët e këtij plaku. Ti, Gurkë, rri me mua!

Hynë brenda dhe ndenjën këmbëkryq rreth zjarrit. Mbi fytyrën e vogël të Nazimit, nxirë nga erërat dhe dielli i dimrit, bridhnin lodhja e mërzia. Dukej sikur ai bënte një mundim të madh, kur i duhej të qeshte ose të bërtiste.

«As e qeshura, as e bërtitura nuk i kanë hije — mendoj plaku. — Këtij do t'i kishte hije më shumë dremitja. O zot! Ky pesë para njeri i bën njerëzit të dridhen, kur i dëgjojnë emrin!» Kilotat e Nazimit, me meshinë në shalët, nisën të avullonin, dhe plakut ju duk sikur po i avullonin koskat e gollganët e gjunjëve, ndehur si biga mbi stofin e kilotave. Nazimi nisi t'i fërkonte prapë plumbat dhe gëzhojat e fishekëve të gjerdanit me gishtat nervozë.

— S'po na i bën nderet sipas zakonit, o i zoti i shtëpisë — tha ai.

— Edhe ju nuk trokitët si mysafirë, po erdhët e u sheshuat vetë!

— Shumë të gjatë e ke atë gjuhë, or Dolo Shirka — tha Nazimi.

— Nga pleqëria — tha nëpër dhëmbë plaku.

— Hidhna kutinë e duhanit, siç e do zakoni!

— Unë pi duhan të sertë!

— Edhe gjuhën të sertë e ke! Nga trimëria thua? — tha Nazimi dhe sytë e vegjël ju përshkënditën.

— Jo, prapë nga pleqëria! — tha ai. — Trimëria ka hedhur pushkën krahut dhe ka dalë malit!

— S'futesh kollaj në leq, jo — tha Nazimi. — Mal më mal ma hedh fjalën, po unë kam parë edhe më të zgjuar se ti, dhe ua kam vënë festen sipas kokës. Por sot nuk të ngas, jo. Jam në qejf, se do gjej më nusen e Gurkës, ja, të këtij kapedanit këtu. O!.. mos u çudit ti, se e nuhas unë që ajo është e fshehur këtu, në këtë fshat. Edhe që s'ka vdekur, e ndjej. Ma thotë një zë këtu përbrenda ngaherë: Nazim! — O! Ti do ta zësh të gjallë, dhe Gurka do dëfrojë me të, sa t'i nxjerrë dufin! Ma thotë ngaherë ai zë! Edhe kur të më vijë mortja, unë do ta di, do të ma thotë prapë ai zë. Ke dëgjuar kështu ti, plak?

— Paskë rënë në ujdi me të përtejshmit! — tha plaku.

— Mos u hidhëro, Gurkë! Po s'ta gjeta nusen, mos më thëncin Nazim Koro!

Gurka, i imtë dhe ai si i vëllai, me një push të verdhë posambirë në faqe, u skuq si lafshë gjeli dhe u drodh.

— S'çaj kokën unë, jo! — tha.

Jashtë, në hajat, u përplasën këmbë. Plaku Dolo doli. Ishte një nga ata të pesë që shkuan me Asimin. Dolua e njihte prej vjetësh këtë njeri. Ishte një bujk i këputur me një zhgan fëmijë.

— Po ty, ç't'u desh kjo kapë e gjelbër, o Nuro! — tha ai.

— Për mëmëdhe, thonë të gjithë, or ti! — tha Nurua dhe hapi sytë si guak.

— Do ta thonë edhe ty ndonjë ditë mu në lule të ballit, po dale — tha plaku.

Nurua vuri në kokë qylafin me shkabë, shkundi dëborën dhe hyri brenda.

— Gjetëm një varr! — tha me zë të lartë.

Nazimi kërceu sikur e shpoi njeri me bizë.

— Ë? — tha.

— Bosh. Duan të na venë krunde, më tha Asimi. Kishin bërë vetëm një tumbë, pa varr.

Nazimi brodhi nëpër derë si i marrë. Koburja i rëndonte në brez dhe ai anonte si kali që s'e ka barrën tamam.

— Tëmën! — tha. — Kur s'kemi një qen me erë, si të gjermanëve!



Deri në mesditë, në fshat s'e merrte vesh qeni të zotin. Dy plevica me bar morën zjarr. Një ballist korrozi, me shkumbë të bardha jargësh piksur në buzë, derdhte kadet me turshi në oborrin e Qenan Gunës. Plaka e Qenanit rrokullisej si lëmsh nëpër dëborën e ngrirë dhe mbledhte në mësallën e zezë domatet turshi. Mallëkonte sa i mbante në kokë.

— Na thave lugën, or t'u thaftë zorra!

Korroziu hingëlliu dhe u vuri shqelmin kadeve, që u rrokullisën, mblodhën dëborën e u bënë si ortekë. Kodet u përplasën pas një muri dhe u shkërmoqën.

Në drekë herë zuri një dëborë e butë, e qetë. Degët zunë të ngarkonin. Befas, prej thellësive, aty ku ishin derdhjet e ujërave, u ngrit një zhurmë e mbytur, si thirrje habie. U dëgjua një krismë e vetme. Dikush gulçonte duke u ngjitur përpjetë shtegut.

— E zunë... e zunë! — klithi një zë.

Nazimi dha ca urdhëra që s'u morën vesh, nëpër dhëmbë. U zverdh. Tani nuk e dinte saktë as vetë se ç'do të bënte. Një grahmë e egër urretjeje i shkallmonte gjoksin dhe ai mezi mbushej me frymë.

— Ç'ishte ajo krismë? — tha.

— E vrava mullisin — tha Asimi. — Ai e kishte fshehur. M'u lëshua me dhëmbë si qen dhe unë e vrava.

Nazimi s'foli. Hyri në oborin e shtëpisë së Dolo Shir-kës. Pas tij hynë edhe dy vetë që mbanin për sqetullash atë që duhej të ishte partizanja Lule. Ajo tani i ngjante një kufome. Plaka e Dolos ja vuri një kuje të gjatë e të thekshme që mori malet. Nazimi bëri një shenjë padurimi dhe Nurua e shtyu plakën në hajatin e shtëpisë.

— Po të pëllasë më ashtu, zerjani gojën me çorap! — tha Nazimi.

Plaku Dolo u mbështet pas gurëve të ftohtë të maurit. E ndjente në shpinë ftohmën e tyre si akull, po s'bënte dot këmbë. I bëhej se s'ishte ajo partizanja Lule, që ishte dergjur anës vatrës së tij. I bëhej se ajo ishte një vajzë e çuditshme që kishte dalë nga mulliri i vjetër, zbardhur nga pahaja e miellit, i bëhej se ajo ishte vajza e mullisit Kron Vani që s'kishte pasur kurrë fëmijë dhe që dergjej tani kufomë në truallin e mullirit të vjetër. Asaj nuk i dukeshin sytë. Flokët i rrinin mbi ta si karthje të ngrira nga cikna. Ai nuk e kuptonte, në shihnin apo jo ata sy. S'e kuptonte rronte më ajo, apo ishte diçka e bardhë, prej mielli e prej dëbore bashkë!

Binte dëborë e butë.

Plaku vuri re se dëbora shtronte shtroje mbi gjithë kokat e zbuluara, mjekrat dhe shajakët. Vetëm mbi flokët

e saj, dëbora nuk zinte vend po shkrihej e bëhej ujë nga zjarrmia. Ujërat e dëborës, si lot, i rridhnin faqeve. Ajo dridhej, rronte. Dridhjet e saj u hynin në trup edhe dy ballistëve që e mbanin për krahu.

— Lëshojeni! — tha Nazimi.

Vajza ra, sikur ja prenë gjunjët me kosë dhe mbeti ashtu. Nazimi u afrua me hapa të shkurtër dhe e përfshiu me të dyja duart pas xhakaventos, në gjoks. E ngriti më këmbë. I shkopsiti kopsat e xhakaventos. Të linjtat e bardha dhe gjinjët i kërcyen përpara dhe frymëmarrja e nxituar i gufoi ata. Ai u mundua ta shihte në sy, të vidhte vështrimin e saj, po sytë e saj ishin të turbull si ujë dhe shihnin zbrazësinë. Ai e pa me ngulm. Diçka u përpëliti brenda bebëzave të saj dhe ai u mundua të kuptonte ç'thoshin ato përpëlitje bebëzash. Ato s'thoshin asgjë. Ajo i përkiste një bote tjetër. Botës së ëndrrave. S'kuptonte, ose përbuzte gjithshka që bëhej rreth saj.

Plaku Dolo desh të çapitej drejt saj, të mbyllte me kopsat përhedhjet e gjoksit, po këmbët i kish si prej druri dhe u mbështet më fort pas murit.

— Dosë, moj dosë! — tha Nazimi. — Ç'na bëre!

— Ajo ka vdekur! — thirri me mundim plaku Dolo. — Ka vdekur! Nuk e sheh, or qen?

Do ta shohim në ka vdekur apo jo! — tha Nazimi.

— Vrite, or qen! Vrite! — bërtiti ai.

Asimi i gjatë hunguroi dhe u gjend pranë tij.

— Lere plakun, lere! — tha Nazimi. — Më duhet mua ai — dhe u afrua vetë.

— Nuk ka ngordhur, or jo! — përtypi fjalët ai. — Ka katërmbëdhjetë shpirtra si macja, femra. Nuk e sheh si i hidhen gjinjët përpjetë? Unë do t'ja lë atë Deme Korroziut. Demes, që i ka buzët me shkumbë dhe që i është bërë syri bakër për femër. Pastaj do ta le edhe ty një amanet. Unë e kam ditur gjithnjë se ti je i lidhur kokë e këmbë me ta. Edhe që i ke djemtë partizanë andej nga Skrapari, e di! Ti e ke gjuhën shumë të gjatë dhe e ke hak një plumb në lule të ballit. Po unë do të të kursej që të më shpiesh një amanet, se vetëm ti mund t'i gjesh ata. Në s'e shpënc,

këtu jemi. Ai varr që hape për të na gënjyer, hapur është prapë!

... Gurka, si i mpirë, ju afrua vajzës që ishte shtrirë në dëborë dhe u mundua t'i kopsitte gjirin. Ju duk sikur s'merrte frymë. Duart i mërdhahnin dhe nuk i fuste dot kopsat nëpër vrima. Nën këmishën e bardhë, asaj i hidhej mishi i gjinjve dhe ai vuri dorën aty, si i trembur.

... — Largohu — tha Nazimi. — Je shumë i pastër ti që të ndyhesh me atë kurvë! Lerja Deme korroziut!

... — Është nusja ime!.. — belbëzoi Gurka.

... — Ishte. Tani është nusja e Demes dhe e qenve, sepse është bushtë!

... Demja u afrua. Një cep i buzëve i kishte vajtur shtrembër dhe i dukej mishi i nxirë i dhëmbëve.

... — Jo, këtu, or derr! Fute në plevicën e barit — tha Nazimi. Demja e mori në krahë si pupël dhe hyri brenda. Një pëshpëritje, si psherëtimë përshkoi turmën e ballistëve. Dikush hapi portën dhe bëri të dilte jashtë.

... — Këtu! — tha Nazimi me një zë të ulët, sikur zgërdhihej — Kush bën këmbë jashtë, ja numroj në lule të ballit! Namuzlinj ju!

Plakut Dolo i ishin veshur sytë. Mbi qepalla i rëndonte dëbora si strehë plloqash. Pas një çasti shumë të shkurtër, Demja doli me rrëmbim nga plevica, i zverdhur dyllë dhe me sy të trembur prej idioti, që shikonin në zbrazësi. E lëshoi trupin e partizanes përtokë dhe murmuriti nëpër dhëmbë: «Është e kotë, o kumandar, se ajo është pothuajse e vdekur».

Nazimi bëri sikur nuk dëgjoi gjë. Ai s'donte të dëgjonte asgjë. Ai donte që ajo të ishte më e gjallë se të gjallët dhe t'i ndjente të gjitha. Dhe ai besonte se ajo i ndjente të gjitha. Një vërshim i egër gjaku i ndezi kokën, i zbriti nëpër remba.

... — Më bëj dy gisht kartë, or ti! — tha ai.

U afrua me të shpejtë një djalë i ri, veshur si qytetar dhe nxori letër e stilograf.

... — Ç'ke kështu? Pse të dridhen duart? Apo do të veç edhe ti aty ku ishte Demja?

— Jo, jo!.. — belbëzoi qytetari. — Më ngrinë nga të ftohtët.

— Hukiti një herë dhe shkruaj: Fehmi, o derr i dërrit, komunist! Ishalla s'je bërë akoma kërmë dhe të bie në dorë kjo kartë! Po që kërmë përrenjve do mbetesh e që do të hanë korbat, kjo dihet! Ne me gjermanët jemi mizëri dhe do t'jua shuajmë pishën! Mëso tani se tët motër, që e patëm fejuar për Gurkën, e zura gjallë dhe ja dhashë për ta shkërdhyer Deme korroziut nga Lëngëzi. Atij Deme që i varen jargë. S'ishte nuse për ne ajo, po për të. Në rrojtë edhe më, se unë jam shpirtmadh dhe do ta lë gjallë, ajo ka për të pjellë dobiçë budallenj e jargamanë dhe kështu fara juaj do të shuhet e do të bëhet pleh. Ja kështu ta punon Nazim Korua!

Nazimi ja futi në gji letrën plakut Dolo, që kishte ngrirë si qerpik i zi akulli pas murit. Në dritare, ja vuri prapë ulërimës, sikur e thernin, plaka e Dolos.

— Ne do kaptojmë vaun sot dhe, si ta spastrojmë vendin edhe andej, do të kthehemi. Ti ua di strofkat. Në s'më sjellsh përgjigje, varrin e ke gati — tha ai.

Bëri një shenjë dhe tërë turma e zezë, ngarkuar me dëborë doli jashtë. Plakut s'i bënin më këmbët. Dëgjoji se si zbriste kuja e plakës nëpër shkallë, se si u hap porta, se si doli plaka si një gjë e errët dhe u rrokullis drejt pleviçës së barit.

Binte dëborë e butë.



Binte dëborë e butë.

Shkrinë akujt e lumenjve dhe vija të tëra lotësh rrodhën nëpër qerpikët e strehëve. Lotët e qerpikëve ishin të ngrohtë dhe shkrinin dëborën, hapnin gropëza të vogla deri në dheun e fortësuar nga ngrica. Kolonat gri të gjermanëve s'dihej nga shkuan dhe tri ditë rresht, në fshat erdhi mysafire prej pyllit qetësia e thellë dhe e trishtuar. Digjeshin me ngut qindra zjarre në vatrat. Kudo ku kishte

vatër, kishte zjarre të ndezura. Njerëzit zbonin itomën e dimrit.

Pastaj u ndez një luftë e ashpër në Qafën e Mprehtë. Plumba qorrë fërshëllenin mbi çatitë e mbi tymin e oxhakëve. Në mbrëmje hynë dy batalione partizane. Thoshin se kishin zënë rob Nazim Koron, po asnjëri s'dinte gjë me siguri. Në mëngjez u muar vesh që kjo ishte e vërtetë.

Plaku Dolo teshtinte në çdo çap dhe i therte në shpatull. Ai nxitonte dhe i pyeste të gjithë për komisarin Bakir. I thanë që ishte në shkollë. I thanë që kishin zënë dhjetë ballistë dhe i mbanin lidhur këmbë e duar bashkë.

Një partizan roje deshi ta ndalte, po ai e bëri mënjanë butësisht. «Dua komisarin Bakir — tha. — E kam një amanet dhe, po të mos e shoh edhe një herë atë Nazim Koron, s'do më tretë dheu!» Komisari Bakir doli nga një dhomë. Një partizan e ndiqte pas. Partizani s'thoshte dot asnjë fjalë. Plaku Dolo vuri re se kyçet e gishtërinjve të partizanit ishin verdhur limua nga shtrëngimi. «Qetësohu, or Fehmi — thoshte komisar. — Do t'i gjykojë gjyqi partizan!»

Plaku u afrua.

— E kam edhe unë një punë me atë Nazimin, or komisar — tha plaku.

— E dimë, Dolo, e dimë! — tha komisar. — Po ajo ç'bën?

— E kemi çuar në Llëngë — tha ai. — Po s'bëhet më njeri ajo, or bir. Nuk i mbyllen më plagët!

Partizani zuri të qante si fëmijë, me kujë. Komisar. e mbështolli me krahun e tij dhe pëshpëriti: «Mbahu, se je partizan, or Fehmi!»

Plaku Dolo shtyu derën dhe i pa të dhjetë aty në qoshe. Në dhomë të grinte veriu nga dritaret e thyera. Nazim Koros i lëshuan sytë lëng të idhët. Ishte mbledhur grusht, mu në cep, po megjithatë sytë ju përshkënditën nëpër lëngun e përhershëm dhe plaku vuri re se ai shihte me përbuzje. Gurka e kishte humbur fare dhe i kishte sytë me lot. Asimi dukej sikur s'merrte frymë dhe shihte si guak.

Më të errur, Nazim Koron, Asimin dhe një tjetër i

pushkatuan në përdua, mu aty ku mullisi kishte bërë tumbën e rreme.

Partizanja Lule vdiq pas dy ditësh. Ajo s'mori vesh asgjë. Kishte ditë që s'merrte vesh asgjë dhe shihte vetëm një mjegull të trashë. E varrosën në një kodër të vogël, në mes të drurëve, aty ku qajnë përjetësisht erërat dhe rënkojnë pishat e blerta me dhimbje.

AJRI I FTOHTË I MESNATËS

Një natë unë përgjova padashur një bisedë. Do të bëhej një martesë.

Por më parë ju duhet të dini se ne me Llanon kishim katër muaj që i kalonim së bashku të gjitha pasditet. Kjo ishte e natyrshme sepse të dy ishim të transferuar në Tiranë dhe banonim në të njëjtën dhomë të hotel «Sopotit». Mua më dukej se tanimë ne ishim bërë shokë të ngushtë. Bisedat tona zakonisht ishin pa bukë sepse vërtiteshin nga vajzat deri te kampionati i futbollit, por ama ishin zbatimëse dhe i shtynin ditët. Për letërsinë nuk bisedonim sepse Llanua lexonte vetëm vepra të klasikëve dhe manuale të ekonomisë.

Dy javë para Vitit të ri, Llanua u fejua. Ai s'më kishite thënë kurrë se kishte ndër mend të fejohej dhe kjo e papritur nuk ishte aq e këndshme për mua që në ato netët e gjata të vjeshtës, i mbledhur kruspull në shtrat, i rrëfeja pareshtur histori të vogla me vajzat ose me shefat e mi. Në fillim u zemërova, po më pas m'u duk se s'kisha të drejtë për këtë gjë sepse fundja, a mund të gjesh kurrë dy njerëz njëlloj? Nëse unë isha shoshë e shpuar, pse duhet të ishte ashtu edhe ai? Veç kësaj, unë e kam një të metë: të njohurit e rinj më duken më të mirë e më të këndshëm se ç'janë në të vërtetë dhe, po ta sjellë rasti, pas ndonjë jave ata do ta dinë fije për pe ç'më ka ndodhur mua në këto 25 vitet e mia. Kur u fejua, se si më vajti mendja

në një hollësi që duhet ta kisha nuhatur prej kohe: ai s'më kishte rrëfyer pothuajse asgjë për vete dhe gjithë ato net të ftohta i kisha ngrohur vetëm unë me historitë e dashurive të mia ose të shokëve. Ai dëgjonte dhe, kur i dukej interesante, pyeste më nge për hollësitat. Përpos kësaj gjëje, që unë s'e kisha shkuar ndër mend, duhet ta pranoj se Llanua më kishte bërë disa herë shërbime të çmuara. Më kishte dhënë para hua dhe, meqë e kishte grurë me portierin e pasdites, Nikollën, kishte ndërhyrë që Nikolla të mbyllte kur e kur njërin sy.

E fejuara e Llanos kishte një emër pak të rrallë: Fioralba. Llanua më tha se punonte diku në një laborator po tani s'më kujtohet mirë nëse ky ishte laborator bakteriologjik apo mikrobiologjik. Dy ditë pas fejesës, ai më ftoi në «Dajti». Atë natë, me ta ishte edhe xhaxhai i së fejuarës, emrin e të cilit nuk e mësova dot sepse ata i thoshin vazhdimisht me familjaritet «xhaxha». Ky ishte një burrë me trup të rëndë, nga ata tipa që japin vazhdimisht këshilla «në lidhje me punën dhe me jetën», që flasin për urtësinë e popullit dhe për përvojën e tyre dhe që në përgjithësi, të gjithë më të rinjtë u duken pak a shumë fëmijë që kanë nevojë për kujdestarë. Këta s'kanë durim t'i dëgjojnë të tjerët dhe janë dashuruar me zërin e tyre, si solistët e operës.

E fejuara e Llanos, që ta themi shqip, nuk m'u duk gjë, po kjo s'duhet marrë kallëp sepse unë në këtë pikë jam i çuditshëm dhe e vlerësoj bukurinë vetëm sipas syve të mi. Veç kësaj, kjo ishte puna e tij «e brendshme» siç thuhet në politikë. Në mbrëmje, kur ramë të flinim, i thashë Llanos me intimitet të madh se tashmë unë mund të bridhja rrugëve saherë të donte ai... por ai tha se s'kishte fare nevojë për këtë gjë, se në përgjithësi të fejuarve nuk u kishte hije të lektiseshin nëpër dhomat e hoteleve e nën vështrimet e vëngra të portierëve, se kjo mund t'i përshtatje një dashurie të dyshimtë dhe se midis normave të shëndosha të moralit dhe dashurisë nëpër dhoma kishte një hendek të madh.

Llanua më ftoi edhe disa herë të tjera nëpër lokale. Kjo ishte një mirësjellje model që provonte se miqësia

— Fshati ynë është tjetër lloj — tha Llanua. — Është i zhvilluar. Rinia bën mbrëmje vallëzimi. Ishit ju?

— Ne?.. Jo, jo! — tha Zenuni. — Janë për rininë ato gjëra!

— Sikur ti u plake! Ti sivjet i mbush të tridhjetat!

— Ashtu, po i kam katë kolopuçë ama!

— Shumë! — thashë unë.

— Shumë! — tha edhe Fiora.

— E po...

— Fshati ynë shtohet me ritme të shpejta — tha Llanua. — Ky është tregues i mirëqenjes. Rritja e popullsisë varet nga ekonomia. Kur njeriu ka siguri në të ardhmen, ai shtohet më shumë, apo jo?

Kjo ishte një arësye pak e cungët, por unë e lashë Llanon të shijonte efektin e mahnitjes së Zenunit dhe të krenarisë së Fiorës.

— Po ju, pse nuk na erdhët? — tha Zenuni me keqardhje. — Hem dërgoni letër që do të vini më 30, hem s'bëheni të gjallë fare. Ne therëm edhe derrin. Unë dola t'ju prisja.

— Ishte kohë e keqe — tha Llanua. — Na thanë që kishte rënë dëborë.

— Ra, po shkriu shpejt.

— Maqina s'vinte dot, sigurisht — tha Llanua.

— Dola ju prita me kuaj. Prit e s'ka, prit e s'ka, deri më të errur. Ishin bërë merak. Nëna u dëshpërua. «Na harroi Llanua thoshte, na harroi!»

— E si ju harrokam? Ç'do të thotë kjo? Si e harroka njeriu gjakun e tij? Ti duhet ta kishe marrë me mend që s'vinim Nuk e pe kohën? — Llanua dukej si i fyer dhe i mërziur dhe ktheu një gotë verë me një frymë.

— E di, e di... — belbëzoi Zenuni si fajtor. — Ishte kohë e keqe. — Dhe, si për ta shkarkuar ca nga barra e mërzi së të vëllanë, shtoi: — Po nënat ashtu e kanë, bre! Nga dhembshuria e kanë!

— Ranë shira të mëdha — tha Zenuni i qetë. — Kur bien shira të tilla, xhadeja e fshatit prishet nga përrenjtë. Me kalë s'vinim dot, se Fiora s'di të mbahet në samar. S'ka hipur kurrë në kalë. Kështu u thuaj!

— Do t'u them — tha Zenuni.
 — Sa ju doli derri?
 — Njëqind e njëzet. Dhjamë i tëri. Si llokume.
 — Ua! — u çudit Fiora.
 — Shumë mirë ju paska dalë — thashë unë, sa për të hyrë në bisedë, sepse kisha mbetur i huaj.
 — Shoku im është mjek veteriner — tha Zenuni.
 — A?.. po ç'punë bën këtu në Tiranë?
 — As unë s'e di se ç'djall bëj! — thashë.
 — Ç'flet gjepura dhe ti! — tha Zenuni. — Ti punon në Ministri, në Drejtorinë e blegtorisë.
 — Po, po. Në ministri — thashë unë.
 — Ne s'kemi veteriner — tha Zenuni. — Vjet në pranverë u frynë katër lopë me jonxhë dhe ngordhën. Kot së koti ngordhën.

— Po ju, si i keni bagëtinë? — pyeti Llanua.

Zenuni dukej tashmë shumë i kënaqur që ishte hapur një bisedë e tillë, ku edhe ai mund të merrte pjesë. Siç duket, heshtja e fillimit dhe pastaj biseda jonë për filmin «Më fal» që Fiorën e kishte lënë pa mend në kokë, ja kishin ndrydhur shpirtin në një mërzë të murrme.

— Mirë i kemi dhe mbarë na venë. Bëri vjeshtë e gja-të sivjet dhe morëm një kosë më shumë nga jonxha.

— Ju në fshat i keni të gjitha — tha Llanua. — Këtu për çdo gjë duhet ta futësh dorën në xhep. Kjo darkë për shembull, sa thua ti se do të vejë?

— Ku ta di unë?

— Do kapërcejë mijën!

— Mos, more! — shpërtheu Zenuni me një habi që i mbuloi të gjitha tiparet e fytyrës.

— I thonë Tiranë këtu! — tha Llanua. — A e di sa më vret ndërgjegja që s'i dërgoj dot hëpërhë lekë nënës? Kushedi ç'thotë! U bë haram Llanua, thotë. Po ja, ti e sheh edhe vetë!

— Ju kemi blerë të gjithëve dhurata për Vitin e ri — tha Fiora. — Do t'jua japim, kur të shkoni!

— Falem nderit! Nga zemra! — tha Zenuni.

Pastaj biseduam edhe disa kotësira të tjera. Llanua pagoi. Sytë e Zenunit ishin zvogëluar.

Afër mesnatës u kthyem në hotel. Bënte ftohtë. Llanua kishte mbështjellë veshët me shall. Zenuni e kishte skopsitur këmishën më në fund dhe ecte duke zvarrisur këmbët. Bulevardet ishin të shkreta. Në vitrinat zbardhte ende dëbora prej pambuku dhe një sërë llamba të kuqe e blu digjeshin më nge dhe uronin Vitin e ri. Në qoshe të një rrugice qentë kishin përmbysur një fuçi mbeturinash. Një qen i dobët hunguronte e gërryente diçka me hundë në togun e plehrave. Porsa na pa, qeni futi bishtin nën shalë e ja mbathi nëpër rrugicat e verbëra. Zenuni ecte në trotuar. Kur e kur ndalej dhe vërente vitrinat me ngulm. Dëbora prej pambuku dhe shiritat e letrës me ngjyra që varreshin krye e tërthor e pengonin të shihte mirë.

— Punë e shpifur! — shfryu Zenuni papritur.

— Kush? — thashë unë.

— Pambuku nëpër xhamet. S'ka dëborë të vërtetë dhe gënjejnë sytë me pambuk. Në Elbasan i kishin lidhur pemët e bulevardit me spanko, si me shpërgej, dhe në spango kishin ngjitur pambuk. Dimër, demek! Hë? Unë u shkula gazit!

Llanua më shkeli syrin me djallëzi, sikur deshi të më thoshte që mos t'ja vija re, por ato që thoshte Zenuni mua m'u dukën të mençura e të zgjuara, si çdo e vërtetë që e zbulojmë papritur.

Nikolla e kishte lënë derën e hotelit hapur, për ne. Në dhomë kishin shtruar shtratin mbi një sustë. Llanua bëri naze një copë herë, sepse Zenuni s'pranonte të flinte në krevatin e tij dhe më në fund më vunë mua gjykatës. Unë thashë që në krevat duhej të flinte Zenuni, sepse ai ishte mysafir. Ashtu u bë. Unë mbylla dritën. Mbrapa murit tonë dikush kollitej dhe unë u bëra nervoz. Pastaj kolla pushoi dhe unë i dhashë karar të flija. Ndjeja të më derdhej nëpër gjymturë kënaqësia e ëmbël e rakisë që kisha pirë dhe në gojë kisha aromën e mirë të rrushit... Po mendoja se sa mirë ishte të flije tani, pas një darke të tillë, me biseda të rëndomta e pothuajse të kota, si shumica e bisedave të njerëzve, po megjithatë të këndshme, biseda nga të cilat s'të mbetet në mendje asnjë proekupacion për të zgjidhur. Po s'di sepse më vajti prapë mendja çapraz, tek

ajo pyetja: «ç'djall i tha Llanua kamerierit?» M'u shfaq përpara fytyra e kuqe si petull dhe buzëqeshja e tij e lyrshme!.. «Ç't'i ketë thënë ky Llanua?» Ja, de! Prapë nxori kokë një nga ato manitë e mia për hatër të të cilave unë e quaja veten pak të çuditshëm. Më kot e quaja, se të tilla teke, kush nuk i ka? Kjo ishte një tekë, si ato që na bëjnë ta detyrojmë trurin të kujtojë një emër që është fshehur e mbuluar në një skutë të tij nga ku s'ja ka ënda të dalë. S'di sa kohë kaloi kështu në këtë kokëngulje të pashpresë. Dëgjohej frymëmarrja e thellë e Zenunit. Dhoma po ftohej. Dikur fjeta edhe unë, po me një gjumë të shqetësuar e të lehtë si të lepurit. Llanua nuk e mori vesh kurrë se unë bëja një gjumë të tillë, sa më zgjonte edhe brerja e minjve. Pastaj u zgjova përsëri. M'u duk sikur ishte ndaj të gdhirë, por në janar ngatërrohen shumë kufitë e muzgut dhe të natës... Zenuni vërtitej në shtrat. Ndezi një cigare. Cigarja digjej me shpejtësi. U zgjua edhe Llanua.

— U zgjove ti?

— Po. Mua më del gjumi herët.

— Fli! — tha Llanua. — Ora është tre e gjysmë.

— Jo, more! — u çudit Zenuni. Po ku e di ti?

— Akrepat e orës sime janë me fosfor. Shiko si ndrisin. Zenuni lëviz nëpër rrobe. Siç duket ai tani ka afruar fytyrën tek ora e Llanos.

— Mos, more! — foli. — Dreq! Thonë se edhe koskat e zbuluara nëpër varreza kështu ndrisin!

— Kanë fosfor! — tha Llanua.

Unë isha ngrohtë në shtrat dhe nuk lëviza.

— Ore përse më thirre? — tha Zenuni. — S'më ke thënë gjë akoma.

— Nesër, nesër — pëshpëriti Llanua. — Sonte mund ta zgjojme atë!

— Mirë, si të duash! — tha Zenuni.

Një copë herë ata s'folën. Shkrepsja shkrepri një flakë blu.

— S'bëre mirë që s'erdhe! — tha Zenuni. — Nëna u dëshpërua shumë. Ajo ka qejf të shohë nusen.

— Do t'ju vijmë sa të mërziteni! — tha Llanua. Do t'ju mbijmë në sy.

— Ç'thua ashtu? Si do të mërzitemi me ty, me vëllanë tonë?

— Do të mërziteni, Zenun, do të mërziteni. Kështu e ka kjo botë!

— Pse e ka kështu?

Llanua nuk u përgjegj. Pastaj ngriti zërin.

— O Todo! — tha.

Mua sëç më shkrepri të shtiresha i fjetur. Jo sepse përgjoja ndonjë bisedë sekrete dhe më shtynte kërsëria. Biseda ishte e zakonshme. Heshta nga mirësjellja. Ata dëshironin të bisedonin diçka kokë më kokë. Le të bisedonin, njësoj sikur unë nuk isha aty. Unë u shtira i fjetur.

— Fle! — tha Zenuni.

— Folë me zë të ulët! Më jep edhe mua cigare!

U ngrit më bërryl. Të dyja cigaret digjeshin me ngut dhe ja bënin me sy njëra-tjetrës.

— Thonë se ajo Lulja e Fuatit kishte qarë kur kishte marrë vesh se u fejove.

— Si? Kush të tha?

— Më tha gruaja. Verës së shkuar, ti sikur u ngatërrrove ca me të, apo jo?

— Jo. Ç'janë këto budallallëqe me brirë?

— Pëshpëriste fshati se gjoja Llanua e kishte ujditur me mësuese Lulen. Po s'paska qenë gjë, jo.

— S'ka qenë gjë! — tha nëpër dhëmbë Llanua.

— E mirë ishte! — psherëtiu Zenuni. — Për nder, çupë më të bukur s'ka në gjithë krahinën tonë!

— Mendjelehtë — tha Llanua. — E di unë.

— Iku ajo tani. Po edhe nusja jote më pëlqeu. Ishte e qeshur.

— Kur martohet, njeriu duhet të peshojë shumë gjëra. T'i bëjë sytë katërmbëdhjetë. Martesa është e ardhmja e njeriut. Fiora s'është prej fisi dosido!

— Ashtu?

— Fis i gjerë. I lidhur ngushtë me luftën.

— Edhe në kemi qenë të lidhur ngushtë.

— Kemi qenë, po asnjë nga tanët s'patë funksione më vonë. Mbetën bujq. Kurse ata janë njerëz me merita të mëdha. Një xhaxha në Ministrinë e Brendshme. Tjetri

në Drejtorinë e përgjithshme të Turizmit. Vëllai i madh është pilot.

— Qofshin shëndoshë! — tha Zenuni.

— Rrethi familjar ka rëndësi të madhe — tha Llanua.

Tani mua m'u duk se po mërdhijja pak. Ndofta nga-
që s'bëja asnjë lëvizje? Apo hynte ajri i ftohtë nëpër të
çarat e padukshme? Kushedi? Djall, o Llano, më shkrepiti.
Do t'i ketë thënë kamerierit që Fiora është mbesa e atij
të drejtorisë së përgjithshme. Mund t'i ketë thënë edhe
kështu. Uh! E gjeta.

Mua më kishte pushtuar ajo ndjenja e pavetëdijshme
e përgjimit. Më kishte mbërthyer si një makth. Turp, e
shaja veten. Po hë? Gjumi ishte arratisur.

— Të thirra që të bisedojmë për dasmën time — tha
Llanua.

— Kaq shpejt do martohesh?

— Shpejt, sepse kam një rast të mirë për shtëpi.

— Ti e di!

— Jam i shqetësuar! — tha Llanua. — Të lot mendja
nga këto halle, vëlla! S'është një dasmë e thjeshtë dhe aq!

— Do ta djegim, mos u mërzit! Bagëti kemi, edhe
raki kemi!

— S'është halli aty, jo — psherëtiu Llanua. — Duhet
shpenzime edhe për t'u veshur, për dhurata, për...

— Sa mund të të duhen? — tha Zenuni.

M'u bë se edhe zëri i tij dridhej. Ndofta mërdhihte
edhe ai si unë?

— Ç'më pyet? Një djall e gjysmë!

— Sa mund të venë rrobat e dhëndërrisë thua?

— Një kostum i mirë, i do nja njëzet...

— Mos, more!? — u habit Zenuni.

— Shëëët!

— Kaq shtrenjt? Kur u martova unë...

— Aq, aq... — e ndërpreu mbytur Llanua. — Se, s'do
të vishem dhëndërr me një kostum dosido! Të jetë të pak-
tën njësoj me kostumet e rrethit të saj!

— Të jetë më i mirë — tha me vendosmëri Zenuni.

— Mirë është edhe aq. S'do të shkallmojmë thëmelet
e shtëpisë! Kemi pastaj edhe këpucët nja tri...

— Mos, more!?! Po këpucët sikur janë vetëm njëmijë!
— Të vendit, po. Mua më duhen të jashtme. Nga ato që gjënden me zor.

Zenuni u lëvri nëpër shtrat sikur ishte në kashtë. U ngrit. Llanua i vazhdoi llogaritë dhe, me sa më kujtohet, doli se veshja e tij dhe ato të tjerat i kapërcenin të dyzetat...

— E sheh tani në ç'hall kam rënë, apo jo? — tha ai. Zenuni s'fliste. Vetëm shtrati rënkonte. Sytë e cigareve digjeshin me ngut.

— Do të turpërohem! — tha Llanua. — U pa puna.

— Turpin dhe nderin e kemi bashkë. Jemi vëllezër!
— tha Zenuni.

— Bashkë i kemi! — pohoi Llanua.

— Mirë e the qëparë! Dasmë që të luan themelet e shtëpisë!

— Themelet...

— Po s'të lemë të turpërohesh! — vendosi Zenuni.

— Do bëjmë një punë. Do shesim kalin, do shesim edhe ndonjë bagëti të imtë. Do të t'i dërgojmë.

— Kur?

— Pas një jave.

— Falem nderit! Mbase e sjell rasti dhe ju tërheq edhe ju këtu në Tiranë.

— Pa.. pa.. pa.. — kundërshtoi Zenuni. — S'më duhet kurrë! Këtu batërdisësh!

Ata heshtën, të zhytur secili në shqetësimet e veta. Zenuni pyeti edhe një herë sa ishte ora. «Katër», tha Llanua. Zenuni u kthye në krahun tjetër dhe shtrati kërciti sikur do të thyhej.

Dhoma ishte bërë akull e ftohtë. Ajri i mesnatës rridhte tani nëpër të gjitha hapësirat dhe të çarat e padukshme të kanatës së dritares. «Kjo dritare më ishte dukur e puthitur mirë dhe e ngrohtë, ta marrë dreqi! Kurse paska shumë të çara që mezi duken. Dhe nëpër to hyn brenda gjithë fryma e akullit e natës!» Pastaj u dëgjua frymë-marrja e thellë e Zenunit.

Kur u zgjova, ata s'ishin më në dhomë. Llanua më kishte lënë një shënim: «Të lutem, lajmëro Fiorën se unë

shkova në Elbasan të përcjell vëllanë. Ajo nuk e di këtë gjë...»

Unë mblodha teshat e mia në valixhe dhe e braktisa hotel «Sopotin». Shkova zura dhomë në hotel «Vjosa». Largimi im, mendoja, do t'i dukej çiftit si një tekë e zakonshme e një njeriu pak çapkën. Por nuk do ta vrasin mendjen gjatë për këtë. Më vonë, saherë i shihja së largu, unë ndërroja udhë, sikur isha fajtor. Po ata nuk e vunë re as këtë.

SHTËPIA E LAKURIQËVE TË NATËS

— novelë —

Era mbërtheu gjethet e fundit të drurëve. Po shkonte vjeshta. Edhe ata shkuan, dhe ne mbetëm fare të vetëm. Kur të gdhieheshin netët e gjata të dimrit, shtëpia e tyre do të dukej si kube e madhe e një furre të shembur dhe unë s'do ta shihja më Nijen.

Dikur, kur nata i mbushte udhët me dëborë, porsa zbardhte dita, Nija hapte udhën e plevicave me lopatën e drunjtë të furrës. Unë përgjoja nga dritarja. Xhamet, drurët dhe purtekat e gardheve ishin vechur me okitë. Në luginë kishte mjëgull. Nija e priste dëborën kallëpë, më nge dhe pastaj i hidhte me lopatë. Shtëpia e tyre ishte një prazhdë larg dhe ajo më dukej e vogël. Aq e vogël më dukej, sa çuditësha përse s'vinte më në kolovegën tonë, në livadhet e mëllenjave, pse s'vinte e të rrëshqiste me mua, me sajën e gjatë që i thoshin kamion. Yyyy... Sa kohë kishte që Nija s'vinte të kolovitej ndajnatëhere, kur dilte hëna! Sa kohë!

Unë kolovitem gjithë dimrin. Dihet, sajën tani e kam lënë dhe rrëshqas me ski... Xhaxha Deliu më shante. «Me gjithëse bëra ushtrinë, ti mbete kalama», më thoshe. Unë qeshja. Xhaxha Deliu është babai im po, qëkur ishim të

mitur, ne u mësuam ta thërrisnim xhaxha, njësoj si fëmijët e Salikos dhe të Abazit. Ama edhe atij më duket se i pëlqente t'i thoshim xhaxha. Ku ta dish sepse? Mbase fjala baba i dukej shumë e butë dhe përkëdhelëse. Atij s'ja kthente asnjëri fjalën. Mua më vinte çudi me të, që nuk e kuptonte gëzimin tonë për dimrin dhe për kolovegën. Se dimri dhe kolovega ishin tonat, vetëm tonat. Bile edhe Servetit ja donte qejfi të kolovitej, po ai kishte frikë nga xhaxhai dhe nuk e bënte veten.

Po sa vjet kishte që s'vinte më Nija në kolovegë? Su? Hh... po. S'vinte më që porsa mbaroi tetëvjeçaren, domethënë dy vjet para se të shkoja ushtar dhe dy vjet në ushtri, që bëjnë katër vjet. Katër vjet kishte që ajo s'kolovitej më. Si i durohej xhanëm? Po ku ta dish? Ndofta na përgjonte me zili nga dritaret e shtëpisë. Mundet që na përgjonte, sepse netët ishin me hënë dhe çdo gjë ndriste. Vetëm shtëpia jonë nxinte e bënte një hije që zvarrisej e ngatërruhej me hijet e shtrembëra të drurëve. Nija s'kishte ardhur kurrë vetëm, po me Nushin. Atëhere Nushi ishte i vogël, kolovega jonë shkiste shumë sepse unë i hidhja ujë përpara. Atij i shkisin opingat dhe sytë i lëshonin lot nga thëllimi.

—O Nush... pse s'erdhi Nija sonte? — e pyeta atë natë.

— Se Nija... Se Nija u rrit! — tha ai.

Sajës së tij i ishte zbërthyer njëra këmbëzë, ajo rrëshqiste shtrembër dhe kruante një vijë të bardhë në akull.

— Ti mos u kolovit më, se e gërvish akullin dhe kolovega nuk shket shumë pastaj! — i tha Kuçua. Nushit ju mbushën sytë me lot. Unë i dhashë Kuços një pallavesh të atillë, sa më dhembti pëllëmba. — Merre sajën time — i thashë Nushit. — Dhe nesër sille që t'i mbërthejmë këmbëzën. More vesh? — Mora — tha ai. Unë ika. «Se Nija... u rrit. U rrit dhe nuk do të rrëshqasë më kurrë me sajë! Nija u rrit!» Se ç'dreqin më ndiqnin pas këto fjalë, nëpër gjurmët e dëborës, si qen. Si u rrit kështu menjëherë ajo?

Sa vjet kishin shkuar që atëhere? Po! Dy vjet para se të vija ushtar dhe dy të tjerë... që bëjnë katër.

U liruam në dimër. Kolovegën e kishte bërë Kuçua,

nuk ishin të Gjokajve, ishin pronë e kooperativës. Verës, pasmesnate, Deliu nxirrte nga ahuret dhentë dhe mushkën e i lëshonte të kullës nin në livadh derisa rralloheshin yjet dhe nisnin diku lëvizjet e njerëzve.

Shtëpia ishte e madhe. Deliu herë pas here hipte në tavan dhe godiste trarët me mykën e sqeparit. Trarët lëshonin një zhurmë të ëmbël, të qartë, si qemane. Këputej e binte prej tyre bloza dhe ai gëzohej si fëmijë. Gëzohej se trarët ishin të fortë, se nuk u kishte hyrë krimbi dhe se shtëpia do të rronte edhe shumë vjet. Vetëm një tra i madh, karinë pishe, e mërziiste. Jepte një tingull të shurdhër si zë pusi dhe shkundej prej tij pluhur druri i brejtur nga krimbi.

Po gëzimet dhe hidhërimet e vogla të Deliu askush nuk i dinte, askush s'kishte të drejtë t'i dinte. Dhe ai ishte përherë i vrejtur e i ftohtë. Ai dhe shtëpia ishin njëlloj të heshtura dhe rënktonin njëlloj në gjumë, sikur rënkonte pylli.

Netve dëgjohej grindja e erës me degët e thata të dru-rëve. Pylli vuante nga kjo grindje e vjetër. Ai shushurinte me fletët e tij të shumta, sikur u binte miliona pizgave të gjelbëra, por prapë nuk e mposhtte dot grindjen e degëve që thyheshin dhe binin duke shkundur pizga të gjelbëra. Një kukuvajkë këndonte përnatë diku, askush s'e dinte se ku, mbi ndonjë dru gjysmë të tharë, dhe Deliu me vete ja bënte përnatë benë zogut të trishtimit, po asnjëherë s'e pa dot me sy, sepse kukuvajka ishte e vjetër dhe dinake. Një mot, zogu nuk u ndie më fare dhe Deliu psherëtiu. «Këta djaj zogj rrojnë shumë vjet, ndofta më shumë se drurët dhe, qëkur mbaj mend veten time, mbaj mend edhe zërin e kësaj kukuvajke. Po shyqyr i erdhi radha të ngordhë» — mendoi ai. Mirëpo pranverës tjetër, porsa çeli gjethi, se nga dreqin doli një kukuvajkë tjetër. Zogu i ri kishte një thirrje të çjerrë, të mprehtë dhe të gërvishte diku, në kokë. Ishte zog grindavec si era e veriut, dhe Deliu i erdhi keq që kishte ngordhur zogu i vjetër me zërin e thellë e të përmallshëm si shpellë. Ai deshi ta ruante me çifte, po në fund të fundit hoqi dorë, u mësua pastaj edhe me zërin e tij, ashtu siç ishte mësuar tërë jetën nga-

dalë, me drurin, me pyllin, me erën, me ulërimat e ujqve dhe me dëborën e trashë.

Dëborë binte dendur, sepse pylli i ndillte retë mbi kokën e tij, i mbante si shtëllunga leshi për t'u ngrohur dhe ato ja shpërblenin duke derdhur, në netët e gjata, mizat e tyre të bardha butësisht, në heshtje, si në përrallë. Pothuajse kurrë s'kishte thëllime dhe cikna, kishte vetëm dëborë që ngjishej e trashej. Udhët e fshatit ziheshin dhe, kur mbarohej misri i blojtur, ata dilnin e hapnin udhën deri në mulli. Po kjo ndodhte shumë rrallë, një herë në disa vjet dhe prandaj tërë dimrin ata s'shkëmbenin fjalë me njerëz të tjerë. Kjo nuk çudiste asnjëri, sepse të gjithë rronin kështu. Plaku Saliko rrëfente se dikur fisi i tyre kishte tri kulme po dy prej tyre i hëngri hasmëria. S'mbetën meshkuj, familjet u shuan, vatrat u shuan, oxhakët u shuan... Salikua ishte më i madhi i vëllezërve, po familjen e drejtonte Deliu, sepse Salikua kishte shumë vjet që lëngonte nga një sëmundje e panjohur. Herë bëhej keq dhe kërkonte hoxhën, herë lëngonte qetësisht, anës zjarrit, mbuluar me brucë. Kur ndjehej mirë, zvarrisej deri jashtë, në lëmë dhe rrinte gjer në mbrëmje. Vërente perëndimin e diellit dhe kurorat e hënës. Në gusht ja ngulte sytë si zgavra qiellit e reve, pyeste në kishin shumë lajthitë dhe në frynin erërat e veriut e pastaj thoshte ngadalë: «Dimri i sivjetmë do të jetë i rëndë plumb. Të vini zahire! Pranvera do dalë kaçak!»

Të gjithë e shikonin gojëhapur. Ai heshtte dhe harronte. Po në të vërtetë ai s'harronte asgjë dhe, porsa vinte njeri i huaj, i jepte duhan e i thosh «Dimri i sivjetmë do të jetë i rëndë...» — Dhe tërë fshati përsëriste gojë më gojë profecinë e Salikos. Gratë bridhnin prozhmeve për bar.

Deliu e dinte që Salikua s'ishte me të mirat, bile e dinin të gjithë po asnjëri s'guxonte ta thoshte me zë të lartë këtë gjë, sikur kishin frikë se, posa ta thoshin, Salikua do të vdiste. Kur ishte i sëmurë dhe rënkonte, Deliu dëgjonte përshpëritjet si në jerm të Salikos që i lutej: «O Deli, shpjermë në stanet dhe lermë të fle jashtë... E di unë se ç'më shëron, e di. Të shtrihem në vathë dhe të pi qumësht dhije nga gjinjët. Ja, ajo...»

Zërin e kishte të ronitur e të hollë, si prej fëmije. Deliu s'thoshte asgjë, i dridhte një cigare dhe ja jepte. Plaku psherëtinte. Kur i rritej mjekra shumë, vinte Abazi, vëllai i tretë dhe ja shkurtonte me gërshërën e dhenve.

Një vit para se të bëhej kooperativa, banorët e shtëpisë u pakësuan dhe mbetën njëzet. Pas lëmit, u martuan me radhë dy vajza të Salikos dhe një e Abazit. Plaku e harroi për një kohë motin, vathën dhe qumshtin e dhive dhe grindej me vete: «Tri dolën, tri të hyjnë.» — Në fillim askush nuk e mori vesh ç'desh të thosh me ato fjalë. Djemtë fshihnin me zor buzëqeshjet, Deliu i murrëtye. «Ju jeni humbësira — tha — kurse xhaxhai ka dy barrë mend më shumë se ne të gjithë po, ngaqë jeni aguridhe, s'kuptoni dot gjë prej gjëje!» — Mezi e morën vesh që Salikua kërkonte të hynin tri nuse në shtëpi. Kështu duhej martuar Serveti, që e kishte radhën, Bilbili, që s'kishte vajtur ushtar dhe Kuçua, që po mbaronte tetëvjeçaren. Djemve u hipi gazi më keq, se, përditë Salikua murmuronte... «tri dolën, tri të hyjnë.» Deliu s'fliste dhe heshtja e tij thosh që ai s'ishte në një mendje me Salikon, po thosh edhe që ai s'mund ta kundërshtonte fjalën e Salikos, sepse nuk ja kishte thyer zemrën kurrë! Dimrin e shkuar plakut nuk i doli profecia për motin. Kish thënë që dimri do të vinte vonë dhe pastaj do të dështonte, mirëpo që në fund të nëntorit bëri vend një cipë dëbore dhe s'u shkri më. Xhamet zunë okitë. Një mëngjez, ishte vrejtur dhe s'u muar vesh se kur u gdhi, Salikua mbeti duke fjetur nën brucë.

«Ç'ka xhaxhai që fle kaq rëndë?» — tha Deliu.

Bilbili hoqi brucën dhe e zbuloi. Plaku ishte mbështjellë si gruçkë dhe gjunjët i kishte mbështetur në mjekër, si nga ngërçi. Duart i kish kyçitur. Në dhomë ishte gjysmerrësira e motit të vrejtur.

«O xhaxha Saliko!» — tha Bilbili. Plaku i shihte me dy sy të ngrirë, të turbullt, që s'lëviznin fare.

«Ai fle me sy hapur» — tha Bilbili dhe i shkundi dorën. Dora ishte e ftohtë si lëkurë gjarpëri dhe ju var në dysheme. «Paska vdekur — tha zëri i trashë i Deliut. — Nisuni e lajmëroni në fshat dhe fisin tonë, në Gllavë!»

Nuk qau njeri, përveç Sanijes, vajzës së Deliut. Ajo

ishte trembëdhjetë vjeçe dhe qante për higjë. Bile edhe kur e pyeste mësuesi në shkollë, ajo qante. Serveti sikur u mpi dhe i ktheu shpinën babait të vdekur. Bilbili s'ja lëshonte dorën.

«Lëshoje atë dorë — u grind Deliu. — Dhe hidhi brucën sipër...»

Të nesërmen erdhi hoxha dhe disa kushërinj të largët.

E varrosën afër pyllit, në krye të livadhit. Toka kishte ngrirë dhe varri mezi u hap...

Dimri ynë ishte i gjatë dhe qetësia ishte e madhe. Ngjarjet ishin aq të pakta, sa që kur ndodhte diçka, që ja vlente për ta mbajtur mend e për ta tjerre nëpër gojë, njerëzit merreshin me të ditë të tëra. Bëj hesap, kur rronte xhaxha Salikua ynë, njerëzit, posa takoheshin, pyesnin «Ke marrë gjë vesh për Salikon? — Jo — thoshin. — Thonë se s'ka thënë ndonjë gjë. Unë dëgjova që ka thënë se dimri do dalë dështak».

Vetëm kur vinte pranvera, kur shkrinte dëbora dhe qindra përrenj të vegjël nisnin e rrëkëlleheshin tatëpjetë, dukej sikur zgjohej çdo gjë nga gjumi dhe gurgullima e ujërave e trette edhe qetësinë e madhe. Dheu avullonte i tëri si një levenxë e murrme e nderur për t'u tharë. Ne ja nisnim me pendët e qeve. Unë isha pendar.

Në luginë, brenda atyre që u thoshin «vija të verdha» po ndërtohej edhe një shtëpi tjetër, për Hysu Grivën. Ish-te bërë tollovi e madhe, or vëlla. Hysua desh ta ngrinte përmbi konakët e vjetër, po kryetari ja kishte shtrënguar rripat. Ehu... Si ishte tërbuar xhaxha Deliu! Sikur ja kishin punuar atij këtë reng e jo Hysos. Ç'të kujtosh më parë? Mirë po shtëpia po rritej përditë dhe kur takoheshin njerëzit tani, pyesnin: «Ke qenë ndonjëherë andej? — Kam qenë — thoshin — hodhën brezin e dytë...»

Vetëm në shtëpinë tonë s'pyetej kurrë për shtëpinë e re. Ose më mirë, që të mos gënjejmë, s'flitej kurrë në sy të xhaxha Deliut. Të shuante pishën, po të të dëgjonte që

flisje për të. Dhe pse? Kot së koti, më duket mua. S'di si ju duket juve. «Po ti, derr, s'ke punë tjetër që tjerr nëpër gojë punët e botës?» — të thosh.

Një natë, unë u ktheva vonë nga arat. Qetë ishin të djersitur ujë dhe stallieri më pa shtrembër. Ama kisha lëruar atë ditë, jo llafe. Më kishte qëlluar një dhe i butë që çajej si hallvë. Udhës më dhimbnin kyçet e më çante trupi. Sapo kishte hapur gjethin e parë një minjollë e vogël, karshi diellit. Këputa një degëzë. Fletët ishin të buta, me një push si të bardhë dhe të shijshme si uthullnica. Ama edhe mua seç më shkrepri atë mbrëmje të kthehesha njëherë nga shtëpia e braktisur e Nijes. Kot së koti më shkrepri. Keni parë ju kështu? Dredhova te kapërcyelli dhe ja mora nëpër udhishten e vjetër. Në udhishte ishte rritur bari dhe ashtu, në të mugët, unë vija re se si mbetej një copëherë gjurma e opingës dhe se si ngrihej pastaj bari me përtësë e zinte vendin e parë. Që ta dini ju, kjo bëhej kështu se toka ishte e llazhdyer ende nga lagështia dhe se bari ishte rritur e s'ishte mësuar me thundrat e hajvanëve e me këmbët e njerëzve. S'shkonte më njeri në atë shteg. Të gjithë e kishin harruar, bile edhe Batua e kishte harruar. Batua mund të vinte ndonjëherë aty nga vjeshta, kur të bëheshin gorricat, se ishte lakmitar i prapë ai. Le që ç'punë do të kishte Batua me gorricat? Për ato mund të vinte Nija. Po, doemos. Nija dhe unë. Unë? Si atëhere. Ne me Nijen shkundim gorricën dhe kokrrat i fshihnim pastaj në plevicë, në sanë. Nuk i linim sa të zhugeshin, jo. S'na durohej dhe vinim përditë e i zbulonim. «Eja të shohim, u zhugën gorricat vallë?» — thosh Nija. Unë mbushja krahët me sanë dhe zbuloja folenë e gorricave. Sana ishte e butë. Ndonjë fletë hithri më shponte duart... Por... y... y... y!.. Sa kohë ka që atëhere! Sa vjet vallë? Ah... po! Ishte disa vjet para se të veja ushtar. Nija atëhere nuk ishte rritur ende dhe netve me hënë vinte në kolovegë. Tani Nija është rritur. Dhe s'të shikon fare në sy, pa le. Po gjithë sytë përdhe, sikur i ka humbur gjësend. Ama edhe unë, ç'ja punova pardje kur e gjeta vetëm, nën arrën e xha Asimit. «Hë, moj Nije, ngrije kokën lart, se do të të dalë kurrizi» — i thashë. Ajo u hutua fare, budallaqja dhe më tha: «Si je,

o Bilbil, si i keni nga shtëpia?» Ama, budallaqe, ore! Si i keni nga shtëpia! Ë? Dhe iku! Po të thuash se është aq e turpshme, s'thuh dot, se a s'u ngrit një herë në mbledhjen e rinisë dhe m'i punonte gjuha bilbil?

Oborri i shtëpisë s'njihej më. Kishte mbirë bari në mes të gurëve dhe vendi ishte bërë i butë. Çudi e madhe ama, sa shpejt rritet bari në mes të gurëve, kur nuk shkel njeri. Dyert ishin hapur nga erërat. Po kalbeshin. Batua e kishte këputur shkallën që ngjitej në katin e dytë dhe dy parmakë kishin mbetur varur, si çengela. Ishte ngrysur, po jashtë vendi ndriste si ditën, se kishte dalë hëna. Ajo ishte e madhe dhe shkëlqente si tepsi e kallaisur. Ç'të ndritur që bënte! Mund të shkoje perin në gjilpërë. Brenda shtëpisë, ishte një terr i dendur, sa të vinte frikë. Le që ç'frikë të më vinte? Aty s'kishte asgjë. Ama, prapë seç kisha një si të dridhur, një si shybe, sikur isha në tjetër botë, në tjetër kohë, ku s'kisha qenë kurrë. Ploçat e kulmit kishin shkarë dhe ishin hapur vrima. Njëpër to futeshin rrezet e hënës, po nuk zbrisnin dot deri në hajat dhe mbeteshin varur nëpër trarë. Dhe nga dritaret hynte një dritë e venitur. Ato më ngjanin si sy të verbër e të verdhë, si sytë e xhaxha Salikos atë mëngjez që... Dhe befas seç më erdhi prapë një si dyshim. Një si çorape e vjetër kishte mbetur varur në një tra të qoshes dhe unë çuditesha, ç'donte aty ajo çorape prej leshi të zi? Ja këputa me një gur, kur fryy... ja bëri gjëja si çorape dhe zuri të furfuronte nëpër errësirë. Për besë, të ishte ndonjë që s'ishte mësuar me shpellat dhe mazgallat e gërmadhave, shtatë do t'i vinin... aq shumë furfurinte dreqi! Merrej vesh që ishte lakuriaq nate dhe mua më hipi gazi kot së koti.

Fundja s'kishte ndonjë gjë për të qeshur, vetëm se më hipi gazi për Nijen. Kur ta takoja, do t'i thosha: «Ë, Nije! Po ta mbajti, ngjitu ndonjë natë nga shtëpia e vjetër, se ju kanë vajtur mysafirë!» Nija do të dridhej nga frika. Po sikur të ngjitej ndonjëherë? Sikur ta merrte malli për shtëpinë e vjetër? Ja... siç më mori malli mua. Nejse, unë erdha kot xhanëm. Ashtu m'u shtynë këmbët, po përse do ta merrte malli Nijen? Në shtëpi s'kishte mbetur asgjësend. Asgjësend. Vetëm mazgallat, kamaret, trarët dhe mu-

ret. Muret, megjithëse kishin dhënë bark, prapë e hëngrën dhe këtë dimër. Ku dihej? Mund të mbaheshin më këmbë edhe tjetrin. Dhe kështu, në shtëpinë e errët do të shtoheshin lakuriqët e natës. Ajo do të bëhej shtëpia e tyre, sepse ajo ishte më e ngrohtë se shpellat e pyllit. Në vjeshtë, kur të piqeshin gorricat, do të vinte Nija. Po prapë, s'dihet! Ku e linte Batua ate? Megjithëse mund të vinte me Nushin. Ose me Kasemin. Ama edhe ai Kasemi! Hajvan paska qenë! Ka bërë edhe ushtrinë në marinë, pa le! Ai e vuri atë rregull të shpifur në mbrëmjen e vallëzimit, apo doli vetëvetiu? Jo, more, ai e vuri. Se ai tha së pari që të bënim mbrëmje vallëzimi. «Ne që kemi mësuar në ushtri, tha, mësojmë kushërirat, motrat dhe pastaj kërcëjmë.» Mbrëmja u bë xhanëm, drodhëm edhe gjithë ato valle, po kur erdhi puna për të kërcyer çift, aty ngeci karkaleci! Jo se s'lojtëm, po secili me kushërirat, me motrat.. Ë... në ta mbajtë shko e vallëzo me ndonjë vajzë që s'e ke të fisit. Me Nijen, ta zemë. Le që edhe Nija s'tundej vendit nga frika, po mund të bëhej shërri-sherr! Mbrëmje e bukur, besa! Për zili! Dhe tërë fajin e ka Kasemi, sigurisht! Është edhe sekretar rinie tjetri, pa le!

Le që... ndofta s'bëhej dot ndryshe, ë? Thonë se edhe gjetiu kështu bëhen. Nejse. Po hë? Si të bësh? Po sikur t'i mbushej mendja Kasemit dhe të vinte të merrte Dudijen tonë? Jaaa!.. E pse tamam Dudijen? Le të lozte me... Au! ç'them edhe unë! Gjepura! Eja të shkojmë tani prej këtej! Eja! Natën e mirë! Natën e mirë, lakuriqë të natës! Natën e mirë, Ni...

Erdhën ditë të ngrohta dhe kumbullat e egra çelën lule përnjëherësh. Në livadhe dolën luledhentë dhe ato dukeshin si të mbuluara me breshër kokërrmadh. Në mezhdat e arave dhe të livadheve kumbullat shtoheshin vetëvetiu nga bërthamat që mbeteshin vjeshtës dhe, po të mos i hanin dhitë e Deliu, do të ishte bërë një pyll i tërë. Ishte fresk, dhe mbante vlagë, drurët hazdiseshin. Hidhnin gjembat e trashnin degët. Kësaj stine i gëzohej Deliu. Në mbrëmje,

kur kthehej nga arat, ulej në lëndinë, mbi kryet e burimit që dilte në mes të livadhit dhe psherëtinte. Abazi, i mër-zitur ngaqë s'e merrte dot me mend se përse psherëtinte ashtu Deliu, ndjente në ato çaste një uri prej ujku dhe zorrët e gërricin. Ç'dreqin kishte Deliu që çlodhej e dridhte duhan tamam këtu, në prag të shtëpisë? Sikur t'i thosh njeri që aty në livadh shpirti i rreshkur i Deliut zbutej e shtrihej si për t'u qetësuar një copë herë, s'do kishte gjë më të habitshme për të, sepse ai s'e merrte dot me mend ndryshe Delium, veç të vrejtur si moti që mund të bubullojë kur të duash. Deliut i dukej sikur i shkriheshin ca akuj të mbe-tur nga dimri. Ata shkriheshin në vijën e gjelbër e të bardhë të majit. Pastaj inatosej me vete për këtë, thithte me duf tymin e duhanit dhe e shihte fytyrën në ujët e burimit. Burimi ishte i tij. Asnjeriu s'i binte udha këtej, prandaj asnjeri s'ja turbullonte. Në ujë fytyra e tij dukej e shtrembër, dhëmbët si shata dhe sytë të fryrë e të enj-tur. Inatosej përsëri me shëmtimin që i bënte uji dhe e zhyste fytyrën në të e gëlltiste gllënka të mëdha, si pa ngopje. Ujërat i kullonin nëpër mjekër e në qimet e kra-hërorit. Ngrihej, fshinte buzët me pëllëmbë dhe psherëtinte.

Njëherë, Batua kishte lëshuar gomarin azat nëpër livadh dhe kafsha e ngratë, kishte futur kokën në burim. Deliu, që kosiste jonxhë, e pa së largu, ju lëshua në pikë të vrapit dhe i hyri gomarit me shqelma. «Derr, o derr!» — bërtiste.

Pranvera e sivjetme ju duk Deliut e mbarë. Dheu ishte mbuluar me lulet e bardha të kumbullave. «Vetëm mos i gënjejë pemët... — mendonte me ankth. — Vetëm mos i gënjejë dhe mbetemi pa raki. Se rakia na duhet. Do të martojmë Servetin sivjet. Do fati, martojmë edhe Bilbilin. Po të rronte Salikua, do ta dinim si do të vinte pranvera. «Pranvera do të jetë e mbarë dhe brymëra s'do të ketë», do të thoshte. Kur s'rrojti edhe ca Salikua i gjorë...»

Ra të flinte herët. As që u zhvesh fare. Hyri nën jor-gan me gjithë rrobe. Gruaja ju avit dyshekut si mace dhe i hoqi çorapet. Dheu i ngjeshur pas pllazeve u thërrmua në dysheme. Deliu u kthye në krahun tjetër dhe u grind.

— Dulja dërgoi fjalë. Do të vijë nesër mbrëma — tha gruaja.

— Mirë, mirë... — murmuriti ai dhe u mbështoll me jorgan. — Thuaj Abazit t'ja këputë kokën këndežit!

Dhe fjeti.

Të nesërmen, porsa do të dilte në udhë, vuri re Gjonin që u dha në fund të livadheve, hipur në një kalë të bardhë. Deliu kishte ca mendime mjaft të ngatërruara për Gjonin. Mirë, në fshat e donin. Qëkur erdhi ai kryetar, s'kishte më hatëre. Pastaj, fjalën e kishte të ëmbël dhe ishte njeri behar ditë e natë. Aq i qeshur, sa s'të bëhej t'i besoje. Deliu tërë jetën kishte besuar te burrat e vrazhdë, hijerëndë e fjalëplumb, që i mbajnë kyçur buzëqeshjet e tyre. Sikur të mos ishte ai, që sollti «vijat e verdha», Deliu mund ta donte. Dhe kur të donte Deliu, mund të bëhej copë për ty. Mirëpo, posa erdhi ai, erdhën edhe urdhëra për ato të mallëkuara «vija të verdha» dhe ai s'do ta kuptonte kurrë ç'punë kishin ato në fshatin e tyre. S'do ta pranonte kurrë që strehët e çatisë së një tjetri të rridhnin në truallin e tij, dhe nga dritaret ta përgjonin sy të huaj. Kjo ishte përbuzje për gjithshka kishin lënë amanet të vjetrit e oxhakut të tij, stërgjyshët dhe gjyshët, babai Taip e vëllai Saliko. Ishte njëlloj si të harroje amanetet e tyre. Dhe amanetin s'e tret dheu. Jo, s'e tret.

Kur pa Gjonin, Deliu deshi t'ja mbushte mendjen vetes se atij i ra udha rastësisht, sido që i çërriti për drejt. «Kushedi ç'djall urdhër mund të sjellë ky! Mund të urdhërojë, sepse s'është kot së koti kryetar!»

Tërhoqi opingat bran nëpër bar. Vesa i lagu thembrat e këmbëve që i kishte jashtë çorapeve të grisura, si vezë të verdha, po ai s'ndjeu gjë. Doli nga lesa e kopshtit. Gjoni zbriti kalin dhe e lidhi kapistrën pas gardhit. Kali futi kokën në barin e ri të mezhdës dhe këputi me ëndje një gojë bar. Deliu vuri re se si shkurtuhej bari e se si kullonin jargët e kalit.

— Mirë mëngjez, o Deli — tha Gjoni.

— Shyqyr që urdhëruat një herë edhe në konakët tanë, or shoku kryetar — tha Deliu. — U bënë dy vjet që je këtu dhe s'na e ke parë prakun!

— Do të vijmë kur të kesh gëzime! — tha ai.

— Gazi dhe helmi janë njësoj. Duan njerëz — i hodhi një thumb të largët Deliu.

— Kur vdiq Salikua, s'u ndodha këtu. Isha në qytet — tha Gjoni.

— S'e dija.

— Po edhe sot, puna më pruri. Më thanë se je sharr-xhi i vjetër dhe e njeh qerestenë. Erdha për një mendje...

— Kot thonë more... — u përtyp Deliu, po gjithsesi i erdhi mirë që goxha kryetar kishte ardhur të merrte mendje prej tij. Dhe ashtu, rrëmbimthi, ju kujtua se kishin mbetur në gjerdhet e trojeve të tij dhe kështu nuk e donte zakoni, prandaj nxitoi ta ftonte brenda «sa për një kupë dhallë». Po Gjoni tha se s'kishte nge dhe u ul në mezhdën e llazhdyer nga vesa, pastaj u ngrit menjëherë dhe fshiu pantallonat.

«Ka ndonjë hall, pa nuk i ze bytha vend» — mendoi Deliu.

— Unë s'para marr vesh nga punët e drurit — tha Gjoni. — Kur bëmë shtëpinë e Batos, ma preu mendja që qeresteja e shtëpisë së vjetër nuk do të hynte në punë, andaj i vumë qerestenë e re, që patëm në plan. Kështu u ngutëm dhe tani mbetëm në diell, se shteti s'ja ka ngenë të na japë qereste saherë të hapim gojën. Thashë, pa të shohim njëherë me usta Deliun, ç'mund të ketë trarë të mirë në atë gërmadhë.

— Vonë u kujtove. Tërë dimrin, ç'ra jashtë, ra edhe brenda aty, se çatia pikonte e vinte jaz.

— Vonë, vërtet — u pikëllua Gjoni.

— Po prapë, mund të hedhim një sy. Do të marr pas edhe Bilbilin, se vetë s'hipi dot në trarët e çatisë.

— Atij po ja le zanatin? — deshi të bënte shaka Gjoni.

— Kush do, e merr zanatin vetë — tha ai me inat.

Nuk i pëlqeu që të tjerët besonin se tamam djalit të tij dhe jo atyre të Salikos apo të Abazit po ja mësonte Deliu zanatin e sharxhiut të qerestesë.

Shtëpia e Batos ishte mbushur me pezhishka, sikur kishte vjete e pabanuar.

— E dini një gjë? — tha Bilbili. — Këtu është një kope me lakuriqë nate.

Dhe menjëherë kafshoi gjuhën.

«Prit tani kur të pyesë xhaxha Deliu. Jo po kur i ke parë ti lakuriqët e natës, jo po ç'ke dashur natën në shtëpitë e braktisura». Po Deliu nuk e kishte mendjen aty. Vente e vinte gjatë një trari të dyshemesë dhe e godiste me mykën e sqeparit, pastaj e qëllonte dy-tri herë me presë dhe vërente drurin.

— Po tani ku janë? — pyeti me naivitet Gjoni.

— Kush? — tha Bilbili.

— Ata, lakuriqët e natës?

— Janë fshehur nëpër hatulla — pëshpëriti Bilbili dhe i erdhi për të qeshur që s'e dinte goxha kryetar, që lakuriqët e natës nuk lëvizin ditën. Po u kujtua që Gjoni ishte qytetar dhe në qytet s'kishte lakuriqë me siguri.

— Ky tra, s'bën — tha Deliu. — E ka brejtur krimbi. Le që shumica e trarëve qenkan prej ahu — shtoi me përbuzje.

— S'jemi aq të pasur, do të zgjedhim — tha Gjoni. — Kemi mbetur në fill dhe shtëpia e Kasos do të na mbetet përgjysmë.

— Pse s'prisni qereste në pyll? — tha Deliu.

— Se s'kemi në plan. S'na jep damkë pyjorja.

— Njëherë s'kishte gjëra të tilla. Jo plani, jo damka. Deshe qereste, i futeshe pyllit dhe hə... Dhe vetëm po të ishe dorëthatë si Batua mund të bëje qereste të tillë.

— Njëherë ishin ndryshe shumë gjëra. Njëherë kër-ciste edhe pushka fis më fis dhe pleqtë i bënë shtëpitë kulla, një të shtënë pushke larg. Mirëpo tani të gjithë i bëjnë shtëpitë shpinë më shpinë.

— Pse ashtu, apo që të kenë muret ngrohtë? — u tall Deliu.

— Të kenë ngrohtë njerëzit — tha Gjoni.

— Aha... njerëzit! Ama edhe unë, or kryetar! Paskam qenë i trashë deri më sot! E dija që shëndoshë pylli dhe krahët, pa dimri bëhet i ngrohtë për njeriun, mirëpo ja ç'na qenka tani!

— Trarët e çatisë më duken të mirë — thirri që la-

Bilbili. Kish shaluar një tra të zi dhe lëkundej për qejf.

— Kujdes! — u alarmua Gjoni. Deliu s'e prishi gjakun.

— A këndojnë? — pyeti.

— Këndojnë, këndojnë. Dëgjo! — tha Bilbili dhe i selloi traut me mykë. Zbrazësia e murrme e shtëpisë dha një kumbim që u shurdhuan nëpër mure dhe Deliu rrahu ajrin me pëllëmbë, i mërztur.

— S'dëgjohet, jo. Po ti vëri veshin mirë! Ku të shurdhohet zëri, ciflose dhe shiko, se thellë është krimbi. More vesh?

— Hë... hë... — tha Bilbili dhe u kacavjerr në një tra tjetër.

— Na duhet shumë qereste, shumë — psherëtiu Gjoni.

— Pse? — pyeti Deliu. — Mos do të bëni gjë zyra të reja?

— Do të bëjmë shtëpi kulture...

— Ç'e do!? Harxhe të kota — tha Deliu.

— Do të bëjmë edhe shtëpi të reja. Familjet këtu janë shumë të mëdha dhe do të vijë dita që vëllezërit të ndahen. Dhe kur të ndahen, do të duan shtëpi më vete. Kështu po e sjell koha.

Deliut ju bë sikur ky njeri besonte me kokëfortësi sikur, ja që nesër, gjithë djemuria, nën çdo kulm, do të dilnin e do të iknin prej familjeve të tyre, sikur ta kishin bërë me fjalë. Kjo ishte aq e pabesueshme për Deliu, saqë i erdhi keq për atë burrë, goxha kryetar, që përralliste gjepura kësisoj. Heshti një copëherë dhe pastaj u murrëtye i tëri. U bë i zyrtë, rrudhat ju shtuan dhe e qepi gojën. Jo, s'mund të ishin gjepura. Se ai ishte kryetar. Fjala e tij peshonte dhe rinia s'para ja ka për pesë pleqërisë tani. Jo atij, doemos, po të tjerëve. Atyre humbësirave, që futen në fjalën «të tjerët». S'foli. Po të fliste, do të bubullonte e do të zihej me Gjonin. Se, ju ndez prapë mëria për vijat e verdha që donin të mbyllnin në darën e tyre gjithë fshatin. Po të fliste, fjala do të priste si thikë. Po a s'ishin thika edhe fjalët e atij njeriu? Të ndaheshin vëllezërit! Të ndaheshin djemtë! Pse? Ky s'kupton asgjë dhe do të na marrë më qafë, medoemos. Atë çast e urrate

sikur një mëdyshje e dyshim i fshehtë e bënin që të për-
gjonte diçka, një zhurmë të largët e të panjohur, që për
të tjerët ishte asgjë. Pastaj gjallërohej, shkundej dhe ni-
sej me ngut sikur porsa kish lexuar në qitapin e udhës, të
shkruar nga këmbët e dhenve, atë që duhej të bënte.

Deliu e pa së largu dhe doli ta priste. Dhentë ju shty-
në nëpër këmbë në shtegun e tyre dhe u futën në stallë.
Deliu i mori torbën dhe e la ta kapërcente i pari prakun.
Në heshtje, u sheshuan këmbëkryq mbi postet e zeza të
dhive. I ardhuri kishte trup të vogël e të kruspullosur
dhe rrinte i palëvizur, si hejbe. Pastaj u shtriq. Koskat
i krisën. Deliu nxori kutinë e duhanit.

— Ë? — tha Deliu.

Dulja u përtyp dhe u gëlltit.

— Do allahu dhe një ditë bëhen të gjitha. Mos u së-
këlldis, se secili e ka kismetin të shkruar — tha ai.

— Një ditë — tha Deliu. — Mirëpo ditët s'kanë fund
dhe rrokullisen shpejt.

— Ne po lodhemi për mirë — tha ai. — S'duam që të
ngatërrohen krundet me pahun e miellit. Ti s'mund ta
dish sa zor është të gjesh sot nuse të mirë. Bota po merr
huqe dita me ditën. Asgjë tjetër, vetëm huqe. Fisi juaj
është i shquar e i madh, po rinisë i është bërë mendja
hekurudhë. Çupave u është hapur syri filxhan. Filxhan u
është bërë. Dhe burrave, zemra bakër nga dëshpërimi. Se
s'janë të gjithë Delj Gjëkë. Ç'të them? Po vdes burrëria.
Burrëria s'është më mbi shalë të kalit, as në kocaqe jo,
ka zbritur te bishti. Serveti juaj është xhevahir. Xheva-
hir i rrallë është Serveti. S'është për të thënë, po a e di
ti ç'më thanë aty te Kaçulët, në Vidhas? Ata janë larg botës,
në humbje të zezë, më thanë. Kush mbyllet me kukuvajkat?
Çupat duan të martohen fushës. Kurse fushës ka plasur
sevdaja sheshit. Larg qoftë!

— Ti e di më mirë, or mik — psherëtiu Deliu i pikë-
lluar. — Po unë e kam një brengë të madhe për djalin, se
po i shkon mosha. Dhe sa më shumë i shkon, aq më i hesh-
tur bëhet, sikur ka kyçur brenda në shpirt një mëri e një
dëshpërim pamasë dhe prite kur të teptisë ndonjë ditë
jashtë, si gjëmë e zezë.

— Po ti mos u pikëllo ashtu, jalla! Mos! — tha Dulja.
— Paçka se bota po shpështillet keq dhe fijet janë ngatërruar, ta ka gjetur një nuse Dulja, ta ka gjetur...

Deliu seç pat vetëvetiu një dridhje e një dyshim dhe nuk e ndjeu dot gjithë atë gëzim që priste të ndjente kur të dëgjonte këtë lajm. Përkundrazi, gëzimi ju zbyth në një qoshe dhe tërë mendjen ja pushtoi një dyshim i egër.

— Po pse ma tjerr kaq gjatë e s'ma thua që në fillim?
— tha ai.

— Si të të them? — tha Dulja dhe vari kokën e kroi veshin me thua. — Sepse nusja e ka një cen të vogël. O, jo kushedi çë, jo! Njerën këmbë pakëz më të shkurtër, po ja, aq sa s'vihet re. Prandaj. Sa për fisin... ç'të të them? Derë e parë.

— Ku? — tha Deliu.

— Në Dudës.

— Ku?

— Përtej, thellë. Matanë lumit, nga Skrapari.

— S'e kam dëgjuar.

— Ç'e do? A s'ke besim tek unë?

— Kam.

— Ja, kështu. Unë s'të shtrëngoj. Ti mendohu. Po dije, është zor të të vijë nuse këtu.

— Serveti është... është si lis!

— Asllan është! Dhe i urtë, shqerrë! Dhe ty s'ta prish kurrë! Do ti, puna mbarohet! Ata edhe mund të paguajnë.

— Mos më zerë para në gojë! Mos më zerë! Dëgjove?

— Mirë. Tjetër hall ke ti. Ama, e thotë edhe fjala, s'ka insan pa noksan. Dije edhe këtë.

Dules ju këput koka mbi gjoksin e futur brenda, si dërrasë e brejtur dhe nga lodhja e nga rakia që pinin i erdhi gjumë. Deliu i erdhi keq kur e pa ashtu, një grusht njeri. E pat munduar shumë duke e dërguar fshat më fshat. Vërtet, çdo njeri ka zanatin e tij dhe gjithë krahina s'kishte mbles më dorëmbarë se ky, por tani ky ishte shkërmoqur shumë, si një kalli i harruar në një arë të pakorrur që hedh mbi tokën si çerep, kot më kot, kokrrat e tij dhe mbetet ashtu, i zbrazët e i lehtë, derisa e shkelin këmbët e bagëtive. Kështu. Ishte drobitur ky njeri nga vjetët, lodh-

ja, rrugët e hallet e botës dhe prandaj koka i ishte vajisur edhe më.

— Të mos ishte për ty, që të kam mik, s'ja hyja kësaj valleje. S'më bëjnë këllqet më — u zgjua ai, sikur e kish-te nuhatur keqardhjen e Deliu.

— Të paçim! — tha Deliu. — Ty të kemi pasur dhe të kemi.

— Me djemtë e tjerë do ta kemi kollaj. Serveti vjen ca i leshtë dhe i avashëm. Ka marrë nga Salikua. Andaj s'para e pëlqejnë njerëzia. Kur të vijë sëra e Bilbilit, do të bëhem edhe një herë djalë. Copë do të bëhem. . .

— Të paçim! A ta shtrojmë darkën? — pyeti me zë të ulët Deliu, sikur po bënte një faj që prishte zakonin.

— Shtro, shtro — tha Dulja. — Jam lodhur dhe dua të fle.

Darkën e hëngrën të tre, me Abazin. Abazi s'fliste. Mban-te erë bajgë të freskët, se posa ishte kthyer nga hauret, po asnjërit s'i vajti mendja aty, sepse asnjëri s'ndjeu gjë. Zjarrri po shuhej. Kërcisnin lugët në misurin prej balte. Dulja ra të flinte. Deliu ndenji edhe një copë herë në dhomën e miqve. Gojën e kishte pelin të hidhur dhe nga vreri bëri të dridhte një cigare. Duart e ashpra, gdhë, ju drodhën dhe duhani ju derdh përdhe. S'i kishte bërë vaki kurrë kjo. Deliu s'i bëhej të besonte se ishin të tija ato duar që dridheshin, s'i bëhej të besonte se kjo mund të ishte pleqëria. Jo, kjo s'mund të ishte pleqëria, sepse ajo s'është si nata, që vjen menjëherë pas ditës. Kjo ishte një brengë e panjohur, e errët dhe e thellë, si guvë. Sepse ai do të martonte tani djemtë e tij. Të gjithë ishin djemtë e tij. Edhe Serveti i Salikos, edhe Kuçua i Abazit. Të gjithë. Dhe ai duhej t'i martonte. Pse s'kishte ardhur më parë kjo brengë vallë? Atëhere kur vinin e kërkonin çapat e tyre? Pse? A, po! Dihet! Tanimë nuk shkojnë njerëz nga kulmi ynë, po vijnë! Vijnë njerëz të panjohur! Nuset! Kush shkon, udhë e mbarë! Kush vjen... mirëseardhtë, në e ka këmbën e mbarë! Ato do t'i zgjidhte Dulja. Ja, do të vinte së shpejti ajo nga Dudësi. Ajo që çalon pakëz, sa mezi duket. Pakëz. Fundja, s'ka insan pa noksan, s'ka. Dhe do të vinin edhe net të tjera, si kjo nata e sotme.

Brenga e tij do të dendësohej. A do t'i dridhej më dora dhe a do t'i binte duhani përdhe?

Kur u gdhi, i dha mushkën Dules dhe ai i hipi pa daië nga oborri.

— Po ky, ç'deshi? — e pyeti Bilbili që po shkonte në livadh, me kosë në sup.

Deliu u murrëtye dhe u mat t'i këpuste një të sharë mirë, po s'i bëri zemra të grindej sot që kishte vendosur për fejesën e Servetit.

— Servetit i gjetëm nuse! — tha. — Do të të gjejmë edhe ty. Me ty do ta kemi kollaj, sepse Serveti vjen pak i leshtë dhe. . .

«Ptu! — pështyu vrerin e gjelbër të duhanit. — Ç'po them ashtu?» — Dhe iku duke hequr zvarrë opingat.

Bilbili ndoqi me sy shpinën e tij të kërrusur dhe ja dha gazit, sikur e shponte elbi.

Serveti është i humbur. Për nder, mirë thonë që është pak leshko. Këtë nuk e kisha besuar, se, ndonëse i mbyllur, po është thëngjill i mbuluar ai. Kujt ja thoshin, mua? Hm... Po tani u muar vesh që paska qenë humbësirë. Si, ore, s'çau kokën fare ta dijë ç'është e si është kjo nuse? Unë u zura. I thashë: «Ti je njëqind vjet prapa, me Turqinë!» Ai qeshte si budalla. «E di xhaxhai këtë gjë» — thosh. Ptu! Unë, or vëlla, s'e bëj dot një gjë të tillë. Kurrë. Pse, ku jemi? Derr në thes, s'ka! Dhe xhaxha Deliu, po të dojë, le të inatoset. Apo jo? Le që unë do të marr... Hm! Ç'jam ngrysur larg edhe unë! Një, dy dhe aty më vete mendja, sikur më ka hedhur trutë e gomarit, siç thonë. Ja, edhe dje, tërë ditën, kështu... Nxirrnim trarë nga shtëpia e Batos, bashkë me Servetin. Ai s'e kishte mendjen fare në punë. Unë, ca më keq. Për nder, gjesh ramë thes e përdhe nga trarët e çatisë. Mirë Servetin që e shponte elbi i nuses, po mua, ç'ne?

Më vinin në mendje, varg e varg, të gjitha kujtimet e kësaj shtëpie, që tani po bëhej gërmadhë. Më vinin në mend ato mbrëmje të dimrit, kur dëbora ngrinte dhe bëhej

e fortë, sa të mbante përsipër, kur dëbora kërciste nën këmbë dhe mua më dukej sikur kjo zhurmë i ngjante shumë përtypjes së krëndit prej dhive, kur kolovega lëmohej nga sajat dhe bëhej akull dhe kur hëna dridhej e shëmtohej në akullin e kolovegës e bëhej si kungull i gjatë dhe ne rrëshqisnim përmbi faqet e saj të verdha. Ja, atëhere dilte Nija nga porta. Këmbët e saj nuk ndiheshin fare, sepse Nija mbathte pllaze të trasha, të arnuara me shajak. Ajo vinte si hije dhe thosh: «O Bilbil, a do të më marrësh edhe mua në sajë?»

Eh! ç'kohë ishin ato! Ç'dimra ishin! Dimri ishte i tëri yni. Askush s'na e merrte dot dimrin dhe askujt, askush s'na e trazonte kolovegën dhe hënën dhe gjithë atë botë që ishte e qetë, e verdhë, tërë fshehtësira... Kurse tani.

Punuam deri në mbrëmje. Serveti zbriti në luginë, në kryesi. Unë ndenja mbi trarët që i kishim vënë sërë. Çatia ishte zbuluar edhe më dhe nëpër të çarat e patavrave dukej qielli i natës, sterrë i zi. Kamaret dhe mazgallat nxinin si xhepa të hapur në errësirë dhe unë merrja me mend se si ishin mbushur ata xhepa plot me lakuriqë nate, se si dilnin tani lakuriqët në heshtje dhe e varnin trupin poshtë, si çorape të zeza. Dhe, saherë që përfytyroja lakuriqët, më dukej se çdo gjë që braktisej e mbetej shkretë, pushtohej ngadalë prej ushtrisë së tyre të padukshme që furfurinte nëpër ajër me krahët e gjatë. Nganjëherë, unë jam i çuditshëm. Filloj e harrohem pas një gjëje, mendja nis e më bredh poshtë e lart dhe vetëvetiu vijnë e më bëhen pamje të ndryshme dhe kujtime. Atëhere dua të kem njeri pranë dhe t'ja rrëfej të gjitha ato që më rrjedhin në gjuhën e mendjes si mjalti në hoje, po kjo është e pamundur sepse, kur jam me njeri tjetër, s'flas dot kurrrë kështu si me veten time, dhe mendimet vijnë e më shkurtohen.

Ç'do të bëhej sikur të vinte një natë kur edhe shtëpinë tonë të madhe ta zinte ushtria e lakuriqëve të natës që do të dilnin nga guvat e errëta të pyllit? Ata do të gëzoheshin që gjetën një shtëpi kaq të madhe.

U vonova atë natë. U përmenda kur pashë se kishte

dalë hëna dhe ca gulshe drite të venitur u varën nëpër të çarat e çatisë. Hëna ishte e madhe. Te ne gjithmonë ka një hënë të madhe dhe më të ndezur. Kam vënë re se në qytet hëna duket e vogël, e zbetë dhe e pluhurosur. Pse vallë?

U ngrita dhe bëra të dilja. Te praku më vajtën sytë në nja dy sende të hedhura përdhe. Ishin fletore. I kish-te hedhur Serveti kur kontrollonte kamaret. I mora. Fletët ishin të lagura e të ngjitura nga muli. Në kapak, nën dritën e hënës, lexohej «Fletorja e punëve praktike në ekonominë shtëpiake». Emri i nxënësit: Nije Shkurtaç.

Nije!

M'u bë sikur një zë i ulët përshpëriti kështu te kop-shti me kumbulla të egra.

Nije!

Dhe u drodha i tëri! Ndofta kisha pëshpëritur vetë, padashur! Ej dreq! Ç'turp! Ç'është kjo kështu, vallë? Mos është dashuria? Ni... Dashuria? Sikur të ishte kjo dashuria! Sikur të ishte tani edhe Nija aty, nën hijen e errët të kumbullave! Dheu është bërë lëndinë dhe bari është rritur. Unë do t'i thosha: Nije, a do të martohesh me mua? Se xhaxha Deliu, pas Servetit, e ka syrin tek unë, Nije. Ai do të ftojë prapë Dulen, atë plakushin e gjorë dhe do t'i thotë të gjejë një nuse për mua. Dhe ai do të trapitë fshat më fshat, si lypsarët dhe do të nderë dorën «Një nuse për Bilbilin», do të thotë. «Kush ka një nuse për Bilbilin e Deli Gjokës?» Kurse, po të duash ti, Nije, unë mund t'i them: «Këput zverkun prapa diellit, o Dule, se unë e kam gjetur vetë nusen». Po të duash ti... Po ti... s'do? Ke frikë? Edhe unë kam frikë. Prej kujt kam frikë? Ku ta di unë, Nije? Prej xhaxha Delikut, prej Batos, prej kushëririt tënd, Kasemit, që është sekretari i rinisë. Prej fjalës dashuri.

Jo... sonte s'kam frikë as prej dreqit. Copë të bëhet. Pse, mos do bubullojë qielli, kur të të them ashtu? Ç'do të bësh ti? Ku ta di unë? Ndofta do të ulësh kokën dhe do të ikësh. Me siguri. Po unë s'të ndahem. Derisa të flasësh edhe ti. Nuk do ta bëj më si pardje, kur të takova aty, te shtegu që të shpie në vatër të kulturës. Nën

mollën e Pajos, mban mend? Ishte më të ngrysur dhe ti shkoje në shtëpi. Unë të thashë:

«Pse s'vjen ndonjëherë nga shtëpia e vjetër, Nije?

«Ç'të dua?» — the ti. «Aty s'ka më asgjësend».

«S'të merr malli?»

Ti u mendove.

«S'e di», the. «Ndofta edhe më merr».

«Po për kolovegën?

«U... u... edhe ti! Po atëhere ne ishim të vegjël!»

«Unë kam qenë në shtëpinë tuaj».

«Vërtet? Si është bërë ajo tani?»

«Po rrënohet. Dhe e kanë zënë lakuriqët e natës. Ësh-të mbushur citë me lakuriqë».

«Ua... sa qejf! Po gorrica ka lidhur shumë sivjet?»

«Ka lidhur. Do të vish të mbledhësh, në vjeshtë?»

«Do të vij...»

«Edhe unë...»

«Mirë»

«Nije!..»

«Ua.. sa u ngrysi!» — the ti. «Kur erdhi nata kaq shpejt? Ika unë, se...»

...«se? Ç'do të thoshe pas asaj,... se... ti, Nije?»

— Ngrihuni, bërtiti Deliu! Ngrihuni, se kaptoi nata!

Të katër djemtë, që flinin njëri pranë tjetrit, u shtrigën të përgjumur dhe murmuritën me mërzi. Deliu priti një hop. po aq ishte, mjaft që ata të kridheshin prapë në gjumë. Kuçua nisi të gërhiste.

— Ngrehu, derr! — tha Deliu dhe e shtyu me këmbë.

Kuçua ndenji më bythë dhe fërkoj sytë. Ishte errët.

— Ç'është? — tha ai.

— Do të nisemi — tha Deliu. — Si ju zu gjumi, more!? Për kë po vjen drita këtu, për mua, a?

S'e kuptonte, në kishte fjetur apo jo atë natë Deliu. Ndofta edhe kishte fjetur, po «gjumë të atillë, mos bëfsha kurrë,» mendoi. Çdo çast i dukej sikur ishte zgjuar, ngrihej e bariste zbathur nëpër dhomë dhe nxirrte kryet

nga dritarja e vërente qiellin, në lindje. Qielli ishte i vrejtur. Asgjë s'lëvizte. Yje s'kish, as hënë s'kish. Pështynte dhe shtriqej. «Duhet blerë një orë me zile — mendonte. — S'është punë, kjo!» Kur ju duk sikur po hapej përtej një dritë e mugët, zgjoi Abazin. Abazi s'bëri zë, zbriti në haajat dhe po merrej me fenerin.

Djemtë u ngritën hundë e buzë.

— Ç'na zgjove që tani, o xhaxha? — tha Serveti.

— Nuk është shpejt jo — tha ai. — Është vrejtur sot dhe s'merret vesh mirë kur gdhihet.

Që të gjashtë u varën tatëpjetë shtegut me nxitim. Kuços s'i kishte dalë gjumi mirë dhe e hiqte kazmën zvarrë nëpër dhe.

— Mbaje në sup, dembel — shau Deliu. Kuçua, si i trembur, vuri bishtin mbi sup.

Po t'i kishin thënë ca vjet më parë që në shtëpinë e tyre do të vinte drita elektrike, Deliu nuk do të ishte çuditur aq shumë, sepse rrallë çuditej ai, po edhe as që do të gëzohej si sot. «Eh... — do të thoshte me vete. — Ç'na ka gjetur ne që u rritëm me pishë dhe me vajguri? Asgjë s'na ka gjetur. Drita është për natën, kurse nata na duhet për gjumë.»

Kur na qenka nata për gjumë, ç'duhet kjo dritë? Po tani ndryshonte puna. Ai ishte aq i gëzuar, sa i kishin lindur papritur edhe shumë shqetësime. Durimi, anëtar kryesie, i kishte thënë si fshehurazi. «Dëgjo, kryetar Gjoni tha në kryesi: «e dini sa do të na kushtojë elektrifikimi i shtëpisë së Gjokëve? Aq sa t'i ndërtojmë një shtëpi të re». Po ti mos u tund. Ti kërkoje» — i kishte thënë ai. «Kërkoje, të thotë truthari! Po ku ta kërkoshe?» Dhe s'kishte folur. E kishte mbyllur brenda atë shqetësim. As Abazit s'ja kishte thënë. Vetëm po të rronte Salikua, atij po! Nganjëherë, i vinte turp për frikën e tij, sepse ai e dinte që ky ishte një vendim i madh dhe në të përfshihej edhe shtëpia e tij. Po gjene, ku dihet? Tërë ujërat në burim janë të kulluara, po turbullohen më poshtë. Kush dreqin e di ç'mund të ngatërrojë ky Gjoni? Le, po të hiqet edhe si mik! Të kërkon këshilla për qerestën!.. Kurse dri-

ta duhej të vinte. Ajo do t'i lidhte edhe më djemtë me atë shtëpi.

Mbrëmë ishte sqaruar çdo gjë. Deliu kishte zbritur në qendër për një punë dhe aty, Gjoni i kishte thënë: «Nesër, dilni të gjithë, se do hapim gropat e shtyllave për linjën që do të vijë te ju.»

Kur zbritën në luginë, s'regëtinte asnjë dritë gjëkund. Fshati flinte. Djemtë u ulën në ca gurë të mbledhur togje, anës lumit. Lumi kishte shterrur e kishte mbetur një vijë. Llumi ishte çarë thela-thela, si pjepër.

— Ishalla bie një shi — tha Abazi.

— Si për shi duket — tha Deliu.

— Po të rronte xha Salikua, do ta dinim — psherëtiu Abazi.

— Dihet ajo — tha Deliu.

Bilbili kafshoi buzët, që të mos qeshte.

— A, o xhaxha — u ankua Kuçua. — Ç'ma prishe gjumin në një vend të ëmbël, që ç'të të them!

— Hë, zagar — tha Deliu.

Rrallëherë ndodhte që Deliu të bënte shakara me djemtë dhe, kur ndodhte kjo, do të thoshte se ai kishte një gëzim aq të madh, sa s'mund ta mbyllte dot, sado që të mudohej. Dhe gëzimi, vetëvetiu diku do t'i shpërthente, si një burim që del nëntokë dhe do ta gjejë medoemos një udhë ku të rrjedhë nëpër damarët e dheut.

— Hë... zagar i djallit — tha prapë — Pa na trego!

— Bah! po s'tregohet dot ajo, o xhaxha! Aq e ëmbël ishte! A, ç'më bëre, ç'më bëre!

Nga gjithë djemtë Kuçua ishte i vetmi që dinte t'ja zbuste zemërimin xhaxha Deliu.

— Hy... gremisu — tha Abazi. — Duheni martuar ju, djaj, po ç'të bëjmë që na ka zënë rrota bishtin.

Shkoi edhe një copë herë sa zbardhi. Kuçua e zgjidhi thesin dhe zuri të këpuste shakara. Ashtu i gjeti Gjoni dhe dy elektrikistët që kishin ardhur nga qyteti. Të dy ishin djem të rinj. Njëri, flokëdrudhë e i parruar, si korb, ja nisi bisedës me djemtë sikur të ishin ndarë mbrëmë. Tjetri, flokëverdhtë, s'fliste dhe ju duk Deliut serioz. «Ky duhet të jetë përgjegjësi», mendoi. Mirëpo doli që asnjëri s'ishte

përgjegjës dhe kjo gjë i çuditi pakëz atë dhe Abazin.

— Ku është shtëpia? — pyeti zeshkani.

— Larg... mu në humbje të zezë është — tha Gjoni.
— Nja pesë a gjashtë kilometra që këtu.

«Dreq! — mendoi Deliu. — Këta duan ta nxjerrin gjetiu fjalën, se këtë gjë duhet ta kishin biseduar më parë. Që duan të dalin në një shteg, dihet ajo, po, pa të mbajmë veshët bigë! Apo më mirë të mos flas fare? Më mirë të mos flas. Le t'i bien teneqesë ata. Aq më bën. Drita të vijë. Dihet!»

— Më parë, të përcaktojmë marshrutin e linjës! — tha flokëverdhi.

— Ç'thotë ky, more? — e pyeti Abazi me zë të ulët.

— Punë për ta — tha Deliu. — Ti dëgjo dhe hesht!

— E bëjmë kështu — tha Gjoni. — Petriti dhe një nga djemtë të shkojnë shtegut dhe të venë kunjat, të tjerët, pas tyre, për gropat. Si thua ti, Deli?

— Ju e dini — tha Deliu.

— Kështu po e bëjmë — tha Gjoni.

Elektriçisti flokëverdhe me Servetin shkuan përpara. Tjetri vuri dorën mbi vetulla, si strehë, sepse kishte dalë dielli.

— Po të ngjitemi në atë kodër, a duket shtëpia? — pyeti ai.

— Po ç'të duhet shtëpia? — tha Deliu.

— Që të vërejmë udhën. Mund të gjejmë udhë më të shkurtër për linjën.

— S'duket, jo — tha Gjoni. — Shtëpia është fshehur rrëzë pyllit, në një rrah. Ja, nën atë dendësi të pyllit, ku duket pisha...

— Po ç'djall qenkeni futur në atë vrimë? — pyeti elektriçisti.

Deliu ishte mërzhitur dhe e gjithë biseda ju duk e kotë, prandaj deshi t'i bënte bisht.

— Ndiqni shtegun, se s'ka udhë më të shkurtër! Ata që e kanë hapur shtegun, s'kanë qenë budallenj!

— Pse s'më thua, ç'kërkuat deri aty? — nguli këmbë elektriçisti.

— E po... aty e gjetën për më mirë stërgjyshët tanë
— hyri në fjalë Bilbili.

Deliu i hodhi të birit një nga ato vështrimet e zakonshme që ja qepnin gojën, mirëpo këtë herë Bilbili u shtri si guak, gjoja sikur s'kuptoi gjë dhe vërshëlleu.

— Vend më të mirë se ai s'ka gjëkund, sa të mban syri — tha Abazi.

— Mundet, po është larg qendrës — tha elektrikisti.
— Pse nuk zbrisni edhe ju në luginë?

«Këtë e ka kurdisur Gjoni, pa llototit kështu. Ai e ka vënë, për besë», mendoi Deliu.

— Se aty kemi shtëpinë tonë. Ç'të kërkojmë në luginë?
— u çudit Abazi.

— Ne mund t'ju ngremë shtëpi të re — tha Gjoni.
— Aq sa kushton linja elektrike, aq kushton edhe një shtëpi e re. E dini këtë?

— E ku ta dimë? — tha Deliu. — Ju i dini të gjitha, se rrini me laps në vesh. Në qenka ashtu, ç'e sillni fare dritën? dhe blojti nga inati me vete: «Po ç'më hëngri gjuha që e thashë — këtë?» — mendoi.

— Ç'thua ashtu, or xhaxha? — tha Kuçua. — Si do të mos e sjellin? Ky është vendim i Partisë, e di apo jo?

— Edhe në majë të malit të ishe, ne do të ta sillnim — tha elektrikisti.

— E di, e di. Mua m'i rrëfen ato? — tha Deliu. — Po më vjen inat me këtë Gjonin, se në një vrimë i bie fyellit! Ngaqë e ha malli për ne, pa ja ka ënda të na mbledhë në një vend e të na ketë në sy? Mirëpo halli që ne s'jemi as Hysë as Shkurtaç! Ne jemi Gjokë. Dhe shtëpia jonë është shkëmb i fortë. Pa, edhe në u vajjshin muret e në u kalbshin trarët, duart s'na janë tharë. Dhe jemi, shqyr, një stan. Aty kemi varret e pleqve dhe të vëllezërve. Aty na ka rënë koka, dhe duam që aty të na bjerë prapë, kur të vdesim. Si të vdesim ne, zjarri i rëntë. Megjithëse ku i dihet? Mund të ndërrojë shumë bota. Ka pasur njëherë tri kulme dhe mund të bëhen prapë tri.

Deliut i ishte fryrë një damar i vogël në tëmth dhe Gjoni vuri re se si rrihte ai me rrëmbim. E pa të udhës të mos fliste më me të dhe pas pak shkoi me elektrikistin.

Nisën të hapnin gropat. Deliu u lodh shpejt dhe zuri të shfrynte. Kështu i ndodhte saherë i prishej gjaku. I binte kazmës me inat, mirëpo Bilbili e hiqte sakaq dheun me lopatë dhe priste.

— Nema kazmën mua — tha Bilbili.

— Mirë, merre — u pajtua ai. — Thirr edhe Kuçon, se na qëlloi dhe i fortë. Apo ta lëvizim ca më tej kunjën?

— Jo, s'bën — tha Bilbili i sigurt.

— E po, lere atëhere.

— Kemi për të vuajtur deri në shtëpi — tha Bilbili.

— E çë? Puna për njeriun është. Kur të vijë drita, do ta kemi mirë. Do të blemë radio. Thonë se radiot ta sjellin botën në shtëpi. Ti rri aty në kllanik dhe dëgjon ditë e natë...

— Bota s'është një radio, o xhaxha — tha Bilbili.

— Po ç'është, sipas teje? — u nxeh Deliu.

— Bota janë njerëzit... Për nder, andej nga jugu, ku isha ushtar, të zinte meraku me fshatrat. Mbledhur brinjë më brinjë, njëra afër tjetrës shtëpitë, kurse ne cep me cep, si kaçakët.

— Pusho! Ç'e keqe të gjeti ty? Asgjë! Shtëpi më vete, varr më vete, thonë. Po ç'djall shtëpie ma quan atë kur të numron fqinji kafshoret nga dritarja, dhe gjen belanë se të hyjnë në meranë tënde bagëti e fqinjit? Pastaj, ne s'jemi pak, jemi vetë një fshat i vogël. Dhe do të shtohemi. Dëgjove? Mua ma do zemra të mos ndaheni kurrë. Nesër unë bie e vdes, do të vdesë edhe xhaxha Abazi. Ma thotë zemra që fisin do ta drejtosh ti, paçka se je pas Servetit me moshë! Edhe unë, i dyti isha. Serveti vjen i avashëm, kurse ti...

— E po si? stan me dhen do të bëhemi në ata konakë, o xhaxha?

Deliut i shkrepri kazma në gur e ju hodh përpjetë. I dhembti krahu. Ju morën këmbët dhe do të ishte rrëzuar sikur mos e përfshinte Bilbili për mesi.

— Mbahu — tha ai. — Ç'pate?

— Ç'të të pëlcastin, qen! Ti do të më gërryesh eshtrat, më duket! Me këto mend që më ke, s'ke për të bërë hair! Po, sa rroj unë, këmbë s'ke për të lëvizur! Dëgjove? Pastaj, plas në vend...

— Mirë, de, mirë. Ç'të thashë që u inatose kaq? —
tha Bilbili.

Deliu i sëlloi prapë dheut dhe kazma u ngul deri në
myke. Shkëputi një plis të rëndë...

Mbrëmë, gjumi s'deshi të vinte me mua. Më vinte
inat me veten time, që s'isha aq i zoti sa të shtrihesha si
përnatë dhe të mposhtja ngadalë errësirën, heshtjen dhe
pastaj gjumin. Vërtitesha sikur më hanin pleshta dhe dërra-
sat e dyshemesë kërcisnin. Servetit i mbanin këmbët erë të
thartë, kurse Faiku grindej nëpër ëndërr e gërhiste. Unë
nduka dy herë buzët si cinxër, dhe ai pushoi, po u zgjua
Kuçua, që kishte gjumë të lehtë...

— Ç'ke? — tha ai.

— Hiç. S'më flihet — thashë.

— Numro gjer më njëqind. Dhe mos lëviz në të errët,
se do qorrollisesh!

S'fola më dhe dola në ballkon. Ballkoni ynë ishte prej
druri, i vjetër e gati më të këputur. Nata ishte e përhime
dhe turbull, dukeshin kurrizet e maleve. Pylli nxinte dhe
fëshfërinte nga era. Ç'ndodhi kështu me mua? mendova.
Po Nija? Fle vallë sonte, apo është mbledhur kruspull nën
jorgan dhe mendohet? Jo, ajo s'fle. S'mund të flerë. Gjumi
ynë bredh dorë për dorë sonte. Dhe thotë: le të mos fle-
në sonte ata. Ama, unë s'e prisja të ndodhte kaq shpejt
dhe kështu. Po ja, vjen rasti dhe...

Pardje, në të errur, ne u takuam padashur, tamam në
atë shteg, nën arrën e Pajos, ku e gjeta edhe një herë tje-
tër. Ju bie ndër mend? Nejse. Kishim mbledhjen e rinisë
pardje, po mua m'u shkrep të zbrisja shpejt në luginë.
Bridhja shtegut kot më kot. Ju do të thoni që s'bridhja
kot, sepse e dija që në atë shteg vinte ajo. Mirë, xhanëm,
këtë e dija, po ama s'mund ta dija që do të vinte vetëm.
Apo jo? Le që vërtet, ajo s'ishte vetëm, po me Kasemin,
mirëpo, për fat, Kasemin e takoi instruktori i zonës dhe
mbetëm më pas.

— Po ti?.. — thashë unë.

— Në mbledhje. Harrove? — tha ajo.

— Jo.

Unë s'dija ç'ti thosha më.

— E di — tha befas ajo. — Nesër do të vijmë në shtëpinë e vjetër, të mbledhim gorricën.

— Kur?

— Ndajnatëherë.

— Vetëm do të vish?

— Si? Vetëm? Pse vetëm? Jo, jo. Me Nushin.

— Aha...

— Po ti... do të vish?

— Po të duash ti...

— Mirë.

U dëgjuan hapat e nxituar të Kasemit dhe ajo iku shpejt. Kasemi më pa shtrembër. Ç'budalla ë? Le, po është edhe sekretar... Na kishte vënë re që shkëmbyem dy, tri fjallë dhe tani s'dinte ç'të thosh. «Po ti... po ti, ç'paske ardhur?» — tha. «Për mbledhje» — thashë unë.

Dje e lashë punën shpejt. Ama, më dukej sikur e dinin që të gjithë që unë do të veja të mblidhja gorrica dhe më përgjonin. Desha të dilja fshehurazi dhe ashtu, gjoja sikur bridhja kot, ja mbajta nga gjerdhet e bëra të zija një shteg që ishte hapur. Po, se ku më pa Sanija, motra ime e vogël dhe m'u qep pas. Ajo është katërmbëdhjetë vjeçe, po duket më e vogël, se ka qenë shëndetligë dhe për hiçmosgjë qan. Megjithëse s'është më e vogël, në shtëpi i flasin dhe e urdhërojnë si fëmijë. Ajo s'bën zë, po ama brehet në vetëvete dhe qan fshehurazi, prandaj unë e dua më shumë.

— Ku do të vesh ashtu? — tha ajo.

— Asgjëkundi — gënjeva unë.

— Po çantën pse e ke marrë me vete?

Hë, ta marrë e mira. Harrova që kisha marrë me vete çantën ushtarake.

— Do të vete të mbledh gorrica te Shkurtajt — i thashë.

— Të vij edhe unë? tha dhe sytë i shkëlqyen.

— Jo, jo. Rri këtu ti, se të shan xhaxhai. Rri, pa të sjell unë sa të duash.

Ajo përplasi këmbët dhe m'u shkreh.

— Më sillke ti, posi! Sikur jam e vogël unë! Po të dua, marr edhe vetë! — Ktheu shpinën. Supet i tundeshin nga ngashërimet, dhe me siguri do të qante sa të enjtej. Një lëmsh m'u mblodh edhe mua në grykë. S'mund ta merrja, apo jo? Mirë bëra që s'e mora se, po të ishte ajo... ne s'do të mbeteshim asnjë çast vetëm me Nijen.

Kur erdhën Nija me Nushin, unë e kisha dredhur një herë gorricën dhe lëndina zverdhte.

— Ore... po ti e paske dredhur të gjithë... — tha Nushi i pikëlluar.

— Jo, jo. Kam lënë ca degë në majë, se aty s'ma mban-te të hipja — thashë.

— Zbrit, hajt! — tha ai. — Gorrica është jona! Dhe bëj sehir se si shkundet!

Nushi deshi të hiqej si i madh në moshë, paçka që por-sa kishte mbaruar tetëvjeçaren. Ama, u kacavjerr mirë dhe hipi në majë. Nija u tremb:

— I i... Zbrit, Nush, se mos biesh! — tha ajo.

— Hë, moj, mos më çaj kokën! Mblidh ti dhe mbushi torbat, atë bëj!

Ne u ulëm dhe nisëm të mblidhnim. Kishte shumë vjet që unë s'kisha qenë kaq afër me Nijen. Që kur vinte në kolovegë. Nija atëhere ishte një vajzë e vogël me gërsheta dhe flokët i mbanin erë sapun. Dhe s'kishte frikë fare. Kurse mbrëmë, sepse trembej, gishtat i dridheshin dhe mezi i zinte gorricat. Nushi i dha një të dredhur të fortë, kokrrat na ranë si breshër në shpinë e në kokë dhe Nija qeshi tërë qejf.

— Eja mbledhim nën shtogun, se aty nuk na zenë kokrrat — thashë unë...

— Eja — tha ajo.

Ne vajtëm nën shtog. Shtogu ishte në ledh dhe fletët e tij bënin hije të murrme. Kur do të ngrysej?

Ne s'flisnim. Asaj i dridheshin gishtërinjtë, sikur mër-dhihte dhe, saherë i binin kokrrat, guguriste. Unë e përgjoja me bishtin e syrit. Flokët i kishte mbledhur. Në gushë i

rrihte një damar. Ishte skuqur. Nganjëherë, kafshonte ndonjë kokërr.

— Shiko mos hash ndonjë krimb — thashë unë.

— Bobo! Sa paskemi për të mbledhur — tha ajo. — T'i them Nushit të zbresë, se ndryshe do të ngrÿsemi këtu.

— Po ti... lere ta shkundë mirë, se pastaj vijnë e hanë të tjerët — thashë unë.

— Ka këtu edhe për...

Asaj i mbeti fjala në grykë, sikur i kaciti. E hoqi dorën sikur kish zënë thëngjill. Duart tona kishin prekur njëra-tjetrën. Por, padashur ama, ta dini! Sytë ju trembën dhe m'u duk sikur tha pse?

— Mban mend kur i vinim gorricat në sanë? — thashë unë.

— Mbaj... — tha ajo.

— Sa mirë zhungeshin aty, ë?..

— Po.

— Pse e mbani mbyllur plevicën e barit?

— Se kemi sanën aty. Sa të ujdísim plevicën e re, do ta heqim.

— Eja të vemë një torbë gorrica në sanë... — thashë unë, befás.

— O i! — tha ajo. — Po kur t'i marrim?

— Në fund të vjeshtës, kur të ngrini sanën.

— Mirë thua — tha ajo. — Dale t'i them edhe Nushit, se ai e ka çelësin. — Ajo ju afrua tringut të gorricës dhe thirri:

— O Nush! A të fusim gorrica në plevicë?

— Pse? — bërtiti ai që nga maja.

— Se nuk i shpiem dot gjithë këto. I lemi aty që të zhungen.

— Shpini nga dy torba, se ja, po vij edhe unë — tha ai dhe hodhi çelësin. Ne nxituam ngarkuar me torbat. Asgjë s'më shkonte ndër mend, jo. Po ju s'më besoni. Dhe e keqja është se askush s'të beson po t'ja thuash, po thonë: me qëllim, me qëllim. . . Po ç'ne? Ja, Nushi po zbriste dhe pas pak do të ishte në plevicë. Në plevicë mbante erë të mirë rigoni të egër dhe zhumbricë.

— E mban mend? — thashë. — Në atë qoshe i fshihnim atëhere. Bëjmë një fole në bar?

Dhe prapë duart tona e gjetën njëra-tjetrën. Asaj i digjeshin shumë dhe unë e pashë në sy. Ajo uli kokën, po dorën nuk e hoqi, sepse më duket se nuk ja lëshoja unë.

— O Nije — thashë.

— Ç'do? — tha ajo.

— O Nije — thashë unë. — Desha t'i them «të!» po gjuha m'u lidh dhe thashë: — Servetin e fejuam!

— E di — tha ajo. — Të bukur e ka nusen?

— S'e di! — thashë unë. — S'e kam parë!

— Sa keq!

— Pse?

— Që... asnjeri s'e ka parë.

— Keq! — thashë edhe unë. — Xhaxhai më thotë që... tani e kam radhën unë.

— Ti?

— Po, unë... Ama unë s'jam leshko. Unë do ta gjej nusen vetë — thashë. — Do ta gjej këtu në fshat — i thashë.

— Në fshat?! — tha ajo dhe dora ju drodh.

— Po... Unë do të të kërkoj ty.

— Pse? — belbëzoi ajo.

— Sepse, nuk e di ti? Sepse unë të dua shumë...

Unë vura dorën mbi flokët e saj të ashpër dhe ja afrova faqen në buzët e mia dhe e putha.

— Oi... — klithi ajo. — Po vjen Nushi! — dhe doli te dera e plevicës. Nushi kishte zbritur dhe po mbathte opingat.

— Unë do të të kërkoj ty — thashë. — Dhe pastaj, ne do të zbresim në luginë dhe do të bëjmë një shtëpi të re. Ç'të duam më këtu në pyll? Mirë?

— Unë vij me ty, ku të duash — tha ajo, dhe u skuq. — Edhe në fund të botës po të jetë, vij!

Pastaj erdhi Nushi. Ja kaq. Ama, ato fjalë «edhe në fund të botës vij» Nija do t'i kishte lexuar në ndonjë roman, patjetër. Se, lexojnë ato shejtanka vajza, dhe i shkojnë librat dorë më dorë. Neve djemve s'na mbetet kohë që...

Bre!.. po ç'pata që i thashë se do të zbrisnim në luginë?

Tani që erdhi drita, s'kishim për të zbritur kurrë. Ku të le xhaxha Deliu? A mos i thashë se kisha frikë vallë pranonte, meqë ne jemi më larg se të gjithë tani? Ku ta dish? A nuk i thoshte Dulja xhaxha Deliut, se s'duan të vijnë këtu vajzat.?

Nata sikur po zbardhej. Do të dilte hëna. Mërdhiha. Po syri s'më desh gjumë.

Hëna doli dhe në mes të lëndinave u ngritën, të shtrembra e të ronitura muret e shtëpisë së Nijas.

A flinte Nija vallë?

Në luginë ishte errësirë. Hëna dilte më vonë aty, se e pengonin malet.

Ndenja derisa kodrat, livadhet, arat e korrura dhe përrenjtë u shtrinë me radhë të flinin nën hënë. Njëherë më vajti mendja edhe në hatullat e shtëpisë së vjetër dhe te lakuriqët e natës.

Por... a flinte vallë Nija sonte?

Kuajt shtynin njëri-tjetrin me vithe dhe mezi u vunë në udhë. Në lindje, thellë, dridhej Ylli i Karvanit. Hëna kishte perënduar dhe tufat e errësirës shtynin njëra-tjetrën e zbrisnin mbi shtretët e përrenjve. Lëndinat dhe rrëpirat e maleve ishin kredhur në një dritë të hirtë që po endej fije-fije sikur shpështillej lëmshi i agullimës së kaltër të mëngjezit.

Kuajt pengoheshin nëpër gurë dhe shfrynin avuj. Qetësia e zgavrave dhe guvave të pyllit u tremb nga zilet dhe u struk. Asnjëri s'fliste. Shtrati i përroit ishte i thatë dhe potkonjtë shkrepnin xixa. Dukej sikur disa hije mudo-heshin të zinin zjarr me masat, po më kot, se gurët e strallit s'bënin dot flakë dhe nata xixëllonte përsëri sikur shpupurisheshin thënjijtë e një zjarri më të shuar. Kishte kohë që udha binte nëpër shtratin e thatë të përroit. Binin fletët e drurëve, duke u dredhur nëpër ajër, sikur mërdhihnin. Kuajt zgjatnin qafën e djersitur nëpër fijet e barit, anës shtegut, po frerët i shtrëngonin me kokëfortësi dhe ata, të pajtuar me frerët, tundnin kokën e rëndë poshtë e lart, poshtë e lart... Ata i mërzhiste heshtja e rëndë e njerëzve.

Kur udha binte në ndonjë lëndinë, era e athët e barit të fundit që kish radhën të kalbej ua ngacmonte flegrat dhe ata zgjatnin përsëri drejt barit qafën e gjatë dhe përsëri kalorësit u shtrëngonin frerët dhe fshiknin ajrin me fshikujt prej thuprash.

S'kishte të gdhirë kjo natë, ky qiell pus mbi thellësitë, kjo heshtje.

Dhe ishte dasmë. Kalorësit ishin dasmorë.

Vetëm kur u ngjiten në qafë, zagushia e dendur e përrroit sikur u tret nëpër greminën blu të qiellit dhe qielli nisi t'i pinte yjet një nga një. Dasmorët psherëtinë si të lehtësuar nga një brengë dhe zbritën kuajt. Bilbili vuri pëllëmbën mbi vithet e kalit që kishte hipur dhe ajo ju njom me djersë, sikur ta kish shkuar dorën nëpër vesën e barit. Kali uli kokën dhe këputi një gojë bar. Kruup...

— Sa larg është ky Dudësi, o xhaxha? — tha ai.

Abazi, që ja kishte hequr samarin kalit dhe po i shih-te një plagë, lëvizi supet poshtë, sikur shkarkoi një barrë dhe bëri sikur llogariste diçka me mend. Bilbili e dinte që as ai, asnjëri tjetër nga fisi i tyre s'kishin qenë kurrë në Dudës, bile as që e kishin dëgjuar këtë fshat. Përveç atij njeriut të pakët që kalëronte në krye të vargut me një peshqir tërë yndyrë lidhur pas qafe, askush nuk e dinte më parë që kishte në botë një Dudës dhe që kishte aty një nuse për Servetin. Ai edhe mund të mos pyeste, mirëpo heshtja e gjatë e topitëse u ishte ngjitur tërë udhës si rrodhe dhe ai çuditej se përse asnjëri s'kishte dashur të fliste, dhe të gjithë bënin sikur dremisnin. Atij i bëhej sikur secili priste që të fliste diçka Dulja, po ai s'thoshte gjë dhe andaj heshtja pleksej, dridhej, zgjatej e bëhej tërkuzë.

— Nuk është larg, jo — tha Abazi. — Pas mëngjezit, aty afër drekës, do të sosim...

— Po ti, ke qenë ndonjëherë? — pyeti Bilbili.

— Kam qenë aty afër... — tha Abazi.

Aj e dinte që Abazi gënjente. E kishte ditur këtë qëkur e pyeti. Abazi mbahej sikur dinte çdo gjë dhe me asgjë s'mund ta çudisje. Bilbilit i pëlqente të dëgjonte se si i thurte gënjeshttrat xhaxha Abazi, mirëpo këtë herë ai seç nuhati një thumb të fshehtë në ato pyetje të kota të nipit dhe u

zbyth prej tij e ju avit Dules. Dukej që e pyeste për diçka. Pastaj e arriti prapë dhe i tha:

— Karshi Dudësit, është një fshat i madh që i thonë Orek. Matanë lumit Osum. Ti duhet ta dish, se je me shkollë.

— S'mbaj mend — tha Bilbili.

— E po... kush të ka faj? Ti gjithnjë s'ke mbajtur mend, se mezi i kaloje klasët.

Abazi gënjente përsëri, po ai nuk u inatos. Bile i erdhi për të qeshur.

— E di ç'mbaj mend unë? — tha. — Mbaj mend që orët e para më zinte gjumi mbi bangë.

— Nga dembellëku — tha Abazi.

— Jo, nga lodhja — tha ai. — Shkolla ishte një orë e gjysmë larg nesh.

— Mirë, mirë. Mjaft tani, se më shastise — tha Abazi dhe iku.

Megjithëse ishte vjeshtë e vonë, afër drekës, shtrëngoi vapa. Vendi ishte gur dhe malet ishin gollashë. Ende dëgjohej çërri.

— Ja, andej përtej malit është fshati — tha Abazi dhe bëri një shenjë të dyshimtë që përfshiu tërë hapësirën e maleve.

— Erdhëm si në përrallat e xhaxha Salikos... — tha Bilbili. — Larg e larg mërguar, tri male kaptuar.

— Më mirë. Ky ishte fat për ne — tha Abazi.

— Pse?

— Ti s'kupton gjë — tha ai. — Ti nuk e di as këtë, që krushqia sjell krushqinë. Se, ju erdhi radha ty, Kuços, Faikut.

— Të gjithë këtu do t'i marrim nuset?

Abazi dyzoi dhe heshti. Pastaj, sikur kish marrë një vendim me rëndësi, tha:

— Dëgjo! Me ty mund të bisedojmë si burra, se e bëre ushtrinë. A e di ti që xhaxhai ka tre vjet që kërkon nuse për Servetin dhe s'gjen dot? A e di ti?

— E di — tha ai.

— E ku e di ti? — u çudit Abazi.

— Unë e di edhe përse nuk gjen dot.

— Jo more! Të punoka mendja si mulli ty!

— Nuk gjen, sepse asnjë vajze s'i pëlqen t'rrrojë në karakollin tonë që ruan pyllin, ta dish. Se vajzave u janë hapur sytë dhe u pëlqen të kenë fqinjë njerëz e jo kukuvajka.

— E pse kukuvajka, a s'më thua? Ne jemi fis i madh dhe me nder. Kur u martuam ne, kush nuk jepte nuse në Gjokajt? Ta them që ta dish.

Bilbili s'foli më. Çudi, mendoj. Ne jemi shumë njerëz. po prapë, pse më duket aq e madhe dhe e zbrazur shtëpia? Pse më duket heshtja aq pa fund, saqë diçka më shtrëngon në fyt? Vërtet ne s'gjejmë nuse sepse... rroj-më aty, apo? Jo, jo. Kur vjen puna me mblesëri. mund që ke një pengesë. Po jo për mua, ë? Atij ju kujtua përsëri Nija. Nijen e kishte kujtuar gjithë udhës. Nija, që pëshpëriti atëhere «me ty vij në fund të botës». Nija, që i kishte gjetur ato fjalë nëpër libra. Nija, të cilën e përkëdhelte vetëm me sy, sepse s'vinte më rasti që të mbeteshin të dy. Nija që...

Kuajt avullonin. Ai ndjeu erën e djersës së kuajve që ishte trazuar me ajrin e udhës dhe prej saj ajri ishte trashur e ishte bërë i lyrshëm.

Në malet gollashë bari ishte i përzhitur dhe i shkurtër, sikur e kishin ngrënë gojët e një kopeje të padukshme. Mirëpo atë e hante vetëm kopeja e zhuritur për ujë e rrezeve të diellit dhe prandaj, në këtë vend pa pyje, s'kishte më vjeshtë e pranverë, po vetëm verë dhe dimër. Gjithshka ju duk e shkretë. Po ndofta s'ishte ashtu. Ndofta udha e gjatë dhe lodhja, erërat e ndenjura dhe ndryshimi i fortë i natyrës midis pyllit dhe skërkës të sillnin në mendje ndjenjën e trishtimit e shkretisë?

Shpoi kalin me thembër dhe u avit në krye të vargut, ku kalëronte Dulja. Trupi i tij i vogël mbi pelën e bardhë, bojallie, e bënte të dukej si një gjeraq hipur mbi shalë. Lëkundej si i përgjumur, të thuash se do të kaptonte mbi qafën e pelës dhe do të gremisej. Po ai s'gremisej dhe Bilbili vuri re se si gishtërinjtë e thatë me lesh të thinjur ishin ngjitur pas samarit si gjemba rro-

dhesh dhe këmbët ishin bërë një me brinjët e pelës. Murmuriste me vete sikur përtypte bukë të thekur.

Në të hyrë të fshatit, Dulja bëri shenjë të zbrisnin e të fshinin pluhurin. Kuajt i lidhën në një lëmë dhe u vunë torbat me tagji.

Gjithë ceremonia e marrjes së nuses u bë si me përtesë, sepse të gjithë ishin si të mpirë. Pinë raki të butë e si të ngrohur në diell dhe ca njerëz ja morën një kënge. Kënga thosh se si u mbush molla plot me lule të bardha dhe se si fryu era e i rrëzoi asaj shaminë. Bilbili bëri të përfytyronte se si ja rrëzonte era shaminë nuses së Servetit. Nusja ishte llangosur me bojë të bardhë dhe me vura të kuqe nëpër faqet. Atij ju duk e mërzitur, e thatë dhe e shkretë si skërka. E hipën në kalë. Përmbi shalën e kalit skuqte si gjak i piksur levenxa dhe thekët e saj ishin ngjitur pas qimeve të kalit. Vonë në mbrëmje u kthye në shtëpi.

Veç Deliut, asnjëri s'e kishte ditur që nusja çalonte. Serveti s'shikonte asgjë dhe ngjyra e fytyrës i ndërrohej për minutë. Bilbili vuri re se si shtrëngonte grushtet aq, sa i zbardheshin gishtërinjtë.

Dulja hoqi peshqirin nga qafa, hyri në odën e miqve dhe ja mori një kënge me iso. Pastaj erdhën mysafirët dhe të gjithë i harruan edhe nusen, edhe Servetin. Rakia gurgullonte dhe era e mishit të pjekur mbushi dhomat. Deliu e pa të birin që rrinte në një qoshe dhe ju shkreh:

— Po ti... ç'më rri ashtu i ngrysur? Ti s'duhet të rrish ashtu, se kemi dasmë!

— Jam i lodhur — tha Bilbili.

— Jo, gënjen — bërtiti Deliu. — Pusho! E di unë se përse gënjen ti, derr! Nusja është e mirë! E çë se çalon pakëz? Njeri është! Punën ta bëjë të drejtë, pa le të ecë shtrembër! Serveti s'tha gjë! Ti, ç'do? Ty, s'do të të ndodhë ashtu, jo! I kam dhënë Dules para dhe ai ka nisur të gjurmojë për ty, kështu që në pranverë... Dëgjove?

— Merrja ato para, merrja! Jepi utujagat atij su-r-rati, baba! Se mos e ndriti Servetin!

— Pusho! Ti je aguridhe! Nejse. Shko njëherë andej nga piqen mishrat!

— Merrja paratë — nguli këmbë Bilbili. — Se unë do ta gjej vetë nusen!

Deliu bëri sikur s'dëgjoi. Nuk zgjidhte dot një gjë sot ai: përse i kishte thënë baba e jo xhaxha si gjithnjë? Dhe a i pëlqente apo s'i pëlqente ky djall, me ato që bënte e që thosh? Që ja kthente fjalën, dihej, por... edhe që ishte i zgjuar dhe s'ja hante kollaj qeni shkopin, dihej edhe kjo. Si të bënte Deliu me të?

Pa kohë, ende pa u rrëzuar fletët e skuqura të aheve, erdhi dimri. Ai erdhi qetësisht, brenda një nate të vetme, si një udhëtar që pritet të vijë dikur dhe që, kur vjen, nuk troket, po hyn tinëz në shtrojet e bëra gati qëkur. Retë ishin rënduar e varur mbi brinjët e maleve që ditën dhe, posa u fikën vështrimet e dritareve të shtëpisë, zunë të bienin mijëra flokë të rëndë e të lagët. Dëborra shtroi shpejt. Pas një jave, udha e luginës u zu për kafshët dhe shtegu shënohej tani vetëm nga gjurmët e njerëzve. Udhën e kishte hapur Serveti dhe çapet i kishte bërë larg e larg, si i xhindosur.

Një mëngjez, Sanija u gdhi e sëmurë. Ankohej nga një dhembje e fortë në bark dhe e ëma i zjeu lule basani. Deri në mbrëmje s'ja vuri veshin njeri dhe ajo ndenji shtrirë në dyshek, anës zjarrit. Natën, u bë më keq dhe dhimbjet ju bënë aq të forta, sa përpëlitej si zog.

— Ç'ke ngrënë, të marrtë djalli? — tha Deliu. — E? Pse s'flet?

Vajza rënkoj dhe nga dhimbjet i rrodhën lot.

— Veri ndonjë gjë të ngrohtë në bark — tha Deliu dhe shkoi në dhomën tjetër. Kishte filluar të binte përsëri dëborë. Nusja e Servetit vërtitej si hije në korridor e nëpër shkallë, me fshesë.

— Po kjo e fshirë natën, ç'është? — u grind Abazi. Po Deliu nuk ju bë krah. Ai e donte nusen. Qëkur kishte ardhur, i kishte thënë apo jo tri fjalë bashkë, po kjo gjë nuk e çudiste, në mos e gëzonte. Para se të shtrihej për të fjetur, ai hyri prapë në dhomën ku dergjej e bija.

Gruaja nuk e kishte nderur dritën dhe në gjysmerrë-sirën tërë hije të gjata prej flakëve të zjarrit, fytyra e vajzës ju duk e tretur, e mpirë dhe e mavijosur nga të ftohtët.

— Ç'thotë? — pyeti.

— Sikur u qetësua — tha gruaja.

— Veri zjarrit dru, që mos mërdhijë! — tha ai.

Bilbili, që vërtitej nëpër dhomë me duar në xhepa, ju afrua shtratit dhe u përkul më gjunjë. Vajza hapi sytë dhe e pa me ca sy të mëdhenj që pyesnin diçka pa kuptim. Ai ktheu kokën.

— Mërdhijë? — pyeti.

Vajza mbylli sytë.

— Është bërë si dru — tha e ëma.

— Deri nesër, do të shërohesh — tha Deliu dhe doli jashtë. Në korridor ndjeu hapat e të birit pas shpine.

— Ajo s'është mirë, baba — psherëtiu ai.

«Është e dyta herë që më thotë baba — mendoj Deliu.

— Një herë kur pa nusen e Servetit, dhe tani...»

— Sëmundjet për njeriun janë, — tha Deliu. — Ajo është e pakët dhe mezi u bën ballë.

— Duhet të thërrasim mjekun — tha Bilbili.

— Nesër. Ku të vemë tani?

— Unë do të vete.

— Kush tundet të vijë në këtë dimër dhe në këtë natë, ë? Edhe telefoni nuk duhet të punojë, se telat do të jenë këputur nga dëbora — tha Deliu. Bilbili doli në ballkon. Era ja përplasi dëborën në fytyrë dhe i hyri në gjoksin e hapur. Ai ndjeu se si e shkriu dëborën ngrohtësia e trupit të tij. S'pipëtinte gjë. U drodh. Hyri përsëri në dhomën ku dergjej Sanija.

— Fjeti? — pyeti ai.

— Jo — tha nëna.

— Po pse rrini në të errët — u inatos ai. — Kush ju thotë kështu?

— Pse të digjet drita kot? — tha nëna. Ai hapi çelësin. Sytë e Sanijes tani ju dukën më të mëdhenj, çuditërisht të mëdhenj dhe lutës, sikur do të shpërthënin pas

një çasti në lot. Ai mbylli derën me forcë dhe ndezi fenerin. Deliu zgjati kryet te dera.

— Ku vete?

— Do të shkoj — tha ai. — Do të zbres në luginë.

— Merr edhe çiften — tha Deliu dhe mbylli derën.

Doli në errësirë, gjeti shtegun dhe u nis. Deri në luginë ai mund të zbriste me sy mbyllur, mirëpo shtegu ishte zënë dhe herë pas here fundoste thellë. Në zyrat e këshillit kishte dritë dhe digjej zjarri. Kasemi, që ishte dezurn, ja kishte marrë gjumit. Për fat, linja s'ishte këputur dhe atij i thanë që mjeku do të nisej me maqinë deri ku të mundte, pastaj do të vinte më këmbë. Bilbili mendoi se aty nga mëngjezi mjeku duhej të arrinte dhe ndenji ta priste. Vuri bërrylet mbi tryezë, mbështeti faqet mbi pëllëmbë dhe deshi të flinte.

— Mos e lërë zjarrin të shuhet — tha Kasemi. — Drutë i ke nën krevat — dhe u mbështoll me batanije. Ai u afrua te pori. Pantallonat nisën të lëshonin avull. Pastaj fjeti. U zgjua se ndjeu një rrymë ere që e ftohu në shpinë. Zjarri ishte shuar dhe posa kishte mugulluar. Mjeku erdhi më shpejt se ç'e priste ai. Merrte frymë me zor dhe pantallonat e lagura i ishin ngjitur pas shalëve.

— Ku është i sëmuri? — pyeti ai.

— Lart — tha Bilbili. — Aty!

— Keni edhe dy orë udhë të mira — tha Kasemi.

— Një e gjysmë — tha Bilbili.

— Mirë — tha mjeku. — Po nga se ankohet?

— Nga barku. Është keq!

— Pret puna sa të thajmë pak këmbët? — pyeti mjeku me drojtje. Ishte i ri, i gjatë dhe i dobët dhe ishte skuqur i tëri nga thellimi. Bilbili pa me bishtin e syrit këpucët e shkurtëra të mjekut, zgjeruar e njomur nga dëborra dhe çorapet nailon.

— Unë e lashë keq! — tha ai.

— Ç'presim atëhere? — Eja të nisemi — tha mjeku.

— Rrugës mjeku mundahej të mos mbetej prapa. Këpucët i shkisinin dhe e ndjente që mezi ngopej me ajër. Ai e dëgjonte frymëmarrjen e lodhur të mjekut dhe ma-

tej të qëndronte, por këmbët nxitonin vetëvetiu. Mjeku tashmë kishte hapur gojën dhe shfrynte. Pështyma i ishte tharë.

Mëngjezi ishte i qetë, i kthjellët dhe doli dielli. Dielli ju duk i ftohtë. Diell me dhëmbë. I vrau sytë dëborë dhe qortoi veten që i erdhi turp të merret në fshat syzet e errëta.

Shtëpia u doli përpara thujse papritur, buzë pyllit dhe ai psherëtiu i kënaqur.

— O doktor — tha djali. — Të gjithë oxhakët tymojnë ashtu, apo më bëjnë sytë?

— Të gjithë! — tha mjeku.

— Pse? — pyeti ai, dhe mjekut ju duk se diçka u këput, u drodh dhe ra thellë zërit të djaloshit.

— Por... sepse është dimër! pëshpëriti mjeku.

— Po ne s'i ndezim kurrë gjithë zjarret! — tha ai.

Mjeku s'foli. Ngriti supet. Vështroi me habi zverkun e shëndoshë të djaloshit, ku ishin ngjitur drudhat e pakrehura të flokëve të gjatë! Pastaj ju bë sikur era solli një klithmë, si një ulërimë që vinte prej pyllit. Klithma u përpëliti nëpër erë dhe humbi grykave. Djaloshi qëndroi e mbajti vesh.

— Dëgjove gjë? — pyeti ai.

— Jo! — gënjeu mjeku.

— Mua m'u bë sikur klithi dikush — tha ai.

— Jo! — gënjeu mjeku.

— Po dyert pse janë hapur kat më kat, o doktor?

— Nuk e di! Ndofta i ka hapur era — tha mjeku.

— O! — klithi ai. — Unë dëgjova. Unë e di. Ajo ka vdekur, doktor! Ka vdekur!

— Jo — nguli këmbë mjeku me një zë të pasigurt.

Befas Bilbili ja dha vrapit. Mjeku e ndoqi pas si automat, po s'mund ta arrinte më. Shkau, u rrezua dhe fshiu dëborën. I sëmbonte gjoksi dhe zemra i rrihte sikur do t'i çahet.

Në mbrëmje, mjekun e përcolli përsëri po ai djalë. Heshtnin. Koha po zbutej dhe mjeku ndjeu zagushi. Djaloshi zvarriste këmbët si i dehur.

— Eh! — psherëtiu mjeku. — Fati! Ajo s'kishte gjë

të madhe. Apendicitin kishte. Sikur të mund të venim më parë. Po shtëpia juaj ishte shumë larg!

— E di — tha rreptë ai — e di!

Mjeku ndjente tani një zgavër në gjoks. Këtë zgavër e ndjente saherë gjente vdekjen shtrirë në shtrat.

Të nesërmen, pranë varrit të Salikos, hapën varrin e Sanijes. Kishte nisur të frynte jugë dhe këtu dëu qëlloi tul, i butë. Varri u hap shpejt e shpejt.

— Mbani mend se ç'hoqëm kur hapëm varrin e Salikos? — tha një prej fshatarëve që ishte varrmihes. Kishte ngrirë dheu kallkan sikur s'donte ta qaste brenda. Kurse Sanija e gjorë e ka dheun të butë.

Gratë ja dhanë një ulërime të gjatë që u duk sikur u dynd nëpër pyll dhe humbi guvë më guvë!

Pastaj, shtëpinë buzë pyllit e pllakosi një heshtje e një trishtim që s'kish të sosur. Deliu jepte urdhëra, grindej me të gjithë, megjithëse askush s'ja bënte fjalën dy. Një mur i plevicave u rrëzua dhe ata e ngritën me duart e mardhura. Abazi dhe Serveti hipën dy herë në çati dhe qeruan dëborën. Askush nuk u shkeli tërë dimrin.

Një mbrëmje, kur ishin mbledhur të gjithë anës zjarrit, Bilbili lëshoi befaz ca fjalë, sikur i tha vetëm për veten e tij.

— O xhaxha Deli! A e di ti që, po të rronim në luginë, Sanija do të ishte sonte me ne?

Zjarri kërciste dhe oxhaku bubullonte nga tymi i shumtë që viltë në qiellin e zi të natës.

— Pse merresh me të vdekurit? Ajo aq e kishte të shkruar — tha Deliu.

— Aq ja shkruam ne — tha Bilbili.

Deliu kërceu më këmbë, i hakërryer dhe përplasi këmbët në dysheme.

— Hesht! gjidi derr! Hesht, të them!

Bilbili sikur ngriu një hop, pastaj u ngrit qetësisht dhe doli jashtë.

Të nesërmen Deliu ju duk sikur dëborë mbi çati ishte trashur prapë dhe, ngaqë mërzia e shtynte të merrrej me ndonjë gjë, hapi baxhën, hipi mbi trarët dhe nisi t'i provonte me sqepar. Ai e dinte që kjo ishte një

punë e kotë, sepse çatia s'pikonte dhe trarët ishin ata që kishin qenë në vjeshtë, mirëpo ai desh të harrohej në një punë çfarëdo. I godiste njërin pas tjetrit me mykë dhe mbante vesh. Çatia mbushej me këngën e tyre të vjetër e të bukur. Vetëm karina e madhe e pishës jepte prapë një zë tjetër, si më të shurdhër se më parë.

Ju kujtua vajza e vogël, Sanija. Ju kujtua se si ju shua ngadalë përmes dënesave zëri i dobët e i hollë, sikur binte e humbiste nëpër qilare dhe vetëvetiu u ngashërye.

Zbriti dhe doli jashtë. I biri qëronte udhën e plevicave me lopatë.

Khaxha Deliu është zemëruar me mua që atë natë kur i thashë «aq ja shkruam ne, Sanijes»... Ndofta bëra jabim. Sigurisht, kujt nuk i erdhi keq për Sanijen? Po pse thashë ashtu?

E gjora Sanije! Pse nuk e mora atë ndajnatëherë, kur m'u lut të vinte me mua për të mbledhur gorrica, pse? Ndofta ajo qau tërë mbrëmjen. Kur i vinte për të qarë, ajo futej në rrugicën prapa shtëpisë, karshi stelës së qenit. Edhe atë natë ajo do ishte fshehur dhe do të kishte qarë vetëm, karshi stelës së qenit.

Qëkur ka vdekur ajo, s'më bën zemra të shkoj aty.

Khaxha Deliu më shikon shtrembër. Edhe Abazi. Duket sikur kanë një frikë të fshehtë prej meje, po s'guxojnë ta thonë këtë gjë. Tani flasim më pak në shtëpinë tonë. Na ka mbështjellë një heshtje aq e madhe, sa duket sikur secili vret mendjen për vete dhe kërkon të gjejë diçka që s'ka për ta gjetur kurrë. Secili kërkon një gëzim të vogël, po gëzimet janë arratisur prej nesh. Kur biem të flemë, heshtja jonë bashkohet me heshtjen e natës që hyn me vrap nëpër derë dhe shtrihet këmbëkryq odatave e varet nëpër trarët. Kurse, porsa gdhihet, nis e vjen vërdallë gruaja e Servetit, me fshesë në dorë. Tani shtëpia jonë rrezëllin nga pastërtia aq, sa Abazi inatoset dhe shfryn se ç'duhet gjithë kjo pastërti. Më shumë ndje-

het gërhitja e maces se sa hapi i saj. Pastaj, vjen nata dhe prapë heshtja varet nëpër trarë, si lakuriqë nate. Një ditë, kur ta braktisim këtë shtëpi, aty mund të vijmë vërtet lakuriqët dhe do të shtrihen rehat nëpër hatulla. Një ditë!

Në pranverë, ose në vjeshtë, e kam bërë në mend të marthohem me Nijen. Mund të shkoj dhe të kërkoj në kryesi që të më bëjnë një shtëpi të vogël në luginë. Po prapë, ç'të flasim për nesër?

Ja, sonte po dëgjoj se si ulërin pylli. Fryjnë erëra të trazuara dhe ai ulërin me dhembje, si një ujë i plagosur. Çudi! Gjithnjë më ishte dukur sikur pylli rënkonte nga erërat, nga netët, nga pesha e dëborërave dhe e fletëve të kalbura. Tani më duket se era ulërin nëpër vetminë e thatë të drurëve, ulërin, ulërin, ulërin...

PËRMBAJTJA E LËNDËS

	Faqe
Tregim lirik në dimër	3
Katër të panjohur	10
Heshtja.	23
Damka e rojtarëve	34
Në tren.	45
Çështja e pulave e të tjera	52
Fortesa.	60
Rrugica, mjeshtri i mandolinës dhe xhaxhai.	75
Dy që vallëzonin të dielave	85
Katër akte të provës	96
Maçoku.	115
Kapërcimi i hallkave	127
E fshehta	145
Egërsia.	156
Ajri i ftohtë i mesnatës	172
Shtëpia e lakuriqëve të natës (Novelë)	184